



ZGJIMI ISLAM NË ANDALUZINË E SOTME

DR. ALI EL-MENSUR EL-KITANI

dr. Ali el Mansur el Kitani

**ZGJIMI ISLAM NË
ANDALUZINË E SOTME**

“Zëri Ynë”

2004

Titulli i origjinalit
الصحة الإسلامية في الأندلس اليوم
جذورها ومسارها

Përkthyes:
Muhamed Jusufi
Fitim Flugaj

Recenzent:
Ajni Sinani

Bismil Lahir Rahmanir Rahim

Nga seriali i librave “Libri i Ummetit”

ZGJIMI ISLAM NË ANDALUZINË E SOTME,

RRËNJËT DHE RRJEDHAT E TIJ

I Lartëmadhëruari në Kur'anin Kerim thotë:

“Mos tregoni ligësi dhe mos u pikëlloni! Se ju gjithësesi jeni më të lartë, nëse jeni besimtarë të vërtetë. Nëse ju ka goditur juve ndonjë plagë, edhe popullin (armik) e kanë goditur aso plagë. Ato ditë, Ne, i ndërrojmë midis njerëzve (me triumf dhe disfatë) për t'i dalluar besimtarët e durueshëm dhe për t'i bërë disa nga ju dëshmorë. Se All-llahu nuk i do zullumqarët.”

(Ali Imran: 139-40)

PARATHËNJE

Nga: Omer Ubejd Hasan

Lavdi All-llahut, i Cili u tregoi besimtarëve, duke ju thënë:

“Para jush kanë kaluar (shumë popuj) e ligje. Udhëtoni nëpër botë dhe shihni si ka qenë fundi i atyre, që i kanë përgënjeshtruar pejgamberët. Këto lajme e shpjegime janë këshilla, udhërrëfyese për njerëzit besimtarë. Mos tregoni ligësi dhe mos u pikëlloni! Se ju, gjithsesi, jeni më të lartë nëse jeni besimtarë të vërtetë. Nëse ju ka goditur juve ndonjë plagë, edhe popullin (armik) e kanë goditur aso plagë. Ato ditë, Ne, i ndërrojmë midis njerëzve (me triumf dhe disfatë) për t'i dalluar besimtarët e durueshëm dhe për t'i bërë disa nga ju dëshmorë. Se Perendia nuk i do zullumqarët”¹

Kur’ani kërkon që të mos qëndrojmë në një vend, ai i nxit njerëzit të udhëtojnë, sepse lëvizjet sjellin informacione rreth historisë së popujve të mëhershëm, pra të udhëtojmë nëpër tokë, për t’a njohur të kaluarën. Kjo kërkesë është urdhëruar, prandaj duhet që ne t’a zbatojmë. Ata, të cilët kanë kërkuar njohuri, udhëzimet i kanë marrë prej traditave dhe ligjeve, me të cilat janë qeverisur popujt e mëhershëm. Shoqëritë, përvojat i marrin prej ndryshimeve, pastaj ato analizohen nga njerëzit e ditur dhe prej tyre nxirren mësimet dhe këshilla për njerëzit e tjerë. Për t’i kuptuar këto mësimet apo këshilla, këta njerëz duhet të kenë arritur një shkallë

¹ Ali Imran, 137-40, Kur’ani i Madhëruar, sipas përkthimit të Prof. Hasan I. Nahi

pjekurie, gjë që ndikon më pas, në mbjelljen e kulturës së një populli ose ummeti. Këta njerëz e forcuan imanin dhe ai shërbeu si mburojë, shumë më vonë, për ruajtjen nga zhdukja e civilizimit. Ata u kushtëzuan, më pas pësuan vuajtje të tepruara, dhe u detyruan t'i kthehen jetës së rreziqeve dhe të papriturave. Por, meqenëse kishin imanin, sjellet e tyre ishin brilante, dhe kështu arritën që, brenda civilizimit të tyre, të përpëliten deri në frymëmarrjen e sërishme, që dha shpresat e rizgimit.

Falja dhe përshëndetja i takon të dërguarit të fundit të All-llahut, shembullit tonë, i cili na paralajmëroi për hutinë kolektive, gjendjen amorfe dhe humbjet që do t'a kaplojë ummetin (komunitetin musliman). Kjo e tëra, do të vijë për shkak të mospastrimit të elemneteve të këqia, që do të futen në traditën tonë, dhe një turme njerëzish të molepsur. Muhammedi a.s. thotë: *Do t'ju sulmojnë popuj të tjerë, ashtu sikur e sulmon egërsira viktimën e vet...* I thanë: Mos vallë atë kohë do të jemi pak në numër, o i dërguari All-llahut? Tha: *Jo, ju do të jeni shumë, sikur shkuma e vërshimeve, por do t'i largoheni respektit dhe bindjes ndaj All-llahut, për t'ju afruar zemrave të armiqve tuaj, deri sa në zemrat tuaja të mbillet vehni.* I thanë: Ç'është vehni, o i dërguari All-llahut? Ai tha: *Dashuria ndaj botës dhe urrejtja e vdekjes.*

Sikur shkuma gjatë vërshimeve d.m.th., Ummeti musliman do të humbë forcën dhe vullnetin. Kjo nënkupton fitoren e armiqve dhe rënien e civilizimit... e pastaj...

Ky libër, që është pranë jush, është i 31-ti me radhë² “Zgjimi islam në Andaluzinë e sotme” të prof. dr. Ali el Mansur el Kitani dhe i përket serisë së librave “Libri i Ummetit”, të cilën e boton Qendra e Hulumtimit dhe Informimit, nën mbikqyrjen e Zyrës Ligjore dhe Çështjeve

Fetare të shtetit të Katarit. Kjo zyrë ndihmon në ngritjen e kulturës, civilizimit dhe vetëdijes muslimane. Me këtë vepër synohet kthimi i krenarisë, deri në përsosmërinë e personalitetit musliman bashkëkohor. Gjithashtu, ky libër bën nxitje për ringjalljen e Ummetit, duke përkujtuar ata të vdekur, të cilët ishin dëshmitarë të ngjarjeve dhe qeverisjeve për ringritjen e ndërtesës: *“Dhe kështu ju bëmë ummet (komunitet musliman) të mesëm për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve dhe i dërguari të dëshmojë për ju”*³

Ummeti, duhet të kuptohet se kemi të bëjmë me peshoren e drejtësisë islame. Kjo do të ndikojë që të lindin mendje të ndritura kur të largohemi nga vehni dhe shkuma. Këta duhet të jenë vazhdimisht në qëndër të vëmendjes dhe nuk duhet të pengohen, pasi janë forcë e konsiderueshme, që ndihmojnë në çdo pikëpamje, e në veçanti në lëndën e historisë. Për t’a rritur fuqinë, duhet të udhëtohet nëpër tokë dhe duhet pasur parasysh historia e përgjithshme. Ky udhëtim duhet të kryhet duke përfillur krijesat e All-llahut në mbarë universin dhe pastaj, në sajë të udhëtimeve, duhet të bëhen përpjekje për të zbuluar ligjet, forcat e organizuara dhe ngjarjet historike, të cilat ishin shkaktare të rënies së ummeteve dhe prosperiteteve, brenda historisë së përgjithshme.

Mbase ishte prej caktimeve të All-llahut xh.sh., që ky libër t’iu bashkëngjitet librave të tjerë serikë, të cilët ndoshta do të ndikojnë në rizgjim islam në Analuzinë e sotme. Ndoshta, do t’u mundësojë që, pikërisht këtë vit, t’a kapin kthesën e të rikthehen në origjinë. Pra, ky vit, është viti që përkujton 500 vjetorin e rënies së Granadës, në vitin 1492. Gjithashtu, le t’i bashkëngjitet epokës së përjetimeve të botës arabe dhe atyre islame, të cilat sot po përçmohen, po coptohen, bile edhe në shumë raste po kapitullojnë. Kjo epokë, nuk u përket të gjitha shtresave të shoqërisë, sepse në të është edhe shtresa e mbretërve dhe e klaneve, të cilët (këta të fundit) ishin shkaku i rënies së

mulimanëve në Andaluzi. Kjo ndodhi pasi që shoqëria muslimane, civilizimi dhe kultura e saj, kishte shkëlqyer për tetë shekuj. Kjo, sot, kujtohet nga historia e Spanjës apo gadishullit Pirenej, si ndarje prej lindjes, apo djepit e shkencave dhe njohurive, për t'u vazhduar, më tutje, prej europianëve.

Si duket, ishte e domosdoshme dhe e paevitueshme rënia e Andaluzisë, me qëllim që të bëhej argument për ummetin tonë. Rënia duhej të ishte pastrim: *“Këto lajme e shpjegime janë këshilla, udhrrëfyese për njerëzit besimtarë (të devotshëm që ia kanë frikën All-llahut)”*

Përderisa nuk u përfillën fjalët e All-llahut të Lartësuar, pasoi shkatërrimi. Kishim një civilizim të konsiderueshëm, ndërkohë që shteti, civilizimi i muslimanëve dhe krenaria jonë mbetën një emër në letër, duke u përçarë deri aty, sa u bënë edhe vëllavrasje. Ishte Granada, kalaja e fundit e muslimanëve, e cila nuk u dorëzua lehtë. Të gjitha parashikimet, paralajmëronin se edhe ajo nuk do të mund të qëndronte më shumë, se sa seria tjetër e kapitullimeve të qytet-shteteve të vogla të Andaluzisë. Atyre iu kishte hyrë virusi dhe po garonin se cili e kishte fronin më të “sigurtë”. Ata jetonin në sajë të bazamentit të fortë, që e kishin krijuar të parët e tyre, e s’ju mbeti gjë tjetër veçse të zhyten në grindje ndërmjet vete. Ata, aq shumë i acaruan marrëdhëniet, saqë arritën deri në atë shkallë, që i biri t’a luftonte babain, vëllai vëllanë. Kjo grindje dhe përçarje e thellë, solli si rezultat formimin e mbi njëzet minishteteve në Andaluzi. Lirisht mund të thuhet se, çdo qytet u shndërrua shtet më vete. Derisa s’ishin një fuqi, përçarjet u reflektuan dhe i prekën thellë edhe dijetarët, shkencëtarët dhe elitën në përgjithësi. Shumica e tyre, të pafuqishëm për të mbrojtur veten, nuk kishte rrugëzgjidhje tjetër, përveç migrimit. Dislokimi i tyre bëhej më shumë në krahinën e Shamit (Siria e sotme), ose edhe në Afrikën Veriore. Qeveritarët, thujase, mbetën pa elitë të mirëfilltë. Prijetarë, tani, kishin këshilltarët injorantë apo karrieristë; dijetarët që kishin mbetur ishin spostuar thuajse tërësisht. Kështu, të gjitha

institucionet mbetën pa kokat e ndritura, nuk kishte se kush t'iu përgjigjej nevojave dhe dukurive të reja, që shfaqeshin në rajonin e qytet-shteteve.

U humb barazpesha, drejtësia humbi ekuilibrin, arsimi dhe shkenca pësuan më së shumti. Tani, civilizimi po ushqehet pa komentimin e mirëfilltë të Kur'anit, apo më mirë që të mund të kuptohet, Kur'ani u spostua prej qeveritarëve. Kështu u spostua politika nga kultura, gjykata nga shkenca dhe në këtë mënyrë antivlera mbizotëroi mbi vlerën dhe natyrshëm, çdo gjë filloi të vyshket deri në mjerim.

Pas gjithë kësaj, marrim guximin për të thënë se: Shkakun kryesor i humbjes, rënies politike, prapambeturisë, shuarjes së civilizimit, dhe nëpërkëmbjes së kulturës, erdhi pa dyshim si rezultat i dy faktorëve vijues:

Pika e parë- Propaganda rreth nacionalizmit arab, dhe nacionalizmave të tjerë të lashtë. Ummeti u trondit, u përçmua, u copëtua dhe u përça ideologjikisht, derisa përçarjeve nuk iu doli era, për të mos u ribashkuar asnjëherë. Këto përçarje vazhduan, derisa nuk mbeti asnjë familje pa u prekur. Mendoj se, e sotmja që ne po përjetojmë, nuk ka nevojë për t'a sqaruar.

Pika e dytë- Sfondi i përçarjeve, vëllavrasjeve dhe humbja e civilizimit doli nga pasioni për pasuri, për sundimin e të mirave materiale me vizione afatshkurtëra, të ngutshme dhe iluzionare. Por, ajo që ishte edhe më e keqe, të gjitha këto, bëheshin në emër të parimeve islame. Ky ishte kulmi i së keqes, ngase kjo ishte "ajka e interesit". Do të ishte mirë, që për këtë të sillnim disa shembuj nga historia e hershme dhe nga e tanishmja. Do të përkujtojmë, për pak çaste, konfliktin e Mustalak-ut në kohën e Pejgamberit. Ajo ftesa e mbrapshtë, e cila desh i grindi Muhaxhirët dhe Ensarët⁴, për shkak të përparësisë së ujit. Kemi shembullin e Muhammedit s.a.v.s., se si e shëroi dhe e pastroi shpejt e mirë këtë ndytësi, duke ju

⁴ Muhaxhirë- migruesit dhe ensarë-vendasit

thënë: *“Vallë rifilloi injoranca ndërmjet jush, duke qenë unë prezent para jush? Shporreni atë, sepse ajo është e kalbur”*.

Le të na mbetet në kujtesë ky faj ose dënim i yni, për të gjitha kohërat, si për ekstremistët, ashtu edhe për të devijuarit përgjatë historisë, duke kujtuar ata që morrën pjesë në ndarjen e presë, pas betejës së Bedrit. Disa prej sahabëve⁵, këtë e kishin komentuar kështu: u grindëm aq fort, sa që për pak nuk filluam konfliktin mes nesh, dhe nuk zgjati shumë, pas pak (një viti) humbëm betejën në Uhud. Për këtë luftë, All-llahu xh.sh. na tregoi shkakun në Kur'an: *“...dikush nga ju, që dëshiroi këtë botë (të mirat e kësaj bote)”*⁶. Kur'ani mbetet i shenjtë përgjithmonë, ai është këshilluesi ynë, dëshmitar përgjatë historisë. Kështu, arritëm deri tek beteja 'Pallati Dëshmorëve' në Andaluzi. Më pas lakmuam prenë, e cila u bë shkaktar i humbjeve të muslimanëve, dhe kështu ngeci shtrirja e Islamit, në muret e Europës.

Si duket, tek ne, ende është prezent shpirti i vjetër fisnor i kohës së injorancës. Nacionalizmi i tepruar, pastaj mbyllja nëpër regjione, grindjet rreth presë, nuk kanë të ndalur ndër muslimanët e kohës. Ndërsa kur është fjala për përhapjen e fesë, na ngushtohet rrethi, grindemi për doket tona fisnore, të cilat na gllabërojnë. Kjo mënyrë e jetës, na shpuri drejt luftërave ndërmjet vete. S'do mend se e njëjta politikë vazhdon të jetë prezente edhe sot, nëpër shtetet islame, edhe pse informini, propaganda, ligjëratat dhe zëvendësimi i shteteve të vogla me emra krahinore, derisa mbeti aq pak sa tani nuk kanë mundësi tjetër pos ta mashtrojnë shoku shokun. Ajo është mendja me karakter të shpërbërë, kështu jemi në ideologji dhe politikë. Për këto veprime mesquine, kemi marrë vërejtjen e Resulullahit s.a.v.s., që në fillim të ngritjes së shtetit. Ai, menjëherë pas hixhretit⁷, arabizmin e cilësoi si nacionalizëm fisnor dhe këtë e lidhi me injorancën, pastaj

⁵ Sahabëve- shokët e Muhammedit s.a.v.s.

⁶ Kur'an, 3-Ali Imran, 152

atë e zëvendësoi me revelatën islame – vepër, e cila shkriu shumë doke fisnore dhe disa civilizime të mëdha, duke premtuar botën tjetër - ahiretin.

Pa ndonjë ekzagjerim, ideja fisnore që shkaktari i rënies së ideve politike, dhe më pastaj edhe vetë civilizimit. Shenjat e para, që ishin paraqitur atë botë në Andaluzi, si duket kanë filluar të duken çdo ditë edhe tek ne, ato janë prezente tek disa individë me reputacion tek arabët, por gjithashtu, ato nuk mungojnë edhe tek disa shoqata. Historia e Andaluzisë në jetën muslimane - ose do të mbesë në mendjet tona të shpërbëra vazhdimisht pa u humbur dhe me plagë, të cilat nuk do të pranojnë shërim; - ose gjaku do të rrjedhë vazhdimisht, sikurse në ditët e sotme, dhe gjithashtu, nuk do të lërë që historia të harrohet përgjatë kohës. Ngjarjet dhe rrjedhat, si duket s'kanë të ndalur, ato po na i rikujtojnë vuajtjet dhe dhembjet, edhe pse janë bërë shumë e shumë përpjekje për ngritjen e urave. Ato janë munduar t'i kapërcejnë edhe pa dialog, vetëm e vetëm të harrohen persekutimet. Cilat janë dobite nga e kaluara dhe cilat janë mësimet për të ardhmen, në mënyrë që njeriu të vendosë të largohet definitivisht nga mësimi historik rreth Andaluzisë? Qëllimi është mbrojtja e të tanishmes arabe dhe e relitetit islam. Por pikërisht, kjo na bën të mos dalim nga ky rreth dhe të ndahemi. Ajo çfarë po lexojmë rreth historisë së Andaluzisë, na ngjason me leximet e titujve të tanishëm, tentimimet për shpërbërjen tonë. S'ka dyshim se duket haptazi, se ummeti ynë është në krizë dhe kjo, tani, vjen nga përpjekjet për t'a zhdukur atë, por me mjete më të sofistikuar. Po të lexojmë me vëmendje, civilizimi ynë është peng i ndalesave politike, dhe kornizave kulturore. Kjo analizë ka nxjerrë në pah, se të gjitha këto ndalesa ose pengesa, fshihen nën petkun e filozofive dhe elitës sonë "superiore".

⁷ Hixhretit- migrimit të Muhammedit s.a.v.s. nga Meka për në Medinë

Sikur të lexoheshin shkrimet e historisë islame, me ndodhitë e saj të vërteta, në përgjithësi do të ishim krenarë. Por, mos të harrojmë edhe historinë andaluziane dhe veçoritë e saj, sepse ajo jep këto mesazhe:

1. Rrethanat e humbjes, shkatërrimit, shlyerjen nga kujtesa e ummetit.

2. Vendosjen në binarë, historinë e komunitetit të tanishëm dhe vënien e strategjisë për të ardhmen. Ne nuk do t'a vendosim në këto binarë vetëm Andaluzinë, por do të orvatemi të shkruajmë edhe për të tjerët. Format individuale, si edhe nëpërmjet shoqatave, do të vazhdojnë, derisa të harrohet gjendja e vuajtjeve të botës sonë dhe të fillojë të dominojë dashuria.

Ne paraqesim shkaqet tona, ato më të rrezikshmet, që shkaktuan rënien e civilizimit, thyerjen ushtarake dhe dobësimin kulturor. Nuk duhen marrë faktet historike si shembuj pesimistë, që i pamundësojnë ummetit për t'a ndërtuar të tashmen dhe krenarinë për të ardhmen. Ishte e pamundur mbrojtja e historisë ndaj plaçkitjeve ideore dhe civilizimeve. Kjo, është ajo, që ne tani jemi duke e përjetuar. Kujdesemi për të tjerët me historinë tonë, japim analizat dhe studimet për t'i plotësuar planprogramet dhe qëllimet e tyre. Kjo paraqet një hyrje të vërtetë për bashkëveprim, ku ne jemi dominues ose drejtues. Në këto vende, duhet t'ju kujtojmë dobësitë e atdheut tonë, hendeqet që na u bënë më parë dhe se si ato, akoma, janë duke u vazhduar.

Nuk është për t'u çuditur se çifutët, që në start, i përzgjedhën dijetarët dhe studiuesit e tyre. Ata i dërguan për të studiuar dhe për të specializuar, në fusha të ndryshme rreth luftërave të kryqëzatave dhe, pas studimit të gjërë, dolën me konkluzionet e tyre rreth botës islame. Këtë e arritën duke organizuar tribuna, tryeza të rrumbullakta, konferenca, etj. Ekspertët e tyre, janë shprehur se kanë përfituar shumë nga këto organizime dhe kanë fituar përvojë për mbështetje nga qendrat universitare dhe institucioneve hulumtuese.

Tubimet, i organizonin në shenjë përkujtimi të betejave të ndryshme dhe prej tyre nxirnin rezultate rreth historisë, në përgjithsi dhe asaj islame, në veçanti. Do të marrim si shembull: mbrojtjen e temës së “Mosha Livit” - ish kryetar i brigadës së ushtrisë, që specializoi rreth historisë islame, diploma e të cilit titullohej “Të mësoj si t’i luftoj muslimanët deri në fitoren përfundimtare”. Sa për t’a ngjallur kujtesën “Musa ibn Mejmun Al Kurtubi” adaluzian, ishte mbishkrimi i simpoziut të organizuar nga çifutët në vitin 1985, për hir të 850 vjetorit të lindjes së Ibn Mejmunit. Kështu vepruan me shumë tribuna, simpoziume dhe konferenca të ndryshme, për hir të takimit të gjashtë të filozofëve në qytetin e Kudsit (Jerusalemit), gjithashtu në të njëjtën mënyrë, vepruan edhe me konferencën vjetore, të njëzetegjashtë me radhë, për intelektualët çifutë në Francë më 30.11.1985. Për këtë takim, është shkruar shumë, bile edhe ditoret më të mëdha si ‘Le Monde’, e cila ia kushtoi këtij takimi një faqe të plotë, në datë 27.12.1985.

Njëri prej shumë titujve ishte “Vitet e ibn Mejmunit”, titulli tjetër “Shpresat rreth shtetit çifut dhe trashëgimia e tij”. Po në të njëjtën gazetë, ishte një titull “ Nëntë shekuj të çifutëve”!

Nuk është për t’u çuditur se, historia jonë islame në Andaluzi, është e cunguar, nga shumë kaside vajtuese, njëra prej të cilave thotë: “Për çdo gjë kur kryhet me mungesë...”, ne, e dorëzuam atë realisht, por pastaj nuk punuam sinqerisht. Ajo, që më së shumti ia kushtuam dështimit në Andaluzi, dhe që është më e keqja, filozofuam shumë rreth saj. Fatmirësisht, ende ekzistojnë atje dëshmi, të cilat na lidhin me civilizimin islam. Atje ishte ngritur një infrastrukturë dhe kulturë, kur evropianët, në atëkohë, ishin shumë mbrapa atij civilizimi.

Gjithashtu, nuk duhet të habitemi, që çifutët sot e kanë kthyer alfabetin e tyre. Ata e kishin ruajtur atë nga Andaluzia, por atyre nuk iu mjaftoi vetëm kjo, por ata

pretendojnë se janë bashkëveprimtarë të ngritjes së civilizimit të atjeshëm dhe atij islamik. Ata i kushtojnë një kapitull të veçantë civilizimit aberik.

Ibni Ruzhdin, ata, e konsiderojnë me origjinë çifute. Këtë e argumentojnë me faktin, se kur njëherë Kalifi qenka hidhëruar rreth filozofisë së tij, e kishte kthyer në fshatin e vet të origjinës. Kurse ai fshat, paska qenë “enklavë çifute”. Ky argument, ju mjaftoi atyre që të thonë se ai paska qenë çifut! Të bazuar në këtë, ata kanë ngritur një qendër për studime Ruzhdiane në Universitetin Aberik, në Jerusalem. Ata kanë botuar një libër në gjuhën arabishte dhe pastaj atë e kanë përkthyer në gjuhën aberishte dhe anglishte.

Kjo nuk është bërë nga dashuria për Ibn Ruzhdin, por për interesat e tyre personale. Ata nuk janë marrë vetëm me falsifikimet rreth tij, por ata kanë vazhduar me falsifikimet e tyre, duke falsifikuar tërë historinë Andaluziane. Ata kanë sjellë “argumente”, se ata kanë qenë themelues të civilizimit dhe kulturës, duke paraqitur filozofë , dijetarë, këshilltarë dhe ekspertë, si Ibn Mejmoni, Ibn Xhibruli etj. Vërtet, këta ishin bashkëveprimtarë në qeveri, politikë, kulturë dhe gjithashtu edhe në histori andaluziane, por edhe sikur të ishin çifutë, kjo nuk iu jep të drejtën se ishin themelues të civilizimit. Por ja që, ata e paraqesin si etapë të historisë çifute dhe abere, në përgjithësi!

Nëse vetëm pak gërmojmë ose vetëm pak grithim, del se çdo gjë është islame. Sikur të merremi me historinë islame, që nga fillimi, do të shohim se aty ka mbretëruar një gjuhë, e cila ka rrezatuar kulturë. Do të shohim burimet e Islamit prej mendimtarëve, që gjithashtu kanë rrezatuar civilizim. Do të shohim djersën, që kanë lënë prodhuesit e zejeve të ndryshme dhe do të shohim arkitekturën e tyre. Gjithashtu, do të shohim laboratorët dhe institutet e ndryshme, etj. Vallë, e gjithë kjo, mund t'i atribuohet vetëm disa individëve?!

Por e mira së mirës është se, shumë prej ngjarjeve historike, flasin edhe sot, ende kemi fakte arkeologjike. Edhe tradita që është prezente është dëshmitarja jonë. Për të mos lënë pa përmendur disa dukuri, kujtojmë se vendasit kishin marrë disa tradita prej nesh, disa data historike, festa politike, festa vjetore, gjë që për të cilat nuk kemi se çfarë të shtojmë diçka të re, sepse janë ende një realitet. Kur i përkujtojmë të gjitha këto, ia vlen të përmendim se, kemi të bëjmë me një periudhe kohore prej pesë shekujsh, nga rënia e Granadës dhe fundit të qeverisjes islame në Andaluzi. Këtë datë e përkujtojnë shumë vende edhe në ditët e sotme, prej tyre zyrtarë spanjollë dhe ekstremistë. Ata festojnë në forma të ndryshme, varin fotografitë e arabëve dhe muslimanëve, i ngrejnë heronjtë e tyre si heronj mitologjik, thuajse po vijjnë si “shpëtimtarë” dhe rimëkëmbës të sërishëm të të krishterëve katolikë.

Kjo, gjithashtu, manifestohet edhe me organizimin e shumë konferencave kulturore e ideologjike, në nivel shteti dhe ndërkombëtar. Këto të fundit japin shkëlqimin e parë islam, sepse flitet për një epokë të ndritshme, ajo jep pamjen e vërtetë të Andaluzisë. Ajo ishte një pjesë e pashlyeshme e historisë së Spanjës, e cila i dha kulturën, civilizimin dhe shkencat. Janë bërë përpjekje që t’a kthejnë në origjinën e vërtetë, në atë të spektrit shkencor dhe atij kulturor. Kësisoj përpjekjesh kishin bërë më herët edhe çifutët.

Në anën tjetër, shohim angazhimin e vogël të arabëve dhe muslimanëve në përgjithësi, thuajse janë të dëbuar dhe të humbur, në publicistikë. Kurse strukturat akademike, as që janë dëgjuar, edhe pse Andaluzia, në tërësi, është histori islame dhe civilizim botëror.

Por ja që, pas pesë shekujsh, nga rënia e Granadës dhe fundit të qeverisjes së Islamit në Andaluzi, ka filluar një epokë e re. Kjo është epoka, kur katolikët po mundohen të jetojnë në dashuri, pa mbjellë urrejtje. Tani, është lejuar të përkujtohen disa data historike, edhe për muslimanët.

Organizohen disa ceremoni të vjetra, edhe pse nganjëherë vërehen disa mospajtime, nga segmente të ndryshme klanore, brenda për brenda spanjollëve. Ato klane, paksa më ekstreme, orvaten t'i ndalojnë për të mos dalë në shesh disa ngjarje të vërteta. Por, megjithatë sitemi i ri i hapur dhe të drejtat ndërkombëtare kanë mundësuar që të ato të festohen dhe të përkujtohen. Ato nuk ndalohen për shkak të drejtave shoqërore dhe marrëdhënieve ndërnjerëzore. Tek e fundit, prej tyre shoqëria nuk humbë asgjë, sepse ato paraqesin përparimet dhe sukseset ndërcivilizuese. Dalëngadalë, ata kanë filluar t'a nxjerrin zërin e tyre të mekur, edhe pse ato janë të karakterit ideologjik, apo hulumtime shkencore rreth rrënjëve të tyre. Ato, ndonjëherë ndërlidhen me to, dhe ndonjëherë mbeten vetëm përkujtim i epokës islame. Kjo epokë, i dhuroi civilizimin dhe kulturën popullit të Spanjës në njërën anë, dhe botës në anën tjetër. Kuptohet se ajo është një periudhë e ndriçme e historisë së Spanjës dhe për këtë, ajo histori nuk mundet të anashkalohej aq lehtë, ajo nuk mund të quhet e huaj, por ajo duhet konsideruar si periudha e Islamit dhe muslimanëve.

Nga ana tjetër: Dëshën apo jo, spanjollët nuk mund të mos e konsiderojnë historinë e tyre, si pjesë të epokës së Islamit në Andaluzi (Spanja e epokës së Islamit). Historia e Spanjës, pa epokën e islamit mbetet e pa histori, ngase mbetet shumë e varfëruar. Për të nxjerrë një civilizim, kulturë, ose ndonjë trashëgimi tjetër të asaj kohe, është e pamundur, sepse ajo periudhë ishte si të thuash kohë e injorancës totale. Aty nuk mund të paraqitet asnjë argument, përveç atyre që merren me falsifikime, apo ide ekstremistësh, që mund të sajojnë kujtesa njerëzore, apo historira të përgjithshme.

Kjo formë e paraqitjeve ka filluar të jep rezultatet e para. Publicistika ia ktheu reputacionin Andaluzisë muslimane, me anë të përkujtimit të personaliteteve si të Ibni Ruzhdit, Kurtubiut, Ibni Hazmit, Shatibiut etj. Këto përkujtime tani janë një pjesë shumë e vogël e publicistikës në Spanjë. Ajo çfarë na intereson të themi

këtu është se ka filluar një përmirësim ndaj vetes, ekziston një orientim nga e kaluara e ummetit spanjoll, ashtu siç e kupton edhe ana tjetër: se Islami ishte një erë për Andaluzinë, ai s'ishte as i huaj, as okupues i jashtëm. Ajo nuk ishte ofensivë, apo valë ushtarake që shkaktoi dëme, dhe që së fundi i detyroi të tjerët të kapitullojnë nga epërsia e madhe ushtarake që kishin muslimanët. Islami, në fakt, ishte alternativa e Andaluzisë dhe ajo duhet të kuptohet si një bimë brenda dheut të tyre. Kështu që kthimi, do të nënkuptohet si kthim në origjinë, duke e vazhduar e duke e plotësuar atë civilizim andaluzian, aty ku ka ngelur. Vazhdimësia duhet të bëhet me mjetet më të sofistikuar të kohës së tashme bashkëkohore dhe gjithmonë, duke u mbështetur në pjesën e historisë kombëtare spanjolle.

S'do mend se, tek shumica kjo ngjall frikën e lejimit të rishfaqjes së kulturës dhe civilizimit islam, por kjo nuk duhet kuptuar kështu, sepse historia ka ngelur atje si një tërësi dhe ajo është historia kulturore. Duhet të dallohet historia politike, e cila nënkupton, në prapavijë, konfliktet e mundshme. Po e përsëris se, vlerat e civilizimit ishin shumë më të fuqishme se shkuarja ose prezenca e ushtarëve, përndryshe ata nuk do të qëndronin me shekuj pa u mundur.

Për këtë arsye edhe themi: spanjollizmi tani është historia islame në Andaluzi, ajo duhet t'i hapë dyert sërish, që Islami të dhurojë vlerat e tij kulturore dhe civilizuese. Islami nuk është i huaj, ai nuk është aziatik, as afrikan, por ai është shpallje e All-llahut për mbarë njerëzimin.

* * *

Është për t'u çuditur, se si kaluan pesë shekuj pas rënies së Granadës e të mos jetë regjistruar asnjë rast takimesh ndërintelektuale, ndërkulturore ose të paktën takime akademikësh, takime të nivelit tradicional, marrëdhënie reciproke ndërmjet shoqatave ose qendrave kërkimore botërore, etj. Jo vetëm kaq, por këtu ka

munguar edhe iniciativa individuale, për të bërë një analizë shkencore ose ndonjë koment historik, si prej palës së Lindjes ashtu edhe prej Perëndimit. Habitemi, se si nuk paska paraqitur interes njohja e kësaj fushe, nga universitetet arabo-islame, organizatat kulturore, arsimore dhe shkencore, si p.sh. “Esisko” dhe “Elisko”. Ministrisë së Kulturës, si dhe qendrave të ndryshme kërkimore historike spanjolle dhe universiteteve, thuajse, të gjithë këtyre, u ka munguar personeli ose kuadri për t’i angazhuar njerëzit tanë. Por kjo punë, u ngeli çifutëve, të cilët e falsifikuan historinë. Ata e kanë bërë këtë për qëllime mesquine ndaj Islamit, sepse propoganda e tyre e paraqet Islamin si antivlerë dhe të dëmshëm për shoqërinë. Jemi dëshmitarë se shumica prej tyre janë orientalistë, paraqitjet apo disertacionet e të cilëve, janë përplot kundërthënie dhe të pavërteta.

Disa prej studiuesve, që në start të hulumtimeve, kanë pasur qëllime të liga, apo programet i kishin të deformuara. Nga ngjarjet historike, do të veçonim rënien e Andaluzisë, ajo na mëson se si është kryer si të thuash një operacion kirurgjikal, dhe se si ne jemi marrë me festimin e humbjeve. Atyre iu mungoi kushtrimi apo thirrja e përkujtimeve të shembullit të mirëfilltë së të kaluarës. Qoftë ajo e ndritur apo jo, ajo duhet për të përfutur të tashmen dhe për të parashikuar të ardhmen.

Gjithësesi, nuk duhet t’a lëmë ummetin të kalbet së bashku me historinë. Sikur të shoqërohet e kaluara me zhvillimet e civilizimit që po përjetojmë, do të ndihmohej në parashtrimin e tezave për të tashmen dhe gjithashtu do të jepej një vizionin për të ardhmen. Këtu do të veçoja Andaluzinë, e cila nuk qe tokë e pushtuar në mënyrë klasike, prej ushtarëve muslimanë. Ata qëndruan aty një kohë të gjatë, paraqitja tyre ishte shumë e kulturuar, sepse bartnin me vete një civilizim të lartë. Atyre iu ofruan dijen, vlerat njerëzore dhe shkencën. Kjo i bëri të fortë dhe formuan një taban me baza shumë të shëndosha, aq saqë mbi këtë taban qëndron sot civilizimi perëndimor. Andaluzia, neve na intereson shumë, sepse atje ende

qëndron literatura islame, shkenca e fikhut- legjislacioni islam, hadithi-autobiografia e pejgamberit s.a.v.s., letërsia, etj.. Atje janë arkivat, trashigimia shkencore dhe kulturore. Me plot të drejtë, mund të themi se: civilizimi ynë i mundur, atje akoma është stabil dhe i qëndrueshëm, bile më i qëndrueshëm se vetë forcat mundëse. Ende atje vazhdon të ndriçojë fanari i civilizimit islam, në tërë historinë e Spanjës. Sikur t'a shlyejmë historinë spanjolle moderne dhe civilizimin tonë, atje nuk do mbetej asgjë, përpos relatave dhe marrëdhënieve të kohës së injorancës që të mbjellin frikën! Por, shumë spanjollë po bëjnë thirrje që të kthehen në origjinë dhe të bëjnë kërkime në identitetin e tyre dhe në civilizimin e vërtetë. Këto ftesa dalin nga brendia e tyre dhe ata janë përqëndruar në to.

Ameriko Kastro, është historiani më i njohur bashkëkohor spanjoll, i cili ka vdekur para pak vitesh. Në librin e tij "E vërteta historike e Spanjës", ai thotë: Ndjenjat e atdhetarisë, spanjollëve, iu kanë mbjellë andaluzianët. Sikur të mos ishin ata, ne nuk do të dalloheshim si komb nga të tjerët, dhe do të hynim në radhët e popujve të prapambetur. Por ja që, ata na ngritën, dhe ne kemi pjesë në historinë bashkëkohore.

Kështu ka deklaruar edhe orientalisti spanjoll dr. Petromartinez Montapth: Spanjollët nuk kishin për të hyrë në historinë e civilizimit, sikur të mos jetonin tetë shekuj nën hijen e Islamit dhe civilizimit të tij. Atëherë, Islami ishte drita dhe kultura e vetme e Europës së errët dhe plot konfuzionit.

* * *

Nga kjo mund të konkludojmë se, mendimtarët e sotëm spanjollë veprojnë në interes të Spanjës, ose për triumfin e vetvetes, për t'a tejkaluar shovinizmin duke fshehur realitetin, sepse Islami akoma jeton në shpirtin spanjoll. Spanjollësve ju ka ngelur kultura islame sepse iu ka ngelur në traditën, trashigiminë e popullit dhe shumë shprehje në gjuhën e tyre edhe pse gjitha forcat i kanë drejtuar kundër Islamit dhe muslimanëve. Duke filluar që

nga koha e inkuizicionit, vuajtjet e Sarskinit, të cilat Gustav Lebon, i ka përshkruar në librin e tij "Civilizimi arab" duke thënë: Eshtë e pa mundur të lexojmë, pa na u kujtuar vuajtjet dhe persekutimet që të krishterët ngadhnjimarë, u kanë shkaktuar muslimanëve të mundur dhe duarthatë ... Jo vetë kaq, i kanë krishterizuar me forcë, ua kanë dorëzuar inkuzicionistëve, i kanë djegur në turma... i kanë vrarë, i kanë torturuar dhe kanë larguar më shumë se tre milionë arabë. Shumica e të dëbuarve ishin intelektualë, mendimtarë dhe zejtarë spanjollë. Me këtë ofensivë, ata shuan civilizimin e ndritur, që rrezatonte Europën për tetë shekuj.

Mbase, sot, muslimanët e kanë humbur pusullën dhe janë dezorientuar, pas humbjes së programit, apo siç mund t'a quajmë ndryshe: të programit kulturo-historik, në të cilin përfshihen shkencat dhe njohjet e nivelit të lartë, apo ndryshe vitet e zbulimeve njerëzore dhe ligjet që e sundonin dhe sundoheshin me to. Këtë kohë ndryshe e quanin: mungesa e shkencës së historisë, por, në fakt, në këtë kohë, janë vënë bazat e historisë. Në këtë kohë, janë regjistruar shumë ngjarje historike edhe pse nuk i kanë njohur parimet shkencore. Ata, me ato ligje kanë udhëhequr ose qeverisur, kurse ngjarjet e kaluara të popujve të tjerë, nuk janë ruajtur, ngase ata nuk ishin vetë protagonistët e atyre ngjarjeve. Këtu kemi parasysh edhe davin⁸ e Kur'ani Kerimit, i cili u shpërnda në mbarë botën, sepse ishte obligim i tyre, derisa ata vetë ishin kujdestarët e atyre trojeve. Kjo vazhdoi deri në rënien e plotë *"...Udhëtoni nëpër botë dhe shihni si ka qenë fundi i atyre që i kanë përgënjeshtuar pejgamberët"*. Këtë ajet muslimanët e kuptojnë si këshillë, se duhet të janë të vëmendshëm, preciz dhe vizionarë. Lëvizjet ose udhëtimet janë sikurse të shikuarit nga dritarja, prej së cilës vërehen ndryshimet dhe merren njohuri të reja. Gjithashtu, nëpërmjet lëvizjeve mësohen ligje, që e ndihmojnë shoqërinë të përparojë. Para tyre, ata kishin qenë të

⁸

Davin-ligjërimet e Kur'anit

sunduar, por arritën të udhëheqin ummetin musliman. Qëllimi, për të shkruar historinë, ishte njohja e kësaj shkençe, sepse kjo ndikon në nxerrjen e zbulimeve dhe ngjarjeve: “ *...Udhëtoni nëpër botë dhe shihni si ka qenë fundi i atyre që i kanë përgënjeshtruar pejgamberët* ”

Që nënkupton urdhërin: shikoni format dhe mënyrat, se si filluan dhe se si përfunduan popujt para jush. Shikoni shkaqet dhe vuajtjet që përjetuan ata, sepse All-llahu nuk ua do këtë muslimanëve, pasuesve të revelatës së fundit. Ai nuk do, që neve të na mungojë përvoja personale, historia e veçantë, ose me fjalë të tjera historia islame. Ai na dëshiron, gjegjësisht na ka ngarkuar me më shumë, ne jemi ngarkuar me njohjen e historisë së përgjithshme, pra të popujve të tjerë dhe njohurive rreth krijesave të All-llahut, që i ka dëshmuar historia. Përkundër dëshirës së Tij, neve na ka munguar dëshmia historike, por fatmirësisht ngeli imani dhe ai mjaftonte sa për fitoret ndaj armiqve, edhe pse kuptoheshim negativisht. Ummeti, i cili është ngarkuar me revelatën e fundit është trashëgimtar ideor i civilizimit njerëzor dhe njohës i standarteve të ummeteve të mëhershme. Për këtë arsye, nuk mund të rimarrim përgjegjësinë pa arritur në pedestalin e përvojës së plotë njerëzore, për të qenë të aftë për të bartur përgjegjësinë e plotë ashtu si duhet.

Historia nuk është vetëm regjistruar i ngjarjeve, udhëtimeve spontane të kota dhe të pavlera. Ajo, nuk duhet kuptuar si një grumbullimin i ngjarjeve njerëzore, por ajo duhet t’u përgjigjet bindjeve ideologjike, vlerave, përvojave shoqërore. Gjithashtu edhe lëvizjeve për t’ju mundësuar implementimin e ligjeve të natyrshmërisë njerëzore. Ajo i ngjason orës, prej së cilës nuk shohim asgjë, përveç lëvizjeve të akrepave, por në realitet prapa saj fshihen një sërë elementesh të tjera që e bëjnë atë të lëvizin. Lëvizjet e tyre na japin me shumë saktësi për lëvizjen e kohës, e ajo na bën të kuptojmë se koha po ikën.

Pa kurfarë ndrotje, mund të themi se: muslimani duhet të plotësohet deri në përsosmëri. Këtu kemi parasysh,

udhëtimin nëpër tokë dhe jashtë saj. Të mos ngurojë në shpikje, të zbulojë ngjarjet gjatë historisë, të cilat do t'i shërbejnë në ngritjen e civilizimit të tij. Ato, të cilat janë të mira dhe të qëndrueshme, le t'ia ofrojë gjeneratatve pasuese. Ashtu siç janë ligjet dhe rregullat ligjore, ato të cilat ju mungojnë ne, thujase në formë obligative duhet t'ju kërkojnë ekspertëve të fushave të ndryshme plotësimin e tyre.

Fatkeqësisht nuk janë prezantuar ngjarjet historike, as në nivelin historik të pjesërishëm të Ummetit musliman, e as atij të përgjithshëm, duke marrë si shembull përvojën e ngjarjeve botërore. Nuk është prezantuar si duhet as jurisipodencia, sipas komentatorëve të Kur'ani Kerimit dhe analizave të duhura të qenësisë së Islamit bashkëkohor. Edhe pse ngelëm prapa, të paktën, historinë tonë t'a kishim ruajtur sa për të qenë me aktualitetin, amanetin. Sikur të paktën të kishin qenë të regjistruara, sot ato do t'i kishim kaluar për analiza.

Kjo vepër me shumë rëndësi ishte obligative për ne. Kjo do të duhej të mbetej në sferën e formimit të një shkence, e cila do t'i radhiste ngjarjet dhe do të bënte lidhjen ndërmjet ngjarjeve dhe analizave. Pastaj me ato që do të vlerësoheshin, do të bëhej strategjia e ngjarjeve, që do të kishin vazhdimësi. Ato do të ishin valide, derisa nuk do të zbulonim rregulloret dhe mënyrën e qeverisjes, që do t'i përshtatej situatës. Me këto elemente, njeriu do të bëhej gjenerator i lëvizjeve mbarë shoqërore dhe mbikqyrës i ngjarjeve të ngelura për të ardhmen. Të gjitha këto, do të ishin larg parashikimeve astrologjike dhe supozimeve, ato do t'ishin vlerësuar dhe studiuar deri në klasifikimin e tyre për zbatim. Qeveria, me strategji të tillë, do të ishte rezultative sepse do të bazohej në vizione të qarta dhe kështu do t'i siguronim vetes vetëbesim, me gabime eventuale që do të ishin minimale. Kjo e tëra do të vinte nga përvoja e mëhershme e regjistruar, e analizuar dhe e radhitur sipas planprogrameve.

Rëniet dhe ngritjet ndodhin nëpër shoqëri, por ato duhet të studiohen, cilat ishin ato lëvizje, qëllime dhe rrethana që e detyruan atë rënie-ngritje. Këto rrugë e motivojnë njeriun deri tek arritja e ndryshimeve historike dhe rrokullisjen e civilizimeve. Këto iniciativa, akoma, qëndrojnë larg mentalitetit kolektiv musliman, me përjashtim të disa individëve që kanë lidhshmëri dhe kontakte të rralla. Këta nuk kanë rezultate të mjaftueshme, por ato mbeten si orvajtje, ose më mirë të themi mbeten programe në letër për studime dhe objektiva për të ardhmen. Çështja, e cila nuk arrin të përfundojë sipas parashikimeve, ajo mund të zë një vend tjetër. Ajo, të paktën mbetet si produkt i kulturës ose formësimit kulturor, e nuk duhet të mbetet vetëm si njohje ose filozofi. Kjo nënkupton: produkt i formësimit për të ardhmen e tyre.

Historia pa njohjen e natyrës së mirëfilltë të ngjarjeve dhe rregullave, me të cilat i kanë detyruar rrethanat e lëvizjeve, mbeten vetëm vepra të së kaluarës. Ato nuk mund të rikthehen. Prandaj, qeveritë duhet të fillojnë nga e para, sipas prioriteve që përbërja e tyre duhet të jetë organizuar sipas projektprogrameve.

Parapërcaktimi i kësaj forme, duhet të bashkërenditet me logjistikë, e cila do të mbështetet në forcën, sa për t'ia transferuar kohës së tashme, e cila do t'i jepte qartësim të ardhmes, ose në kuptimin tjetër: dëshmitarët e historisë do të ishin të pavlefshëm sikur të mos iu jepet mundësia e dëshmive kohës së tanishme dhe vizioneve prioritare obligative për të ardhmen, të radhitura sipas imperativit.

Kjo pasuri kulturore e depozituar, nëse shtresohet në historinë tonë të përgjithshme, do të duket shumë e qartë historia e Andaluzisë, sepse andaluzianizmat mund të përsëritet tek-tuk nëpër shumë vende. Kjo formë le t'a përcaktojë fatin tonë, me kapitalin e së kaluarës, të cilin e posedonim të depozituar.

Historia konsiderohet si laborator i vërtetë për akaidin⁹, idetë, vizionet, individët, popujt. Ajo është argument i arritjeve për veprimtari me akaidin, idetë dhe përkthimet, deri tek e vërteta. Ajo ju mundëson komentimin dhe analizat historike, të cilat pastaj ju japin të kuptuarit real duke i vendosur ato, në atë pozitë, që do të jetë e përafërt me një ndodhi historike. Së fundi, ajo mund të shërbejë për ndërtimin e strategjisë në të ardhmen.

Besojmë se mundësitë që ju ofruam më lartë, me studimet historike - konsiderohen bazë, ose ajo quhet babai ligjor i të gjitha shkencave shoqërore. Është shpalues i ligjeve dhe rregullave, të cilat ndikuan dhe do të ndikojnë në lëvizjet e shoqërive. Të tjerët, këtë gjithashtu, e kishin bazën e arritjeve tek shkencat shoqërore. Tani, kjo konsiderohet si shkenca më e rëndësishme dhe një prej më të rrezikshmeve. Është indikator themeltar për studimin e gjendjes së popujve dhe veprues i drejtëpërdrejtë i ndryshimeve brenda përbrenda. Qofshin ato në fushën e betejave, ideve, rënieve të civilizimeve, ndërrimeve ndërmjet ideve, komparacioneve dhe vlerësimeve për bashkëpunimin të përbashkët. Muslimani bashkëkohor e ka shumë të vështirë të marrë kthesa. Ato, sigurisht, varen nga ngarkesa dhe përgjegjësitë ligjore. Por, duke qenë se është obliguar të udhëtojë nëpër botë, ai e ka për detyrë qetësimin e popujve, ashtu siç e kishte me ata të mëherëshmit. Duhet të realizojë idetë, duke shpalosur shkaqet e rënieve të civilizimeve, dhe ligjeve që ndikojnë në shoqëritë njerëzore. Kjo formë e grumbullimit të ngjarjeve dhe stivosjes, u bë obligative, ashtu siç theksuam më sipër.

Pas kësaj mund të themi: Kur'ani na tregoi për disa luftëra, por ne fatkeqësisht nuk i studiuam ato, ndoshta pse ato ishin në formë tregimi! Me ato, do të kishim përfutur përvoja edhe më të mëdha. Sikur t'i kishim spostuar rregullat laike, filozofike, psikike, dhe t'ishim

⁹ Akaidit, filozofia e besimit në islam

marrë me humbjen e civilizimeve, që prej Ademit a.s. deri tek Muhammedi s.a.v.s..

Ato tregime mbase do t'a kthenin harmoninë brenda shoqërisë. Ato do t'a lehtësonin formimin e ligjit dhe rregulloret për marrëdhëniet shoqërore. Kjo pastaj do të bëhej shkak i themelimit të bazave të shkencës së sociologjisë. Vendosja e një baze të fortë historike ose asaj kur'anore, nuk do të ishte e tëra, sepse ato nuk bartin të gjitha laboratorët eksperimentale të njerëzimit, por ato tregime kur'anore janë bartëse të rezultateve bindëse për eksperimente laboratorike, që janë themeluar për përvojat njerëzore të quajtura shkencë. Leximi i këtyre ligjeve në ditët tona është i pamundur, sepse herë janë të përshtatshme e herë jo, sepse dinamika e jetës i kundërshton shpesh herë ato. Mungesa e kësaj shkence, solli prapambeturinë tonë, kur dihet se të gjitha shkencat shoqërore në realitet përfaqësojnë urat, nëpër të cilat kalojnë shumica e civilizimeve.

Mbase, e gjithë kjo, ishte për shkak të abstenimit nga analizat e komentimeve të historisë. Për ta realizuar të kaluarën duhet të rikthehemi në: shkaqet e rënies së qetë të historisë islame. Kjo rënie mbase ishte rezultat i mos njohjes së fesë sepse çdo gjë ia lenin shenjtërimit të Islamit, duke menduar se është i pa mposhtur. Ai mund të pësojë disfatë deri në humbje, sepse këtu është përzier shenjtëria e Kur'anit me veprimet e sakrificave njerëzore. Si duket, të studiuarit dhe hulumtimet janë vlerësuar gabim, duke besuar në profesionalizmin e klaneve të shtetit. Pas kësaj, ka rrjedhur neglizhenca për zbulimin e tyre, sepse është vlerësuar gabim, duke besuar në fuqinë e vet Islamit, si një forcë mbinatyrore.

Mund të ketë edhe arsye tjetër. Është “vendosur” të fshihet e vërteta, për shkak të rrethanave kohore, kështu që ndalesa ka ardhur pa ndonjë precedent, për shkak të hutisë së ummetit përgjatë historisë. Këtë e argumentojnë për shkak të qëndrimeve të qeverive që ishin, sepse nuk dallonin kulturën nga udhëheqja politike. Nëse e

përcjellim historikun kulturor islam të përgjithshëm, në më shumë etapa dhe historinë Andaluziane, në veçanti, do të vërejmë se, në to, të dalin disa vetëkënaqësi. Të atyre që ishin të dhënë pas të mirave materiale dhe mosinvestimi në përparimin e civilizimit dhe kulturës. Kjo vazhdoi kështu, derisa arriti aty ku arriti dhe pësua kolaps përballë historisë.

Në fillim, muslimanët ishin të angazhuar në zbulime shkencore, më pas, ajo kaloi në konflikte të brendshme. Ky qe edhe një shkak tjetër i dobësimit të ummetit atje, sepse shumë koka të ndritura morën arratinë. Pas kësaj etape, ata u copëtuan në shumë krahina e qytete, të cilat më vonë u shpallën shtete. Thujase të gjitha këto shtete të vogla kishin lidhje të ngushta me armiqtë e tyre, sepse ju paguanin tatimin për sigurinë e tyre me para kesh. Kush e bënte këtë? Ata të cilët nuk e meritonin pushtetin, ata të cilët nuk përfitonin nga siguria e huaj asgjë, ata të cilët kapitullonin para kohe, pa ndonjë kusht paraprak me pretekst se do të hidhërohej popullata muslimane, sikur të kuptonte realitetin. Ka pasur raste, përgjatë historisë islame, që duhen konsideruar si më të shtrenjta, se në kohën e vetë Resulullahit s.a.v.s., ngase Kur'ani iu kishte përcaktuar përgjegjësinë për të krijuar histori, duke ju thënë:

“E kur ju pësuat fatkeqësinë (në betejën e Uhudit), pësuat sikur që ata pësuan më parë dyfishin (në betejën e Bedrit) dhe thatë: nga (na erdhi) kjo?! Thuaj (o Muhammed): kjo ishte nga vetvetja juaj”¹⁰

Kur'ani nuk ndalon të mirat materiale, të cilat janë përcaktuese të jetës, por ai kërkon që ato mos të teprohen dhe të mos bëhen shkak të shkatërrimit të brendshëm. “...nga ju ka që duan këtë botë”¹¹ (pasurinë). Ne nuk jemi kundër pasurisë në këtë botë, që ia sjell dikujt koha. Dëshira për pasuri është brenda natyrshmërisë së qenies

¹⁰ Kur'an, 3-Ali Imran 165

¹¹ Kur'an, 3-Ali Imran 152

njerëzore dhe kjo është e kuptueshme, por problemi qëndron se kjo që edhe një shkak shumë i rëndësishëm i rënies së civilizimit tonë. Mosarritja e edukimit të shpirtit, duhet të kuptohet se është shkatërrues për njeriun, në të janë detyrat elementare të krijimit dhe të civilizimit. Ai bën ekuilibrin ndërmjet parimeve dhe interesave, ose edukimi të jetë i tillë, sa të kuptohet se parimet dhe interesi janë një dhe të pandara.

Fshehja ishte iluzion, ishte gabim historik. Kjo mënyrë mendohej të sjellte paqen, por kjo solli kthimin prapa, solli reaksione dhe këto u reflektuan me gabime të tjera, që vazhdimisht po përsëriten. Kjo formë, bëri që shoqëria islame të heshtë, të mbesë pa opozitë dhe pa rezistencë. Forca dhe krenaria ishte vetëm në letër. Brenda shoqërisë sonë u fut një virus shkatërrues, prandaj sërish të themi: Historiku kulturor akoma vazhdon të qeverisë mendjet muslimane, sepse nga kjo mendësi kanë dalë disa shoqata dhe organizata aktive islame, të cilat janë bërë shkak i rifshehjes së gabimeve. Kjo po pengon hapjen e debateve, diskutimeve dhe polemikave, kjo po reflekton sërish sjellje negative. Kjo duhet të shqyrtohet, nuk duhet t'i japim rast armikut të na zbulojë pikat e dobëta, sepse ai do t'i shfrytëzojë ato. Nëse, ai i vëren ato gabime, do të vazhdojnë gabimet njëra pas tjetrës dhe rimëkëmbja do të jetë shumë e vështirë. Grumbullimet e gabimeve shndërrohen në mina, të cilat ekspodojnë kohë pas kohe. Ato, pastaj sjellin gjykime të tjera, të cilat çdo gjë, para se të rritet, do t'a shkatërrojë.

“Gjithsesi, ata të cilët kanë bërë të keqen dhe gabimet e tyre shpërndahen, ata do të janë banues të zjarrit, aty do të qëndrojnë përgjithmonë”¹²

Thuajse Islami ka filluar me ne, dhe me ne do të mbarojë. Thuajse vetëm sjelljet dhe sakrificat tona e përbëjnë Islamin dhe ne jemi e tëra. Ne jemi Islami! Prandaj të supozojmë se secila periudhë i përket gjeneratës sonë, e ajo është periudha e Islamit. Çdo gabim

¹² Kur'an, 2 Bekare 81

i lëvizjeve tona, duhet të konsiderohet si gabim i Islamit. Pra, kundërshimet eventuale, përgjatë historisë sonë, duhet të konsiderohen si kundërshtime kundrejt vlerave tona të pagabueshme! Atëherë, si është e mundur të bëhen kundërshtime kundrejt Islamit, kur Islami është i pagabueshëm, kurse ne jemi muslimanë!?

Çështja tjetër është se ne, mendja jonë, nuk duhet të preokupohet rreth tij, sikur që është:

Përfito forcë, sa për të dalluar midis ngjarjeve të brendshme, që janë të përmbyllura me shariat dhe midis atyre, që janë të diskutueshme, të cilat arritën prej të parëve tanë, gjatë periudhave më të hershme, që parapërcaktojnë veprimet tona. Pastaj, ato duhet t'i shtrohen debatit dhe të polemizohet rreth atyre ndodhive historike. Ngjarjet që ishin të sukseshme duhet rikthehen pasi të janë përputhur plotësisht me kohën. Gjithashtu duhet të kornizohen ngjarjet rreth Islamit dhe të ndriçohen shtyllat, që janë të vlerësuara në Islam, si ato të moralit dhe të shkencave të tjera që i kërkon sheriat. Pas gjithë kësaj, të formohet një vizion i qartë me vlerësime pozitive ndaj sakrificave dhe veprimeve të gabuara, sepse një prej elementeve më të fuqishme të projektit ideor, janë rregullativat.

Për këtë arsye, shumica e librave islame, ishin të orientuara drejt veprimeve me konstruksione të jashtme. Ky vizion i tyre bëri që Andaluzia të bierë. Ende është e diskutueshme në mesin tonë, deri në ditët tona të sotme, shkaku kryesor i rënies së Andaluzisë, ngase nuk jemi në gjendje t'a saktësojmë shkaku kryesor, nëse ishte nga luftërat, apo nga konflikti i brendshëm ndërmjet mbretërve të qytet-shteteve atje. Na mungojnë studimet shkencore, analizat dhe njohjet e shkaqeve, që qenë shkaktarët kryesorë që të na turpërojnë para realitetit të Islamit. Ne duhet t'i pranojmë konstatimet, që janë të përfunduara dhe janë të gatshme për zhvillimin tonë, qofshin ato që e vështirësojnë edhe më shumë gjendjen. Kemi prej atyre që kërkojnë ndihmë për rimëkëmbjen tonë

nga armiqtë tanë. Ndërsa, ata që mundohen t'i ndalojnë armiqësitë dhe mashtrimet e tyre, janë mashtrues. Kjo do të ishte deviza jonë e ngadhnjimit!?

Drejtesi dhe mirënjohje ndaj periudhës sonë, zbulimi dobësive dhe dhënia e një orientimi të sjelljeve të jashtme, që nënkupton pranimin e gabimit dhe humbjen, pastaj të hapen dyert e studimeve për veprime të jashtme me një projektprogram të studiuar mirë.

Pakujdesia në ndërtimin e personalitetit, reflekton në kulturë, civilizim dhe në ushtri. Kjo paralajmëron humbjet, paralajmëron ndërhyrjet e armiqëve tanë, kur ne jemi të përçarë. I Lartëmadhëruari All-llah, në Kur'ani Kerim, na thotë:

“Le të jenë syçelë dhe të marrin armët e veta. Mohuesit dëshirojnë që të jeni të pakujdesshëm ndaj armëve tuaja dhe paisjeve, që të sulmojnë mbi ju me tërë fuqinë”¹³

Arma, këtu nuk nënkuptohet vetëm në ushtri, por edhe në formacione ideologjike dhe kulturore, që është qendra e konfliktit të vërtetë. Por, pakujdesia dhe arsyetimi personal, e ka okupuar çdo lloj ngritje të mundshme.

Të rikthehemi tek thënia e hitorisë islame në Andaluzi. Ajo vazhdon akoma të jetë e lidhur ngushtë me historinë e Spanjës bashkëkohore, përkundër urrejtjes dhe shovinizmit të tyre dhe orvajtjes për t'a shtrembëruar historinë. Sikur të kishin mundësi, do t'a shtrembëronin edhe tani historinë politike, me anë të personaliteteve dhe shoqatave brenda saj. Por fatmirësisht, kësaj po i vjen në mbrojtje historia shkencore dhe kulturore, ato ndikojnë drejtëpërdrejtë në ndjenjat njerëzore dhe e mbajnë gjallë Spanjën, prandaj këto nuk e përmbysin dot, apo nuk arrinë t'a mbyllin prej sipër. Për këtë arsye, ka filluar kthimi në origjinë. Ata janë pajtuar me historinë dhe tani po e kërkojnë të vërtetën në sfera të ndryshme. Po e përsëris, kjo po ndodh përkundër ekzistimit të rrymave të

¹³ Kur'an, 4-Nisa, 102 bazuar në përkthimin e Hasan I. Nahit

ndryshme shoviniste, ata pareshtur përkujtojnë rënien e Granadës. Me këto kremtime, ato i karrikojnë ndjenjat e tyre kundër Islamit dhe muslimanëve në nivel kombëtar dhe zyrtar, duke e mbushur shpirtin spanjoll bashkëkohor me urrejtje.

Për këtë arsye, shihet si e natyrshme që sot të kthehet shovinizmi fetar, me gjithë shterpësinë dhe pamundësinë historike. Me të, vetëm sa paraqesin përkujtimet e historisë së spanjollëve, parafytyrojnë persekutimet dhe zymtësinë e inkuizicionit. Me liberalizimin e vendit, mediat, mjetet e informimit dhe dijes, me anë të projekteve ideore, nxorrën dokumentacionin nga arkivat e shtetit. Aty u kuptua se epoka islame përmbante në vete perlat e civilizimit, si Kështjellën e Kuqe, Xhaminë e Kordobës, Universitetet. Aty, gjithashtu u kuptua se shkaktar i rënies së civilizimit, kishin qenë konfliktet e mbretërve, ata vetë e thyen armatën e tyre. Nga kjo, doli në pah, se ata i kishin dhënë vendit një kulturë të lartë, zhvillim shkencor të madh, saqë edhe sot e kësaj dite, spanjollët ushqehen ideologjikisht prej tyre. Ky ushqim, pra, ju kishte mundësuar që Islami të vazhdojë të jetojë atje.

Sikur të kthehen sërish mësimet e Kur'anit, atje do të ishte dita më e mirë, nga të gjitha ato që kaluan. Të ndierit e barës së përgjegjësisë, me rikthim të planifikuar dhe të drejtë, ashtu siç thotë i Lartësuari:

*“Para jush kanë kaluar (shumë popuj) ligje.
Udhëtoni nëpër botë dhe shihni...”¹⁴*

Ky ajet na obligon në studiojmë ligjet, ato që janë kontradiktore, sepse ato shkaktojnë lëvizjet e jetës dhe gjallërimit. Me këto qeveriset, dhe krijohen lëvizje në shoqëri, po ashtu këto edhe bëhen shkak i rënieve dhe ngritjeve të popujve. Shpalosja e këtyre ligjeve, nuk vjen si rezultat i studimit të koherencës, por ato vijnë nga shikimi i thellësishëm i historisë dhe vetë jetës së historisë së bashku. Prandaj, domosdoshmërisht të udhëtohet nëpër

¹⁴ Kur'an, 3-Ali Imran 137

tokë për ta tejkaluar koherencën, për ditët e së ardhmes. Ato nuk duhen të zgjerohen deri në atë masë, sa që periudha e një jete njeriu, mos të jetë në gjendje t'i zbatojë ato ligje, se ato i kthehen bumerang shoqërisë. Nuk përfitojmë asgjë, vetëm nga mësimet e kohës së tashme, nga mosudhëtimet nëpër popuj tjerë, nga tentimi i avullimit të historisë, duke mos ju përmbajtur komentimeve dhe analizave të qëndrueshme. Studimi i përvojave dhe i rezultateve pozitive është domosdoshmëri, në të kundërtën, i Lartësuarit na mëson:

“...shihni si ka qenë fundi i atyre që i kanë përgënjeshtuar...”

Me fjalën 'dëshmitarët e historisë' kuptojmë informimet e njerëzve, ato duhet t'i kuptojmë qartë e mirë. Argumentimi i saj për ne, vjen nga Kur'ani (*...lajme nga njerëzit...*). Duhet të njoftohemi me ndodhinë ose vendndodhinë, Kur'ani na mëson me shprehjen (*...shpjegime...*), mjet sa për të arritur deri tek ligji ose rregullorja. Ky udhëzim, udhëhiqet nga mësimet e Kur'anit (*...këshillime ...*), këto japin vizionin për të mos dështuar sepse kemi prej tyre, që nuk i kishin marrë të vërteta dhe për këtë e kishin merituar dënimin. Të gjithë ata pësuan këtë rënie ose goditje, me përjashtim të ummetit musliman. Ai po valëvitet e nuk po humbet përgjithmonë, për shkak se ende është refuzues i ligjeve njerëzore, duke i shërbyer ligjeve hyjnore (*ligjërime për ata që i frikohen All-llahut xh.sh.*).

Sikur ne t'a kishim parasysh këtë ajet Kur'anor: *“Para jush kanë kaluar (shumë popuj) e ligje. Udhëtoni nëpër botë dhe shihni si ka qenë fundi i atyre, që i kanë përgënjeshtuar peygamberët. Këto lajme e shpjegime janë këshilla, udhërrëfyese për njerëzit besimtarë...”* do të kishim arritur të kuptojmë largësinë ndërmjet nesh dhe ndërmjet paradhënjeve të dhuntive të Kur'anit, për problemet shoqërore.

Për këtë arsye themi: na ishte dhënë mundësia e zbulimeve shoqërore, por në fakt ato studime historike

munuan tek ne. Tek ne, ndikuan më shumë veprimet meskine dhe vetëm këto u regjistruan, kurse shumë ngjarje të tjera, me rëndësi të madhe politiko-historike, ngelën pa u regjistruar. Çështja mbetet të vërtetohet, ne duhet të jemi të vëmendshëm që analizat historike tani mos t'i ekzagjerojmë, edhe pse mund të ndodhë të vërtetohen shumë gjëra, ato duhet të stivosen dhe të nxirren sipas prioriteteve.

Pasojat e rënies ishin sekret, ato u fshehën me shpërnguljet masive të muslimanëve, duke mos anashkaluar neglizhencën e dijetarëve dhe gabimet kolektive. Gjithashtu, nuk u morën në konsideratë programet e shkecape shoqërore, me të cilat sot administrohet bota. Sot, historia konsiderohet laborator dhe udhëzuesi kryesor, por që fatkeqësisht, faktet mbetën në duart e të tjerëve.

Duhet të pranojmë orvajtjet e sotme, rreth zgjimit islam në Andaluzi, ato janë të prekshme përgjatë rrugëtimit që po kalon nëpër shumë vështirësi. E kemi parasysh barrën nacionale dhe ndikimet e jashtme, të cilat janë të shumëngjyrshme. Ato bëjnë përpjekje për të shkatërruar dhe brenda vendit krijohet konfuzioni. Ata, në bashkëpunim me hipokritët dhe dytyrëshat, ndikojnë në devijimin dhe humbjen e plotë të drejtimeve atdhetare, kundër qëllimeve të përbashkëta rajonale e më gjërë. Këto veprime nuk duhet t'a hutojnë mazhorancën, duhet të jetë në dijen tonë, sepse tek e fundit, këto janë shumë normale ndër popuj. Ato mund të evitohen, nëse i përmbahemi normave islame, mbi marrëdhëniet me individë, familje dhe shoqëri.

Mbetet të kërkojmë nga specialistët e fushave që na interesojnë, për zbatimin e atyre programeve, të cilat janë paraparë sipas prioriteteve brenda rrethit islam. Gjithçka duhet të jetë legale, por ato duhen të janë të qarta dhe të sakta.

Tani, rëndësia e këtij libri, të cilin po e paraqesim sot, me autor dr. Ali el Mensur el Kitani, mendojmë se do t'a

luajë rolin e vet edhe pse disa studiues, që janë marrë me historinë e Andaluzisë, nuk janë dakort me pikëpamjet e tij. Ky është përpjekur të sjellë, në formë shumë transparente, zgjimin islam. Si i tillë ka zgjuar kureshtjen dhe ndërgjegjen islame tek spanjollët, duke investuar për një të ardhme të largët. Ai, ka qenë i vetëdijshëm se do të përballlet me shumë probleme, të cilat i ka argumentuar shkencërisht dhe me anë të përvojës, si dhe ka grumbulluar fakte dhe dëshmi okulare, për shkak të mungesës së historisë së shkruar islame në Andaluzi. Mungesën e shumë ndodhive, që kanë të bëjnë me këtë lëmi, e kanë plotësuar në forma të ndryshme çifutët e sotëm, duke e falsifikuar dhe vjedhur historinë e civilizimit dhe kulturës islame. Ata, me këso faktesh, pasuruan civilizimin e tyre.

Ky libër ka vlerën e vet, sepse përputhet me pesëqindvjetorin e rënies së Granadës, njëkohësisht hap dritaren për studijuesit dhe mundëson që secili të festojë në mënyrën e vet. Mungesa e madhe arabo-islame, tani, ka gjallëruar sërish me xhamitë, shoqatat shkencore dhe kulturore. Ata, tani, e kanë në konsideratë historinë e kohës sonë dhe janë të kujdesshëm për të ardhmen e mjegullt. Kjo formë duhet të jetë shembull edhe për popujt muslimanë, anë e kënd botës.

I mençur është ai, i cili mbështetet tek vetja dhe tek të tjerët, kurse i metë është ai që mbështetet tek të tjerët, ose ashtu siç shprehej Deridi:

Atij që nuk i shërbeu shembulli në kohën e vet

Do të ishte i verbëri udhëzues i tij në vend të udhëzuesit të vërtetë

Kurse ai që gjykon pa dëshmitarë në vend të dëshmitarëve

E shoh se si i afrohet atij ajo, që nuk i përket

All-llahu është mbrapa qëllimit.

HYRJE

Prej paraqitjeve më të rëndësishme të zgjimit islam, në vitet e fundit, është pranimi i fesë në trojet ku Islami nuk ishte më parë, ose aty ku ishte më parë, por që ishte harruar. Paraqitja e Islamit në këto troje, herë është njohur si shumicë, e herë si pakicë, ato kanë qenë të ndërlidhura nga problemet dhe konfliktet historike, veçanërisht nga shtetet që kufizohen me kufijtë e shteteve islame. Shikuar në vija të trasha, zgjimi ka filluar të vijë, ose Islami është rikthyer atje, nën ndikimin e nipërve ose stërnipërve të tyre, stërgjyshërit e të cilëve kishin emigruar më herët, të cilët kishin ëndërruar që Islami një ditë të kthehet në trojet e tyre. Rikthimi i tyre bëhej në forma të ndryshme, por përgjithësisht, ata me vete kishin argumente të forta, kundrejt argumenteve të vendasve. Qeveritë e kësaj kohe nuk kanë instrumente për t'a parandaluar përhapjen e Islamit, sepse feja islame posedon përvojën dhe praktikën e të jetuarit më të mirë, se të gjitha sistemet njerëzore. Një teori, siç është Islami në paqe përhapet shpejt, sepse ndikon drejtëpërdrejt në vetëdijen e individëve.

Por, ajo që të habit, është fakti se zgjimi islamik ka arritur edhe në vende shumë të largëta, në ato kontinente që më parë nuk ishte dëgjuar fare. Një lloj paraqitje e tillë, mund të themi se tani është evidente edhe në Andaluzi, këtu do t'a veçonim jugun e Spanjës së sotme bashkëkohore. Cilat janë shkaqet dhe cili ishte motivi tyre? Kur filloi ajo dhe nga ia ka mësyre?

Këto përgjigje do t'i gjeni brenda këtij libri. Është më se e qartë se, zgjimi islam në shoqërinë andaluziane, nuk ndryshon nga ato që i shohim në botën islame. Shkaku

është se, andaluzianët e përjetuan Islamin për tetë shekuj dhe këta ishin viktimat e parë të persekutimeve dhe barbarisë krishtere. Këta luftuan Islamin, brenda familjeve ose fëmijëve të tyre, derisa i pëkulën plotësisht. Që nga rënia e Granadës, në vitin 1492, kisha nuk është ndalur së persekutuari bashkëkombasit e vet, ajo shpeshherë paraqiste edhe artin persekutues me muslimanët andaluzian. Pas ngadhënjimit të tyre me forcë, ata ndaluan përdorimin e gjuhës arabe, dogjën mijëra libra të lëmive të ndryshme. Atyre nuk ju mjaftoi vetëm kjo, ata do të kënaqeshin sikur t'i kapnin dijetarët e t'i mbytin, duke i djegur ata për së gjalli. Fëmijët e tyre, i merrnin në shkolla të veçanta, për t'ju mësuar krishterizmin.

Edhe pse të mundur, ishin përpjekur t'ju rezistonin të krishterëve gjeneratë pas gjenerate. Ata nuk frikësoheshin nga administrimi inkuizicionist. Ishin të vetëdijshëm se do të digjeshin, apo se vujtjet e tyre do të vazhdonin deri në vdekjen e tyre, nëse nuk bëheshin të krishterë. Kjo administratë ua shkatërroi objektet e kultit dhe ua vodhi pasuritë. Megjithatë, ata rezistuan pa ndihmën e shtetve islame, përplot njëqind e njëzet vjet pas rënies së Granadës.

Rezistenca pushoi pas shumë vuajtjeve, por nuk pushoi jetësimi i Islamit në fshehtësi. Humbën të gjitha vlerat njerëzore, humbën lirinë, krenarinë, nderin dhe shpeshherë herë edhe jetën, por nuk e kishin humbur atë, që ishte më e shtrenjta për ta, imanin-dëshminë La Ilaha Il-lallah Muhammedun Resulullah (Nuk ka Hyjni tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij).

Kjo qëndrueshmëri dhe kryeneçësi, i theu të gjitha forcat kryqtare dhe përfundimisht, në vitin 1609, kryqtarët kishin vendosur që shtresën e lartë të tyre t'a përzënë. I detyruan të largohen dhe dërguan në bregdetin e Mesdheut, mbi një çerek milioni. Të gjithë këta, nuk e flisnin gjuhën arabe dhe gjithashtu kishin emra të huaj,

por që të gjithë ishin krenarë, që nuk ju ishin nënshtuar dhe nuk e kishin fshehur Islamin. Pas kësaj ofenzive-fshesë, muslimanët ishin fshirë nga sipërfaqja e tyre, por tek një numër shumë i madh mbeti kujtimi se ata janë andaluziano-spanjollë. Ky fenomen është paraqitur thujse tek të gjithë popujt, kohë pas kohe, por sa i përket Andaluzisë, për herë të parë, Islami u rikthye më qartësisht në shekullin e njëzetë. Në fillim të këtij shekulli, u paraqit “Pallas Anfanti” lideri i tyre, i cili e përqafoi Islamin, por para jo shumë kohe, ra dëshmor (All-llahu bëftë Rahmet) nga ana e forcave kryqtare.

Në vitin 1975, për herë të parë pas rënies së Granadës, prej një errësire dhe despotizmi, një numër i madh andaluzianësh përkrahën Islamin. Pastaj, prej viteve të 80-ta, shoqatat islame filluan të regjistrohen zyrtarisht. Këto shoqata kanë marrë përsipër detyrën, që popullit andaluzian t’ia mësojnë Islamin sërish. Ata kanë filluar nga parimet e para të tij. Krahës kësaj, ata u mësojnë edhe gjuhën arabe, së bashku me historinë e andaluzisë muslimane.

Ky libër, nxit që në mënyrë shkencore të arrijnë deri tek rrënjët e zgjimit islamik në Andaluzi. Jep informacione mbi luftërat e popullit musliman, gjatë shekujve dhe tregon se si janë orvajtur t’a ruajnë identitetin islam, ose ç’ka mbetur prej tij. Gjithashtu, është nxitës për dhënien e sakrificës për rizgimin islam në Andaluzi. Ato duhet të vazhdojnë derisa t’i mundësohet shoqërisë muslimane të kenë lidhje me ummetin islamik. Atyre duhet t’ju ndihmohet derisa t’a bëjnë elitën e tyre prej intelektualëve muslimanë dhe pastaj, ata t’a shpërndajnë islamin burimor, gjeneratë pas gjenerate.

Para së gjithash, zgjimi andaluzian i tëri është vendor. Ka lindur në shoqërinë andaluziane, nga përvoja e hidhur e tyre. Suksesi i tyre është në duart e vetë shoqërisë vendore, të cilëve iu është mundësuar të bëjnë dialogje me shtresat e ndryshme të popullit. Ne ju dëshirojmë sukses dhe përparim.

Ç'është për All-llahun, vazhdo dhe përkushtohu, kurse
ç'është për të tjerët, ndalo dhe shkëputu. Triumfues i
vetëm është All-llahu i Lartëmadhëruar.

Dr. Ali al Mensur al Kitani

NGRITJA DHE RËNIA E SHTETIT ISLAM

NË ANDALUZI (711-1492)

Islami, në Andaluzi, arriti gjatë viteve 711-714, ndërsa populli i saj ishte i besimit të krishterë, ku një pakicë besonte në trinitetin kishtar, ndërsa shumica dërmuese ishte e konfeksionit krishter unitarist, e që në një masë ishin të shtypur e të përbuzur nga ana zyrtare e kishës dhe pushtetit të asaj kohe. Për këtë shkak, ata (unitaristat) ndiheshin të zhveshur ndaj pushtetit dhe franksioneve të tjera trinitare. Për këto dhe shkaqe të tjera, ata përqafuan Islamin dhe e praktikuan atë me dëshirë dhe pasion të lartë.

Ky integrim, kaq i shpejtë dhe i vrullshëm në Islam, i shtyri shumë mendimtarë bashkëkohorë spanjollë, që atë t'a përkufizojnë si një Revolucion Islamik në botën perëndimore. Padyshim, se një lëvizje e tillë i ngjante revolucionit, sepse për një kohë shumë të shkurtër, hyri nën ombrellën e shtetit islam, pothuajse i gjithë territori i Andaluzisë, një pjesë e Francës së sotme, me përjashtim të zonës malore të Pirinejeve. Pra, territoret që kontrolloheshin nga muslimanët, arrinin sipërfaqen mbi 700 mijë km².

Me kalimin e viteve, dhe si rrjedhojë dhe reflektim i një sundimi të drejtë, u krijua një popull i ri spanjoll, me besim islam dhe gjuhë arabe dhe me tipare të një populli me origjinë autoktone vendase. Pra, ky çlirim i

Andaluzisë, nuk ishte një invazion siç e quanin disa historian, e as një imponim i fesë dhe i gjuhës, që nuk e kish pasur më parë ai popull, por ishte populli spanjoll ai, që e zgjodhi Islamin për fe të tij dhe gjuhën arabe e përvetësoi për vete, si gjuhë të atij civilizimi, dhe nga e gjithë kjo, u pa se populli spanjoll i mirëpriti çlirimtarët e parë muslimanë, siç i pret i shtypuri shpëtimtarët.

Në fillim të çlirimit, Andaluzia, iu bashkua vilajetit (principatës) së Marokut, e cili në atë kohë për kryeqytet kishte qytetin e Kajrevanit (qytet ky, që sot, gjendet në Tunizi), vilajet i cili njëkohësisht ishte edhe pjesa më perëndimore e shtetit islam.

Andaluzia u mëvetësua në vitin 756, kur u shkëput nga pushteti qëndror i dinastisë Abasite me qendër në Bagdad. Këtë ndarje e udhëhoqi princi i Andaluzisë muslimane, Abdurahman al Dakhili al Amavij, i cili u shqua si rithemelues i dinastisë Emevite në perëndim, e i cili për kryeqytet të shtetit të tij të sapomëvehtësuar, zgjodhi qytetin e Kordovës.

Andaluzia, nën sundimin e Emevitëve, arriti një lulëzim dhe ngritje të lartë, sidomos në kohën kur ata e udhëhoqi princi i shquar Abdurrahman al Nasiriu, për gjatë viteve (912-961). Pas kësaj periudhe, Andaluzia filloi të tkurrej dhe të humbë territore, ku nga 700 mijë km², tani u reduktua në 440.000 km². Kjo humbje e madhe në territor, ishte si rezultat i luftërave të pandërprera, që zhvillonte kualicioni i principatave të krishtera në pjesën veriore. Ato principata u njohën me emrat: Principata e Kashtall-ës, Principata e Nebarër-it dhe Principata e Lion-it. Këto principata, në parim, ishin në kundërshtim të një Spanje muslimane dhe me luftërat e tyre të parreshtura morën nën kontroll shumë zona të Spanjës veriperëndimore, si rajonin e Korkoshun-ës, disa pjesë të Francës së sotme, Bartolomenë, regjionin e Barcelonës, regjionin e Bergushit, disa zona të Lionit dhe territore të tjera përreth tyre.

Spanja, si shtet musliman e sunduar nga dinastia emevite, filloi të dobësohet në periudhën e sundimit të princit al Mansur ibn Abu Amir dhe nipit të tij Xhabir Hisham el Thani, derisa pushoi së funksionuari si dinasti, në vitin 1021. Me këtë rast (të themi tragjik për Spanjën muslimane), shteti musliman i Spanjës u nda (u riciklua) në 23 principata dhe mbretëri të vogla. Menjëherë, këtë ndarje të shtetit musliman të Spanjës në miniprincipata, e shfrytëzuan fqinjët e saj të krishterë, të cilët filluan sërish luftërat ofensive kundër këtyre principatave të sapoformuara, duke aneksuar pjesë dhe provinca të tëra të tyre.

Nga këto ofenziva të mëdha krishtere, të cilat zgjatën gjer në vitin 1085, të krishterët aneksuan shumë territore të Andaluzisë, ndër to, edhe qendra urbane të rëndësisë të veçantë, si Tarkanën, Paruxha, Kalmerinë, Madridin si dhe Tulejtulen. Pas kësaj disfate, populli musliman i Spanjës kërkoi ndihmë nga princi i Marokut, Jusuf bin Tahsin al Murabiti, i cili menjëherë iu përgjigj ftesës së tyre pozitivisht. Ky princ i shquar i Marokut, me ushtrinë e tij, arriti që t'i ndalojë të krishterët dhe invazionet e tyre kundër Andaluzisë, në betejën e shquar al Zelake, në vitin 1086. Ai përveç kësaj i rimorri edhe principatat Andaluzisë, që në përbërje të territorit musliman, kapte sipërfaqen e vetëm 250 mijë km², dhe si një njësi të tërësishme territoriale, ia bashkangjiti principatës së vet të Marokut.

Pas një periudhe kohore jo shumë të gjatë, filloi të dobësohet dinastia e al Murabitinëve në Marok, dhe si rezultat i kësaj, muslimanët e Spanjës filluan sërish të rimëvehtësohen si principata të vetëorganizuara, megjithatë, ata prapë u detyruan të kërkojnë ndihmë nga muslimanët e Marokut, për arsye se e ndienin veten të pafuqishëm, përballë koalicionit të principatave të krishtera, që tani shtriheshin në tërë sipërfaqen e Spanjës veriore.

Kësaj radhe, Andaluzianët, kërkuar ndihmë nga dinastia e re e Marokut, e njohur si dinastia e al Muvahidinëve, në vitin 1145. Edhe kësaj radhe, muslimanët e Spanjës dhe principatat e tyre, u detyruan t'i bashkohen principatës së Marokut, përkatësisht të dinastisë al Muvahidinëve, por gjithashtu edhe kësaj radhe me humbje të disa territoreve, që deri në atë kohë ishin nën kontrollin e tyre, pra pa krahinën e Sarkastës, të cilën e invaduan të krishterët, në vitin 1118. Pas kësaj beteje, të krishterët spanjollë u hodhën në ofensivë të përgjithshme kundër Andaluzianëve, përkatësisht kundër dy udhëheqësve të tyre të asaj kohe: Ibn al Ahmar dhe ibn al Hudit. Të krishterët i thyen këta dy prijësa në betejën e njohur të al Ikabit, e cila u zhvillua në vitin 1212. Pas kësaj beteje, të krishterët arritën të pushtojnë (kryeqytetin e parë të Andaluzisë- Kordovën), më 29 qershor 1236. Pas humbjeve të njëpasnjëshme të muslimanëve të Spanjës, në vitin 1237, vdiq njëri nga princërit kryesor të Spanjës muslimane, ibn al Hudi.

Pas kësaj ngjarje tragjike, ibn al Ahmari, bëri riorganizimin e vendit dhe e mori të tërë pushtetin në duart e tij. Njëherësh shpalli si kryeqytet të ri të Andaluzisë, Granadën, si hap për të ribashkuar territoret muslimane të Spanjës. Mirëpo, invazioni i krishterë, në atë kohë, nuk kishte të ndalur, pasi aragonitët edhe pse pushtuan Kordovën, në vitin 1238 ata arritën që të pushtojnë Ballancën, Shatibën dhe territore të gjëra përreth tyre. Ndërsa në vitin 1243, Marseja edhe zyrtarisht iu dorëzua Kashtalljanëve të krishterë, e cila, deri në atë kohë, ishte pjesa më lindore e Spanjës (Andaluzisë muslimane).

Nga ky invazion i krishterë dhe nga tmerret që pasuan mbi muslimanët spanjollë, këta të fundit u detyruan të ikin, respektivisht u deportuan në mënyrë masovike në provincat e Marokut. Ata, nga këto zona, kërkuar ndihmë, mirëpo nuk hasën në përgjigje, e as ndihmë, për arsye se marokenët edhe vet ndërmjet vete, ishin në luftëra civile të brendshme. Këta muslimanë spanjollë u drejtuan edhe

në Tunizi dhe kërkuan ndihmë nga principata e Hafsëve, mirëpo edhe këta nuk qenë në gjendje t'ju ofrojnë ndihmë. Në anën tjetër, ibn al Ahmar, udhëheqësi i muslimanëve të Spanjës, bëri një qëndresë të jashtëzakonshme, gjersa u rrethua në kryeqytetin e Granadës, në vitin 1244. Pas këtij rrethimi, ai u detyrua që t'i dorëzohet princit të krishterë kashtallijan, duke hyrë nën urdhërin e tij, dhe t'i dorëzojë provincat e tjera që kishin bërë rezistencë, siç ishin Ishbilia, dhe tërë zonat perëndimore të Spanjës muslimane (Andaluzisë).

Pas njëqind viteve, në luftëra dhe invazione të pareshtura nga të krishterët, ranë në duart e të krishterëve edhe këto treva muslimane të mbetura, të cilat kishin një sipërfaqe prej 30 mijë km². Këto zona ishin territore të Granadës, Almalikës, Meries, disa zona të Kadisisë, Kurtubës dhe Xhejanës; pra, të gjitha këto zona, ishin me një reliev të thyer malor dhe kanione të njohura, të cilat ishin të papërshtatshme për bujqësi, mirëpo nevoja, në njërën anë dhe intelektu i muslimanëve të Spanjës së asaj kohe, në anën tjetër, i riktheu ato zona në territore maksimalisht të shfrytëzueshme për bujqësi dhe për interesa të ndryshme të kohës.

Këto ngjarje të dhimshme, të sipërpërmendura, çuan në ndryshime rrënjësore tek komuniteti (ummeti) musliman i Spanjës. Kështu, pas çdo okupimi të pjesërishëm territorial nga të krishterët, një pjesë e popullatës muslimane, që përbëhej nga njerëz intelektualë, zanatlinj dhe mjeshtër të ndryshëm, shpërngulej nga zonat e pushtuara, drejt zonave të lira, e në këtë rast, drejt Granadës. Ndërsa shumica e popullatës së thjeshtë, qëndroi nën okupim, e robëruar dhe ishte e painteresuar dhe njëkohësisht nuk kishte fare mundësi për t'u larguar. Të krishterët, këtë shtresë të popullsisë muslimane, e konsideronte më të përulët, injorante, por në të njëjtën kohë, konsideronte se kishin qëllime djallëzore. Pra, kjo pjesë e robëruar e muslimanëve, me gjithë pozitën e tyre nënshtruese, bënte përpjekje që të mbijetojë dhe të organizojë jetën e vet fetare, në bashkësi

të ndryshme, por megjithatë ata konsideroheshin nga të krishterët, minoritarë në vatrat e tyre shekullore. Ata, me një fanatizëm të paparë, u orvatën që t'a ruajnë fenë e tyre, edhe pse jetonin në kushte dhe rrethana shumë të vështira, të cilat në atë kohë konsideroheshin si kushte të robërve klasikë. Ndërkohë, tek ata, u dobësua dhe u varfërua përdorimi i gjuhës arabe, dhe si rezultat i kësaj, ata detyrimisht shkruanin letra dhe libra në gjuhë të huaj, si të katalonasve, kashtalianëve dhe aragonitëve. Mirëpo, këto gjuhë, ata i shkruanin me shkronja arabe.

Përsa i përket Granadës së asaj kohe, numri i banorëve ishte shumëfishuar, si rezultat i migrameve të shumta të refugjatëve, nga zona të shumta të Andaluzisë, përgjatë viteve të luftërave të mëdha, që u zhvilluan në atë vend. Banorët e Granadës, ishin të gjithë muslimanë, dhe gjuhë zyrtare ishte arabishtja, që kuptohet se kishte një dialekt andaluzian, megjithëse edhe në Granadë filloi të përhapet me të madhe, tek vendasit, komunikimi në gjuhë të huaja, për arsye se ajo ishte nën sundimin e të krishterëve.

Megjithatë, Granada konsiderohej vendstrehim i të gjithë muslimanëve spanjollë andaluzianë, një pjesë e madhe e të cilëve ishin muslimanë, që kishin migruar nga zonat e tjera, të okupuara më herët nga të krishterët, dhe një pjesë tjetër ishte gjithashtu prej muslimanëve vullnetarë të Marokut, që në çdo periudhë vinin pareshtur për t'i ndihmuar vëllezërit e tyre muslimanë, në Spanjë.

Të krishterët, gjithnjë, janë munduar që t'a pushtojnë tërësisht Granadën. Këtë gjë u orvatën t'a bëjnë edhe pas vdekjes së ibn al Ahmarit, mirëpo ai, para se të ndërronte jetë, emëroi birin e tij Ebu Abdulla Muhamed al Fakih, për trashëgimtar të fronit dhe njëherësh e la të plotëfuqishme marrëveshjen që kishte bërë me pricipatën e Marokut, që udhëhiqej nga dinastia Merinite, për ndihmë bilaterale dhe ushtarake, mes dy vendeve.

Pra, në këtë kohë të ligë, princit të Granatës, Abu Abdullahut, i erdhi në ndihmë princi i dinastisë al Marinije të Marokut, Sulltan ebu Jusuf al Mansuri, e i cili

personalisht udhëhoqi ekspeditën ushtarake, duke u nisur prej kryeqytetit të tij Fes-it, për në Granadë të Spanjës.

Princi i Marokut, udhëhoqi një ushtri të madhe dhe të fortë, ai i luftoi të krishterët, që e kishin rrethuar Granadën. Princi Sulltan ebu Jusuf al Mensuri, i theu keqas të krishterët në betejat që u zhvilluan në vitet 1275 dhe 1284. I ndjeri Sulltan ebu Jusuf, vdiq në po të njëjtin vit 1284, në ujdhesën al Khadra (e gjelbërt).

Kjo ushtri e lavdishme e al Mansurit të Marokut, pasi që i theu të krishterët, hyri triumfalisht në qytetin e Garnadës, ku u prit përzemërsisht nga muslimanët. Me këtë rast solemn, princi i Granadës e nderoi atë ushtri dhe i privilegjoi nga banorët vendës, duke i lejuar ata, që të themelojnë komunitetin e tyre të përhershëm në Granadë, komunitet, të cilin do t'a udhëhiqte një njeri i urtë, i përzgjedhur nga ata vetë. Ky komitet, kishte për detyrë mobilizimin e të gjithë muslimanëve të ardhur marokenë, të cilët do të bëheshin të aftë dhe do të qëndronin në gjendje gadishmërie, në mbrojtje të vëllezërve të tyre muslimanë të Granadës, në çdo rast sulmi, që do të kanosej nga të krishterët e veriut të Spanjës. Princi trashigimtar i Marokut, Sulltan ebu Jakupi, vazhdoi politikën dhe strategjinë e babait të tij. Ai, me vëmendje të veçantë, përcolli ngjarjet në Granadë dhe në Spanjë, në përgjithësi. Të gjithë u befasuan, kur ai ndoqi rrugën e babait të tij. Ai vazhdoi t'i printe ushtrisë së tij në Spanjë, që kishte për qëllim t'i ndihmonte princit së Granadës, ebu Abdullahut. Kështu vazhdoi deri sa vdiq, në vitin 1302.

Pas vdekjes së tij, të krishterët rifilluan të marrin ofensiva të mëdha kundër muslimanëve të Granadës. Ata i sollën Granadës dhe popullit të saj musliman, humbje të mëdha gjersa, në pushtet të Granadës, erdhi princi ebul Velid Ismaili, në vitin 1314. Ky princ, nuk ishte nga trugu i princërve të dinastisë al Ahmar, që e kishin themeluar principatën e Granadës. Ky princ i ri, bëri një organizim të tërësishëm në principatën e Granadës. Ai, njëkohësisht

krijoi një startegji të re mbrojtëse për vendin e tij, duke rifuqizuar marrëveshjen e koalicionit me Marokun, në njërën anë, ndërsa në anën tjetër, lidhi marrëveshje paqeje me principatën e Aragonitëve (krishtere). Të tërë këtë, e bëri për të qenë i përkushtuar në luftimet e tij mbrojtëse, kundër sulmeve të Kashtalijanëve (të katalonasve). Këtë pozicion, e mbajti gjatë tërë jetës së vet. Pas vdekjes së tij, në pushtet erdhi biri i tij, ebu Abdulla Muhamedi, i cili u detyrua të kërkojë ndihmë nga principata e Marokut, për t'u bërë ballë sulmeve të krishterëve. Ftesës së tij, iu përgjigj pozitivisht princi i Marokut, ebu hasan al Merini. Ai u shkoi në ndihmë muslimanëve të Granadës, ku përgjatë rrugës bëri një betejë të ashpër në Gjibraltar, në vitin 1333 dhe arriti t'i thyejë keqas të krishterët dhe kështu e shpalli të lirë këtë vend (ujdhesë). Në këtë vit, në Granadë, u vra (ra dëshmor) princi ebu Abdullah Muhamedi, të cilin e zëvendësoi ebu Haxhaxh Jusufi. Ky princ, njihet si princ i devotshëm dhe udhëheqës, që kishte një pietet të lartë, ndaj vendit të tij dhe ndaj muslimanëve, në përgjithësi. Ai, për pushtet të tij të fortë, gjeti mbështetje tek një ministër i tij i quajtur Lisanud-din ibn al Khatib.

Granada dhe udhëheqja e saj ishte e ngulfatur nga rrethimet dhe luftërat, që zhvillonin të krishterët kundër saj. Udhëheqësia e Granadës, sikurse edhe paraardhësit e tyre, u detyruan të kërkojë ndihmë nga principata e Marokut, e konkretisht nga princi ebu al Hasan. Ky i fundit, i dërgoi në ndihmë Granadës një kontigjent ushtarësh, me në krye të birin e tij, ebu Malikun. Për fat të keq, ky princ me të arritur në Spanjë, në betejën e tij të parë, u mund nga të krishterët dhe u vra edhe vet. Me të dëgjuar për këtë lajm, princi i Marokut, ebu al Hasani ndërmori një ofensivë ushtarake, që e udhëhoqi vetë. Ai u ndesh me të krishterët spanjollë, në betejën e njohur të Solados, në vitin 1340. Princi ebu Hasan e humbi këtë betejë dhe vetë u zu rob, kurse dy djemtë e tij, që e shoqëronin atë në betejë, u masakruan duke i therur para publikut.

Pas kësaj humbje të princit të Marokut, të krishterët bënë invadimin e të gjitha territoreve muslimane të Spanjës, ndërkohë që duhet të përmendet edhe orvatja e fundit e principatës së Marokut, për t'a kaluar detin dhe për t'i ndihmuar vëllezërit e tyre muslimanë të Spanjës (Andaluzisë).

Pas kësaj humbje të madhe, Granada filloi të çrregullohet me shpejtësi të madhe. Paralelisht me këtë, filluan të lindin probleme edhe në principatën e Kashtalias dhe si indikacion i këtyre problemeve, ishte edhe fitorja që arritën ata. Në Granadë, çrregullimet me të mëdha, u paraqitën pas vdekjes së Ebu El-haxhaxh Jusufit, ndërkohë gjendja u normalizua, kur erdhi në pushtet i biri i tij, Ebu Abdullah El-Ganiji Bilah. Ai, si preventiv për vendin e tij, ndër morri aksion kundër kashtalianëve duke i sulmuar, ndërkohë bëri aleancë me marokenët dhe aragonitët, në njërën anë, kursë në anën tjetër, u angazhua për mirëmbajtjen dhe rindërtimin e vendit të tij. Këtë politikë, dukshëm pozitive, e përcolli edhe i biri i tij, Ebu Abdullah Muhamed bin Jusuf, i cili erdhi në pushtet në vitin 1394.

Gjithashtu, edhe trashëgimtari i tij, Jusuf bin Jusuf, ndoqi po të njëjtën politikë, derisa u ballafaqua me një sulm të egër të krishterë, nga ana e kashtalianëve, të cilët sulmuan dhe pregatitën një ofensivë ushtarake dhe politike jashtëzakonisht të ashpër dhe, si rrjedhojë, okupuan Antakiren, në vitin 1409. Ndërkohë, që sulmet vazhdonin, gjendja në Granadë u keqësua shumë, pasi që në pushtet erdhi i biri i sulltan Jusufit, Ebu Abdullah El-Eiser, në vitin 1417. Në atë kohë, ndërhyrja e Kashtalianëve në punët e brendshme ishte e tmerrshme, derisa përfundoi në kryengritje dhe dhunë. Ky çrregullim rezultoi me largimin nga fronin të sulltan El-Eiserit, në vitin 1428, i cili e humbi betejën e "Lugina e Ashit". Në këtë rast, kashtalianët në bashkëpunim me fisin Siraxh, ju shkoi përshtati ish udhëheqësi El-Eiser, për atë arsye ata e kthyen atë prapë në fron, mirëpo popullata muslimane, me në krye Ebu Abdulla Muhamed El-Ahnafin, me dhunë

e larguan prapë nga pushteti, në vitin 1441. Ky udhëheqës vazhdoi t'i luftojë të krishterët (kashtalianë), derisa ndërroi jetë në vitin 1458, ndërsa atë e zëvendësoi prici Sad bin Muhamed.

Në gjithë këto vite të mbrapshta, përplot me grindje dhe shpifje të brendshme, gjithashtu edhe nga luftërat e pandërprera, Granada pësoi shumë. Ajo humbi pjesë tokësore gjeografike, qytete dhe kështjella, ndërkohë që familjet fisnike dhe mbretërore u shpërbënë dhe humbën, ndërkohë që edhe shtreat e popullatës së ngritur intelektuale dhe asaj në pushtet, pësuan një kataklizmë të vërtetë, si dhe popullata në përgjithësi, dhe qëndrimi i saj, që të mos bashkëpunojë me armikun. Si rrjedhojë, të gjitha këto, çuan në shkatërrimin dhe rënien e Granadës, edhe pse në të u bë një luftë (xhihad) e pandërprerë, rreth dy shekuj. Si duket, kësaj radhe, të krishterët ishin më se të pregatitur që të dominojnë mbi muslimanët në Andaluzi, ndërkohë që muslimanëve nuk mund t'u vinin në ndihmë aleatët e tyre të natyrshëm, marokenët, për arsye se që nga viti 1462, të krishterët e kishin okupuar ngushticën e Gjibraltarit.

Në vitin 1463, Ebu El-Hasan Ali, bëri një kryengritje për pushtet kundër të atit të tij, princit Sad dhe e largoi atë nga pushteti. Ai u konfrontua dhe luftoi edhe vëllain e tij, Ebu Abdulla Muhamed El-Zagal, ndërsa ky i fundit, nga frika e humbjes, kërkoi ndihmë nga armiqtë e të vëllait, nga kashtalianët. Në këtë rast, edhe kjo principatë e vogël, që ishte e Granadës, u nda në dy pjesë, kësaj rrastie, El-Zagal mbajti pushtetin në El-Malika dhe rrethinat e saj, me ndihmën e kashtalianëve të krishterë, ndërsa Ebu El-Hasani mbajti pushtetin në Granadë dhe pjesën më të madhe të saj. Krah i krishterë në Spanjë, principata e Aragonitëve dhe principata e Kashtalianëve, bënë një bashkim (Union), dhe zyrtarisht dëshmi e këtij unoini u bë martesë mes princit Ferdinand, të Aragonitëve dhe princeshës Izabela, të Kashtalianëve, ngjarje e cila rrodhi dhe u zhvillua në vitin 1474. Nga ana e muslimanëve, princi Ebul-Hasan, u orvat që t'a vazhdojë

marrëveshjen paqësore me Kashtalinët dhe Aragonitët, qëllim të cilit edhe ia arriti, mirëpo ata i parashtruan kushte, si: njohjen e sovranitetit të tyre, pagesën e tatimit mbi sigurinë dhe në rast kundërshtimi, marrëdhëniet e tyre kalojnë automatikisht në luftë të dyanshme përsëri.

Prici Ebul-Hasan, udhëheqësi i Granadës, ishte në një farë mënyre edhe dilitant. Ai “si akt brilant për të” ndërmori martesën e tij me një vajzë të krishtere, që quhej Thureja, ndërkohë që ajo ishte e bija e udhëheqësit të Kashtalianëve, Sançez Sulis. Nga kjo grua, atij i lindën dy djem Sadi dhe Nasri. Ebul-Hasani, nga frika dhe egoja e tij, largoi nga qyteti i Granadës gruan e tij të parë me të dy djemtë e tij, Ebu Abdulla Muhamedin dhe Ebu el Haxhaxh Jusufin. Ai, jo vetëm që i largoi të dy djemtë e tij, por njëkohësisht edhe i internoi në kështjellën “Kamarish” të pallatit të kuq. Ata, në një mënyrë, ia arritën që të largohen nga ai pallat, si duket me ndihmën e të krishterëve, të cilët shfrytëzuan nga rasti, dhe u futën në luftë, biri kundër të atit (Ebu el Hasani me Ebi Abdilah). Të krishterët, në vitin 1482, pushtuan tërë rrethinën e qytetit të Granadës, në kualicion me të birin e Ebul-Hasanit, ndërkohë që popullata e Granadës, vullnetarisht përkrahi dhe hyri nën udhëheqjen e Ebi-Abdilahut.

Pas këtij triumfi të pjesërishëm, nga ana e të Krishterëve, ata ndërmorën sulme edhe më të ashpra ndaj pjesës së mbetur të principatës të udhëhequr nga Muhamed El-Zagali, në vitin 1483. Ky i fundit, arriti që t'i mbrojtë trojet e tij, duke i dhënë rast Ebu Abdullahut, që t'i rikthejë disa nga territoret e tij, ndërkohë që ai u kap nga të krishterët dhe u zu rob. Këtë rast, mbreti Ferdinand dhe mbretëresha Izabel, e shfrytëzuan maksimalisht duke ringjallur edhe një herë grindjen në mes të Ebu Abdullahut, në njërën anë, dhe Muhamed-Zagalit, në anën tjetër. Ebu Abdullahu, pasi që u zë rob, nënshkroi një marrëveshje sekrete me udhëheqjen krishtere, duke iu nënshtruar atyre tërësisht dhe duke paguar taksën e sigurisë (El-Xhaixh) në rrotacion vjetor dhe duke e lënë të birin e tij peng. Të gjitha këto, i bëri për t'a rikthyer

pushtetin e tij. Ai ndërmori hapa konkretë në rikthimin e pushtetit të tij mbi Granadë, me ndihmën e të krishterëve, në vitin 1485. Ai, gjithashtu, negocioi me princin Al-Zagal, për t'a bindur atë se duhet të lidhë marrëveshje me të krishterët, mirëpo këta hapa, vetëm sa e acaruan gjendjen politike dhe shoqërore në principatën e muslimanëve të Spanjës. Megjithatë, ata mbetën të ndarë. Ebu-Abdullahu e shtriu pushtetin e tij mbi Granadë, Malika, Almërie dhe Almankibi, ndërsa princi Al-Zagari e mbajti pushtetin në tërë territorin lindor të principatës.

Të krishterët spanjollë, pa humbur kohë, vazhduan ofensivat e tyre kundër muslimanëve-spanjollë. Ata, në vitin 1486, pushtuan Lushan. Më pas, vazhduan të okupojnë territoret, që mbante nën kontroll princi Al-Zagal. Në vitin 1487, okupuan Balshën, Malikan, ndërsa në vitin 1489, ata pushtuan edhe kryeqytetin e pjesës lindore, të quajtur Vadiashin, së bashku me territoret e veta. Pas këtij okupimi, princi Al-Zagal me suitën e tij, u detyrua që të emigrojë në qytetin Telmisan, në Algjeri, ndërsa të gjithë njerëzit e mbetur nën okupim, u trajtuan si robër nga të krishterët. Pas kësaj fitore të të krishterëve, atyre nuk iu mbeti gjë tjetër, veçse të vazhdojnë që t'a pushtojnë edhe pjesën tjetër të principatës së mbetur të muslimanëve në Andaluzi (Spanjë), që udhëhiqej nga princi Ebu Abdullah. Në vitin 1490, princi i krishterë Fernando, dërgoi një emisar special, tek princi musliman Ebu Abdullah, duke kërkuar nga ky i fundit që të dorëzohej. Princi Ebu Abdullah nuk e bëri një gjë të tillë. Ai pranoi që të ballafaqohet me ushtrinë e të krishterëve, mirëpo pasi që të krishterët e rrethuan dy herë Granadën, më në fund në vitin 1491, princi Ebu Abdulla u detyrua që t'a nënshkruajë kapitullimin. Marrëveshja e kapitullimit, si dokument përbëhej nga njëzeteshtatë pika, pjesët e para të saj kushtëzonin që muslimanët, gjer në vitin 1492, t'ua dorëzojnë Granadën dy mbretërve katolikë, ndërsa pikat e tjera të këtij projekt-dokument-dorëzimi përmbanin të drejtat e muslimanëve të Spanjës, nën okupimin e të krishterëve, si: respektimin e fesë dhe traditës së tyre,

mosmarrjen e tyre me dhunë, mosdetyrimin i tyre për të vënë shenja identifikuese të veçanta, mosangazhimin e tyre në aktivitete pa dëshirën e tyre, respektimin e objekteve të kultit respektivisht xhamive dhe dijetarëve, të drejtën që ata në mes vete të aplikojnë rregullat e Sheriatit Islam, që të sigurojnë pronat e Vakëfit dhe objektet administrative të jurisë së saj, që të mos detyrohet asnjëri prej tyre, që me dhunë të heqë dorë prej fesë së tij dhe të konvertohet në fenë e krishterë dhe që, parisë së tyre, t'u rezervohet një e drejtë e veçantë, etj. Ratifikimin e kësaj marrëveshje e aprovuan të dy mbretërit katolikë, duke garantuar me fenë e tyre dhe nderin e tyre, se ata do t'a respektojnë këtë projekt-dokument, në tërësi. Njëkohësisht, pasuan nënshkrimet dhe aprovimet edhe nga trashëgimtarët e fronit mbretëror katoliko-spanjoll dhe u deklarua se kjo marrëveshje do të jetë e respektuar, me statut të përhershëm. Në po të njëjtën ditë, të krishterët spanjollë, që ishin armiq të muslimanëve spanjollë, nënshkruan edhe një marrëveshje sekrete me princin e trashëgimtarin për pronësinë edhe pasurinë e të atit të tij Ebi El-Hasan, etj...

Në këtë marrëveshje ata e avancuan princin Ebu Abdullah, familjen dhe suitën e tij, duke i dhënë në pronësi të përhershme atij dhe gjithë atyre që e shoqëronin atë, trevat e Elbesharat-it, të cilat shtriheshin përreth Endershit dhe Azras-it, njëkohësisht atij i dhuruan edhe 30.000 funta kashtaliane. Gjithashtu, i dhanë mundësi të veçantë që t'a ruante dhe t'a mbante pasurinë e Princit Ebu Abdullah që kishte vendosë t'ua dorëzojë principatën e Granadës, armiqve spanjollë të krishterë, por duke pasur frikë se mos populli i tij do të revoltohej, ai ua dorëzoi Granadën të krishterëve, më 2 Janar të vitit 1492.

Kjo ditë ishte e veçantë për të krishterët spanjollë, prandaj edhe e festuan atë, duke marrë në pronësi të tëra trevat e shtetit musliman të Spanjës, tokën e saj, xhamitë, shkollat, tregjet dhe popullin e saj. Një rast i veçantë, ishte kur një ministër i principatës muslimane, i quajtur Ibën-

Kemashe, i dorëzoi kardinalit Mendusa, çelësat e pallatit ALHAMRA dhe kur ky kardinal, me të marrë çelësat, hyri në pallat dhe në në pikën më të lartë të sfondit të faltores vendosi një kryq dhe bëri një lutje të krishterë. Princi Ebu Abdullah, pasi e verifikoi pasurinë e tij personale dhe e bëri konfirmimin e tij legal, duke iu nënshtuar të krishterëve, u largua për në Enderish, si vendqëndrim i tij i përhershëm. Kështu pra, ndodhi edhe rënia (shkrirja) e shtetit Islam në Andaluzi (Spanjë)dhe pas kësaj, filloi sprova e madhe e muslimavëve të mbetur në Spanjë.

TIRANIZIMI DHE KRISHTERIZIMI I DHUNSHËM (1492-1568)

Pas dorëzimit të Granadës, u caktuan dy udhëheqës katolikë: Konti Ditanfia, si udhëheqës politik dhe Irnando Talbire, si ipeshkv. Pas kësaj ngjarje historike dhe vendosjes së Ebu Abdullaut në pronën e tij private, gjërat filluan të ndryshojnë. Ai, u detyrua që t'a shesë pasurinë e tij, vetëm për 21.000 derhem ari kashtalianë dhe pas kësaj, së bashku me suitën e tij dhe ministrat emigroi në kryeqytetin e Marokut, Fas. Një numër i madh i veteranëve të Granadës, e ndoqën rrugën e tij të emigrimit, prej tyre kishte udhëheqës, juristë, teologë, dijetarë, bujqër dhe shumë të tjerë. U shpërngul edhe një ndër udhëheqësit ushtarakë të Granadës, i quajtur Ebul-Hasan-Ali-Elmenzuri, në zonat jugore të Sebdas. Ai, kërkoi leje nga princi Ebu Abdullah-Elvetasi, që me forcat e tij vetjake të bëjë rindërtimin e qytetit të Tatuani, dhe solli në të, shumë të shpërngulur të tjerë nga Andaluzia. Një numër i madh i personelit shtetëror dhe i princërve, kaloi ne fenë e të krishterëve me vetëdëshirë, prej tyre: princi Sad dhe princi Nasir, së bashku me nënën e tyre Thurejën, princi Jahja së bashku me gruan dhe të birin e tij, shumica e familjes së Benigash-it, prej tyre edhe dy ministrat e njohur Ebu-Elkasin, Bin-Ridvan dhe Jusuf-Bin Kemashi, si dhe shumë të tjerë...

Politika e të krishterëve spanjollë, ndaj principatës së Granadës, ndryshoi shumë shpejtë. Ata filluan me transferimin e xhamisë së madhe të Granadës në katedrale, pastaj kisha e tyre filloi të organizojë grupe të deleguarish, për t'i ftuar muslimanët e Granadës që të

kalojnë në fenë krishtere. Në vitin 1499, kardinali Seiseniros, i ftoi të krishterët spanjollë, që sa më shpejt t'i konvertojnë muslimanët në katolicizëm. Ai filloi me të madhe që t'i transferojë xhamitë në kisha. Në të njëjtën kohë, bëri trysni mbi parinë e muslimanëve të Granadës, për t'u konvertuar në fenë e tij, ata dhe shoqëria e tyre. Nga ky invazion ideologjik krishter, muslimanët e mbetur të Granadës, detyrimisht u organizuan në kryengritje për t'i mbrojtur të drejtat e tyre elementare fetare dhe kulturore. Ata u shquan me kryengritjen e Elbejaenit, në vitin 1500, të cilën e udhëheqi Ibrahim bin Umeje. Kjo kryengritje, u shua nga të krishterët, udhëheqësi i saj u vra, bijtë e tij dhe gruaja e tij u robëruan. Në fund të këtij viti, pasoi edhe një kryengritje tjetër, në rrethinat e Benfikës dhe luginës së Almansurës së Almeries, por edhe kjo kryengritje, u shua me një egërsi të paparë, siç u shua edhe kryengritja e Randës, në fillim të vitit 1501.

Ndërsa përsa i përket anës organizative dhe shoqërore, kisha dhe dy udhëheqësit e krishterë spanjollë, vazhduan një punë sistematike dhe të programuar, duke i konvertuar muslimanët e Spanjës me dhunë në krishterizëm. Ata bënë regjistrimin e ri tek famulltari, ndaj të gjithë banorëve të Andaluzisë, gjatë viteve 1500-1501, pastaj u morr vendimi zyrtar me 12.10.1501, për transferimin e të gjitha xhamive në kisha, gjithashtu u morr edhe një vendim tjetër, po ashtu shumë i ashpër, i cili urdhëronte djegien e të gjitha librave islame dhe atyre me shkrim arab. Ky vendim, u aplikua në të gjitha qytetet dhe fshatrat e principatës së Granadës, por më i veçanti ishte, kur u dogjën me mijëra libra voluminoze, në qendrën Alremle të Granadës. Më vonë, këto autoritete zyrtare andaluziane nxorën vendimin, me të cilin ndalohej përdorimi i gjuhës arabe, urdhëruan që të konfiskohen të gjitha armët e gjetura të llojit murusian, dhe në këtë rast, ata që nuk i aplikonin këto urdhëra për herë të parë, dënoheshin me burgim, ndërsa nëse e përsëritnin një gjë të tillë, atëherë dënimi për ta ishte shumë i ashpër - ekzekutim me vdekje.

Pas këtij gjenocidi të paparë, popullata e mbetur muslimane e Andaluzisë, nuk gjeti rrugëdalje tjetër përpos që të kërkojë ndihmë nga udhëheqësit myslimanë të asaj kohe, të cilët ishin princi i Marokut, Abdullah-Elvetasi, princi i Egjiptit, i ndershmi Kansuh Elguri, si dhe nga kreu i shtetit islam, me qendër në Stamboll, sulltan Pajaziti. Të gjitha këto kërkesa të popullit spanjoll, mbetën të parealizuara, për shkak se asnjëri prej të lartpërmedurve, nuk mundi që t'iu dalë në ndihmë.

Autoritetet spanjolle, nën udhëheqjen e kishës, themeluan një organ të veçantë diskriminues ndaj muslimanëve të Spanjës, që quhej Gjykata e Inkuizionit. Kishat krishtere, edhe me parë kishin themeluar gjykata të ngjashme, sikurse kjo që u përmend më lart, si në Itali, Francë, Gjermani, etj. Këto gjykata, në atë kohë, kishin për detyrë që të bënin vëzhgimin dhe hulumtimin e shoqërisë dhe të gjenin ato mendime dhe lëvizje, të cilat ishin në kundërshtin me mendimet kishtare. Për t'i arritur këto qëllime, ato (gjykatat), gjatë hetuesisë bënin përndjekjen, shpërndajen dhe ekzekutimin e atyre, që kishin mendime të kundërta me ato të gjykatës.

Pra, historiku i tyre është ky: gjykata e parë e tillë, u themelua në vitin 1242, në Principatën e Aragonitëve (Spanjës), e ashtuquajtura Gjykata –‘Hetusia e vjetër’.

Në vitin 1459, mbreti Kashtalian Henriku i IV, kishte urdhëruar priftërinjtë dhe i kishte angazhuar ata, që të bënin hulumtimin dhe zbulimin e atyre individëve ose qarqeve, që mendonin dhe vepronin ndryshe nga mendimi zyrtar. Ndërsa, në vitin 1478, kreu krishter Papa, urdhëroi për herë të parë themelimin e “Gjykaës së Inkuizicionit”.

Në këtë rast, kjo gjykatë kërkonte nga të gjithë anëtarët e saj, që të jenë në shërbim të spiunimit, në të mirë të kishës dhe vendit të tyre. Njëkohësisht, ajo bëri ngritjen e numrit të prokurorëve, nga 3 që ishte në 10, d.m.th se paria e Andaluzisë, në atë kohë, bëri përzgjedhjen edhe të 7 priftërinjëve të rinj, në nivel të

prokurorëve. Në vitin 1483, Papa kishte lëshuar një vendim, me të cilin urdhëronte themelimin e këshillit më të lartë të hetuesisë, i cili do të përbëhej nga 4 prokurorë, nën udhëheqjen e prokurorit të përgjithshëm, i cili do të ishte edhe kryetar i këshillit. Ky person, me peshë kaq të madhe, u emërua nga paria mbretërore spanjolle, e ky ish Turkimada famëkeq, që shquhej për arrogancën e tij si njeri i pamëshirshëm, i krisur dhe i pamoralshëm dhe pervers. Në vitin 1498, këtë njeri kaq agresiv, e zëvendësoi prifti i njohur Disa, i cili shquhej gjithashtu për një arrogancë dhe pashpirtësi edhe më të madhe se paraardhësi i tij.

Gjykata e Ikuzicionit, ishte një organ me të gjitha të drejtat për hetime, për ndjekje, kontroll, hulumtim dhe me vendimmarrje (gjykim). Kjo gjykatë, në fillim, e njoftonte të akuzuarin për arrestim, pastaj e ftonte atë që të deklarohej dhe të dëshmonte para trupit gjykues. Pas kësaj, lënda dërgohej tek një komision i veçantë (më i larti, që përbëhej nga priftërinjtë), në shumicën e rasteve ky komision ishte jokompetent dhe pa njohuri të majftueshme, për të gjykuar. Pas vendimit të këtij komisioni, që në shumicën e rasteve ishte arbitrar, i akuzuari arrestohej dhe burgosej pa e ditur fare shkaqet. Të arrestuarin, 3 ditë radhazi e paraqitnin në seanca gjyqësore, ku kërkonin nga ai, që t'a pranonte gabimin, për të cilin ai vetë nuk ishte në dijeni. Në këtë rast, nëse i akuzuari e pranonte gabimin, dënohej pa mëshirë, ndërsa kur nuk e pranonte gabimin, apo nuk e njihte atë fare, keqtrajtohej dhe persekutohej, derisa e pranonte me dhunë gabimin, për të cilin nuk ishte në dijeni. Në shumicën e rasteve, të akuzuarit, nga dhuna e madhe që ushtrohej ndaj tyre, vdisnin nën tortura, e në rast se shpëtonin, atëhere, atyre u mvisheshin gabime dhe vepra penale, të cilat nuk i kishin bërë fare dhe këto akuza ngriheshin tek organi vendimmarrës, i cili përbëhej nga priftërinjtë dhe, pothuajse, në të gjitha rastet, vendimet ishin të paskrupullta.

I akuzuari e kishte një të drejtë ankese. Ai kishte të drejtë të bëjë ankesë tek Papa, por në këtë rast, duke u penduar për "gabimet e bëra" dhe duke garantuar me të gjithë pasurinë e tij që kishte. Në këto raste, pak prej këtyre ankesave kishin përgjigje pozitive, po edhe nëse ndonjëra kishte përgjigje pozitive nga Papa, atëherë si dëmshtëpërblim ndaj dhunës, persekutimit dhe pasurisë, që ia konfiskonte të akuzuarit, i lëshonte një vërtetim, në të cilin dëshmohej për pafajsinë e tij. Ndërsa, në rast se i akuzuari, akuzohej me akuzë të rëndë dhe vërtetohej fajësia e tij, atëherë i akuzuari burgosej, pa ditur asgjë për fatin e tij. Ai transferohej, siç thuhej në "sektorin e besimit". Atij i vishej "uniforma e bekuar", në qafën e tij vihej litari i vdekjes, ndërsa në dorën e tij një qiri, pastaj transferohej zyrtarisht në kishë dhe nga ai kërkohet që të pendohej e më pas dërgohej në gjykatoren publike.

Atje i shpallej dënimi: zakonisht dënimi ishte i përjetshëm, pastaj shpallej konfiskimi i pasurisë së tij, e në rast se i dënuari kishte bërë vepër "mosbesimi", dënimi më i ashpër ndaj tij ishte djegia mbi turrën e drunjve. Këto gjykime me vdekje, ishin të shumënumërta ndaj muslimanëve të Spanjës. Në shumicën e rasteve, këto ekzekutime vëzhgoheshin nga paria shtetërore, priftërinjtë, organet e gjykatës dhe masa e gjërë popullore. Në shumicën e rasteve, ekzekutoheshin familje të tëra, burra, gra, pleq, të rinj dhe fëmijët e tyre. Këto ekzekutime i merrte përsipër gjykata famëkeqe e inkuizicionit, e cila i mbante të gjitha përgjegjësitë për likuidimet individuale, grupore dhe familjare. Anëtarët e kësaj gjykate, gëzonin të drejta të pakufizuara, njëkohësisht ata rridhnin nga familje të njohura për punë të mbrapshta dhe morale. Pra, muslimanët e Spanjës, ishin nën diskriminimin e paparë të këtyre gjykatave, që nga themelimi i tyre, në vitin 1499.

Pasi që u shtypën edhe lëvizjet e fundit islame në Andaluzi (Spanjë) dhe u anulua çdo që ishte zyrtare islame, popullatës muslimane në Andaluzi (Spanjë), nuk i mbeti gjë tjetër, përveç që publikisht t'iu nënshtrohej

rregullave krishtere dhe kishtare, ndërsa fshehurazi, t'a mbante dhe t'a aplikonte fenë e vet Islame, t'i mësojë të rinjtë dhe brezat e rinj me gjithçka që ishte e drejtë dhe islame, duke shpresuar se një ditë të re do të agojë, me ndihmën e Allahut Fuqiplotë.

Shteti dhe kisha spanjolle, në atë kohë, vendosi që t'i radikalizojë vendimet dhe t'i bëjë ato më të ashpra, ndaj muslimaneve të Spanjës. Në vitin 1508, u rishqyrtua dekreti mbretëror i Spanjës, në të cilin u ndalua veshja islame në Spanjë. Ndërsa në vitin 1510, ndaj një pjese të muslimanëve të Mursikisës, u aprovua taksa e veçantë, e quajtur "Alfariza" d.m.th. "Obligative". Në vitin 1511, shteti spanjoll u ndaloi muslimanëve të Spanjës të mbajnë armë, ua dogji të gjitha librat islame, që i kishin të fshehura, njëkohësisht ua ndaloi atyre prerjen e kafshëve, simbas Islamit. Këto vendime, qeveria e atëhershme, i rivazhdoi edhe gjatë viteve 1512 -1513. Ky ekspansion i paparë ndaj muslimanëve të Spanjës, ishte në kohën e mbretit Fernando. Por edhe pas vdekjes së tij, në vitin 1516, trashëgimtari i tij, mbreti Karlosi i V, vazhdoi rrugën e tij të dhunshme ndaj Islamit. Mbreti Karlosi i V, në fillim të pushtetit të tij, nuk ishte edhe shumë i ashpër ndaj Islamit, mirëpo në vitin 1523, situata ndryshoi kur ai nxori një vendim të ri, me të cilin urdhëroi që të krishterizohen me dhunë të gjithë ata muslimanë, që kishin ngelur ende në Spanjë, ndërsa ata që refuzojnë të krishterizohen, të dëbohen dhe të largohen, nga trojet e tyre të Spanjës. Në rast se dikush nga muslimanët i refuzonte këto dy vendime mbretërore, atëherë, atë e priste robëria e përjetshme. Banorët muslimanë të Maoriskisës u ankuan ndaj këtij vendimi dhe për këtë ankesë, vetë mbreti Karlos, në vitin 1526, shkoi në kryeqytet, Granadë, që t'a vëzhgojë gjendjen nga afër. Ai e angazhoi gjykatën supreme dhe prokurorinë e saj të përgjithshme, që t'a verifikojë dhunën dhe detyrimin që ushtrohej ndaj muslimanëve në fenë krishtere. Pas kësaj gjykata, vërtetoi se nuk kishte ndërhyrje flagrante gjatë procesit të krishterizimit të muslimanëve. Pas këtij

vendimi të gjykatës supreme, mbreti miratoi një ligj, i cili nuk i lejonte muslimanët të largoheshin nga Spanja, por e bënte të domosdoshme krishterizimin e fëmijëve të tyre dhe dënimin me vdekje të të gjithë atyre, që refuzonin konvertimin nga Islami në krishterizëm.

Ky ligj, gjithashtu ndalonte ligjëratat dhe shkresat në gjuhën arabe, njëkohësisht urdhëroi për shkatërrimin e banjove publike, gjithashtu urdhëronte që shtëpitë e banorëve Maurisien (muslimanë) të qëndronin gjithmonë me dyer të hapura, në mënyrë që të ishin gjithmonë nën vëzhgimin e “shtetit ligjor”. Nga ky vendim, shihet se përveç represionit të paparë, muslimanët Maurisianë të Spanjës detyrohen që të mësojnë dhe të komunikojnë gjuhën spanjolle.

Nga ky vendim, maurisianët muslimanë të Spanjës, u detyruan që të bashkëpunojnë dhe të hyjnë në marrëveshje me mbretin Karlos, që t’a shtyjnë këtë vendim, të marrë me afat prej 40 vjetësh, duke i paguar atij një taksë të veçantë, me shumë prej 80.000 forinta ari të pastërt. Kjo marrëveshje, në mes të maurisianëve dhe mbretit Karlos, ishte aplikuar deri në atë masë, sa nuk ballafaqohej me punën dhe vendimet e gjykatës së inkuizicionit. Në vitin 1555, mbreti Karlosi i V-të vdiq dhe atë e trashëgoi Filipi i II-të, i cili kishte një personalitet të dobët, në krahasim me priftërinjtë e asaj kohe, mirëpo në stilin e tij ishte mjaft kryeneç. Ai, në vitin 1560, ua mohoi të drejtën që të posedonjë robër, ndërsa në vitin 1563 e ripërsëriti vendimin e babait të tij, që i ndalonte ata që të posedojnë armë. Ndërsa në vitin 1564, e anuloi vendimin paraprak, që ju jepte të drejtë maurisianëve mbi pronësinë e paraardhësve të tyre.

Në vitin 1566, pasi që kishin kaluar 40 vite nga marrëveshja e ish-mbretit Karlos, mbreti Filipi i II-të, vendosi që të aplikojë vendimin, që kishte marrë i ati i tij mbi krishterizimin e banorëve me dhunë, dhe përndjekjen e të gjithë atyre që refuzojnë këtë vendim, duke i burgosur, përdhunuar, duke ua marrë pasurinë dhe së

fundi, duke i hedhur në zjarr. Ky vendim, u publikua në të gjitha territoret e Granandës, më 01. Janar. 1567. Komunikimin e këtij vendimi e morri gjykata e inkuizicionit, duke e lajmëruar atë, në çdo lagje të banuar. Nën shoqërinë e njerëzve vullnetarë të krishterë, me daulle dhe surle filloi aplikimin ky ligj diskriminues, duke i shkatërruar banjot publike dhe duke i mbushur me të burgosur burgjet, njëkohësisht duke masakruar edhe shumë muslimanë, kufomat e të cilëve ngelën rrugëve të Granadës dhe fshatrave të saj. Pas këtij tmerri të paparë, muslimanëve Mauricianë, nuk u mbeti gjë tjetër, përveçse të mendojnë për një kryengritje të armatosur.

Ndërsa principata e Portugalisë, shfrytëzoi nga të gjitha këto raste, duke u zgjeruar territorialisht, në llogari të tokave muslimane në Andaluzi (Spanjë).

Kjo principatë krishtere shtrihej në pjesën Veri – Perëndimore të Spanjës.

Ajo, në vitin 1603, kishte pushtuar zonën e Paruxhës.

Pastaj, në fundvitin 1603, pushtoi zonat e Kalimirisë, ndërsa në vitin 1904, pushtoi Lisbonën që e përzgjodhi për kryeqytet, siç pushtoi në vitin 1606 zonat e Jaburës, ndërsa në vitin 1617, mori në sundim Shelben dhe pallatin e Benidanesit, ndërsa në vitin 1649, vuri nën kontroll të gjitha territoret e Spanjës perëndimore .

Nga ky zgjerim dhe okupim, cekim se Portugalia e asaj kohe, i mbajti këto treva nën okupim, të cilat edhe sot e kësaj dite përputhen me kufirin aktual portugez. Portugalia, gjithnjë, pasoi aplikimin e vendimeve antimuslimane, që ndërmerreshin nga pushteti spanjoll i asaj kohe, p.sh. kur Spanja vendosi t'i krishterizojë muslimanët e saj, në vitin 1499, Portugalia filloi t'a aplikojë këtë vendim, në vitin 1502. Kur ky ligj, filloi të aplikohet në principatën e Portugalisë, atëherë shumica e muslimanëve u detyruan të emigrojnë në Marok. Ndërsa pjesa e vogël e mbetur, u diskriminua deri në masën e mosdeklarimit, si muslimanë.

Kronologjia e diskriminimit

Përveç asaj periudhe aq të errët dhe jo në favor të muslimanëve të Spanjës, që u cek më lart, tani do të pasojnë disa të dhëna kronologjike që flasin për diskriminimin ndaj muslimanëve të Spanjës. Shumë muslimanë të Toledos, ngelën nën pushtimin Katalonas, në vitin 1085, pastaj pason shekulli i XII-XIII-të, në të cilët bien nën pushtim Marseja, Kordova, Espalia, etj.

Në vitin 1258, mbreti Alfonso, aprovoi një vendim, i cili me sanksiononte të madhe të drejtat e muslimanëve në Spanjë dhe, nga ana tjetër, avanconte aksionet që merreshin me krishterimin e muslimanëve dhe, si rezultat i kësaj, pasoi kryengritja e muslimanëve nga Zona e Shershit, në përfundim, deri në Zonat e Marseit, në lindje. Kjo kryengritje daton në vitin 1261.

Principata e Katalonisë, së bashku me atë të Aragonitëve, e luftuan këtë kryengritje, deri sa e shuan atë, në vitin 1266. Muslimanët e rrethinës së Marseit, u detyruan që të izolohehen të pavarur, nën udhëheqjen e parisë së fisit Benihud, gjer në vitin 1308.

Ndaj muslimanëve të Spanjës, pasuan ligje të ashpra dhe sanksionse, gjatë viteve 1348, 1368, 1371. Nga këto ligje, më të dalluarat ishin: dhënia e shenjave të veçanta në rroba të muslimanëve, ndalimi i tyre që të zhvillojnë punë dhe detyra të ndershme, të larta dhe fisnike dhe përndjekjen e atyre, që nuk i zbatonin këto ligje.

Në vitin 1387, i ndanë venbanimet për muslimanë dhe të krishterë, ndërsa në vitin 1388, u morr vendimi që muslimanët të bëjnë përshëndetje homazhi kryqi.

Ndërsa, në vitin 1408, muslimanët u ndaluan që të ushqehen me krishterët, dhe u aprovuan ndëshkime ndaj atyre, që e thyenin këtë rregull, si edhe vendime të tjera të shumta, që i ndanin këto dy konfeksione të popullatës spanjolle.

Ndërsa, në vitin 1422, u mor ligji për dënimin me vdekje ndaj atyre, të cilët pengonin muslimanët, që të konvertoheshin në të krishterë.

Gjithashtu, u morrën edhe vendime të tjera ndëshkuese me vlerë materiale, kundër muslimanëve, gjatë vitetve 1435 dhe 1438.

Ndërkohë, mbretëresha Elizabet, në vitin 1476, morri vendimin për mbylljen e gjykatave islame, si dhe për caktimin në veshje të muslimanëve, në vitin 1480, morri vendimin që t'i robërojë të gjithë muslimanët e ardhur nga principata e Granadës. Në vitin 1502 u mor vendimi me vdekje për të gjithë ata që refuzonin konvertimin e tyre në krishterizëm, apo dëbimin e tyre nga trojet e veta, siç u mor vendimi për moslejim komunikimi ndërmjet muslimanëve katalonas dhe atyre të Granadës, ndërsa në vitin 1515, u mor vendimi për konvertitimin në të krishterë të të gjithë muslimanëve të Katalonias, Lionit, dhe dëbimin nga vatrat e tyre, të të gjithë atyre që refuzonin konvertimin.

Gjthashtu, u mor edhe një vendim tjetër diskriminues, i cili ndalonte të gjithë ata, që përqaфонin fenë krishtere, në Katalonia, që të kontaktonin me ata banorë të Granadës.

Të krishterët, pasi i okupuan, dominuan mbi muslimanët të cilët i kishin marrë nën kontroll ato vende, që prej vitit 960, ndërsa Sarkastën në vitin 1118, Gjabsen në 1235, Balansen në 1238, dhe në fund ujdhesat lindore të Majorkës, në vitin 1286.

Marrëveshja e Balanisas, në mes të muslimanëve dhe të krishterëve, garantonte pasurinë, prodhimin, besimin, gjuhën dhe sherijatin Islam në zonat muslimane.

Mirëpo, princi Aragonit, porsa mori drejtimin e Principatës muslimane në Sp manjë, nuk i përfilli asnjë nga pikat e marrëveshjes. Ai, jo vetëm që nuk e respektoi marrëveshjen, por dhunoi çdo gjë që ishte muslimane. Ai uzurpoi dhe transferoi edhe xhamitë në kisha.

Nga kjo dhunë e paparë, muslimanët u detyruan që të organizohen në kryengritjen e vitit 1254. Ata dominuan mbi Shatiban, Vedanien dhe Velaknet. Këtë kryengritje, princi Krushter spanjoll, mezi arriti që t'a shuajë në vitin 1268, me ndihmën e tërë Evropës, nën urdhërin e Papës.

Pasuan ligjet diskriminuese të vitit 1268, që i detyruan muslimanët prapë të bëjnë kryengritje, e cila vazhdoi që nga viti 1276, deri në vitin 1277. Në vitin 1283, u aprovuan ligje diskriminuese për kryerjen e punëve të ndershme (nga ana e muslimanëve).

Në vitin 1301, muslimanët i humbën disa siguri shtetërore, që i kishin më parë. Në vitin 1328, u mor vendimi që muslimanët spanjollë të vihen nën mëshirën e feudalëve të krishterë.

Ndërsa, në vitin 1342-1370, muslimanëve të mbetur andoluzianë iu ndalua që të emigrojnë në territoret e Granadës, apo të Marokut.

Në mes viteve 1371-1403, muslimanëve iu ndalua e drejta që të kenë robër (shërbëtorë privatë), ndërsa në vitin 1418, u lëshua një dekret zyrtar, i cili ua kufizonte lirinë e lëvizjes, muslimanëve të Spanjës edhe brenda territorit të vet, me një fjalë ata u vendosen nën një kontroll të rreptë nga të krishterët spanjollë, ndërsa në vitin 1428, u nxor një dekret tjetër, i cili u jepte të drejta të plotëfuqishme feudalëve të krishterë, që t'i gjykojnë rastet e muslimanëve, të cilë ishin nën kontrollin e tyre.

Vuajtjet e muslimanëve të Andaluzisë, sa vinin dhe shtoheshin edhe pas rënies së Granadës, ata u detyruan me dhunë, që të konvertohen në fenë krishtere, me përjashtim të një afati kohor, që ua lejoi princi Karlosi i V-të, i cili për kompensim, për ruajtjen e fesë së tyre, i detyroi ata që të paguanin taksën vjetore prej 40.000 duka (forit) ari të pastërt.

Kjo situatë qëndroi ashtu siç ishte, deri në pjesën e dytë të shekullit të XVI-të, kur muslimanët u detyruan që të bënin një kryengritje të përgjithshme popullore, mirëpo, këtë kryengritje, princi krishter Karlosi i V-të, e shuajti me

dhunë, duke i vënë në lëvizje dhe luftë, të gjithë të krishterët evropianë, kundër muslimanëve të Spanjës.

Pas kësaj beteje të përgjakshme, muslimanëve të Spanjës nuk u mbeti gjë tjetër përveç dy rrugëve ju kishin ngelur: disa prej tyre u shpërngulën për në Marok dhe Algjeri, ndërsa pjesa tjetër, më e pafuqishme, mbeti nën okupimin e krishterë, në mes të krishterimit me dhunë dhe izolimit familjar, fisnor, ndërprovincial.

Reprezaljet dhe apartejdi (1570-1608)

Pas okupimit të Granadës, dhuna dhe reprezaljet e të krishterëve, ndaj muslimanëve spanjollë, sa vinin dhe shtoheshin, kështu që në vitin 1570, një dekret i këshillit mbretëror spanjoll, legalizoi shpërnguljen me dhunë të banorëve të Maurisisë, për në territoret e Granadës. Ky vendim i ashpër, u bë pas shuarjes së kryengritjes së Ibën Abuv-it. Njëkohësisht, ky vendim mbretëror kishtar spanjoll, u zgjerua në legjislacion me nëntekste 28/10 dhe 1/11, vendim të cilin e vuri në fuqi një princ i quajtur Huan El-Nemsau. Ky princ i ashpër, me ushtrinë e tij, i detyroi të gjithë banorët e Maurisisë që të shpërngulen nga trevat e tyre, duke iu lejuar atyre që t'a tubojnë dhe t'a marin me veti pasurinë e tundshme. Njëkohësisht, morën vendim që t'ua konfiskojnë tërë pasurinë e patundshme, dhe me dhunë filluan t'i integrojnë fiset dhe familjet e tyre në shoqërinë krishtere spanjolle.

Programi i krishterë, për shpërnguljen e muslimanëve të Spanjës, u caktua që të bëhet në 7 provinca spanjolle. Ato ishin: Granada, Basta, Vadiashin, Elmerie, Bajre, Malika dhe Randa. Zakonisht, këto qendra kishin edhe territoret e tyre të shpërndarjes. Pra, si fillim, të krishterët bënë grumbullimin e më se 46 mijë muslimanëve, në një vend të caktuar. Muslimanët ndaheshin nga 1500 anëtarë, të shoqëruar nga bagëtitë e tyre dhe qerret e stërngarkuara me plaçka, konvoj ky, që shoqërohej dhe

mbikëqyrej nga 200 ushtarë kalorës të krishterë, të cilët e përcillnin konvojin këmba këmbës, në ato rrugë të vështira, në borë dhe në shi. Muslimanët e Spanjës, pleq, gra dhe fëmijë udhëtonin të pashpresë. Prej tyre, 10% vdiqën nga pasojat e rrugës, ndërsa 21 mijë arritën në Basta, 6 mijë në Toledo, 22 mijë në Kordovë dhe 5 mijë e 500 në Ishbili.

Faza e tretë, e shpërnguljes së muslimanëve të Spanjës me dhunë, u zhvillua në pikat e vendosjes primare, dhe gjatë shpërndarjes së tyre, nëpër qendra sekondare, siç ishin disa qytete të vogla dhe fshatra.

Ndërsa, faza e katërt, u zhvillua duke i shpërndarë ata nëpër lokalitete, shtëpi të caktuara, duke mos u lënë atyre mundësi komunikimi në mes vete. Kjo shpërngulje masive, përfundoi në vitin 1570 dhe rezultoi me 17.000 të vdekur dhe vetëm 33.000 të shpëtuar nga represajlet dhe dhuna.

Në vitin 1571, qeveria spanjolle e asaj kohe, vendosi të shpërngulë me dhunë, tërë popullatën muslimane të Granadës, drejt Principatës të Kashtalasm-ës, popullatë e cila numëronte 80.000 banorë.

Por, në të njëjtin vit, qeveria spanjolle nxori një rezolutë, me të cilën i lejonte qeverisë që të konfiskojë tërë pasurinë e muslimanëve të Granadës dhe transferin e saj, në kuadër të pronës mbretërore .

Ndërkohë, mbreti spanjoll vendosi që t'a renovojë qytetin e Granadës, nën përkujdesjen e gjykatës së lartë supreme dhe urdhëroi 50.000 banorë të krishterë, nga veriu i Spanjës që t'a kolonizojnë qytetin në rrethinë. Pas këtij urdhri të zbatuar nga kolonët të krishter, një numër jo i vogël i tyre, u rikthye në vatrat e tyre në veri, meqë kishin jetën e tyre më solide atje, ndërsa në anën tjetër ndodhi që një numër i muslimanëve të rikthehen ilegalisht në vatrat e tyre.

Në periudhën e shekullit XVI-të, muslimanët e rikthyer të Granadës, së bashku me vëllezërit e tyre në zonat rurale, malore të Granadës, organizuan grupe

vullnetarësh, “luftarë vullnetarë” të Islamit, në Spanjë. Gjatë kësaj periudhe 30 vjeçare, ata ndërmorrën aksione luftarake të rrepta kundër qeverisë dhe kishës së krishterë spanjolle.

Nga këto aradha luftëtarësh, shquhej grupi i luftëtarëve të zonës së Randës, nën udhëheqjen e Ibën El Melihit, e cila operoi përgjatë viteve 1571-1576. Të krishterët spanjollë ua kishin frikën muslimanëve të Spanjës, edhe pse ata ishin të shpërndarë dhe të shkapërderdhur në tërë territoret e Spanjës (Andaluzisë).

Shteti i krishterë spanjoll, gjatë tërë kohës së kësaj periudhe (fundi i shek.XVI-të), me gjithë reprezaljet që ushtronte ndaj muslimanëve, ua kishte frikën atyre, për arsye se muslimanët e Spanjës, edhe pse ishin të shpërndarë, aktivizoheshin në celula dhe bërthama, të gatshëm dhe me vullnet të madh, për t’a luftuar shtetin e krishterë spanjoll. Njëkohësisht, ata kishin dëshirë të paparë, për t’a kthyer në jetë shtetin musliman spanjoll (Andaluzian). Këtyre planeve dhe ndryshime shoqërore iu qëndronte prapa shteti i ri i osmanlinjëve që kishte arritur të vendoset në teritoret Tunizisë, në vitin 1574. Nga ky rast, qeveria krishtere spanjolle ndërmori hapa preventivë, duke i larguar banorët muslimanë të zonave bregdetare të principatës së Mauricisë. Përveç atij rreziku (osman), ndërkohë si rrezik u paraqit edhe kontakti i mirë, tani i pakicës muslimane, me një fraksion të krishterë protestant, që vinte nga territoret e Francës. Nga të gjithë këto trazira të brendshme, rezultoi një luftë civile ndërkonfeksionale, në të cilën muslimanët e Spanjës u therorizuan dhe u masakruan, për arsye se shteti ua kishte konfiksuar atyre armët që më parë. Megjithatë, muslimanët e Spanjës, në aspektin diplomatik i qëndruan besnik një lidhjeje të fortë, e cila i bëri ata të jenë deri diku të mbrojtur. Kjo lidhje, ishte marrëdhënia e tyre e pandarë, me principatën muslimane të Marokut, e cila ishte krahu i djathtë i ndihmës së muslimanëve spanjollë.

Shteti osman, konsiderohej si shteti amë i të gjithë muslimanëve të asaj kohe dhe fuqia kryesore (më e madhe në Detin Mesdhe) dhe botë, si edhe protestantët e Francës (hokonët francezë), fraksion ky, i cili edhe pse ishte i krishterë, bashkëpunonin me muslimanët spanjollë, në të mirë të muslimanëve dhe të interesave të tyre grupore. Perandoria osmane, në këtë periudhë jo të favorshme për muslimanët e Spanjës, bëri disa veprime pozitive në dobi të tyre, saqë ndër të krishterët spanjollë, kishën dhe gjykatën e ikuizicionit e vlerësuan si lëvizje shumë të rrezikshme dhe rrezik për integritetin territorial të Spanjës së asaj kohe. Mirëpo në aktin final, kur organizimin e një qëndrese ndërmuslimane në Spanjë, e morën muslimanët mauricianë, ata edhe zyrtarisht i kërkuan ndihmë portës së lartë (perandorisë osmane), në vitin 1578-1580. Këto kërkesa kishin bërë, që në vijën bregdetare të Balansisë dhe Sarkastës, të vendosej një vijë komunikimi direkt me portën e lartë. Njëkohësisht, u kërkua ndihmë materiale dhe ushtarake. Për fat të keq, perandoria osmane nuk iu përgjigj kërkesave të muslimanëve të Spanjës.

Në vitin 1571, muslimanët e Aragonisë së vjetër, arritën që të kontaktojnë dhe të bëjnë kualicion me disa fraksione spanjolle, si orvatje për t'u liruar nga pushtimi i krishterë. Udhëheqësi i shquar Bejarini, në kualicion me muslimanët e Aragonisë së vjetër dhe muslimanët e Algjerisë, bëri një kryengritje, duke filluar nga bregdeti i Ballansias. Kryengritja, e muslimanëve të Aragonisë së vjetër, u bë gjatë viteve 1585-1588. Në këtë kryengritje, mori pjesë edhe fraksioni i njohur francez, i quajtur Hokanë.

Shteti i Spanjës dhe institucioni i kishës, me tërë fuqinë e tyre, u orvatën që t'i konvertojnë të gjithë muslimanët e Spanjës në fenë krishtere, mirëpo koha kaloi dhe ata nuk mundën që t'a arrijnë një gjë të tillë. Në shekullin e shtatëmbëdhjetë, përfundimisht, shteti spanjoll i asaj kohe, i përshkroi tri rrugë, për të arritur qëllimin e tij:

1. T'i izolojnë të gjithë muslimanët mauricianë në një lokalitet të mbyllur dhe të izoluar.

2. T'i vrasin, ekzekutojnë të gjithë dhe

3. T'i shpërngulin të gjithë nga territori i Spanjës.

Pas humbjes së të krishterëve në betejën e Vadi al-Makhazin, të vitit 1581, të krishterët spanjollë me në krye mbretin Filipi i II-të, organizuan tubimin e Lisbonës, nga ku nxorrën konkluzionin, se propozimi i tretë 'dëbimi i të gjithë muslimanëve mauricianë nga Spanja' ishte mënyra e vetme, që të krishterët e Spanjës t'i realizonin qëllimet e veta. Dhe po në këtë vit, mbreti Filip urdhëroi themelimin e një komisioni të veçantë, për të bërë studimin e gjendjes së shtetit, para dhe pas shpërnguljes së muslimanëve mauricianë nga Spanja. Ndërsa nga ana tjetër, kuvendi shtetëror spanjoll, bëri të gjitha rillogaritjet e këtij deportimi masiv dhe verifikoi edhe njëherë, se megjithë dëmet shtetërore dhe të hyrat në fondin mbretëror, si dhe interesa të tjera materiale, megjithatë shpërngulja masive e të gjithë muslimanëve nga Spanja, ishte zgjidhja e vetme e favorshme për të krishterët.

Më 17.09.1587, shteti spanjoll i asaj kohe, vendosi që t'i shpërngulë me dhunë të gjithë muslimanët e mbetur të Spanjës, njëkohësisht urdhëroi që fëmijët e tyre t'ua dorëzojnë kishës për t'i mbikqyrur dhe krishterizuar, gjithashtu ky urdhër lejoi ekzekutimin e të gjithë atyre, të cilët nuk e praktikonin këtë vendim. Ky vendim i shëmtuar, u aplikua gjer në vitin 1598, kur vdiq mbreti Filipi i II-të. Pas tij, në fron erdhi i biri i tij, Filipi i III-të i cili, kishte personalitet të kundërt nga i ati. Ai ishte i lig si personalitet dhe njëkohësisht, me iniciativë dhe vullnet të dobët. Ndërsa, në vitin 1599, kuvendi shtetëror spanjoll, prap e shqyrtoi çështjen e shpërnguljes me dhunë të muslimanëve mauricianë të Spanjës. Ata njëkohësisht vendosën si aneks shtesë të vendimit kapital, që popullatën e vjetër, mbi moshën 60 vjeçare t'a shpërngulin, fëmijët nën moshën 15 vjeçare t'ua dorëzojnë për mbikqyrje kishës, ndërsa të tjerët t'i internojnë në

kampet e punës së rëndë, në ngarkim-shkarkim në portë, gjer në vdekjen e tyre. Njëkohësisht një ministër i shtetit, propozoi që burrat e tyre të mos shpërngulen, sepse ata mund të bëhen ushtarë potencialë të ndonjë ushtrie armike të Spanjës. Për fat të mirë, këto propozime nuk u aplikuan.

Pas mossuksesit të spanjollëve në ofensivën e tyre, që ndërmorrën ndaj Algjerisë, në vitin 1602, shteti spanjoll vendosi të rifillojë shpërnguljen e muslimanëve drejt brigjeve të Afrikës veriore, mirëpo, kësaj radhe kisha e refuzoi një gjë të tillë, duke thënë se tani, ato familje të mbetura muslimane, publikisht e kishin pranuar krishterimin dhe në rast shpërnguljeje, ata do të detyroheshin me dhunë të bëhen muslimanë dhe, për kishën, kjo do të ishte një humbje. Pikërisht, për këto kundërtënie të pushtetit dhe kishës spanjolle të asaj kohe, personaliteti i Papës kishte ndërhyrë në vitin 1608, duke i urdhëruar të dyja palët, që t'a vërtetojnë konvertimin e tyre në të krishterë.

Deportimi masiv i muslimanëve nga Spanja (1608-1614).

Në vitin 1608, kuvendi shtetëror spanjoll vendosi unanimisht deportimin masiv të të gjithë muslimanëve mauricianë nga Spanja. Ky kuvend vendosi gjithashtu, që përdeportimin e tyre do të kujdesen aristokratët e krishter ndërsa për shpenzimet e tyre do t'ju lejohet atyre që t'ua marrin pasurinë të dëbuarve muslimanë. Njëkohësisht, ky kuvend urdhëroi organet përgjegjëse, që pasurinë e mauricianëve të tjerë dhe të muslimanëve në përgjithësi, t'a mbikqyrte me vëmendje, deri në një vendim tjetër.

Pushteti Spanjoll gjithashtu vendosi që muslimanët mauricianë t'i deportojë nën akuzën e rëndë të tradhëtisë shtetërore, duke i quajtur ata si kolaboracionistë me të huajt, siç ishin marokenët, fraksionet franceze dhe kontaktet e tyre sekrete me shtetin osman. Në këtë kohë,

Papa nuk i kishte pëlqyer deklaratimet e shtetit Spanjoll, se mauricianët spanjollë ishin mosbesimtarë, por ai kërkoi nga shteti Spanjoll, që të jepte më shumë nga vullneti i tij, që t'i bëjë ata të krishterë të devotshëm. Mirëpo, mbreti spanjoll i injoroi të gjitha këto këshilla dhe e pa të arsyeshme, që t'i deportojë të gjithë mauricianët, duke u mbështetur edhe në situatën globale, pasi në atë kohë Maroku ishte në luftra të brendshme, kurse shteti otoman, gjithashtu, ishte në konflikt me territoret e tij të lindjes. Ndërsa Anglia kishte marrëveshje paqeje me Spanjën, kurse prej Francë së vetmuar, nuk pritej ndonjë rrezik.

Dhe si shkak i tretë, për deportimin me dhunë të mauricianëve nga Spanja, ishte edhe fakti se ata kishin një natalitet të lartë, në krahasim me të krishterët, për shumë arsye. Nga to ishin se mauricianët nuk ishin të obliguar që të shërbenin në ushtri, ata nuk e përdornin alkoholin, martoheshin të rinj dhe ndër t'a nuk kishte murgjër. Pra këto ishin edhe një shtytje diskrete për shtetin e krishter spanjoll të asaj kohe, që të marrë vendime të njëanshme dhe arbitrare, për dëbimin masiv të një pjese të popullatës autoktone spanjolle, nga vatrat e tyre shekullore. Mauricianët, duke i parë këto vendime si arbitrare dhe diskriminuese, një numër i madh i tyre, vendosën t'a shesin pronën e tyre para se shteti t'ua konfiskonte dhe ndërkohë ata u shpërngulën në drejtim të Afrikës veriore dhe maleve Franceze të Albertit. Shteti spanjoll i zhgënjyer nga këto veprime të planifikuara të mauricianëve, vendosi në vitin 1608, t'a urdhëroi personelin kufitar që mauricianëve t'ua konfiskonte të gjithë pasurinë që ata bartnin gjatë deportimit.

Shteti spanjoll, në vitin 1609, vendosi që t'i shpërngulë muslimanët e mbetur të Balansias, mirëpo për të qenë më efikas dhe për t'a realizuar sa më mirë shpërnguljen, ata e mbajtën sekret datën dhe vendin, prej nga ku do të deportohen. Kështu që, pushteti spanjoll, pregatiti anijet e tij dhe njëkohësisht mori me qera anijet e flotës italiane dhe i tuboi në ujëdhesën Marika dhe prej aty, i drejtoi për në portin e Balansias, nga ku do të fillonin rrugën e

deportimit. Ky vendim i ashpër për deportim, nuk u realizua edhe ashtu fshehurazi si ishte planifikuar, për arsye se popullata e thjeshtë spanjolle e kundërshtonte, duke u arsyetuar se një gjë e tillë do t'a varfëronte tregun e punëtorëve të krahut, si dhe do t'i mungonte shoqërisë spanjolle një pjesë jo edhe aq e vogël e popullsisë. Mirëpo, me gjithë kundërshtimet e popullatës, shteti spanjoll, në bashkëpunim me kishën, vendosi që t'a finalizojë procesin e deportimit të muslimanëve nga Spanja.

Ky vendim, u realizua në gjysmën e dytë të vitit 1609. Organet ekzekutive të këtij vendimi, urdhëruan familjet muslimane që t'i pritnin radhët në shtëpitë e tyre dhe të mos merrnin asgjë nga pasuria e tyre e tundshme, përveç asaj që mundnin t'a bartnin në duar, ndërsa pasuria e patundshme e tyre, si dhe bagëtia dhe pjesët e tjera të pasurisë së tyre, u takonte sipas marrëveshjes, aristokratëve të krishterë spanjollë dhe shtetit të Spanjës. Ky vendim i deportimit i kursente vetëm fëmijët e vegjël dhe ata të cilët dëshmonin pamëdyshje krishtërimin, si fe të tyre.

Ishte vendim i ashpër dhe i vrazhdë, i ekzekutonte të gjithë ata, të cilët devijonin dhe orvateshin që në një mënyrë ose tjetër, t'i shpëtonin këtij deportimi. Në këtë rast, mauricianët muslimanë debatonin për situatën në të cilë ata gjendeshin, dhe disa prej tyre mendonin që të fshiheshin dhe t'i shmangeshin deportimit, ndërsa të tjerët e shihnin deportimin si një çlirim nga Zoti i madhërishëm dhe si mënyrën më të sigurtë për mbrojtjen e fesë së tyre. Mirëpo, si përfundim, ata vendosën që të mos dredhojnë, por të jenë të dëgjueshëm dhe t'i nënshtrohen deportimit masiv. Megjithëkëtë, mauricianët muslimanë të Spanjës, gjatë deportimit masiv nga Spanja, iu nënshtroan një diskriminimi të paparë dhe torturave të lloj-llojshme, prej atyre të plaçkitjes, e deri tek fundosja e shumë prej tyre në det.

E gjithë kjo llahtari e katrahurë, e ushtruar ndaj muslimanëve mauricianë nga ushtria spanjolle, hajdutët

dhe pirateria e detit, bëri që gjatë periudhës, prej shtatorit të vitit 1609 e gjer në janar të vitit 1610, nga brigjet e detit spanjoll dhe porteve të saj: Laknata, Vedania, Elxhabia, Rozafa, Belansia, Bniaruse etj, të deportohen jo më pak se 120.000 muslimanë spanjollë.

Muslimanët e deportuar spanjollë nuk u pritën mirë, as nga vendësit arabë të veriut të Afrikës. Nga kjo situatë jo e favorshme, disa prej tyre, që ishin në radhë për t'u shpërngulur, e ndërruan mendimin dhe kështu ata vendosen që t'ua mësyjnë bjeshkëve të bregdetit spanjoll, në kufirin e sotëm me Italinë, ndërsa të tjerët u hodhën në kryengritëje në portin e Laknatës. Në këtë rast, pushteti spanjoll urdhëroi ushtrinë dhe lejoi hajdutët dhe rebelët e vendit, që të bëjnë masakra të papara mbi ata muslimanë, saqë një numër shumë i vogël i tyre, arriti disi t'i shpëtojë më të keqes, duke hypur në barka dhe me shumë peripeci u larguan nga skëterra e atëhershme e muslimanëve e quajtur Spanjë.

Pas këtij deportimi masiv të muslimanëve të principatës së Balansias, qeveria e Spanjës, në vitin 1611, mori vendimin për të bërë një revizion të brendshëm dhe një spastrim të detajuar edhe të atyre muslimanëve, që eventualisht kishin mbetur në Balansia. Pra, qeveria bëri publike shumën prej 60 lira ari, për secilin që sjell para pushtetit një musliman të fshehur, ndërsa shumën prej 30 lira ari, për secilin që sjell para pushtetit, kokën e prerë të ndonjë muslimani të fshehur, në principatën e Balansias. Numri i përgjithshëm i muslimanëve të deportuar nga Balansia, konsiderohej të ishte 130.000 anëtarë.

Spanjollët krishterë pasi që i deportoi muslimanët e Balansias, vendosi që t'i shpërngulë me dhunë jashtë trojeve të tyre edhe muslimanët e tjerë të Spanjës, të cilët ishin të shtrirë në Granadë, Marsejë, Xhejan, Kashtalia dhe Batlios, me përjashtim të principatës së Aragonisë së vjetër (Sarkastës). Këta të fundit, pra muslimanët e Sarkastës, duke e parë rrezikun e shtetit të krishterë spanjoll dhe sjelljet e tyre me muslimanët e territoreve të

tjera të Spanjës, vendosën në heshtje, që t'i shesin pasuritë e tyre të patundura dhe të largohen nga Spanja. Në këtë rast, shteti spanjoll, duke e parë lëvizjen e muslimanëve të Sarkastës, vendosi të lëshojë urdhër, që askush mos t'i blejë tokat e tyre dhe nëse ndodhte një gjë e tillë, atëherë do të dënoheshin si shitësi, po ashtu edhe blerësi i asaj pasurie, me dënime drakonike.

Pas kësaj ngjarjeje të hidhur, qeveria spanjolle sooli edhe një dekret të ri në po këtë vit 1610, që brenda një afati shumë të shkurtër (tri ditësh), të gjithë muslimanët e Aragonisë së vjetër, t'i lirojnë shtëpitë e tyre dhe të dalin nëpër sheshe të caktuara, duke ju lejuar atyre që të marrin në duart e tyre vetëm pasurinë, që u bart krahu. Po ashtu, ata u urdhëruan që mos t'a fshehin pasurinë e marrë, por t'a bënin publike në çdo rast kontrolli. Atyre iu lejua që t'i marrin me vete fëmijët nën moshën katër vjeçare, ndërsa atyre, të cilët padyshim kishin kaluar në krishterizëm iu rikonfirmua se ata kishin të drejtë qëndrimi në vendin e tyre. Në të kundërtën, qeveria e Spanjës e asaj kohe, do të vendoste burg me punë të rëndë për të gjithë ata, që nuk e zbatonin këtë urdhër, ose që i shmangeshin atij në çfarëdo mënyre qoftë ajo. Pas kësaj urdhërese, aragonitët muslimanë u grumbulluan në 35 pika të ndryshme, e më pas u transferuan për në portin e Feqashit të Katalonias së vjetër. Përgjatë kësaj rruge, ata u trajtuan shumë keq nga ushtria përcjellëse spanjolle. Ata i plaçkisnin, duke ua marrë edhe atë pak pasuri, që ua kishin lejuar për t'a bartur me vete organet e tjera shtetërore, gjithashtu i detyronin që të bëjnë pagesën e tatimit të transferit deri në port, si për të pasurit po ashtu edhe për të varfërit. Një numër jo i vogël i muslimanëve të Aragonisë, vendosi që të shpërngulet për në Francë, nëpërmjet maleve të Albertit. Pra, si tërësi, deportimi i muslimanëve të Aragonisë së vjetër, kapi shifrën e 61.000 të deportuarve. Ndërsa, nëse marrim edhe shifrat e atyre muslimanëve, të cilët u deportuan nga ujdhesat e Aragonisë dhe vendeve të tjera, atëherë kjo shifër rritet edhe për 19.5000 të deportuar.

Në të njëjtën kohë, pushteti spanjoll vendosi t'i deportojë nga vatrat e tyre shekullore edhe muslimanët e Katalonias, numri i të cilëve nuk ishte i madh, si në principatat e tjera. Numri i muslimanëve të Katalonias së asaj kohe nuk e kalonte numrin e 4.000 personave.

Ndërsa në vitin 1611, pushteti spanjoll vendosi që të bëjë deportimin e muslimanëve të principatës së Marsejës dhe të principatës së Kashtalias. Në këtë deportim, bënë pjesë edhe muslimanët e Vernishit dhe të Batliosit. Në këtë rast, të krishterët e Marsejës bënë një demonstrim, në shenjë moskënaqësie për deportimin e vendësve të tyre muslimanë nga vatrat e tyre, mirëpo një pakënaqësi të tillë, qeveria spanjolle, nuk e mori në konsideratë. Tërësisht, nga zona e Marsejës, u deportuan rreth 22.000 banorë, ndërsa nga zona e Batliosit me rrethinë, u deportuan rreth 8.000 banorë. Pushteti gjithashtu vendosi edhe për deportimin e muslimanëve të Ishpiliat, të cilëve u dha afat prej 30 ditëve, për t'i shitur pasuritë e tyre të patundshme dhe për t'u shpërngulur nga portet jugore të Andaluzisë së vjetër. Numri i këtyre të shpërngulurve, arriti në 52.000 të deportuar.

Urdhëri i qeveris spanjolle për deportim, përfshiu edhe muslimanët e Kashtalias së re dhe të vjetër, Elmanshas, Stramadorës, Furasë, etj. Nga këta muslimanë vendës, një numër i konsiderueshëm i tyre, u deportua përmes rrugës së Bergushit për në Francë, ndërsa një numër tjetër përmes Kartagjenës u shpërngul për në Algjeri. Si tërësi, nga kjo krahinë e Andaluzisë, u deportuan me dhunë rreth 50.000 banorë autoktonë, vetëm e vetëm se ishin të fesë Islame. Pra, marrë në tërësi, që nga viti 1609, e gjer me 1614, nga territoret e Andaluzisë së vjetër, u deportuan me dhunë mëse 327.000 banorë autoktonë muslimanë, nga ta 195.000 nga Principata e Aragonisë, ndërsa 132.000 nga Principata e Kashtalias. Pas këtij deportimi masiv të muslimanëve të Spanjës, mbreti i Spanjës, Filipi i III-të, doli në një tubim zyrtar para popullit të tij, dhe në krye të qeverisë dhe njerëzve të tij falenderoi Zotin e tij,

publikisht, në shenjë mirënjohjeje për përfundimin me sukses të deportimit të muslimanëve.

Nga ky deportim masiv, shumica e muslimanëve të Spanjës u vendosën në Marok, Algjeri, Tunizi, si dhe në vende të tjera islamike. Vetëm në Marok, numri i refugjatëve arriti në 60.000 persona. Mes tyre kishte edhe personalitete të njohura të asaj kohe si: Ahmed bin Al-haxhari, përkthyesi i Princit të muslimanëve të Spanjës, zotëriu Zejdan Al-sadi, mjeku i njohur i asaj kohe Ebilkasim Elvezir bin Muhamed Elgasani, si dhe dy atashetë e njohur të shtetit musliman të asaj kohe: Jusuf Buskivjani dhe Ahmed bin Majubi, etj. Gjysma e këtyre të deportuarve me dhunë nga Spanja, që u drejtuan për në Marok, u vendosën në zonat veriore të vendit, konkretisht në Tatvan, Shafshavin, Kasri Alkabir dhe në zonat përreth tyre.

Ndërsa, mëse 10,000 prej tyre u vendosën në zonën e Ebi Qaraqit, të cilët e ringritën qytetin e njohur të Al-Rabatit. Ndërsa 10.000 të tjerë u vendosën në qytetin e Fes-it. Kurse të tjerët në zonat përreth tyre. Shteti maroken i asaj kohe i priti mirë refugjatët muslimanë të Spanjës, mirëpo popullata nuk i priti edhe aq mirë, përveçse në zonat e Fesit dhe të Tatvanit, ku kishte edhe më parë muslimanë spanjollë të vendosur prej kohe.

Numri i refugjatëve muslimanë të Spanjës, të cilët shkuan në Algjeri, ishte 65.000. Shumica e tyre ishin nga Balansia dhe Aragonia, ndërsa një pakicë ishte nga Marseja. Rreth 25.000 prej tyre u vendosën në kryeqytetin Algjer, ndërsa të tjerët në qytete të mëdha si: Telmisan, Bexhajah, Musteganim, etj.

Pushteti qëndror i Perandorisë Osmane i priti këta refugjatë muslimanë jashtëzakonisht mirë, por disa banorë të rretheve të Algjerisë, të njohur si piratë, bënë disa aksione vjedhjeje me dhunë dhe i sulmuan aq shumë, saqë qeveria e Algjerisë, së bashku me personalitete të njohura të vendit, ndërmorri aksion urgjent për t'i mbrojtur këta banorë të ardhur muslimanë, nga të cilët

Algjeria pati vetëm dobi, nga njohurit e tyre në bujqësi, zanate dhe prodhim.

Ndërsa rreth 50.000 të dëbuar të tjerë muslimanë nga Spanja u vendosën në Tunizi. Ata u pritën ngrohtësisht, nga pushteti qendror osman, si edhe nga pushteti vendës tunisian. Qeveria e Tunizisë ju dha atyre autonomi në qëndrim dhe lëvizje, po ashtu e gradoi të parin e tyre të zgjedhur nga ata, si përfaqësues legjitim, si dhe i siguroi ata nga sulmet eventuale të piratëve arabë të Tunizisë.

Pra, numri i përgjithshëm i të dëbuarve muslimanë të Spanjës, që u vendosën në shtetet e veriut të Afrikës, kapi shifrën 180.000 refugjatë. Ndërsa të dëbuarit e tjerë, që ishin nga Aragonia, kaluan zona të tëra franceze dhe italiane, në drejtim të Perandorisë Osmane. Në këtë kohë, në pushtetin islam ishte Sulltan Ahmed i I-rë, i cili ndërhyri tek qeveritë e Francës, Anglisë dhe Italisë që t'ua lehtësonte kalimin tranzit, atyre muslimanëve spanjollë, që ishin drejtuar nga Perandoria Osmane. Një numër i tyre, u vendosën në Bosnje dhe Hercegovinë, ndërsa një numër tjetër në Selanik. Shumë prej tyre shkuan në Stamboll, të cilët më pas ndërtuan lagjen e njohur të Stambollit të quajtur 'Gallatasaraj'. Ndërsa një numër tjetër u drejtua drejt lindjes së afërt (Sirisë) qytetit të vjetër të Damaskut dhe zonave të tjera bregdetare, që njihen me Libanin e sotëm. Pra, numri i të deportuarve muslimanë të Spanjës, që u vendos në territoret, ku shtrihej pushteti i Perandorisë Osmane, arriti në 40.000 refugjatë

Ndërsa, për në shtetet e krishtera evropiane, u shpërngulën rreth 10.000 muslimanë të Spanjës. Kështu pra, numri i përgjithshëm i të deportuarve muslimanë të Spanjës, arriti në 230.000 refugjatë. Por një numër shumë i madhe që kap shifrën prej 65.000 të tjerë u fundosën në detin e hapur, gjatë eksodit të tyre, apo u vranë, u masakruan apo vdiqën prej sëmundjeve të ndryshme. Ndërsa 32.000 të tjerë, nga rrethana të

caktuara, u detyruan që të kthehen prapë, nën pushtimin e krishterë të Spanjës.

Muslimanët e mbetur në Spanjë gjatë shekujve 17-18-të.

Në Spanjë, vazhdoi avazi i vjetër kundër muslimanëve, mirëpo tani me një theks të veçantë ndaj atyre, që ktheheshin ose fshiheshin për të mbijetuar në vatrat e tyre. Në këtë kontekst, mbreti i Spanjës nxorri një dekret, në vitin 1614, dhe e shpërndau atë në të gjitha territoret e Spanjës. Në atë dekret, thuhej: “Pasi që procesi i dëbimit të muslimanëve mauricianë u realizua në tërësi, atëherë kërkohet nga të gjitha organet shtetërore dhe individët, që t’i marrin të gjitha masat dhe të bëjnë kontroll për zbulimin e të gjithë atyre muslimanëve, që janë fshehur ose janë rikthyer.” Thirrja e mbretit iu drejtohej spanjollëve, duke u kërkuar atyre që të bëjnë ekzekutimin e të gjithë atyre muslimanëve, të cilët ishin rikthyer pas largimit të tyre, nën përcjelljen zyrtare shtetërore.

Gjithashtu, iu bë me dije gjykatave që t’i konsiderojnë të mbyllura lëndët e mauricianëve muslimanë, të cilët ishin dëbuar nga Spanja. Shteti spanjoll i asaj kohe, u orvat me çdo kusht që t’a përmbyllë çështjen e mauricianëve dhe për këtë gjë ndërmorri hapa të shpejtë për (spastrimin) e të gjithë atyre, që eventualisht ishin fshehur ose ishin rikthyer në Spanjë. Mbreti i Spanjës, urdhëroi Qeverinë që gjatë viteve 1614-1621, të bëjnë përndjekjen intensive të mauricianëve muslimanë, të cilët për një arsye, apo për një tjetër, kishin ngelur ende në trojet e tyre në Spanjë.

Në vitin 1621, vdiq mbreti i Spanjës Filipi i III-të, dhe atë e trashëgoi i biri i tij, Filipi i IV-të. Mbreti i ri nuk shihte ndonjë rrezik nga mauricianët muslimanë, të cilët kishin mbetur, apo ishin kthyer fshehurazi në Spanjë. Ky mbret, u përqëndrua vetëm në transferin e pasurisë së tyre, nga pasuria private në atë shoqërore dhe i urdhëroi

qëndrat administrative lokale, që të merren me të gjitha ankesat dhe problemet shoqërore, duke ua bërë me dije se nuk ka nevojë të bëjnë represione mbi mauricianët e mbetur dhe se ata duhet të gëzojnë të drejtat në jetë, si të tjerët.

Ndërkohë, mbreti e angazhoi pushtetin lokal për t'i mbikqyrur rrethanat e banorëve, por, në të njëjtën kohë, e konsideroi të mbyllur çështjen e përndjekjes së mauricianëve muslimanë të Spanjës. Pra, ishte viti 1624, kur mbreti spanjoll, me dekret të veçantë, e llogariti si të përfunduar këtë çështje të rëndësisë së veçantë. Mirëpo, ende disa krahina të Spanjës, nuk i kishin dorëzuar raportet e tyre rreth mauricianëve dhe lëvizjet e tyre ilegale, dhe për këtë arsye, në vitin 1625, doli një raport nga krahina e Kashtalias dhe Ishpilisë, duke thënë se një numër i madh i tyre, jetonte në këto zona dhe po ashtu ata u akuzuan se po bënë veprime të paligjshme, në dëm të banorëve spanjollë.

Përsa i përket mauricianëve të mbetur në Spanjë, në një mënyrë apo tjetër, ata ishin nën një kontroll të ashpër lokal, por mbret, me një interes qëndror, i mbronte ata dhe për këtë nxorri një vendim të plotëfuqishëm, në vitin 1626, me të cilin ndalonte çdo abuzim ose fyerje ndjenjash ndaj mauricianëve. Kurse në vitin 1634, rrethi i krahinës së Marsejës dhe të Kartagenës, përmes ipeshkvit kishtar, i bëri një raport Këshillit të Lartë shtetëror dhe kërkoi përcjelljen dhe kontrollin ndaj mauricianëve muslimanë. Ndërsa, në vitin 1712, Këshilli i Lartë i Shtetit, kërkoi që të largoheshin përsëri, të gjithë mauricianët muslimanë të mbetur në Spanjë, vendim që mbreti spanjoll dhe qeveria e tij, asnjëherë nuk e aplikuan.

Megjithë vendim-marrjen e këtyre ligjeve diskriminuese, prapë se prapë, gjykata e inkuizicionit nuk i ndali represaljet e veta ndaj muslimanëve mauricianë të Spanjës. Për këtë, ata ndërmorrën një varg reprezaljesh, duke i varur disa robër mauricianë në Ishpilia, Kordovë dhe Madrid; po ashtu, i dhunuan dhe i persekutuan, duke

i rrahur publikisht ata, që pranonin Islamin si fe të tyre dhe i shtypën dhe injoruan deri në absurd të gjithë ata, që në veten e tyre ndjenin krenarinë e fesë së tyre.

Këto ngjarje, rrodhën përgjatë viteve 1609-1682. Gjykata e Inkuizicionit, i akuzoi mauricianët edhe për keqbërje ndaj objektit të plumbit në Granadë, mirëpo më vonë u zbulua se një gjë të tillë, e kishin bërë qarqe të caktuara spanjolle me iniciativë nga Papa, për t'a ngritur këtë çështje në mit, dhe më vonë në liturgji kishtare. Në vitin 1724, udhëpërshkruesi anglez Sonjuboreni, thotë se gjykata e inkuizicionit në Spanjë, bëri hetime të thella ndaj muslimanëve mauricianë dhe deportoi edhe grupe të tëra. Ndërsa, udhëpërshkruesi tjetër anglez, Taosendi, në përshkrimet e tij thotë se vetëm në Granadë, në atë kohë, Gjykata e Inkuizicionit kishte përndjekur dhe dënua rreth 1800 persona (360 familje të tëra, me akuzën se ata e kishin praktikuar fenë e tyre muslimane, fshehurazi), gjë që na bën që të kuptojmë se në Spanjë, në shekullin XVIII-të, ende jetonin fshehurazi një numër i madh muslimanësh.

Gjithashtu, nga burime spanjolle të asaj kohe, bëhet e ditur se në vitin 1727-1728, vetëm në principatën e Granadës, u bënë gjykime publike të ndara, ndaj 74 muslimanëve, të cilët akuzoheshin për manifestimin e fesë së tyre (Islamit). Në këtë periudhë, në Spanjë, vërehej një përqafim i qetë i fesë islame, nga masat e mesme dhe profesionale të shoqërisë spanjolle. Nga kjo frikësoheshin të krishterët spanjollë, prandaj në vitin 1729, ata i bënë një shkresë mbretit, në të cilën kërkonin nga ai, që të bënte deportimin edhe të atyre pak muslimanëve mauricianë spanjollë, të mbetur në Spanjë, në mënyrë që të pastrohet vendi i tyre nga “gjaku i prishur” i muslimanëve.

Në vitin 1769, Këshilli i Lartë i inkuizicionit bëri njoftimin se, në Kartagjenë të provincës së Marsejës u zbulua ekzistimi i një xhamie, e cila vepronte fshehurazi, për liturgji të muslimanëve të Spanjës. Nga kjo vërehet se

muslimanët e Spanjës, asnjëherë nuk e kishin shkëputur shpresën e tyre, për t'u liruar dhe nuk i kishin ndërprerë aktivitetet e tyre ilegale, për t'a aplikuar Islamin si fe të tyre, po ashtu, ata i mbante shpresa se ata, si edhe muslimanët jashtë Spanjës, do të aktivizoheshin në një kryengritje, për çlirimin e vendit të tyre nga të krishterët.

Gjithashtu, kuvendi i Granadës, ndërhyri në një rast të dy familjeve muslimane, të cilat akuzoheshin për marrëdhëniet e tyre të fshehta, me muslimanët e Afrikës Veriore. Pas humbjes së krishterëve, në betejën e Vadi Al-Makhazinit, si reaksion i saj u bë ndarja territoriale e Portugalisë. Ndërsa, në vitin 1748, gjendja ekonomike dhe sociale në Spanjë, u keqësua jashtë mase, saqë njerëzit filluan të mendojnë për kryengritje, pasi vendin e kishte kapluar një varfëri e skajshme. Ndërkohë aristokratët e krishterë, nga veriu i Spanjës, e magazinuan ushqimin rezervë, ndërsa popullata e thjeshtë, dhe me ta edhe mauricianët muslimanë, mbetën nën mëshirën e kohës, me një uri të paparë, por jo vetëm kaq, ata u goditën edhe nga sëmundje dhe peripeci të tjera. Popullatën e thjeshtë andaluziane e kaploi edhe një pamundësi veprimi, atëherë kur Portugalia u nda territorialisht nga Spanja.

Atëherë, për Andaluzinë, nuk mbeti vend për të vepruar në këtë drejtim, për shumë arsye e ndër to, edhe lidhja e mbretit të Portugalisë me Spanjën, pasi bashkëshortja e tij ishte motra e Dukës së qytetit të Shadunës, i cili ishte njëkohësisht edhe komandant i përgjithshëm i marinës detare spanjolle në Oqeanin Atlantik dhe bregdetin Spanjoll. Ky ushtarak i lartë, vendosi që t'a shfrytëzojë pozitën e dobët të gjendjes së përgjithshme të Spanjës, për të bërë një kryengritje dhe për t'a marrë pushtetin, me ambicie që të bëhet mbret i Spanjës. Ai vendosi bashkëpunim me një princ Maurician (musliman), pasardhës i familjes së princit të Granadës, Ebi Abdullah El-ejserit. Ky trashëgimtar froni ishte i fshehur dhe jetonte ilegalisht në malet e Kadurit, që shtriheshin në rrethinën e qytetit El-merije dhe hyri në

marrëveshje me Dukën, në mënyrë që në fund të fitonte një mbretëri në lindje të Spanjës.

Ky princ maurician, hyri në këtë kualicion, me emrin Tahit Al-huri . Gjithashtu, Duka i Shazononës mori premtime për ndihmë dhe kualicion ushtarak edhe nga muslimanët e Spanjës, që ishin deportuar më parë për në Principatën e Marokut. Ky kualicion, për organizimin e kryengritjes, nuk arriti të kornte sukses, për arsye të një tradhëtie të brendshme. Duka e kishte marrë në mbikqyrje qytetin e Shazonës, gjithashtu e kapi dhe e ekzekutoi iniciatorin e planit për tradhëti, Markiz Axhamentin. Mirëpo shteti spanjoll, megjithatë, ishte në gjendje të mbajë kontroll dhe t'a mbante pushtetin, duke marrë iniciativë për konfiskim të pasurisë së Dukës së Shalokës, të krahinës së Kadisit.

Pas këtij hapi, Duka u detyrua që të kërkonte falje dhe të pendohet për hapat e marrë, në dëm të shtetit spanjoll. Në këtë rast, princi maurician, që ishte në kualicion të kryengritjes, Tahir Al-huri, mbeti i vetmuar në betejë. Ai u tërhoq në periferinë e Eshtabonës, të krahinës së Malikas, në pritje të forcave ushtarake të muslimanëve të Marokut. Në rrugë e sipër, Princi Tahir ra në kurth të forcave spanjolle dhe u likuidua. Ishte kjo edhe orvatja e fundit për çlirimin e Andaluzisë nga ana e muslimanëve. Në këtë rast, flamuri që përdori Princi Tahir, është edhe sot e kësaj dite simbol i zonës së Andaluzisë.

Gjendja në Spanjën e asaj kohe, nuk u normalizua për arsye të shumta dhe, në një mënyrë, rebelimi i popullatës vazhdoi në mënyra të ndryshme. Në vitin 1644, një mori ekspeditash fshatare u vetorganizuan, duke bërë aksione piraterie në karvanet me mallra, që vinin nga Amerika Jugore, në drejtim të Madridit. Këto plaçkitje, bëheshin për t'u dhënë të varfërve pjesën e tyre të merituar. Ndërsa, në vitin 1650, shteti spanjoll zbuloi një kryengritje të brendshme dhe për këtë akuzoi popullatën mauriciane muslimane, duke i dënuar, munduar dhe, në fund, duke

ekzekutuar pesë mauricianë muslimanë, me padinë se ishin organizatorë të kryengritjes.

Në këto periudha vuajtjesh të mëdha, u bë edhe djegia e qytetit të Kordovës, në vitin 1649. Ndërkohë, banorët e saj ishin persekutuar dhe ishte prekur dhe dëmtuar rëndë, rendimenti bujqësor. Si rezultat i të gjitha këtyre, në vitin 1652, u aktivizua një kryengritje, të cilën e filluan gratë, e më pastaj iu bashkuan edhe burrat. Të rebeluarit zgjodhën një burrë, për udhëheqës të qytetit, mirëpo mbreti spanjoll, e shuajti edhe këtë kryengritje, por kësaj radhe, duke i amnistuar dhe falur të gjithë ata, që organizuan dhe morrën pjesë në kryengritje.

Po në vitin 1652, populli i Eshbilisë, u hodh në kryengritje, si rezultat i jetës së rëndë sociale dhe politike. Ata sulmuan çdo gjë që ishte e bejlerëve dhe spahinjve, e shtetit dhe parisë fetare. Po ashtu, e quajtën parinë e tyre gjakpirëse dhe shtypëse të paskrupullt. Paria dhe shteti i krishterë spanjoll, e shuan këtë kryengritje dhe vunë dorë të hekurt mbi popullatën spanjolle, me origjinë islame, duke i dënuar iniciatorët dhe ekzekutuar prijësit e kryengritjes. Po ashtu ata bënë shpërlarjen e trurit, duke i dhënë një pamje krejt të re të Andaluzisë së Re, pa Islam dhe muslimanë, por që tek ne, do të ngelë thellë në kujtesë dhe në origjinë.

Në shekullin XVII-të dhe XVIII-të, Spanjën e vizituan shumë grupe udhëpërshkruesish dhe delegacione, të cilët shkruan për ekzistimin e muslimanëve dhe vazhdimësinë e tyre në Spanjë, por duke mos pasur të drejtë t'a publikojnë fenë e tyre, sepse një gjë e tillë, ndëshkohej ashpër nga shteti dhe kisha spanjolle e asaj kohe. Një dokument i vitit 1660, njofton për rastin se në një kishë të Balansias, në ditarin e saj, për një të lindur shkruante: 'I Krishter i Ri'- që do të thoshte se, ende kishte muslimanë dhe ata detyroheshin me raste, si rasti i regjistrimit të fëmijëve të posalindur, të deklaroronin konvertimin, që llogaritet të jetë një deklaram i dhunshëm.

Në vitin 1690, Princi i Marokut, Ismail Al-alavi, dërgoi në një vizitë në Spanjë, ministrin e tij, ambasadorin Z. Muhamed bin Abdylvehab Al-gasanin, për të biseduar për çështjen e pengjeve. Ky i dërguar, deklaronte në kujtimet e tij, se shumë prej banorëve të Andaluzisë, nuk e fshihnin realitetin se ishin me prejardhje muslimane dhe se një numër i madh i tyre, mburreshin se rridhnin nga familje muslimane. Ndërsa një numër jo i vogël, krenohesh se i përkiste fisit Nebariot (të muslimanëve). Po ashtu, ambasadori Al-gasani, citon se shumica e Andaluzianëve, e urrenin dhe e kritikonin ashpër ligjin, i cili ishte aplikuar në vitin 1609, për deportimin e muslimanëve nga Andaluzia – Spanja.

Ambasadori Al-gasani, këto dëshmi i hasi në zonat e provincës së Ishbilias dhe Xhejanës, mirëpo sikur të vizitonte edhe vende të tjera të Andaluzisë, do të haste po të njëjtat ndjenja të banorëve të Andaluzisë – Spanjës.

Ndërsa në vitet 1766-1768, Princi i Marokut, Muhamed bin Abdull-llah, dërgoi për vizitë në Spanjë, ambasadorin (të dërguarin) e tij, Ahmed bin Al-mehdi Al-gazal Al-andalusi Al-maliki, të cilin e angazhoi për bisedime me mbretin e Spanjës, rreth pengjeve dhe lirim të tyre. Ky i dërguar special, gjatë lëvizjes së lirë të tij në Andaluzi, vërejti se shumica e popullatës kishte simpati dhe ruante, në fshehtësi, dashurinë e tij ndaj Islamit si fe. Këto ngjarje, i dërguari i Princit Maroken, i vërejti në zonat e: Ishbilisë, Xhejanit, Granadës, Marsejës dhe Laknatës. Ai i veçoi banorët e provincës së Lushijas, duke i cilësuar si njerëz me tipare të veçanta të muslimanëve dhe prej tyre disa deklaroheshin si muslimanë, e disa të tjerë e mbanin fshehurazi Islamin, por në sjellje dhe pamje dukeshin se ishin muslimanë shumë të devotshëm.

Ndërsa gjatë viteve 1775-1776, Spanjën e vizitoi udhëpërshkruesi (historiani) i njohur Henri Soinboran, i cili shkroi për veprimet e paskrupullta të gjykatës së Inkuizicionit, gjatë vitit 1724, ndaj muslimanëve të mbetur mauricianë në Andaluzi-Spanjë. Ai deklaroi se

gjatë vizitës së tij, në rrethinat e Granadës, hasi dhe u njoftua me disa familje muslimane të Spanjës. Ndërsa, në vitin 1779, Princi i Marokut, Muhamedi, prapë dërgoi për në Spanjë, të dërguarin e tij, Muhamed bin Osman Al-miknasin, për të diskutuar çështjen e pengjeve. Gjithashtu, ky i dërguar deklaroi se hasi në rrethinat e Granadës dhe Lushias, në familje të tëra që deklarorin haptazi Islamin e tyre si fe, mirëpo te shumë të tjerë, në këto dy zona, vihej re frika, pasi ata në të vërtetë ishin shumë më të mirë, - thotë i dërguari, ambasadori Al-miknasi.

Ndërsa, gjatë viteve 1786-1787, udhëpërshkruesi (historiani) anglez Jousef Tausent, vizitoi Spanjën dhe ai paraqiti disa fjalë, të cilat i kishte dëgjuar nga Gjykata e Inkuizicionit, se në Spanjë ende jetojnë dhe banojnë muslimanë, dhe izraelitë të shumtë, dhe se muslimanët për banim të fshehtë, kishin zgjedhur zonat malore, ndërsa izraelitët qytetet e mëdha. Një gjë të tillë, e vërtetoi udhëpërshkruesi anglez, në vitin 1787. Gjithashtu, në shekullin XIX-të, Spanjën e vizituan shumë udhëpërshkrues (historianë), si: Manjano, Ford, etj. Ata, në vitet 1809-1828, dëshmuan se ende në Spanjë, kishte muslimanë, të cilët në një mënyrë apo në një tjetër, mbanin fenë e tyre, si edhe përmendën mbiemrat islamë që mbanin familjet e tyre, si: Al-zekeriu, ibn

Al-nexhari, Ibn Umajah, Ibn Xhumuati, Beni Gashi, etj.

Po ashtu, edhe deklarimi si jevxhi (rom), nga ana e muslimanëve të Spanjës, ishte shpëtim, kur në fuqi ishte ligji i gjykatës së Inkuizicionit të vitit 1609, për deportimin me dhunë të muslimanëve mauricianë nga Spanja, dhe një gjë e tillë, dëshmohet edhe nga muzika Flamengo. Vlen të përmendet, se për mauricianët muslimanë të Andaluzisë-Spanjës, kanë shkruar edhe mendimtarë dhe filozofë, mes të cilëve edhe: Volteri, Denis Didro, Rajnali, etj.

Fitim Flugaj

FORMIMI I KOMBIT ANDALUZIAN GJATË SHEKUJVE: XIX-TË DHE XX-TË

Padyshim, agresioni i krishterë ndaj mauricianëve muslimanë, me vendimin e deportimit të tyre me dhunë, në vitin 1609, ishte fatal. Mirëpo asnjëherë, kisha katolike dhe shteti spanjoll, nuk ia arritën qëllimit që, nga ta, të krijojnë një popull modern spanjoll, me fe katolike. Realiteti ishte se, edhe pas qëndresës së muslimanëve të Spanjës, 120 vjetë pas rënies së Granadës, ata, në gjakun dhe zemrat e tyre, e ruajtën me xhelozi, fenë e tyre Islamin. Prandaj, mund të themi se, nga ata, mbi një trashëgimi të theksuar dhe bazë Islame, u themelua kombi modern - bashkëkohor spanjoll. Kurse, përsa i përket orvatjes së krishtere, që të bëjë dyndjen e popullsisë së krishtere nga veriu dhe shndërrimin e tyre në spanjollë, u pa se nuk pati sukses, për arsye se rrethanat dhe faktet historike dëshmojnë të kundërtën e saj.

Në anën tjetër, zhvillimet urbane të asaj kohe, na bëjnë me dije se objektet e ndërtuara, si: kullat, xhamitë, kështjellat, parqet, rrugët, kishat që ishin në formë të xhamive, të gjitha këto të jepnin të kuptojë se kjo ishte një arkitektur andaluziane që ishte formësuar një kulturë dhe një popull me një zhvillim të caktuar, që nuk do komente të tjera.

Nga gjurmët më të rëndësishme që kanë mbetur, është vetë njeriu andaluzian, i cili nuk ka ndryshuar as tiparet, as cilësitë, as gjakun, e as qëndrimin e tij dashamirës ndaj Islamit, por as edhe qëndrimin negativ dhe urrejtës ndaj katolicizmit të imponuar me dhunë. Që nga viti 1609,

gjatë revolucioneve dhe trazirave popullore, manastiret dhe kishat kanë mbetur vendcaqet e para për sulme, si hakmarrje kundër tyre.

Por jo vetëm kjo, në Andaluzi, që nga rënia e Granadës e deri më sot, misticizmi andaluzian, paraqitet tek krishterizmi i imponuar andaluzian, që tregon për gjurmë të pastërta islame¹⁵.

Islami ka mbetur edhe sot, në zakonet dhe traditat më të thjeshta të popullit dhe në sjelljet e tyre. Kjo mund të vërehet sot fare qartë, në fshatrat dhe qytetet andaluziane, në ritet e tyre, në librat e tyre, sidomos në Albushrat dhe në Malet Beni Tumez, aty ku rezistenca islame kishte zgjatur më shumë.

Andaluzianët u detyruan që t'a lënë gjuhën e tyre arabe, e cila u zhduk në shekullin e tetëmbëdhjetë, pas një rezistence të gjatë, por megjithatë, ndikimi i saj mbeti në gjuhën e imponuar kishtale. Ky ndikim, ka bërë të mundur të kombinohet një dialekt i veçantë andaluzian.

Nga dialekti i gjuhës arabe, janë trashëguar shprehje të plota, akcentimi i shkronjave, përbërja e fjalisë, etj., saqë njëri nga andaluzianët bashkëkohorë e koncepton këtë dukuri, me këto fjalë: "Ajo (gjuha kishtale e imponuar) ishte si një veshje e ngushtë dhe e papërshtatshme, e imponuar për t'u veshur. Pas veshjes na ngushtoi shumë, por me kalimin e kohës, edhe trupi filloi të mësohej ngapak, e edhe rroba filloi të zgjerohej, kështu kaluam nga një sistem i pranuar me imponim dhe pa alternativë tjetër, në një sistem paksa më të përshtatshëm, por që ka marrë mjaft nga karakteristikat tona¹⁶".

Andaluzianët bashkëkohorë dallohen poashtu, sikurse stërgjiyshërit e tyre, si zejtarë të aftë në të njëjtat zeje, si

¹⁵ Miguel Asin Palacios "Empreintes de L'islam" Al-Andalus XXIIe, 1957

¹⁶ A. Medina Molera, "La Herencia Islamica ya Arabe en la Lengua y Literatura Aljamiada", **Primer Congreso Mundial Andalusi Castellar de la Frontera, (Cadiz), 02-05. IX. 1989.**

zdrukthtarë, përpunues të mëndafshit, prodhues të porcelanit, etj. Të gjitha këto zeje, ata i ushtrojnë në të njëjtat fshatra e qytete, të njohura për këto zeje, që nga koha e stërgjiyshërve. Edhe natyra e veshjes, ka mbetur po ajo, ajo e ruan natyrën e vjetër islame, e sidomos në Albushrat dhe Granadë, të gjitha kanë qenë të ruajtura mirë deri në shekullin e kaluar.

Janë të shumtë shembujt, që argumentojnë për vazhdimin e prezencës islame dhe ndikimin që ajo ka në Andaluzi. Ata, tregojnë edhe sot aftësi të rralla në kultivimin e pemëve frutore dhe zbukurimin e kopshteve, ashtu siç kanë treguar në të kaluarën. Tek andaluzianët, edhe sot janë prezente ndjenjat negative ndaj krishterëve të veriut, si rezultat i pushtimit.

Krishterët e veriut, edhe sot e kësaj dite, e përdorin shprehjen fyese “moro”, që ka kuptimin “musliman”, edhe për andaluzianët, e edhe për muslimanët në tërësi, si edhe vazhdojnë të drejtojnë akuza të rrejshme e të padrejta ndaj andaluzianëve, për përtaci dhe parazitizëm, për perversitet, pasion ndaj kënaqësive epshore. Të njëjtat akuza, i drejtojnë edhe kundër të gjithë popujve muslimanë.

Vetë mënyra e ndarjes së tokës pjellore në Andaluzi, është dëshmi e qartë për sprovën, nëpër të cilën është duke kaluar populli andaluzian. Pas pushtimit të vendbanimeve dhe tërë regjionit andaluzian, tokat pjellore u usurpuan dhe u ndanë për kishën dhe shërbëtorët e kishës, që erdhën nga veriu i krishterë. E njëjta gjendje, vazhdon edhe sot. Pronarët e rinj, sot, e shfrytëzojnë tokën, dhe me shërbimin dhe mundin e andaluzianëve marrin prodhime dhe pasuri, që i transferojnë në vende të tjera të Spanjës, për zhvillimin e industrisë dhe për investime të tjera, dhe e lenë pas dore vendin, nga i cili i marrin begatitë. Në këtë mënyrë, ekonomia andaluziane vazhdon të mbetet e kolonializuar, lëndët e para, qofshin ato minerale ose produkte bujqësore, merren dhe dërgohen në territoret e tjera të Spanjës, jashtë

Andaluzisë dhe importohen të përpunuara, si produkte të gatshme, me çmime të larta për andaluzianët e gjerë. Ky është shkaku kryesor, që një numër jo i vogël i bijve të Andaluzisë, marrin rrugën e emigrimit, për të punuar punë të rënda, për sigurimin e kafshatës.

Tani turizmi masiv, është bërë një nga aktivitetet më të rëndësishme në Andaluzi. Përmes tij është deformuar turizmi dhe kultura andaluziane, janë përhapur industri të ndotura, shkatërrime dhe sëmundje të shumta, në tërë territorin e Andaluzisë.

Identiteti andaluzian kishte mbetur i varrosur thellë në shpirtin, pa u shprehur asnjëherë qartë. Kjo gjendje vazhdoi kështu, derisa u zhvillua ekspedita e ushtrisë franceze të Napoleon Bonapartit, për pushtimin e Spanjës, në vitin 1808, dhe shpërtheu fesati. Mbreti dhe ushtria e tij në Madrid, kapitulluan para ushtrisë franceze. Ata nuk arritën të rezistojnë aspak, dhe lanë vendin në duart e fatit.

Populli andaluzian në Kadis, u ngrit në kryengritje kundër francezëve, më datën 14.07.1808 dhe marina franceze u dorëzua. Më datën 19.07.1808, rezistenca andaluziane fitoi betejën vendimtare në Bajlen (krahina Xhejan), kundër forcave franceze. Më datën 17.12.1808, andaluzianët formuan qeverinë e fshehtë në Sevilje, me emrin "Kuvendi Suprem Qendror". Më datën 19.03.1812, revolucionarët kryengritës, në Kadis, shpallën kushtetutën e re për Spanjën, si mbretëri kushtetuese. Në këtë kushtetutë, u përcaktuan kompetencat dhe autoriteti i kishës dhe mbretit. U caktua që marrëdhëniet në mes qytetarëve, grupeve dhe nacionaliteteve të Spanjës, të organizohen në baza demokratike. Për herë të parë, në mënyrë kushtetuese, andaluzianët njihen si një nga popujt e Spanjës me personalitet dhe identitet të veçantë. Kushtetuta e Kadisit, mbeti si kërkesë e të gjitha lëvizjeve reformiste në Spanjë, gjatë tërë shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Pasi u larguan francezët, monarku, i cili u kthye në shtator të vitit 1812, e anulloi kushtetutën e Kadisit, dhe ktheu Spanjën përsëri nën tiraninë e mbretit dhe kishës. Më datën 01.01.1820, populli i Seviljes u çua në kryengritje dhe kërkoi që të kthehet në fuqi, kushtetuta e Kadisit. Kryengritja përfshiu të gjithë andaluzianët, gjë që e detyroi mbretin që t'a pranojë përsëri kushtetutën e Kadisit. Mirëpo, ai nuk kishte qenë i sinqertë në vendimin e tij. Ai kërkoi ndihmë ushtarake nga Franca, e cila i dërgoi forca dhe e pushtoi Spanjën me parullat: "Rroftë feja! Rrofshin gjykatat e inspektimit! Rroftë tirania e mbretit!". Më datën 03.10.1823, monarku e anulloi përsëri kushtetutën e Kadisit. Qytetarët e Andaluzisë u çuan në kryengritje, dhe sulmuan gjykatat e inspektimit, të cilave ua futën zjarrin dhe i dogjën.

Më datën 28.03.1831, Gjeneral Tarihos në Ishullin e Gjellbërt, organizoi një lëvizje ushtarake për të kërkuar kushtetutën e Kadisit, mirëpo për fat të keq u arrestua dhe u ekzekutua. Mirëpo, përpjekjet për kthimin e kushtetutës së Kadisit, vazhduan edhe më tej. Një gjë e tillë u shndërrua në kërkesën më të rëndësishme të banorëve të Andaluzisë, derisa në mars të vitit 1835, populli andaluzian i Malagës, u organizua në kryengritje, i largoi përfaqësuesit e qeverisë, formoi administratën lokale dhe shpalli zbatimin e kushtetutës së Kadisit.

Shembullin e Malagës, e ndoqën edhe regionet e tjera të Andaluzisë, sa që në fund të gushtit, e tërë Andaluzia u përfshi në kryengritje, e më pas edhe krahinat e tjera të Spanjës. Andaluzianët formuan ushtrinë e tyre popullore, e cila u konfrontua me ushtrinë qeveritare përgjatë kufirit të Andaluzisë, së cilës i shkaktoi disfatë. Në Madrid, u bënë ndryshime dhe u formua një qeveri e re, e cila shpalli se pranon disa nga kushtet e parashtruar nga kryengritësit, prej këtyre kushteve edhe kthimin e tokave të uzurpuara nga kisha. Mirëpo, kryengritësit refuzuan të bashkëpunojnë me qeverinë e re dhe në qytezën Andora (Andogra) (krahina e Xhejanit), formuan "Kuvendin Suprem të Revolucionit", i cili përpiloi kushtetutën e re të

“Andorës”, nëpërmjet të cilës u shpall autonomia e plotë e Andaluzisë. Mirëpo, ky kuvend nuk zgjati shumë dhe u vetësuprimua, më datën 19.10.1835.

Edhe përkundër dështimit, kryengritja e vitit 1835, pati një randësi të veçantë në kristalizimin e identitetit të ri andaluzian, sepse për herë të parë që nga lëvizja e morsikianëve, andaluzianët bënë një lëvizje gjithëpopullore, si një popull i vetëm, përballë qeverisë qendrore, në Madrid.

Pas këtyre ngjarjeve, Spanja u përfshi në kaos. Kisha, nëpërmjet klerikëve të saj ekstremë, e ktheu dominimin e vet. U përhap injoranca, korrupsioni administrativ dhe rryshfeti.

Andaluzia vazhdoi të qëndrojë si zona më e prapambetur në Spanjë. Banorët e saj, vazhdonin të jetonin nën tiraninë e fisnikëve të veriut dhe kishës. Më datën 30.06.1857, fshatarët andaluzianë në regjionin e Seviljes, dolën në kryengritje për të kërkuar tokën e stërgjyshërve, mirëpo ushtria i dha fund kryengritjes, duke lenë të vdekur 25 fshatarë dhe duke ekzekutuar 25 të tjerë, pas gjykimit formal të tyre. Edhe përkundër kësaj, fshatari andaluzian u zgjua nga kllapia e gjatë dhe u lirua nga frika që dominonte mbi të. Në fund të vitit 1861, fshatarët andaluzianë në regjionin e Malagës dhe Granadës, dolën përsëri në kryengritje, e cila u shua nga ushtria.

Më 18.09.1868, në Kadis, shpërtheu revolucion i kundër mbretëreshës, i cili përfshiu tërë Andaluzinë. Në afërsi të Kordovës, ushtria u mposht nga revolucionarët dhe mbretëresha u arratis në Francë. Kryengritësit kërkuar themelimin e republikës federative të Spanjës, njohjen e autonomisë së Andaluzisë dhe anulimin e njohjes së fesë katolike, si fe zyrtare të shtetit. Por, për fat të keq, ushtria arriti t’a merrte vendin dhe vazhdoi të ndjekë politikën e shtetit centralist. Më 03.01.1873, mbretëresha u kthye dhe lëvizjet federative dhe republikane, kalojnë përsëri në ilegalitet. Nuk vonoi dhe u

përhap uria dhe varfëria në territorin e Andaluzisë. Fshatarët e uritur organizohen në grupe guerile dhe terroriste, më i njohuri i të cilëve ishte grupi “Dora e zezë”, i cili futi tmerrin në vend.

Më 10.01.1874, u formua “Partia Republikane Federative”, e cila në fund të vitit 1883, u pajtua rreth projektit “Kushtetuta Ankira”, që planifikonte formimin e shtetit të Andaluzisë federative, demokratike, shembullore, që ka sovranitet, që garanton liritë personale dhe që ndan autoritetet legjislative, nga ato ekzekutive dhe juridike. “Kushtetuta e Ankirës”, më vonë u bë bazë e projekteve federative.

Ajo, që e dallon lëvizjen andaluziane në shekullin e nëntëmbëdhjetë është: përqendrimi brenda një territori të vetëm (Andaluzi), si një popull i vetëm (andaluzian), kërkimi i të drejtave të veta, ballafaqimi me padrejtësitë e pushtetit qendror dhe kishës katolike, dhe ballafaqimi me humbjet agronomike. Mirëpo, për andaluzianet mbasin edhe shumë pyetje, që presin përgjigjjen e tyre: A janë interesat andaluziane të lidhura ngushtë me interesat e krahinave të tjera, apo jo? A është populli andaluzian si popujt e tjerë, apo dallohet nga të tjerët, nga veçoritë e posaçme të tij? Nëse po, atëherë cilat janë këto veçori?

Këtyre pyetjeve, iu është përgjigjur Blas Infante Perez, që sot, andaluzianët dhe muslimanët në mesin e tyre, e konsiderojnë baba të kombit dhe mendimtar të renesansës kombëtare. Blas Infante, lindi në qytezën Kashrish (Krahina e Malagës), më 05.07.1885, nga dy prindër andaluzianë, që të dy me origjinë nga morsikianët e lashtë, familjet e të cilëve kishin dhënë kontribut në mbrojtjen e Andaluzisë dhe popullit të saj. Infante, mësimet fillore i ndoqi në vendlindje. Në vitin 1896, u transferua në Arçelona të Malagës, për të ndjekur mësimet në shkollën e mesme, pastaj në Kovir të Kordovës në vitin 1897, dhe në vitin 1900 diplomoi të mesmen. Pas diplomimit, punoi me babain e tij, në gjykatën e Kashrishit, para se të pranohet në seksionin e

drejtësisë, në Fakultetin e filozofisë dhe letërsisë në Universitetin e Granadës, ku diplomoi me sukses të shkëlqyeshëm, në tetor të vitit 1906.

Gjatë qëndrimit të tij në Granadë, u njoh me monumentet dhe gjurmët islame të Andaluzisë. Sokaket (rrugët e ngushta) e Granadës, populli i këtij qyteti historik dhe shpirtrat e dëshmorëve, ia çelën sytë Blas Infantit, për të kuptuar madhështinë e Islamit dhe të civilizimit andaluzian. Vetë ndjenjat e tij, të çiltra e të natyrshme, morën pamjen e identitetit islam andaluzian. Në rrugën e tij të stërvitjes për garën e drejtësisë, Infanti vizitoi Seviljen, Kordovën dhe Madridin. Gjatë vizitës u takua me liderët e lëvizjes andaluziane dhe krijoi bindjen se identiteti andaluzian nuk ishte thjesht identitet fisi, apo gjaku, por ishte identitet "i ekzistencës" dhe i "njohjes".

Në vitin 1907, Infanti shkoi për vizitë në Sevilje. Aty hasi në një aktivitet ideologjik të madh: siç ishte rasti i shoqatave të rinisë për studimin e historisë andaluziane dhe "Lojërat e trëndafilut", ku bëheshin gara me ligjërime dhe poezi emocionale andaluziane. Në vitin 1909, këto lojëra u bënë festë kombëtare andaluziane. Në vitin 1910, Infanti u emërua jurist në komunën e Kantijanës (vendlindja e dijetarit të fesë Islame, Ebu Medjen El-Gith Define Telmisan). Infanti u vendos me banim në Sevilje, sepse distanca mes Kantijanës dhe Seviljes ishte e vogël. Atij, i duhej të udhëtonte çdo ditë mes dy qyteteve. Infanti, gjatë qëndrimit të tij në Sevilje, u ndikua shumë nga mendimtarët andaluzianë, të cilët i ndihmoi në aktivitetet e tyre kulturore.

Më datën 28.11.1913, Infanti u pranua në Kuvendin e gjyqtarëve. Më 23.03.1914, mbajti një referat në "Atinio" të Seviljes, me titull "Ideali andaluzian", i cili më vonë bëhet bazë për librin historik për kombësinë andaluziane. Në të njëjtin vit, hapi zyrën e avokatit në Sevilje, dhe nxorri nga shtypi, botimin e parë të librit të tij "Ideali andaluzian"¹⁷.

¹⁷ Blas Infante Perez, "I deal Andaluz", Madrid, 1914.

Në vitin 1916, Infanti themeloi qendrën e parë andaluziane në Sevilje, të cilën e pasuan qendrat e tjera në qytetet dhe fshatrat andaluziane. Infanti, këtë vit, nxorri nga botimi revistën “Al-Andalos”, si zërin aktual dhe organ të qendrave dhe lëvizjes kombëtare andaluziane. Pas një kohe, qendra andaluziane e Seviljes, u shndërrua në qendrën e aktiviteteve andaluziane për kulturizim dhe planifikim. Prej kësaj qendre, doli pamfleti që ftonte në mbajtjen e “Takimit të krahinave andaluziane”, në qytetin Randa, pamflet, i cili gjithashtu për herë të parë përdori shprehjen “Ummeti andaluzian”. Në këtë mënyrë, Infanti, me idetë dhe lëvizjet e tij, u bë kryetar i rrymës së re për lëvizjen kombëtare andaluziane.

Më 16.06.1917, Infanti, në cilësinë e kryetarit të “Qendrës Andaluziane të Seviljes”, mbajti një ligjëratë esenciale, e cila i dha forcën revolucionare ideve të tij. Ndër të tjera, në fund të saj, ai tha: “...Ne nuk kemi ndërmend të formojmë parti, ne dëshirojmë të formojmë një popull të aftë, që të ketë mundësi t’a udhëheqë vetveten”. Më 13-14.01.1918, në Randa, u mbajt mbledhja e “Kuvendit të Krahinave Andaluziane”, mbledhje, në të cilën u përcaktuan simbolet e kombësisë andaluziane për ardhmërinë e lëvizjes kombëtare, të ndara në pika:

- Njohja e Andaluzisë si shtet, komb, territor autonom dhe demokratik, i bazuar në kushtetutën “Antekira”, dhe

- Zgjedhja e flamurit me ngjyrë jeshile dhe të bardhë, si flamur i popullit andaluzian dhe si stemë e flamurit, të mbetet simboli i Kadisit.

Pas kësaj mbledhje, Blas Infanti dhe Hoze Andreas Paskes, në emër të konferencës, paraqitën para Entit të Kombeve, kërkesën për njohjen e kombit andaluzian. Infanti hyri në lojërat politike, për t’i bërë të njohura në opinion, idetë e tij për kombësinë andaluziane. Ai, hyri në zgjedhjet regjionale të Gasan-Ashtbona (krahina e Malagës), ku gjendet edhe Kashrish-i, por nuk fitoi.

Në janar të viti 1919, Infanti mori pjesë në mbledhjen inicuese të “Kuvendit Administrativ të Andaluzisë”, e cila

mori fund me aprovimin e “Planit ideor për kombësinë andaluziane”. Një gjë e tillë, kishte ndikim të rëndësishëm në rrjedhat e mëtejshme, për idenë e kombësisë andaluziane. Gjithashtu, në këtë vit, Infanti u martua.

Më 21.05.1919, Infanti hyri në zgjedhjet e Seviljes, në emër të “Demokracisë Andaluziane”, që përbëhej prej: republikanëve federativë, nacionalistëve andaluzianë dhe socialistëve të pavarur. Në fjalimet e tij zgjedhore, denoncoi situatën e mjerë në Andaluzi dhe interesat shfrytëzuese të forcave qendrore, të vendosura nga Madridi, të cilat po i dirigjonin zgjedhjet në Andaluzi, nëpërmjet influencës materiale dhe sektorëve të vet. Infanti, dështoi edhe kësaj radhe, në përpjekjen e tij zgjedhore. Autoritetet qeveritare dhe djathtistët u zemëruan kundërt tij, dhe akuzuan për veprim kundër interesave shtetërore dhe kërcënim të sigurisë dhe unitetit të vendit. Në Sevilje, Infanti themeloi shtëpinë botuese dhe bibliotekën “Avanti” (Përparimi), nëpërmjet së cilës, ai i botoi veprat e tij. Gjithashtu, themeloi edhe “Qendrën për studime andaluziane”. Në vitin 1920, doli në dritë libri i tij “Al-Muatemidi - Mbreti i Seviljes”, që është një tregim dramatik historik, në të cilin, Infanti, bën të njohur rrënjët e identitetit andaluzian islam.

Viti 1921, ishte viti i shpresave për nacionalistët andaluzianë. Edhe përkundër situatës destabilizuese në Madrid, “Qendrat andaluziane” ishin përhapur gjithandej, nëpër qytete e fshatra. Ato përhapnin me vete idetë andaluziane, në aspektin kulturor dhe social. Infanti filloi të mendojë për krijimin e lidhjeve më të forta kulturore. Ai mendonte se si të krijonte lidhje të fuqishme mes andaluzianëve, brenda në Andaluzi, në Marok dhe në Amerikën Latine.

Mirëpo, më 13.01.1923, Spanja kaloi nën regjimin diktatorial, i cili u dha fund lirive, i mbylli “Qendrat andaluziane”, dhe i akuzoi nacionalistët andaluzianë se po organizojnë rezistencë kundër shtetit, dhe se po tregojnë armiqësi kundër kishës.

Infanti nën presionin familjar, u detyrua që të kalojë dhe të vendoset në Islla Kristina (krahina e Vulbës), si jurist në qendrën për regjistrime, duke u larguar nga aktiviteti politik. Ai i këshilloi edhe ithtarët e tij, që të veprojnë në të njëjtën mënyrë... Më pas, e përqëndroi mendjen e tij, rreth fatit të Andaluzisë dhe rrënjëve të identitetit andaluzian.

Më 15.09.1923, në momentin më kritik, kur fshatarët po luftonin kundër kolonializmit spanjoll, Infanti vizitoi varrin e mbretit El-Muatemid bin Aibad, në Agmata të Marokut. Aty u njoh me disa nga bijtë e Andaluzisë dhe aty vendosi, që t'a shpallë Islamin. Pasi u bë musliman, filloi të përpiquej për krijimin e lidhjeve, mes lëvizjeve andaluziane dhe lëvizjeve islame dhe arabe¹⁸.

Në vitin 1930, diktatura u shemb. Infanti kaloi si jurist për regjistrime, nga Islla Kristina në Kuriye, afër Seviljes. Në vitin 1931, themeloi "Kuvendin Çlirimtar Andaluzian", si kompensim për qendrat e vjetra andaluziane dhe u bashkangjiti në "Partinë Republikane Federative". Infanti filloi t'a shenjtërojë historinë islame si themel të identitetit andaluzian, dhe kërkonte prej andaluzianëve që t'a kthejnë identitetin e tyre, historinë dhe tokën e tyre. Ai kërkonte, që të largohej dominimi i kishës mbi shtetin, dhe e sulmonte kishën për krimet, që bënte me gjykimet e padrejta ndaj andaluzianëve dhe ndaj "luleve, që na kanë mbetur nga kultura jonë".

Në prill të vitit 1930, në Delhi të Indisë, u mbajt samiti për "Popujt që nuk kanë shtet". Aty, në emër të nacionalistëve andaluzianë, mori pjesë poeti i madh andaluzian musliman Abel Kadre, i cili në referatin e tij para pjesëmarrësve, bëri të qartë se rezistenca e popullit andaluzian, është pjesë përbërëse e rezistencës së popujve të robëruar të Azisë dhe Afrikës, kundër kolonializmit

¹⁸

J. L. Ortiz de Lanzagorta, "Blas Infante, Vida y Muerte de un Hombre Andaluz", Sevilla, 1979.

famëkeq, dhe bëri të qartë se, rrënjët e popullit andaluzian janë rrënjë islame¹⁹.

Më pas, Infanti kontaktoi me lëvizjet çlirimtare arabe, nëpërmjet revistës “El-Umme El-Arabije” (Populli arab) në Gjenevë (Zvicër), të cilën e botonte princi Shekib Arslan dhe Ihsan El-Xhabirij. Idetë e Infantit dhe nacionalistëve andaluzianë, u qartësuan pas viteve të njëzeta, të shekullit të njëzetë të erës së re dhe ato ishin: Identiteti andaluzian islam, jo perëndimor, gjë që u bë shkas, që armiqhtë t’a sulmojnë vazhdimisht me akuza të ndryshme, dhe lufta e tij kundër të djethtëve dhe të majtëve, së bashku. Ditën e dielë, 02.08.1936, 14 ditë pas shpërthimit të luftës qytetare në Spanjë, një grup guerilësh e sulmuan Infantin në shtëpinë e tij “Darul Ferah” (Shtëpia e lumturisë) në Kuriye, e kindapuan dhe e burgosën në Sevilje, dhe me datën 10.08.1936 e ekzekutuan me pushkatim. Vdiq si dëshmor dhe hero i vërtetë, duke thirrur me zë të lartë : “Rroftë Andaluzia e lirë!”

Shoqatat islame të emigrantëve ²⁰

Islami, publikisht, nuk aplikohet për një kohë mjaft të gjatë, në territorin e Andaluzisë, saktësisht, që nga viti 1609, mirëpo, ai ishte ruajtur në zemrat e muslimanëve, që kishin mbetur mes andaluzianëve. Krishterizimi ishte kusht esencial për të gjithë muslimanët e huaj, që dëshironin të jetonin në Spanjë. Kjo situatë, vazhdoi deri pas Luftës së Dytë Botërore, kur situata u zbut pak a shumë, e sidomos pasi, në të, emigruan një numër i banorëve të vendeve në veri të Marokut, që ishin pretektoriati i Spanjës, e sidomos ata, që kishin qenë ushtarë të Frankos. Frankoja u kishte premtuar atyre, se

¹⁹ La Voz (Cordoba), 19.06.1931

²⁰ Jacinto Bosch Vila, “The Muslims of Portugal and Spain”, Journal of the Institute of Muslim Minority Affairs, Vol.7, No. 1, Jan. 1986.

do t'ua dorëzonte Xhaminë Madhështore të Kordovës, nëse do t'a përkrahnin dhe nëse do t'a fitonte luftën qytetare. Mirëpo, ai nuk e realizoi premtimin ... Por, si kompenzim për Xhaminë Madhështore, ai u ndërtoi një xhami të vogël në sheshin kryesor, në qendër të Kordovës, para spitalit, për t'ua falur xhenazen ushtarëve të vdekur. Edhe kjo xhami e vogël u mbyll, pak kohë pas përfundimit të luftës qytetare (e njohur te qytetarët e Kordovës, si Al-Morabitū). Më vonë, kjo xhami, u shndërrua në depo të mjeteve të kopshtit publik, dhe deri vonë, nuk u përdor për shërbime fetare.

Pas vitit 1960, numri i muslimanëve emigrantë u shtua mjaft, sa që në vitin 1990, numri i tyre arriti në 250 mijë muslimanë, prej tyre përafërsisht 140 mijë marokenë, 30 mijë nga perëndimi arab, 30 mijë nga lindja arabe, 20 mijë muslimanë afrikanë zezakë, 10 mijë pakistanezë, 10 mijë iraniane dhe 20 mijë muslimanë nga shtetet e ndryshme të botës. Shumica e marokenëve ishin punëtorë, ndërsa emigrantët e lindjes arabe ishin studentë, të cilët pas diplomimit, qëndruan në Spanjë dhe morën nënshpëtimin spanjollë.

Emigrantët muslimanë, nuk arritën t'i organizojnë radhët e tyre deri vonë. Më datën 24.12.1964, u aprovua ligji për shoqatat, i cili lejonte edhe ekzistimin e shoqatave jokatolike, gjë që mundësoi organizimin e emigrantëve.

Më datën 28.06.1967, qeveria spanjolle aprovoi një ligj të ri. Ligji i ri ofronte liri fetare edhe për fetë e tjera, gjë që mundësoi themelimin e shoqatave islame, për herë të parë, që nga rënia e Granadës. Ligji kishte mangësitë e tij, sepse nuk lejonte që të ushtroheshin ritet fetare, përveç atyre të fesë katolike. Ritet e besimeve të tjera, kishin liri të pjesëshme të manifestimit të tyre dhe, gjithashtu, grupeve muslimane nuk u lejohej që të kontaktonin me ato shtete, të cilat ende nuk i respektonin liritë fetare dhe qytetare, prej të cilave kërkohej respektimi i tyre.

Ky ligj, bëri të mundur që të organizohen shoqata muslimane nga jo spanjollët, mirëpo kjo nuk e lehtësoi

ekzistimin e Islamit të organizuar, nga ana e qytetarëve andaluzianë.

Nga ky ligj, përfituan sidomos studentët arabë të lindjes, që kishin orientim islam, të cilët themeluan shoqatën e studentëve muslimanë, në Granadë, në vitin 1966, pasi këtë, ua propozoi Profesor Ebul Hasan Enedevi, gjatë vizitës së tij, në vitin 1965. Zyrtarisht, shoqatën e regjistruan në Ministrinë e Drejtësisë, në vitin 1971, me emrin "Shoqata Islame në Spanjë". Më 22 04.1974, rregullorja e shoqatës u ndryshua. Tani shoqata kishte të drejtë të ndërtonte xhami dhe qendra islame, nëpër gjithë territorin e Spanjës²¹. Pas këtij hapi, shoqata hapi degët e saj, nëpër qytete të ndryshme të Spanjës: në Madrid, në Abit (Ashtorijash), në Sorkasta (Aragon), në Belnesia (Belnesija), në Sant Andre (Kantabrija), në Sant Jako (Jelikija), dhe në Malagë e në Granadë të Andaluzisë.

Shoqata i filloi aktivitetet e saj, në një banesë të thjeshtë në Granadë, pastaj kaloi në selinë kryesore të shoqatës në Madrid, në një banesë gjithashtu të thjeshtë, e më pas kaloi në apartamentin e gjerë, në rrugën 'Franko Rodriges', apartament ky, i cili mundësoi që të kihej një faltore për 200 persona, një bibliotekë dhe një dhomë për aktivitetet administrative të shoqatës dhe organizimin e studimeve. Më vonë, shoqata ndërtoi kompleksin e Qendrës Islame me emrin "Xhamia Ebu Bekr", në rrugën 'Anstizo Herero', në lagjen Tatvan, e cila ishte xhamia e parë moderne e ndërtuar në Madrid. Ndërsa qendrat e qyteteve të tjera, kishin banesa të thjeshta me qira, ose të blera nga shoqata.

Shumica e anëtarëve të kësaj shoqate, ishin studentë nga Siria dhe Palestina, të cilët u diplomuan, u martuan me spanjolle, morën shtetësinë spanjolle dhe u integruan në jetën publike. Shumë prej tyre, kanë merita në përhapjen e thirrjes islame, sepse lanë anash jetën e tyre

²¹ Hisham Shishkeli, "El-Islam jenteshir min xhedid fii espanja", (Islami po përhapet serish në Spanjë), gazeta javore 'El-Muslimun', 8 Dhul-Keade 1402H,

profesionale dhe u dhanë pas thirrjes islame në mesin e studentëve arabë, duke shpëtuar gjenerata të tëra studentësh, të cilët nuk kishin mësuar gjë për fenë e tyre në atdhe, dhe u erdhi rasti t'a mësojnë në emigrim. Gjatë aktivitetit të tyre, këta thirrës islamë, dhanë një mund të madh, në mësimin e rregullave të fesë për të rinjtë muslimanë, në botimin e broshurave islame në gjuhën arabe dhe spanjolle, në mbajtjen e ligjëratave islame dhe në mësimin e parimeve islame për fëmijë.

Deri në vitin 1978, shoqata qëndroi brenda kornizës së shoqatave të studentëve, mirëpo pas këtij viti, duke e parë të arsyeshme se, meqë studentët kishin mbaruar studimet dhe ishin martuar e kishin krijuar familje, ata vendosën t'a shndërrojnë shoqatën, në shoqatë të komunitetit të emigruar musliman. Aktiviteti i tyre, u përqendrua në publicitet. Ata filluan të botojnë dy revista në gjuhën spanjolle, çdo dy muaj: njëra ishte "Mbajtësi më i sigurtë" (tirazhi njëmijë copë), dhe tjetra ishte revista "Al-Islam" (tirazhi 750 copë). Shoqata, gjithashtu, botonte kalendarin e kohëve të namazit dhe e shpërndante në mesin e muslimanëve, dhe kishte aktivitete, gjithashtu, edhe në mjetet e informimit spanjoll, dhe pjesëmarrje në debatet fetare.

Programi kulturor i shoqatës, përfshinte edhe mësimet serike javore në shkencën e fik-hut (jurisprudencës) islam dhe të gjuhës arabe dhe mbajtjen e simpoziumit mujor. Shoqata arriti të botojë një numër të konsiderueshëm librash në gjuhën spanjolle, qofshin ato të shkruara nga autorë vendas, qofshin të përkthyer nga gjuhët e tjera në gjuhën spanjolle. Disa prej këtyre librave janë: "Isai a.s. në Kur'an" i autorit Sulejman Mufesir, "Familja islame" i autorit Hurshid Ahmed, "Shpirti Islam" i autorit Muhamed Esed, "Çka i dha Islami civilizimit perëndimor" të autorit Ebu El-Eala Mewdudi dhe libra të tjerë. Nga aktivitetet më të dalluara të shoqatës, në aspektin shoqëror, ishin : organizimi i martesave islame dhe lëshimi i dokumentacionit për ata që e pranonin Islamin, siç bënin edhe shoqatat e tjera.

Në vitin 1978, nga "Shoqata Islame në Spanjë" u shkëput një shoqatë e re, që u bë e njohur me emrin "Qendra Islame në Spanjë". Edhe shoqata e re përbëhej prej studentëve të vjetër arabë të lindjes. Selia kryesore e kësaj qendre, ishte në Madrid, në një banesë, në rrugën 'Allonso Kano', dhe përbëhej prej faltores (Xhamisë), bibliotekës dhe zyrave. Qendra në fjalë kishte hapur edhe filialet e saj në Barcelonë (Katalonia), në rrugën Meridijan, në Lasbalmas (Ishujt e Dy të Amëshuarve), në Granadë (në një apartament të blerë), në Sevilje (në një banesë me qira), në Malagë (në një shtëpi të blerë), në Kordovë (qendra mori xhaminë, që e kishte ndërtuar Frankoja për ushtarët marokenë, e njohur me emrin 'Xhamia Morabito') në Andaluzi.

Në vitin 1990, "Rabita", Liga e Botës Islame me seli në Mekken e shenjtë, e angzhoi "Qendrën", që të menaxhonte xhaminë e mbretit Abdul-Aziz, në Marbella (rrethi i Malagës), në Andaluzi. Marbella është një qytet i vogël, në brigjet e Detit Mesdhe, numri i banorëve të saj nuk i kalon mbi 55 mijë banorë, dhe lulëzimi i këtij qyteti lidhet me përzgjedhjen, që arabët e jashtëm, ia bënë këtij qyteti, si vendi më i preferuar për t'i kaluar pushimet e tyre, në Spanjë. Ky qytet, u përfshi në investimet e mëdha arabe, të cilat e shndërruan nga një liman i vogël për peshkatarë, në një qendër të rëndësishme ekonomike, përgjatë bregdetit andaluzian. Ideja për ndërtimin e xhamisë, lindi në vitin 1979. Prefekti i qytetit të Marbellës në atë kohë, iu drejtua princit Selman bin Abdul Aziz Al Saud, me kërkesën që të investojë në ndërtimin e një qendre për studime arabe dhe islame, kërkesë të cilën princi e pranoi dhe, me pasurinë e tij, ndërtoi në pronën e vet private xhaminë dhe qendrën islame.

Punimet për ndërtimin e Xhamisë dhe Qendrës Islame përfunduan në vitin 1981. Edhe përkundër bukurisë, i gjithë kompleksi i xhamisë, minares dhe qendrës, u punua më një model që ndryshon nga modeli dhe artitektura tradicionale andaluziane, edhe pse dihet se arkitekti i saj ishte andaluzian, me emrin Huan Mora. Kompleksi u

ndërtua në një sipërfaqe prej 10. 500 metrash katrorë, përgjatë magjistrales bregdetare në perëndim të Marbellës. Sipërfaqja e xhamisë është 834 metër katrorë, me një kapacitet prej 800 besimtarësh dhe e pajisur me klimatizim. Kati i parë, ka një sipërfaqe prej 600 metrash katrorë dhe është vetëm për meshkuj, ndërsa kati i dytë është për gra. Tavani i xhamisë mbulohet me një kupolë 12 metra e lartë, me 24 dritare me xhama të ngjyrave të ndryshme, për ndriçim sa më të mirë. Jashtë xhamisë, janë ndërtuar dy salla të gjëra, biblioteka (kur'anoteka) me një sipërfaqe prej 187 metrash katrorë. Në anën perëndimore, janë ndërtuar shtëpitë për imamin, për muezinin dhe për drejtorin e Qendrës. Në mes të ndërtesave, gjendet një sipërfaqe e mbuluar me tavan, 198 metra katrorë e gjerë, kurse në mes është ndërtuar një shatërvan dhe rreth e qark janë mbjellë pemë portokajsh.

Nga aktivitetet më të rëndësishme të “Qendrës Islame në Spanjë” ishin: ligjëratat, takimet publike, përhapja e librit islam në gjuhën spanjolle, mbajtja e mësimëve javore në qendrat e ndryshme, gjithashtu, organizimi i mësimëve për studentët arabë që t’a përvetësonin gjuhën spanjolle, organizimi e piknikeve grupe dhe gjallërimit e rriteve fetare. Qendra, gjithashtu, organizonte kampingun vjetor, në të cilin merrnin pjesë mbi njëqind të rinj muslimanë nga Spanja dhe Evropa. Krahas këtyre aktiviteteve, qendra përkthente libra islamë në gjuhën spanjolle dhe bënte publikimin e tyre. Disa prej këtyre librave, janë: “Katërdhjetë hadithet e Neveviut”; librat e Ebi Hassan Enedeviut, siç është libri “Në mes Lindjes e Perëndimit”; Sejjid Kutbit: “Mësuesi në rrugë” dhe “Kjo është feja”; librat e Muhamed Kutbit: “Gruaja në Islam” dhe “Libri i dyshimeve rreth Islamit”; librat e Ebi El Eala Mewdudi, si: “Popujt e sëmure dhe koha bashkëkohore”, “Ideologjia politike në Islam“, “Parimet Islame”, “Libri i Sunnetit (traditës)”, “Parimet themelore për të kuptuar Kur’anin”; pastaj librin “Jeta e Muhamedit s.v.s.”, të autorit Muhamed Husejn Hejkel; “Islami në ndriçim” të Mahmud Abdul Ati, duke ia bashkangjitur edhe

përkthimin e librave të Nezar Al-Sibag, si: "Namazi", "Poligamia në Islam", "Tevhidi (Besimi në Njësi)", "Martesa dhe shkurorëzimi në Sheriatin Islam", "Kadijanija"; si dhe libra të tjerë.

"Qendra Islame në Spanjë", themeloi "Shkollën Ibni Rushdi" në Granadë, e cila u hap në vitin 1985, pasi u mor pëlqimi zyrtar. Shkolla u hap me 74 nxënës, 22 nxënës parashkollorë, në shërbim të të cilëve ishin 9 mësues, prej tyre katër arabë dhe pesë spanjollë (jomuslimanë). Shkolla ishte e vendosur në një shtëpi të madhe, me sipërfaqe 2.000 metra katrorë, me dhoma të mëdha, terrene sportive, salla të mbyllura sporti dhe xhaminë për 200 persona. Qendra, gjithashtu, ngriti edhe një shkollë tjetër në Barcelonë, për t'ua mësuar fenë islame dhe gjuhën arabe, fëmijëve të emigrantëve muslimanë. Por, asnjëri prej këtyre dy projekteve nuk pati sukses, edhe përkundër përpjekjeve të mëdha.

Qendra, gjithashtu, bleu një parcelë toke, 12 kilometra larg nga aeroporti i Madridit, me një sipërfaqe prej 6.25 hektarësh, për ngritjen e kampingut të përhershëm, për studentët dhe nxënësit muslimanë.

Më 28.06.1973, prefekti i Madridit u kishte ofruar përfaqësive politike islame, një sipërfaqe prej 1.500 metrash katrorë, në rrugën 'Kostarika', në një lagje të re të Madridit, në afërsi të qendrës së qytetit, që të ndërtonin një xhami. Mirëpo, afati përfundoi, dhe mbi tokë nuk u vërejt asgjë dhe prefektura e ktheu tokën përsëri në pronën e vet. Më vonë, pasi ambasadorët muslimanë u zotuan për ndërtimin e xhamisë në Madrid, prefektura ofroi, në periferi të Madridit, në pjesën lindore, saktësisht në rrugën 'Paqa', një parcelë prej 10,365 metrash katrorë. Dhe vërtet, Mbretëria Arabisë Saudite, mori përsipër projektin për ndërtimin e xhamisë, punimet e të cilës përfunduan në vitin 1990, nën kujdesin e ambasadës së Arabisë Saudite. Kjo xhami, u bë qendra më e madhe islame në Spanjë. Xhamia u ndërtua në një sipërfaqe prej 2.000 metrash katrorë, me një vlerë 1.500 milionë pezeta.

Ky kompleks, përbëhet prej gjashtë kateve, tre prej tyre nën tokë, nga minarja 36 metra e lartë, xhamia (faltorja) 650 metra katrorë, që pranon brenda saj 830 persona, prej zyrave, sallave për konferenca, qendrës kulturore, kur'anotekës dhe lokaleve të tjera²². Për menaxhimin e kësaj qendre, u ngarkua “Qendra Islame e Spanjës”.

Numri i muslimanëve marokenë, që kishin emigruar në Spanjë, ishin mjaft i madh. Ata përbënin tetëdhjetë përqind të muslimanëve që jetonin në Spanjë, por për fat të keq, ata nuk arritën të organizoheshin, deri vonë. Shumica e tyre ishin punëtorë të thjeshtë, nëpër zonat industriale, në Madrid dhe në Barcelonë, por kishte edhe shumë prej atyre që jetonin në mënyrë ilegale, në Spanjë. Edhe më tej, organizimi i muslimanëve marokenë mbeti shumë i dobët. Ai u përqendrua në dy drejtime: I pari ishte grupi “Teadidija” “Bashkëndihmësit”, që kishte qendrat në Tori Molinos (rrethi i Malagës) në Andaluzi, në Barcelonë dhe në Madrid. Qendrat e “Bashkëndihmësve”, kohët e fundit, kaluan në qendra modeste, dhe si zakonisht ato përbëhen prej faltores, kafenesë dhe shkollës për fëmijë.

Grupi i dytë është “Tebliğ” (Komunikuesit), të cilët u paraqitën kohëve të fundit me xhami të thjeshta, më e rëndësishmja e të cilave është xhamia në regjionin e Andaluzisë në Islaverde (Ishullin e Gjellbërt). Gjithashtu, marokenët kanë edhe një xhami të punëtorëve, në Xhebelu Tarik (Gjibraltar). Ndërsa, në regjionin Katunije, xhamitë më të njohura, që i themeloi grupi “Tebliğ”, janë: Xhamia San Bizanti Di Kaldiris (rrethi i Turkunë-s), Xhamia Tarik bin Zijad në Birat (rrethi i Barcelonës), Xhamia Ramadan Nebish (rrethi i Barcelonës), Xhamia “Ebu Bekër” në Bijgiras (rrethi i Grande-s). Marokenët themeluan, gjithashtu, shoqatën “Shoqata Islame e Marokenëve në Madrid” dhe “Liga e Grupit Islam” në Las Balmsa, në Ishujt e Dy të Amëshuarve.

²² “Spainias Rediscover the Revelance of Islam” Arabia, October 1983

Vlen të përmendet programi radiofonik islam, të cilin, në radion spanjolle, e transmetonte zotëri Muhamed Shekur, njëri nga figurat eminente nga komuniteti musliman i Marokut në Spanjë dhe lider i tyre, drejtor i Agjencisë Marokiane Arabe për Lajme në Madrid.

Pakistanezët e përbëjnë grupin e tretë të muslimanëve të huaj në Spanjë, shumica e të cilëve punonin në miniera. Ndërsa në Andaluzi ishin të përqendruar në tri qytete: në Kazlon(Linaris) në krahinën e Xhijanit, në Lakoruna dhe në Pinaroga në rrethin e Kordovës.

Në vitin 1982, pakistanezët e themeluan shoqatën islame në Kazlon, u regjistrua zyrtarisht me emrin "Shoqata islame e Xhijanit", kryetari i parë i saj ishte Rexha Muhamed Ikbali. Ata në Andaluzi luajtën rol mjaft të randësishëm në përkrahjen dhe ndihmesën e shoqatave islame në Kordovë dhe Granada kur ato ishin në fillim të aktivitetit të tyre. Grupe islame të pakistanezëve gjejmë edhe në Molira në rajonin e Lejonit (Kashtale Lejon), në Montalban në regjionin Tarvil(Aragon). Pakistanezët gjithashtu themeluan edhe një qendër islame në Barcelonë në rrugën Rifomiro.

Pakistanezët Kadijan e formuan qendrën e tyre më të madhe në Spanjë në qytetin Madrid, ata ndërtuan edhe tempullin e tyre në formën e xhamisë në qytezën "Pedroibad" në regjionin e Kordovës, përgjatë magjistrals kryesore që lidh Kordovën me kryeqytetin.

Shumica e anëtarëve të këtij grupi, që janë pakicë, janë nga India dhe Pakistani. Ata nuk arritën që të tërheqin numër që vlenë të theksohet nga andalozianët.

Senegaljanët janë grupi i katërt i muslimanëve të huaj në tokën e Spanjës, ata kryesisht punojnë në bujqësi, e sidomos në pjesën e Katalonës, prej tyre ka që jetojnë e punojnë në qytezën Lamarzom dhe në qytezën Mataron në rrethin e Barcelonës dhe të tjerë që jetojnë e punojnë në qytezën Ambordan në rrethin Grande, mirëpo nuk kanë ndonjë organizim islami që vlen të theksohet.

Në përgjithësi, organizimi islam i muslimanëve emigrant nuk pati ndikim në renesancën islame te andalozianët, përveç se pak, kjo vjen nga shkakut se muslimanët që vinin nga trojet e ndryshme islame ata me vete sillnin edhe traditat e tyre dhe kishin gjuhën me gjithë dialektet e tyre, ashtu që nuk i tërhiqnin andaluzianët për t'u bashkangjit në mesin e tyre, ata e ndienin vehtën të huaj në mesin e atyre. Gjithashtu muslimanët e jashtëm edhe nëse e merrnin shtetësin spanjolle ata nuk integroheshin në shoqërinë spanjolle, e as që kishin ambicie për t'i kërkuar të drejtat e tyre.

Në këtë formë mbetën shoqatat islame të emigrantëve të njohura sipas përkatësisë regjionale të tyre, ose arabe lindore, ose arabo perendimore, marokiane, senegalijane, pakistaneze, ashtu që asnjëra prej tyre nuk arriti të tërheq qytetarët spanjoll.

Kjo gjendje, dita ditës ndikoi deri te dallimet në mes muslimanëve andaluzian, muslimanëve spanjoll dhe muslimanëve emigrant. Për fat të mirë, udhëheqësit e tyre të urtë po punojnë në largimin e diferencimeve në mes tyre.

Në përgjithësi, nuk pritet ndonjë ndikim nga grupet e muslimanëve të jashtëm në renesancën ose ringjalljen islame andaluziane, por ndikimi mbyllët brenda grupeve të tyre. Këto shoqata islame nuk ndryshojnë nga motrat e tyre në perendim të Evropës.

Rizgjimi islam në Andalozi nuk erdhi nëpërmjet muslimanëve emigrant, prandaj për këtë do të shohim në kapitujt që pasojnë. Do të shohim se si u ndoqën hapat e parë të rizgjimit islam në Andaluzi dhe në teritoret tjera të Spanjës. Do t' i ndjekim aktivitetet e tyre. Sikur që do t' i studiojmë edhe rrymat aktive në këtë renesancë islame, duke i fiksuar rrymat që kanë rrënjë të thella dhe të vjetra në Andaluzi.

Drejtimi Durkavije në Granadë

Një numër i madh i qytetarëve të Andaluzisë, e kishin ruajtur fshehurazi fenë e tyre islame. Pas vitit 1960 të erës së re, disa prej tyre, kishin vendosur që t'a shpallnin fenë e tyre haptazi, brenda në vendin e tyre, në Spanjë, siç ishte rasti i avokatit Khalil bin Umejje, i cili jetonte në Mugerit. Të tillë kishte shumë, por ata nuk ishin të njohur. Kishte edhe të tjerë, të cilët emigruan nga Andaluzia (Spanja), si p.sh. një qytetar i Granadës, të cilin e takova në Kopenhagë të Danimarkës, me datën 05.11.1973, i cili ishte lindur dhe rritur në Barcelonë, ndërsa ishte bërë musliman në vitin 1969, në Pakistan, dhe ishte martuar me një muslimane suedeze. Pas martesës, ai kishte emigruar në Danimarkë dhe kontribuoi në themelimin e një shoqate islame. Më vonë, kaloi dhe emigroi në Los Anxhelos të Kalifornisë (SHBA), ku jeton edhe sot (1990). Kur e pyeta atë për shkakun e konvertimit të tij në islam, ai u përgjigj dhe tha: "Isha fëmijë i vogël, kur gjyshja ime po ndërronte jetë; më ftoi që t'i afrohem asaj, e më pëshpëriti në vesh, duke më thënë: "Feja krishtere nuk është feja jonë, e as nuk është feja e vërtetë, kur të rritesh, përpiqu që t'a njohësh fenë tënde." E kur u rrita, e studiova mirë historinë e Spanjës dhe e kuptova qëllimin e gjyshes sime, e mësova fenë islame, u binda në të, e në Pakistan e shpalla besimin tim islamin, aty edhe e mësova mirë e qartë fenë time". Kështu u bënë muslimanë një numër i madh i andaluzianëve (spanjollëve), prej tyre disa e vazhduan jetën e tyre në Spanjë, dhe të tjerë emigruan dhe e lëshuan Spanjën, duke emigruar në vende të ndryshme, pa menduar fare për organizimin e tyre grupor.

Qyteti Meknas, në Marok, është vendfillimi e organizimit të parë andaluzian. Në këtë vend, para çerek shekulli, rrugën e organizimit e hapi hoxha Ibnul-Habib, i cili ishte edhe prijëtar (prijësi) i drejtimit mistik Durkavije, i cili u bë vendtakim i një numri europianësh, që i joshte Islami.

Në vitin 1975, i njëjti vit kur vdiq diktatori Franko, tre djelmosha andaluzianë, u drejtuan për në Britaninë e Madhe. Ata ndaluan për pak kohë në qytezën Port Jano (Kalaja e qytetit të Rabahit) në zonën e Kashtalijes Mancho. Aty pranuan islamin. Hoxha Kadr i udhëzoi që të shkojnë në Kordovë dhe aty të themelojnë Komunitetin e tyre islam në Spanjë.²³

Në vitin 1977, anëtarët e këtij grupi shkuan në Kordovë, zunë një shtëpi të vjetër dhe të gjithë u vendosën në të. Secili ishte me gruan dhe fëmijët e vet. Filluan të punojnë profesione të thjeshta, si shitës endacakë, për të ruajtur vetveten. Si burrat, gjithashtu dhe gratë, ishin shumë të kujdesshëm në veshje, duke veshur rroba islame. Atyre iu bashkangjiten edhe një numër andaluzianësh dhe të tjerë jo spanjollë.

Numri arriti në katërdhjetë. Grupi u përqendrua në faktin se, duke qenë se ishin duke jetuar në një shoqëri jobesimtare, të kërkohej dalje nga kjo. Prandaj, për secilin që konvertohej në Islam, kërkohej që të largohej nga familja dhe puna e tij, dhe t'i bashkangjitej grupit në fjalë.

Kardinali i Kordovës, MonsinJOR Anfanti Florido, ftonte në mirëqenie dhe mishërim ndërftar dhe përkrahte fuqimisht dialogun islamo-krishter. Pas çdo samiti vjetor të dialogut ndërftar, i ftonte dijetarët muslimanë që të falnin namaz në xhaminë madhështore të Kordovës. Grupi në fjalë, kërkoi që t'a falte namazin e Fitër Bajramit, në vitin 1398 hixhri (1978 sipas Krishtit), në xhaminë madhështore të Kordovës. Kjo kërkesë u pranua dhe ata e falen namazin. Ky ishte aktiviteti i parë i hapur, që njeh ky grup. Grupit në fjalë, gjatë namazit të Bajramit, iu bashkangjit edhe një numër i konsiderueshëm i punëtorëve marokenë, që punonin në Spanjë, së bashku me një numër pakistanezësh (nga Penaruxha, Kazlona dhe Lakrolina), si dhe disa studentë arabë.

²³

Juan Bustos "La Fiesta Musulmana del Final del Ramadan, Celebrada en La Alhambra" Patria (Granada) Agosto 4, 1980.

Grupi, në vitin 1979, vendosi që të transferohet në Sevilja, duke shpresuar se atje do të gjente një terren më të përshtatshëm për thirrjen islame. Aty, për herë të parë, falën namazin në kopshtin e xhamisë El-Mensur. Njëri prej të pranishmëve, u ngjit lart në minare të xhamisë, e njohur me emrin Lahiralda, dhe thirri ezanin. Grupi bëri përpjekje, që xhaminë e ndërtuar nga Maroku, në panairin ndërkombëtar, t'a merrte nga prefektura e Seviljes. Mirëpo, prefektura refuzoi. Me datën 04.04.1980, me rastin e marshimit krishter në javën "Java e shenjtë", anëtarët e grupit ndanë pamflete, në mesin e shikuesve të marshit, të cilët brohorisnin: "Ndaloni gjyqjet e inspektimit". Pamfleti thoshte: "Këto mirësi, janë mirësi të gjyqeve të inspektimit. Ju po festoni gjenocidin (krimin) masiv, po i bëni nder e respekt, kriminelëve të paskrupullt, vërtet Andaluzia islame ishte Andaluzi e lirë. Pastaj erdhën vrasësit (dorasit) e pronarëve të kapelave të gjata (gjyqtarët e inspektimit). Ky manifestim është përkujtim për gjyqet e inspektimit, kremtimi i tyre është krim dhe simbolizon terrorizëm dhe krim masiv".

Policia ndërhyri dhe arrestoi njërin nga muslimanët andaluzianë, i cili pas disa ditësh u lirua. Pas kësaj ngjarje, ndodhi një ndryshim i ri në grup (xhemat), ata vendosën që të transferohen në krahinën Welbe, ku morën një plantacion, në mes Welbe dhe Resine; aty u bënë përpjekje për themelimin e shoqërisë islame, por pa sukses (dështuan).

Xhemati (grupi), pas kësaj, kaloi dhe u vendos në Granada. Kjo, u bë, pasi e shpalli emërtimin e vet, me emrin "Shoqata e kthimit të Islamit në Spanjë"; në disa pamflete e quajti veten "Xhemati i muslimanëve spanjollë".

Më datën 22.09.1980, shoqata u regjistrua në Ministrinë e Drejtësisë së Spanjës, në bazë të drejtës për lirinë fetare, të vitit 1967. Regjistrimi u bë me emrin "Shoqata fetare për përhapjen e Islamit në Spanjë".

Grupi mori me qira një ndërtesë në rrugën Sarabia. Në atë ndërtesë rregulluan xhaminë dhe zyrat e tyre, si dhe filluan me disa projekte ekonomike. Liderët e kësaj shoqate, vendosën që burrat e shoqatës të veshin veshje europiane, si kompensim për fenë islame, për hir që të jetë më lehtë për t'u pranuar nga shoqëria e Granadës.

Xhemati, për herë të parë, filloi me aktivitet të hapur-legal, në Granadë, pasi kishte marrë lejën nga Francisko Sanqes Rolldau, i cili i lejoi grupit që t'a falte namazin e Fitër Bajramit, në oborrin e Pallatit të Kuq. Kjo u bë në vitin 1400h, saktësisht më datën 13.08.1980.

Në namaz, morën pjesë afër 200 persona, prej tyre burra, gra dhe fëmijë. Kishte pjesëmarrës edhe nga studentët arabë dhe punëtorët pakistanezë. Pas namazit të jaciesë, grupi shtroi darkë për të gjithë, në një atmosferë të mrekullueshme fetaro-shoqërore.

E gjithë kjo, krijoi përshtypje dhe ndikim pozitiv në shoqërinë e Granadës. Kjo ndihmoi në njohjen, ose definimin e Grupit, ashtu që më pas t'u bashkangjitet një numër i konsiderueshëm i atyre që ishin kthyer në Islam .

Me rastin e Kurban Bajramit që pasoi, Grupi kërkoi nga Anfanti Florido, Peshkopi i

Kordovës, që t'a falte namazin në Xhaminë Madhështore të Kordovës, mirëpo Peshkopi kësaj radhe refuzoi me shkrim, duke supozuar se një gjë e tillë mund të nxiste panik, përçarje dhe skandal. Ky refuzim, u shoqërua nga një fushatë anti-islame në shtypin spanjoll.

Njëri nga pjesëtarët e Grupit, iu përgjigj kësaj fushate, duke thënë: "Islami nuk është pronë e arabëve, as nuk do të thotë që njeriu, i cili e pranon Islamin është bërë arab, ja për shembull, ne jemi muslimanë spanjollë, sikurse që në botë ka muslimanë rusë, filipinas, etj. Për hir të kësaj, ne nuk kemi kurrfarë lidhje me shtetet e pasura me naftë, përveçse marrëdhënie të muslimanit me vëllain e vet musliman, e asgjë më tepër.

Ishte po i njëjti peshkop i Kordovës, i cili në vitin 1979, ua kishte lejuar muslimanëve të huaj, pjesëmarrës në Samitin rreth civilizimit islam, që t'a falnin namazin në Xhami. Mirëpo, kësaj radhe refuzoi, dhe pas refuzimit të tij, Grupi kërkoi ndihmën e Asamblesë Komunale të Kordovës.

Hulijo Angita, prefekti i Kordovës (aktualisht, president i Partisë së Unionit Majtist), e përshëndeti Grupin dhe i lejoi që t'a falte namazin e Kurban Bajramit në kishëzën e komunës. Kështu, në kishëzën e komunës, u organizua e kremtja e madhe islame, ku morën pjesë edhe anëtarë të Asamblesë Komunale të Kordovës. Në mesin e tyre, prezentoj edhe Antonio Thurita, zëvendëskryetari i Asamblesë Komunale, pjesëmarrja e të cilit ishte si një kritikë ndaj Peshkopit dhe kishës ekstreme, dhe si solidarizim me muslimanët. Me këtë rast, udhëheqësi i grupit, i cili mbajti një ligjëratë të paharrueshme, në fund të ligjëratës tha: "Shoqëria jobesimtare është në buzë të dështimit; është kapluar nga një kulturë e degjeneruar, nga një dështim i shpejtë në skenën politike dhe vazhdimisht po e ndjek kriza ekonomike.

U them të gjithë atyre, që me sinjeritet të plotë hulumtojnë ose bëjnë kërkime, për t'a njohur rrugën e vërtetë, se një gjë e tillë do t'u mundësojë që t'a njohin vetveten dhe të jenë komunikues dhe bashkëpunëtorë të sigurtë me të tjerët, duke shprehur besnikëri reciproke... Islami është shpresa që shndërit, ju ftoj që t'a zbuloni, ju ftoj që t'a argumentoni të vërtetën në besimin e një Zoti... Ju përgëzoj dhe jap sihariqin se, me ndihmën e Allahut, Andaluzia do të kthehet në Islam".²⁴

Në Granadë, Grupi fali namazin e Bajramit që pasoi, në shkollën e Vjetër Juridike, e cila ishte e vetmja xhami që kishte mbetur në qytet dhe që ishte shndërruar në

²⁴ Juan Bustos "No han Nagado La Mezquita de Cordoba para Celebral la Fiesta del Sacrificio: Muhammed Ali" Partia, Oct, 16, 1980

muzeum komunal.²⁵ Namazin e falën me leje nga Asambleja Komunale e Granadës.

Menjëherë pas këtyre ngjarjeve, filloi të rritej numri i antarëve të Grupit. Shoqata filloi të dërgojë delegacione në vendet arabe, në mesin e tyre edhe në shtetet e Gjirit, në fillim të vitit 1980, pastaj në Marok, në dhjetor të të njëjtit vit²⁶.

Shoqata vendosi që të ndërmarrë disa projekte islame, më i rëndësishmi i të cilëve ishte ndërtimi i xhamisë në lagjen Pijazin. Për këtë projekt, shoqata mori përkrahjen e plotë të Asamblesë Komunale të Granadës, me ç'rast Antonio Hara Andro, prefekti i Granadës, kishte shkruar një letër me datën 07.11.1980, në të cilën thoshte: "Të nderuar miq, më këtë datë, Asambleja Komunale pranoi zotëri Umer Abdul Hak Kuka Dominigos dhe zotëri Abdul Kerim Karasiko, të cilët shkurtimisht më bënë të qartë mendimin e komunitetit tuaj, për ndërtimin e xhamisë në lagjen Pijazin të kësaj kryeqendre dhe dëshiroj që t'ua bëj të qartë, në këtë letër, përkrahjen e Asamblesë Komunale, kryesinë e së cilës kam unë nderin t'a përfaqësoj, për projektin tuaj. Natyrisht, ju ofroj përkrahjen time personale, me shpresë që të gëzohemi me realizimin e këtij projekti". Nuk vonoi dhe Shoqata bleu një parcelë toke në lagjen Pijazin, sipërfaqja e së cilës arrinte 2.140 m², për të ndërtuar në të, një xhami, por ky projekt nuk u realizua. Shoqata bleu edhe një shtëpi të madhe, në të njëjtën lagje Pijazin, në rrugën San Grigorio, të cilën e shndërroi në pushimore, shkollë dhe qendër islame. Më pas, Shoqata arriti të marrë edhe një sipërfaqe të re toke, të cilën e shndërroi në varreza për muslimanë e Granadës.

Shoqata filloi të tregojë sukses në realizimin e disa projekteve ekonomike, shumica e të cilave u realizua, në Qendrën e marrë me qira, në rrugën Sarabija në Granadë,

²⁵ Fiesta Musulmana en El Recito de la Piscina Municipal" Cordoba, 18.10.1980

²⁶ Par Espanoles, que Exite en el Pais", Hoja de Lunes (Granada), 20.10.1980

sidomos projekti “Nuril Andalus” (“Drita e Andaluzisë”), për botimin, publikimin dhe distributimin e librit, si dhe inçizimin e filmave dhe videokasetave që flasin për Islamin, duke u përqendruar rreth Kur`anit madhështor. Shoqata ndër morri edhe një projekt, për themelimin e shkollës islame, për të rritur por edhe për fëmijë, pastaj për qendrën për diagnostifikim fizioterapi dhe rehabilitim psikik. Shoqata kishte hapur edhe një “Dyqan mjekues”, i cili ofronte ushqime natyrale dhe ilaçe popullore. Krahas këtyre, shoqata kishte ndërtuar edhe një furrë buke dhe një mishtore. Për t’a thënë më shkurt, shoqata bëri përpjekje që të formojë institucione kulturore dhe ekonomike, për të cilat ka nevojë një shoqëri e plotë dhe e pavarur.

Numri i anëtarëve të shoqatës, kaloi në disa qindra, në këtë mënyrë, filloi të paraqitet me një qartësi të plotë natyra islame në Granadë, e sidomos në lagjen historike Pijazin. Shoqata organizoi dy samite të rëndësishme për Fik-hun Malikij, ku mori pjesë elita e dijetarëve muslimanë nga mbarë bota. Samiti i parë u mbajt në vitin 1982, në pushimoren e xhamisë në Pijazin, ndërsa samiti i dytë u mbajt, nga data 07 deri 11 nëntor 1983, në sallën “Manuel Di Fala”, të cilën ua ofroi Prefektura e Granadës, si lehtësim për organizimin e samitit. Këtë samit e financoi Shteti i Emirateve të Bashkuara Arabe. Në muajin maj të viti 1984, presidenca e gjykatave legislative të Ebu Dhabit, dërgoi me shpenzimet e veta disa profesorë mauritanëzë, që t’ua mësojnë grupit (xhematit) parimet islame.

Grupi u angazhua shumë në fushën e publicistikës, botoi libra në gjuhën spanjolle, gjithashtu nxorri nga botimi revistën mujore me emrin “Vendet Islame”. Shkaku i zgjerimit të këtij grupi, në radhë të parë, erdhi nga solidariteti i anëtarëve rreth një programi të vetëm dhe, gjithashtu, ata i afronte motoja ose simbolet andaluziane, sa që u bë e mundur, që një numër i madh i banorëve të Andaluzisë t’i bashkangjitet grupit.

Mirëpo, do të vazhdonte edhe më tej që të popullarizohej dhe të merrte famë, sikur mos të kishte filluar të kthehej mbrapa, apo të ngecë. Kjo ishte për shumë shkaqe, e një prej tyre ishte: shkaku i sistemit organizativ, i ngritur në baza centraliste, të mbledhur të gjithë rreth hoxhës së madh (sheikut të madh), Abdul Kadr Es-Sufiut, dhe princit ("emirit") të grupit, Dr.Mensur Abdu Selam Askandiro, e pas tij Muhamed Del-Bush Al-Andaluzi; pastaj shkak tjetër ishte rruga ose metoda e ashpër dhe e vrazhdë e grupit, në veprim me të tjerët.

Shkak tjetër ishin kërkesat e disa anëtarëve, që i ishin bashkuar grupit, të cilët kërkonin që të bëhej tërheqja e grupit nga shoqëria andaluziane ose spanjolle, pasi në konceptin e saj, e konsideronte këtë shoqëri si shoqëri jobesimtare. Pas këtyre shkaqeve, pason shkaku tjetër me radhë, kur grupi akuzoi të gjithë qytetarët e tjerë, përveç muslimanëve, si njerëz të humbur - si jobesimtarë dhe kjo rrodhi sidomos nga metodat e ashpra të hoxhës (sheikut-liderit të grupit), Abdul Kadrit, i cili ua ndaloi ithtarëve të tij, që të kenë marrëdhënie shoqërore-ekonomike e miqësore me të tjerët, sa që ndaloi që të kihet bashkëpunim me ata, të cilët nuk i zbatojnë ose përfillin urdhërat e tij, gjë që e largoi një numër të madh të anëtarëve të shoqatës, prej të cilëve kishte edhe iniciatorë të themelimit të shoqatës.

Ndërsa ithtarët e tjerë, që mbetën më besnik, i urdhëronte që mos të kenë kurrëfarë kontakti me të larguarit, e as mos t'u flasin atyre. Kjo masë ndëshkimi, e dobësoi edhe më shumë shoqatën dhe grupin në tërësi. Pas kësaj, edhe marrëdhëniet e shoqatës me shtetet e Gjirit, pësuan ndryshime të mëdha. Së pari: u largua interesimi vetëm për Andaluzinë (nuk ishte më ai interesim i mëparshëm), nacionalizmi duhej larguar prej tij, shoqata ndryshoi emrin nga emri "Shoqata i kthimit të Islamit në Spanjë" në vitin 1981, në "Shoqata Islame e Spanjës" në vitin 1982.

Së dyti: Misticizmi (Tesavufi), konsiderohej dalje nga Islami, hoxha Abdul-Kadr u deklarua se ishte larguar nga misticizmi-tesavufi dhe kishte dalë nga drejtimi durkavije dhe kishte mbështetur idenë selefije, dhe ua kishte parashtruar, e në fakt, edhe imponuar edhe ithtarëve të vet, gjë që nxorri pëshpëritje të mëdha brenda përbrenda radhëve të grupit, ashtu që një numër i ri, u largua nga grupi, në këtë mënyrë u larguan shumica e anëtarëve të grupit, ndodhi që disa prej tyre u larguan tërësisht nga Spanja, por kishte nga ata që formuan shoqata të tjera islame, e kishte të tillë që vazhduan të jetojnë si muslimanë të vetmuar dhe të pavarur, por, për fat të keq, kishte edhe prej atyre që dezertuan nga rradhët e besimtarëve muslimanë dhe u kthyen në besimin e tyre të mëparshëm.

Shoqata hyri në një etapë të re, pasi në Granadë nuk kishin mbetur më shumë se pesëdhjetë anëtarë. Shoqata ndryshoi edhe emrin dhe filloi të quhet “Murabitun”. Revista, gjithashtu, ndryshoi emrin nga “Vendet Islame” në “El-Murabitun”. Me një fjalë, çdo gjë ndryshoi dhe grupi mori formë tjetër dhe krijoi raporte dhe lidhje shumë të ngushta me qendrat e Abdul Kadr El-Murabit në Britani të Madhe, Danimarkë, SHBA dhe shumë vende të tjera të botës.

Ndërsa në Spanjë, vendi i quajtur Pajazin, në Granadë, u bë qendër e grupeve, që i takonin Murabitinëve të Spanjës, që ishin në: Sevilja (Andaluzi), në Palma Di Majorka (Ishujt lindorë) dhe në Bilbao (Oskadi). Ky grup, gjithashtu, filloi të bëjë një organizim të sërishëm mistik në gjallërimin dhe manifestimin e festave e kremtave të përgjithshme, siç bëri në Sevilja, në muajin korrik të viti 1990, si dhe themeloi një institucion ekonomik, ashtu si ish-kompania në Granadë.

Kështu, në këtë mënyrë, dështoi kjo përpjekje e guximshme në përhapjen e Islamit në Andaluzi, edhe përkundër fillimit inkurajues. Ky dështim erdhi për shumë arsye, disa prej të cilave janë: Gabimet esenciale në

organizimin e grupit, mbështetja në centralizëm, nënshtrimi absolut dhe respekti i tepruar ndaj liderit, mënjanimi nga konsultat, dobësia dhe keqpërdorimi i modestisë (thjeshtësisë) islame në mes liderve të grupit, shkëputja e lëvizjes nga rrjedhat e jetës së përditshme në Andaluzi, aty ku ishin ata vetë, mosnjohja e mjaftueshme e historisë së Andaluzisë dhe prekja e ndjenjave të popullit aktual (bashkëkohor) andaluzian, frekuentimi i shijeve të tjera në mes shijes islame që pasoi si presion nga jashtë. Pastaj shkak tjetër ishte edhe mospublikimi i llogarive, gjë që shkaktoi humbjen e besimit tek ata që e ndihmonin shoqatën (donatorët). Megjithatë, kjo shoqatë ose ky grup, do të mbetet element i rëndësishëm në përbërjen islame andaluziane.

Vlen të theksohet se qëndrimi i “Shoqatës Islame në Spanjë” dhe i “Qendrës Islame në Spanjë”, ndaj kësaj lëvizje, ishte qëndrim negativ, sepse ata nuk e shihnin të arsyeshme dhe nuk ishin të kënaqur, që të ketë një lëvizje islame në Andaluzi, jashtë kornizës organizative të tyre.

Qëndrimi i dy shoqatave, mbetet i njëjtë edhe ndaj çdo lëvizje islame lokale. Ky është edhe shkaku i averzionit (urrejtjes) dhe raporteve shumë të largëta, në mes muslimanëve lokalë dhe atyre që kishin emigruar për shkaqe të ndryshme në Spanjë, për punë ose studime, të cilët kishin ardhur nga lindja.

Shoqata islame e Kordovës

Ideja për formimin e shoqatës islame në Kordovë, më lindi kur shkova për vizitë në Mugrit, gjatë kohës prej 19-21 nëntorit 1973, në kuadër të vizitës për t’u njohur me problemet e pakicave islame në Europë dhe Amerikë²⁷, ndërkohë që u njoha me çështjen e xhamisë së madhe (kompleksive) të Kordovës. Në atë kohë, prefekt i Kordovës ishte Kozmin Ranije, i cili në mars të vitit 1972,

²⁷

Ali Mansur al Kitani, “Muslimanët në Evropë dhe Amerikë”, Dar Idris, 1976, pjesa e parë

në emër të Asamblesë Komunale të Kordovës, kishte kërkuar nga UNESCO, që xhaminë komplekse të Kordovës t'a konsiderojnë si një monument humanitar dhe t'i kthehet origjinës së saj reale si xhami, gjë e cila shkaktoi debat të ashpër në shtypin spanjoll. Në një artikull të gazetës "ABC", të datës 10.12.1972, Rifail Kastigon kërkoi në letrën e tij, drejtuar Drejtorit të Akademisë Mbretërore për Shkencë dhe Arte të bukura, që xhamia të kthehet në origjinën e vet islame dhe të transferohet katedralja në një vend tjetër, jashtë xhamisë, në një vend të posaçëm, e xhamisë t'i kthehet vlera ndërkombëtare, dhe publikoi vlerën e shpenzimeve për një transferim të tillë, që arrinte shumën në dhjetë milionë dollarë amerikanë.

Mbreti Fejsal – sovrani i Mbretërisë Arabisë Saudite (Allahu e mëshiroftë), menjëherë tregoi interesim për këtë projekt ose këtë çështje, dhe për këtë e dërgoi Sheikun Muhamed Ahmed Numan, të ngarkuar me një letër gojore, për Gjeneral Frankon, që ndodhi në muajin korrik të vitit 1973, ku tregojë gatishmëri e plotë për t'i paguar shpenzimet e transferimit të katedralës. Vlerësimi im për këtë çështje ishte se një gjë e tillë ishte e pamundur për t'u bërë, sepse në realitet xhamia ishte pronë e kishës katolike, e cila në asnjë mënyrë nuk do të hiqte dorë nga xhamia. Megjithatë, qëndrimi i Asamblesë Komunale të Kordovës, zgjoi interesim tek unë dhe më bëri që të bindem se banorët e Kordovës, kishin simpati ndaj Islamit, dhe se nga mesi i tyre, mund të ketë muslimanë të fshehtë.

Në vitin 1979, u aprovua Kushtetuta e re e Spanjës, e cila në vete përmbante edhe nenin që ka të bëjë me organizimin e feve, detajet e të cilit u vendosën më pas. Më 05.07.1980, Kortesi (Parlamenti spanjoll), aprovoi ligjin e parë për liri fetare, kështu që muslimanët e Andaluzisë nuk kishin më nevojë, që të bëjnë filtrime në mesin e tyre.

Të mërkurën, më datën 26 të muajit hënor Shaban 1400, (09.07.1980) vizitova Kordovën, dhe u takova me një numër besimtarësh muslimanë, prej të cilëve kishte spanjollë dhe marokenë, që jetonin përkohësisht në Spanjë. Atyre u propozova që të themelojnë "Shoqatën Islame të Kordovës", në bazë të ligjeve të reja spanjolle. Punën për themelimin e shoqatës, e mori përsipër Khajimi Sijan, nënpunës në administratën komunale të Kordovës, ai ishte musliman, që kishte marrë nënshtetësinë spanjolle, kishte lindur në Tatvan, më 15.11.1922. Ka qenë i njohur me emrin Abdul-Hamid bin Abdu Selam El-Belgithi. Në vitin 1971, ishte bërë qytetar i Kordovës dhe kishte marrë një emër tjetër, Khajimi Sijan. Ishte zotërues i përkryer i gjuhës spanjolle, tipik si vetë spanjollët, ishte integruar plotësisht në shoqërinë e Kordovës, e kishte nxënë përmendësh Kur'anin madhështor. I kishte të njohura mirë dhe qartë parimet islame.

Vlen të theksojmë se në Spanjë kishte me mijëra spanjollë me origjinë marokene, të cilët kishin ikur nga Maroku, i kishin ndërruar emrat dhe fenë e tyre, dhe ishin shkrirë me spanjollët. Ndoshta ishin bërë të krishterë, sa për hipokrizi që të fitonin të drejtën e qëndrimit në Spanjë, mirëpo, ajo që ishte me rëndësi, ishte se fëmijët e tyre ishin integruar dhe shkrirë në shoqërinë spanjolle, e ishin bërë spanjollë, për nga gjuha dhe të krishterë, për nga feja.

Dhe vërtet, e ndoqa me kujdes, se si po shkonin punët në Kordovë. Më datën 30.09.1980, u regjistrua "Shoqata islame arabe", në emër të Khajimi Sejan Et-Telmisani, Khoze Khuan Delkado Fernandez Di Santaila, Antonio Salsido Bikhano dhe Zahra El-Fasi Errijahi (gruaja e parë), të gjithë me nënshtetësi spanjolle. Më datën 06.11.1980, shoqata e ndryshoi emrin dhe u quajt "Shoqata Islame e Kordovës dhe regjionit". Më datën 05.11.1981, shoqata u regjistrua në mënyrë zyrtare në Ministrinë e Drejtësisë.

Pastaj, në mes meje dhe Khulio Angita Gonzales, prefektit të Kordovës, filloi seria e letrave. Më datën 24.08.1980, i shkrova atij nga Dhahrani (Arabia Saudite), ku i bëja apel që t'a ndihmonte grupimin e muslimanëve të Kordovës. Ai ma ktheu përgjigjen me datën 18.09.1980, ku shkruante: “Ka kohë që unë i shikoj me shumë interesim, interesat e komunitetit musliman, ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesin e tyre në Madrid. I kemi dhënë fund dorëzimit të xhamisë në Kordovë, që të arrijnë t'i kryejnë ritet e tyre fetare në xhami. Marrëdhëniet tona historike me botën islame, janë shkaku i dëshirës tonë që të krijojmë lidhje vëllazërore e miqësore të ngushta me ju”.

Ju përgjigja kësaj letër më datën 11.10.1980, dhe e falenderova. Ndërsa më parë, me datën 06.10.1980, më kishte shkruar prefekti Angita, dhe më kishte njoftuar për themelimin e “Shoqatës islame së Kordovës”, i cili më ftonte që t'a vizitoj në Kordovë, për të studiuar së bashku, mundësinë për marrjen në dorëzim të Xhamisë historike të Kadiut “Ebu Uthman” (që ishte shndërruar në Kisha Santa Klara), për t'a bërë atë qendër islame. Ftesën e tij e konfirmoi me një letër tjetër, të shkruar me datën 11.11.1980.

Përgjigjen e letrës së parë ia ktheva me datën 10.11.1980, në të cilën e falenderova për ftesën e bërë nga ana e tij, dhe për herë të parë e vizitova në Kordovë, më datën 24.11.1980.²⁸ Ishte një takim shumë miqësor dhe i mrekullueshëm, ku u bë e qartë se prefekti kishte dëshirë të veçantë, që qyteti i tij të krijojë lidhje me Islamin, dhe se ai ishte i kujdesshëm që t'a organizojë komunitetin musliman në qytet. Ai më njohu me faktin se Asambleja Komunale e Kordovës, ka dhënë pëlqimin që t'ua jepte xhaminë e Kadiut “Ebu Uthman”, “Shoqatës Islame të Kordovës”, me kusht që të meremetohet (rinovohet) dhe të bëhet Qendër reflektive Islame.

²⁸

“Interes Arabe por la Cesion de Uso de la Antigua Mezquita de Santa carla” Cordoba, 25.12.1980

U morëm vesh që, më datën 26.12.1980, të takohemi me zotëri, babain Sheikun Muhamed El-Muntesar El-Kitani, për t'a pranuar xhaminë zyrtarisht dhe për t'a përgatitur atë posaçërisht për namaz (lutje islame)

Xhamia El-Kadi "Ebu Uthman", u ndërtua në kohën e sundimit të Khalifes Emevi në Spanjë, Abdurrahman Enasi, në lagjen aristokrate të Kordovës, jo më shumë se njëqind metra, larg Xhamisë Madhështore. Sipërfaqja e kësaj xhamie, përafërsisht është njëmijë metra katrorë, në rrugën që quhet "Ri Hiridija". Kur të krishterët e pushtuan Kordovën, e shndërruan xhaminë në kishë, dhe e quajtën "Santa Klara".

Më pas, këtë godinë të vjetër, kisha e shiti dhe atë e bleu Komuna e Kordovës, e cila e kishte fituar të drejtën, që të veprojë me të si të dojë. Ishte xhami e madhe dhe kishte nevojë për një rinovim kapital, simbolet islame edhe më tej qëndruan në të, nuk u shlyen aspak. Ka dy kate dhe minaren, dhe ka mundësi që të bëhet një kompleks i plotë islam.

Në mëngjezin e ditës së xhumasë së datës 26.12.1980, u dorëzuan çelësat e xhamisë, në ceremoninë e organizuar në Asamblenë Komunale të Kordovës, në duart e kryetarit të "Shoqatës Islame të Kordovës", e pastaj të gjithë u drejtuan për në xhami dhe e falëm namazin e xhumasë, dhe ezani u thirr nga lartësitë e minares së xhamisë.²⁹

Autoriteteve kishtare, nuk u kishte pëlqyer aspak ajo që kishte ndodhur, dhe më datën 06.01.1981, Anfanso Florido, kryepeshkopi i Kordovës, i shkruan një letër të hapur Hulijo Angita Gonzales, Prefektiti të Kordovës³⁰, duke i thënë: "Vërtet, dorëzimi i xhamisë dhe i godinave historike, nga ana e Komunës për Shoqatën Islame, është një veprim i rrezikshëm ...na bënë që të ndiejmë se një stuhi islame do t'a kaplojë qytetin tonë, Kordovën".

²⁹ "Entegrada la Llave de la Antigua Mezquita de Santa Clara al Senor al-Kettani" Cordoba 27.12.1980

³⁰ "Precisiones Historicas sobre la Iglesia de Santa Clara" Cordoba, 08.01.1981.

Kryepeshkopi e akuzonte Islamin, se në të ekziston bindja se “xheneti është nën hijen e shpatës”, dhe se: ”përkrahja e Islamit në Kordovë nga autoritetet lokale, ishte një gabim historik, dhe gjithashtu ishte nënçmim për qytetarët e Kordovës dhe zbritje “nga epërsia dhe niveli i lartë krishter” në “nivele të ulët dhe të prapambetur islam”. Kryepeshkopi e akuzoi prefektin dhe Asamblenë Komunale të Kordovës, se i ka provokuar ndjenjat e qytetarëve të krishterë të Kordovës.

Prefekti, të nesërmen, i ktheu përgjigjen kryepeshkopit, në një letër të ashpër, të cilën e publikoi në shtypin ditor³¹, në të cilën shkruante: ”S’ka dyshim, se kushtetuta spanjolle respekton bindjet e të gjithë qytetarëve, dhe garanton lirinë e bindjes, dhe se nuk ka dallim në mes Fesë Katolike dhe feve të tjera para kushtetutës spanjolle... Dhe shkruante se, si prefekt i zgjedhur me votën e lirë, e kam për obligim që t’a praktikoj kushtetutën në qytetin e Kordovës, dhe ashtu siç e ka ndihmuar komuna kishën katolike deri më tash, e ndien për obligim që t’i ndihmojë edhe muslimanët”. Prefekti, gjithashtu, i tha Kryepeshkopit: Se ka marrë fund epoka e sundimit kishtar në shtëpi dhe shtet, pa të drejtë ankese, dhe se kisha katolike nuk është në nivelin e duhur moral, që të ketë të drejtë t’a kritikojë Islamin në Spanjë, e sa i përket ndjenjave të qytetarëve të Kordovës, prefekti tha: ”Janë ata që më zgjodhën mua prefekt të tyre, e ty askush nga qytetarët e Kordovës nuk të ka zgjedhur, o zoti Kryepeshkop i peshkopisë së saj (Kordovës)”, dhe më tej prefekti vazhdon: - Qëndrimi im dhe i Asamblesë Komunale të Kordovës, është qëndrim i drejtë dhe në interes të qytetit, dhe se ai personalisht nuk anon nga asnjëra fe, që d.m.th. se nuk ishte as i krishter, dhe as musliman. Prefekti e mbyll letrën e tij, me fjalët: ”Unë jam prefekti yt dhe ti nuk je kryepeshkopi im”.

³¹ “Cordoba: El Alcalde Replica Al Obispo Sobre las Cesiones de Edificios a Los Musulmanes” A.B.C., 07.01.1981

Pas kësaj, ndodhi një fushatë e ashpër në shtypin ditor, rreth kësaj teme në mes atyre, që ishin opozitë e prefektit dhe atyre, që ishin pro. Fushata zgjati disa muaj, gjë që bëri që i gjithë shtypi spanjoll t'i jepte rëndësi. Kjo fushatë, në fillim fare, ishte pozitive për shoqatën e re, pasi në opinion u bë e njohur se ekziston shoqata, dhe numri i anëtarëve të shoqatës u shtua deri në pesëdhjetë persona.

Disa muaj me radhë, gazetat folën për komunitetin musliman në Kordovë, si një ngjarje intuitive (që s'ka nevojë për të logjikuar shumë), pasi ka qenë diçka që nuk ka ekzistuar. Shoqata e re, pastaj i luftoi me fjalë të buta disa qarqe: në radhë të parë, djathtistët spanjollë, dhe natyrisht kishën, në radhë të dytë, e që kjo është për keqardhje: "Shoqatën islame të Spanjës" dhe "Qendrën Islame në Spanjë", dhe kjo nëpërmjet shkrimeve të raporteve negative, që shoqata përhapte në vendet arabe dhe institucionet e shoqatave islame, kundër shoqatës së re, dhe së treti, luftën me përfaqësitë diplomatike arabe, në Madrid.

"Shoqata Kthimi i Islamit në Spanjë", punoi drejt lidhjeve të ngushta me "Shoqatën Islame të Kordovës", u organizuan disa takime (mbledhje, seanca), në mes dy shoqatave, ku e para synonte që e dyta të shkrihet në të parën. Mirëpo, nuk ia arriti këtij qëllimi, për shkak të strukturës piramidale organizative të shoqatës së Granadës, që ndryshonte nga ajo e shoqatës së Kordovës. Më datën 01.05.1981, në Granadë, dy shoqatat nënshkruan një marrëveshje për bashkëpunim në mes tyre, me këtë citat: pas bismilahit dhe falenderimeve për Allahun u shkruajt: "Betohemi në Allahun e Lartëmadhërishëm, dhe në këtë Kur'an Fisnik, për të punuar si një dorë e vetme, për t'a çliruar Islamin në tokën e Andaluzisë (Spanjë dhe Portugali), dhe kthimin e sheriatit Islam dhe syetit të të Dërguarit (paqa dhe bekimi i Allahut qoftë për të), në Andaluzi, dhe që të jemi ashtu siç na ka urdhëruar Allahu, vëllezër në fenë e Allahut dhe në rrugën e Pejgamberit a.s., që të mos heqim

dorë nga njëri-tjetri dhe që mos t'a turtulisim e telendisim njëri tjetrin. Allahu është dëshmitari më i mirë për këtë marrëveshje. Ai është mbikëqyrësi më i mirë, dhe çlirimtari më i mirë". Për shoqatën e parë, nënshkroi "emiri" (princi) i shoqatës, Mensur Abdu Selam, e për shoqatën e dytë, kryetari i saj Khajimi Sijan dhe dy dëshmitarë; shkruesi i marrëveshjes dhe avokati Muhamed bin Idris El-Hilw, nga Kazablanka (Darul-Bejda).

Për "Shoqatën Islame të Kordovës", ishin caktuar tri punë kryesore, të cilat ishin:

1- Arritja e një marrëveshjeje me shkrim, me Komunën e Kordovës, për marrjen e xhamisë së Kadiut "Ebu Uthman", që t'i plotësojë kushtet dhe t'i mbledhë ndihmat për rinovim dhe meremetim;

2- Shoqata të marrë një Qendër (zyrë) përkohësisht;

3- Të ftojë një imam, për t'ua mësuar anëtarëve të shoqatës (brenda në shoqatë) rregullat dhe konditat islame.

Më datën 17.07.1981, paraqitën lutjen në Ministrinë e Kulturës, për të rinovuar xhamin e Kadiut "Ebu Uthman", pastaj iu drejtuan Komunës me planin e plotë për rinovimin e xhamisë, që kushtoi mbi pesë milionë pezeta. Komuna iu përgjigj më datën 29.09.1981, në mënyrë shumë të kufizuar për projektin. Nga aspekti teknik, nuk ishte problem i madh që të arrihej deri te marrëveshja me Komunën. Por, problemi ishte i madh te kushtet e parashtruara për t'a marrë xhaminë.

Më datën 20.06.1981, Komuna kishte paraqitur një projekt-marrëveshje, ku përfshiheshin pika të padrejta (delikate), që nuk ishte e mundur të pranoheshin në asnjë mënyrë, prej tyre: shoqata detyrohej që të lejonte hyrjen e lirë të turistëve në xhami, t'i hapte dyert para konkurrencës së shoqatave të tjera, në përpjekje për t'a marrë xhaminë, përcaktohej afati kohor i përdorimit të xhamisë për 49 vjet, ashtu që pas 49 viteve të shfrytëzimit, xhamia t'i kthehej pronësisë komunale, që Komuna të

kishte të drejtë t'a ndërpriste marrëveshjen kur të dëshironte, e shumë pika të tjera, gjë që bëri që negociatat të arrijnë në portë të mbyllur. Shoqata filloi të mendojë për ndërtimin e një xhamie, e cila do të ishte pronë e plotë e saj. E la xhaminë e Kadiut Ebu Uthman, me gjithë ato kushte që u paraqitën, si rezultat i trysnive (presionit), që vinin nga qarqet ekstreme.

Komuna, gjithashtu, i paraqiti shoqatës edhe një opcion tjetër, që shoqata t'a merrte "Kështjellën e lirë", për t'a përdorur si shoqatë fetare, por shoqata u tërhoq, sepse nuk kishte mundësi.

Më datën 14.08.1981, filloi fushata publicistike kundër Khajimi Sijan-it. Në të morën pjesë, së bashku, arabët dhe spanjollët. Gazetat publikuan dëftesën që vërtetonte se ai e kishte pranuar zyrtarisht krishterizmin, më datën 06.12.1979, dhe se ai e kishte përsëritur martesën në kishë, si edhe e shanë me të gjitha sharjet³². Khajimi u përgjigj për akuzat që i adresoheshin atij, duke thënë se ai kishte qenë i presionuar (detyruar), që t'a pranonte publikisht katolicizmin, sepse ata "ia morën gruas time nënshetësinë spanjolle, të cilën e kishte gëzuar qysh para 27 vitesh para se të martohehim, pastaj refuzuan që t'u jepnin pasaporta bijve tanë, njërit prej tyre refuzuan që t'ia rinovojnë librezën nacionale, dhe më detyruan që të veproj ashtu siç veprova, mirëpo unë jam musliman, siç kam qenë musliman në të kaluarën, dhe ashtu do të vazhdoj të jem musliman derisa t'a takoj Allahun"³³.

Më datën 1 dhe 2 janar 1982, "Shoqata Islame e Kordovës", në qendrën komunale, në Pallatin e vjetër të kalifës, organizoi "Takimin miqësor arabo-kordovian", që ishte edhe samiti i parë i kësaj shoqate, të cilën e shpalli të hapur prefekti Angita dhe në të cilën morën pjesë edhe shumë personalitete arabe dhe spanjolle. Samiti u hap me leximin e ajeteve Kur'anore. I ndoqa me kujdes ligjëratat e

³² "Jaime Sellan es Catolico" Cordoba, 14.08.1981

³³ "Conozco a Jaime Sellan desde que Llego a Cordoba" Cordoba 20.08.1981

shkrimtarit të këtyre rreshtave, dhe të profesorëve, si: Abduselam El-Huras, Ismail El-Khatib nga Maroku, Antonio Rabasko, Antonio Salsido dhe Lavoro Al Mos nga Spanja, dhe të tjerë³⁴.

Kryepeshkopi Anfans Florido, përsëri bëri trazira nëpër gazeta, një fushatë tjetër që zgjati disa javë, për shkak të namazit përsëritës, që disa nga ligjëruesit, e falën në xhaminë e Madhe, të cilën ai e quajti si poshtërim për katolikët³⁵.

Më datën 11.01.1982, ish presidenti i Algjerisë, zotëri Ahmed bin Bala dhe gruaja e tij, zonja Zahra Selami, e vizituan Kordovën me ftesë nga “Shoqata Islame e Kordovës”.³⁶ Në fund të janarit të vitit 1982, një grup i Shoqatës, e vizitoi Marokun dhe u takua me disa personalitete zyrtare dhe jo zyrtare³⁷.

Në fillim të shkurtit 1982, një delegacion i Kordovës me në krye prefektin Angita dhe gruan e tij, si dhe në shoqërimin e Khajmi Sijan, dhe disa anëtarëve të asamblesë komunale vizituan Marokun. Shrfytëzuan nga rasti disa familje andaluziane, që ta falenderojnë prefektin dhe banorët e Kordovës, për qëndrimin e tyre të guximshëm që ata po i japin Islamit, në qytetin e tyre.

Me këtë rast, zotëri Angita mbajti një ligjeratë në Kasablankë, me titull “Kordova: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e saj”, që pati një ndikim shumë të thellë. Ky delegacion, u prit edhe nga shumë personalitete të Marokut, disa i pritën nëpër shtëpitë e tyre, siç ishte rasti me Dr.Abdul Kerim El Khatib në Ribat, pastaj Prof.Abdullah Kenuni (Allahu e mëshiroftë), që u prit në

³⁴ “Se Celebro el I Encuentro de Amistad Arabo-Cordobes” Cordoba, 03.01.1982

³⁵ Protesta del Obispado por los Resos Musulmane en la Mezquita Catedral” Cordoba, 03.01.1982

³⁶ “El Ekspresidente Argelino Ben Bella Visito Ayer Nuesytra Ciudad” Cordoba, 12.01.1982

³⁷ “Mr.Hachmi Filali Recoit une Delegation de l’Association Islamique Autonome de Cordobe”, le Matin 21.01.1982

Bitanga, pastaj Haxhi Idris El Hulv, në Kasablankë dhe shumë të tjerë. Vizita e delegacionit përfundoi në qytetin Fas, ku kremtuan të gjithë qytetarët³⁸.

Pastaj, një delegacion i “Shoqatës Islame të Kordovës”, i kryesuar nga Sijani, vizitoi disa vende të Gjirit Arab, ku u takuan me zyrtarë të lartë të atyre vendeve, në mesin e tyre edhe me Sheikun Ahmed El-Mubarek (Allahu e mëshiroftë), i cili ishte kryetar i Gjykatës Legjislative të Ebu Dhabit, në shtetin e Emirateve të Bashkuar Arabe.

Në qershor të vitit 1982, “Shoqata Islame e Kordovës”, hapi qendrën e saj në një apartament me qira, të marrë në rrugën Angjel Sabidra, në qendër të qytetit të Kordovës, pasi më parë, anëtarët e shoqatës, takoheshin në shtëpinë e kryetarit të shoqatës, e sidomos pasi dështuan t’a marrin xhaminë e kadiut Ebu Uthman, për shkak të largimit nga kushtet e mundshme. Më pastaj, lindi idea që t’a marrin një imam nga Maroku, i cili të dinte gjuhën spanjolle dhe të kishte njohuri të duhur rreth Islamit, ashtu që t’ua mësonte, anëtarëve të shoqatës, parimet islame. Pas disa konsultave, u vendos dhe u zgjodh imami, i cili zyrtarisht, e filloi punën në korrik 1982.

Më vonë, filluan disa grindje dhe mospajtime brenda shoqatës, të cilat çuan deri te pezullimi i saj, në maj të vitit 1990, ndërsa anëtarët e saj u bashkangjitën nëpër shoqata të tjera islame në Andaluzi.

Nga ne kërkohet që t’i bëjmë një analizë shkaqeve të pezullimit të aktiviteteve të kësaj shoqate, pasi i bëmë një ekspozim të duhur, ashtu që të njihemi me shkaqet e dështimit të “Shoqatës Islame të Kordovës” dhe mësimëve pozitive, që mund të marrim nga kjo përvojë, por edhe provë.

Themelimi i kësaj shoqate, ishte shumë i dobishëm për kthimin e Islamit në Andaluzi. U konfirmua për herë të parë se, ekziston Feja Islame në Kordovë. Pastaj, shumë

³⁸ “Sans la Tolerance entre les Communautés” Maroc-Soir, 12.02.1982.

qytetarë të Kordovës, e pranuan Islamin nëpërmjet kësaj shoqate, të cilët mbetën muslimanë edhe pas dështimit të këtij organizimi, gjë që mundësoi që, muslimanët e Kordovës, të organizohen mbi baza më të mirëfillta e më të fuqishme. Gjithashtu, paraqitja e kësaj shoqate, mundësoi që të kuptohet se, nga mesi i faktorëve të fuqishëm të qytetit të Kordovës, ka të tillë, që e kundërshtojnë prezencën e Islamit dhe të tillë, që e ndihmojnë me të gjitha forcat.

“Shoqata Islame e Kordovës” nuk pati sukses, që të bëhet iniciatore e ringjalljes së Islamit në Andaluzi, për shumë arsye. Prej tyre ka arsye, apo faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Sa i përket faktorëve të brendshëm, ato ndërlidhen me_dobësinë e mundshme prej futjes së elementeve jo andaluziane në radhët e shoqatës, vetë kryetari, i cili e pezulloi shoqatën, ishte orientalist. Po ashtu, edhe kryetari i parë edhe i dytë i shoqatës, bënë disa gabime të mëdha, prej të cilave përfituan armiqët e fesë Islame, në Andaluzi. Në anën tjetër, shoqata nuk arriti të sajojë një program të duhur dhe të qartë islam për Andaluzinë, i cili do t’a jositte dhe tërhiqte masën andaluziane nga Islami. Ndërsa shkaku i jashtëm, ndërlidhet me kundërshtimin e madh nga disa mese islame, të cilat e kishin shijuar një provë të tillë.

Përpyjekjet për organizime të tjera në Andaluzi

Në Andaluzi u paraqitën përpyjekje të tjera islame për organizime, disa prej të cilave ishin të kufizuara, disa ishin të tilla, që patën jetë të shkurtër, disa të tilla që mbetën ngjyrë mbi letër, e disa të tilla që iu bashkangjitën organizatave tjera. Të gjitha këto organizime nuk dolën asnjëherë jashtë qyteve të Andaluzisë.

Ndërsa sot, në Granadë, të gjitha organizimet islame që janë aty, janë të shkëputura, ose e kanë origjinën nga shoqata "Kthimi i Islamit në Spanjë", të cilat u themeluan

nga persona dhe grupe, që dolën nga shoqata amë, prandaj edhe këto shoqata, nuk kanë ndryshime, në aspektin organizativ, nga shoqata amë, prej të cilës janë shkëputur.

E para e këtyre shoqatave, është "Shoqata Islame në Spanjë -Xhamia Takva", në të cilën punonin dy profesorë mauritanëzë. Kësaj shoqate, iu bashkangjitën mbi pesëdhjetë anëtarë të rinj, të cilët hapën aktivitete pune në pjesën e vjetër të Granadës, në mes të lumit Hidra dhe hyrjes së lagjes Pijazin. Qendra e shoqatës, ishte vendosur në një apartament të marrë me qira dhe përdorej si qendër islame. Shoqata bënte përpjekje të madhe në përhapjen e njohurive islame, në mesin e anëtarëve të vet, mirëpo, në Granadë, aktivitetet i kishte shumë të kufizuara.

Shoqata e dytë, është "Xhemati Musliman i Andaluzisë". Ajo është shoqata e parë, që u themelua në Granadë, pas "Shoqatës së kthimit të Islamit në Spanjë". Atë, e themeluan një numër personash, që kishin dalë nga shoqata e mëparshme, më datën 28 Ramazan, të vitit 1401h (që përputhet me datën 31.07.1981). U formua Këshilli i parë ekzekutiv i shoqatës, i udhëhequr nga zotërinjtë Umer Abdul-Hak Koka Dominikos (kryetar, me origjinë nga Sevilja), Abdul-Kerim Muhjiddin Krasko Sasteri (zëvendës/kryetar), Zahra'e Kontriras Kano (sekretare), Abdu-Nur Koka Dominikos (arkëtar), Muhamed Khan (anëtar), Aishe Dijas Bermudes(anëtare), Muhamed Mubin Medine Rodriguez (anëtar). Në deklaratën e themelimit të kësaj shoqate, shkruhej:

"Themelimi i shoqatës "Xhemati musliman i Andaluzisë", me qendrën e saj në Granadë, e themeluar nga burra dhe gra që e përfaqëuan Islamin gjatë viteve të fundit, erdhi si rezultat i boshllëkut të krijuar, si pasojë e anullimit të shoqatës "Kthimi i Islamit në Spanjë" dhe shndërrimit të saj në drejtim mistik (sofist), me emrin Durkavije. Ky ndryshim i shoqatës në drejtim, i cili natyrisht i përket vetëm një pakice të ndarë, ka bërë që

muslimanët, të cilët nuk janë anëtarë të këtij drejtimi, por natyrisht njihen se janë pjesë e pandarë e ummetit musliman, të mbesin të paorganizuar dhe pa një qendër, ku mund të mblidhen për t'i kryerë ritet fetare, së bashku.

Ky xhemat musliman, në Granadë, dëshiron që të shprehë respektin e duhur për çfardo rruge që zgjedh muslimani, e që është brenda sferave të Sheriatit të pashterrshëm, për adhurimin e All-llahut, sipas mësimëve të Kuranit fisnik dhe Sunetit të të dërguarit tonë, Muhammedit s.a.v.s. Xhemati shpreh gatishmëri për të përhapur fenë e pastër islame, dhe forcimin e rrënjëve të saj në zemrat e qytetarëve të këtij vatani (atdheu)".

Shoqata, më pas, hapi qendrën e saj, në një apartament në rrugën Kastenida, më vonë kaloi në një banesë tjetër, në rrugën Shenil në qendër të Granadës, e pajisur me zyrë, banesë për të banuar imami dhe faltore për falje.

Shoqatës iu bashkangjitën edhe dhjetëra muslimanë të Granadës, kështu që shoqata filloi të bëjë përpjekje për t'i bërë të larmishme aktivitetet e saj dhe për t'i shtrirë ato jashtë Granadës. Ajo kishte një projekt, që të formonte një plantacion për muslimanët, në malet Rande, mirëpo nuk ia arriti t'a realizojë, për shkak të mungesës së mjeteve materiale.

Në maj të vitit 1983, kjo shoqatë u bashkangjit me shoqatën "Xhemati musliman në Andaluzi", qendra e së cilës ishte në Sevilja, por më pas, sikur që do t'a shohim, në fund të vitit 1984, u shkëput përsëri. Kryetar i saj, u bë Harun Krakuil Romero, ndërsa shoqata vetë, u shndërrua në shoqatë të vogël në mesin e shoqatave islame të Granadës, me aktivitetet shumë të kufizuara.

Shoqata e tretë, është "Shoqata Islame e Granadës", e regjistruar zyrtarisht në Ministrinë e Drejtësisë, si shoqatë fetare. Kjo shoqatë u themelua në fitin 1984, nga disa muslimanë, të cilët më parë kishin qenë anëtarë në "Shoqatën e Muslimanëve të Andaluzisë", të cilët u bashkangjitën në grupin e shiitve "Ithna-asheri" (Dymbëdhjetë imamije), dhe u shkëputën nga shoqata e

sipërpërmendur. Në momentin e bashkangjitjes, me shoqatën "Xhemati islam i Andaluzisë", që kishte orientim shiit, ndryshe nga shoqatat e tjera, të cilat kishin orientim sunit, kryetar i parë i kësaj shoqate u bë Muhamed Mubin Medine Rodrighez. Selia e kësaj shoqate, gjendej në rrugën Noviba Di Labrihan, në Granadë. Numri i anëtarëve të saj, nuk e kalonte numrin dhjetë dhe kjo shoqatë pati aktivitet shumë të kufizuar.

Shoqata e katërt, është "Xhamia e Bardhë", e cila u themelua në sheshin e bardhë të Granadës. Imam dhe kryetar i saj është Ahmed Abdullah Fotmidjano. Ai, gjithashtu, është nga anëtarët e vjetër të shoqatës "Kthimi i Islamit në Spanjë", që numëron disa dhjetëra anëtarë. Aktiviteti i saj nuk e tejkalon Granadën.

Ndërsa, Dr. Mensur Abdu-Selam Eskodiro, i cili ishte emiri (princi) i shoqatës "Kthimi i Islamit në Spanjë", pasi u largua nga shoqata, u transferua dhe shkoi në Matril, në brigjet e detit, që i takonte regjionit të Granadës. Atje, u vendos me një grup mjekësh muslimanë, së bashku me të cilët ngriti një qendër të plotë mjeksore. Në këtë mënyrë, u krijua një grup i ri muslimanësh në Matril, por pa ndonjë organizim apo aktivitet tjetër, përveç lëmisë së mjekësisë.

I pari, që mendoi për formimin e një xhemati, ose grupi muslimanësh, jashtë Granadës, ishte një burrë nga Xhijani, i shtyrë në moshë, i cili kishte punuar në ushtrinë spanjolle, emri islam i të cilit ishte Mollaj Muhamed bin Alij Al-Andalosi, ndërsa emri krishter i tij ishte Emiljo Akuther Anaja. Ai thoshte se origjina e tij vjen nga princërit muslimanë. Në vitet shtatëdhjetë deklaroi se ishte kalifja i muslimanëve në Andaluzi. Nuk kishte ithtarë, por ishte i pari që pati guximin t'a deklaronte Islamin haptazi nga mesi i spanjollëve, dhe bëri përpjekje që t'a përhapte Islam, sipas metodës së tij. Nuk kishte seli, por shëtiste nëpër gjithë Spanjën, nga njëri vend në tjetrin.

Në janar të vitit 1983, u themelua "Xhemati Islam i Murijes", në Murijs, nga Bilal Kelis Miza Andalosi, me origjinë nga Sevilja, i cili ishte bërë musliman në Belgjikë, në vitin 1975. Edhe kjo shoqatë, u regjistrua në Ministrinë e Drejtësisë. Kjo shoqatë, deri në ditën e sotme, mbeti ngjyrë e shkruar mbi letër. Në të, nuk mbeti tjetër kush, përveç Bilalit, i cili gjithashtu u largua prej Murijs-s. Të gjithë muslimanët andaluzianë të Murijs, sot, janë anëtarë të shoqatës "Xhemati Islam në Andaluzi".

Në gjysmën e vitit 1982, Abdu Semia Ariana, themeloi "Xhematin Islam të Malikas (Mallorkës)". Ai ishte musliman i Mallorkës dhe anëtar i shoqatës "Kthimi i Islamit në Spanjë". Ai ishte shkrimtar dhe hulumtues për çështjet andaluziane. U bë musliman nga fundi i viteve të shtatëdhjeta, gjë që ndodhi pasi u thellua në studimin e historisë së Andaluzisë. Gjatë kësaj kohe, u njoh me Sejidi Ahmed El-Haxhin, njërin nga dijetarët e Universitetit Karuwijn, në Fas të Marokut. Ai qëndroi në shtëpinë e tij, përafërsisht një vit, për të mësuar parimet e fesë islame.

Në vitin 1984, shoqata bleu një ndërtesë prej tre katesh, në rrugën San Agustin, në qendër të qytetit Mallorka, të cilën e shndërroi në qendër islame, që përbëhej nga një zyrë, mesxhidi (falterja) dhe një vendbanim (banesë) për imamin. Shoqata mori një imam nga Maroku, me pagesë nga Mbretëria e Arabisë Saudite. Edhe kjo shoqatë e spanjollëve, nuk numëronte më shumë se dhjetë anëtarë, por më pas, numri i tyre u shtua nga emigrantët e Marokut. Qendra bënte aktivitete, që janë për t'u lavdëruar, sidomos në mësimin e parimeve islame nga ana e anëtarëve të shoqatës.

Në vitin 1986, Abdu Semia Arjana, u punësua si nënpunës, në konsullatën e Arabisë Saudite, në Mallorka, dhe ia dorëzoi qendrën shoqatës "Qendra Islame në Spanjë", duke e shndërruar kështu në degë (filial) të saj.

Në regionin e Mallorkës, u bë edhe një grupim tjetër i muslimanëve. Kjo u bë në qytezën "San Pedro Di Antaro", në perëndim të qytetit Morbella. Ky grup, u formua në

vitin 1983, me emrin "Rruga Islame", nga Khalid Abdul Kerim, ish kryetari i qytezës Mode, në regjionin e Mallorkës, i cili ishte edhe anëtar i shoqatës "Kthimi i Islamit në Spanjë".

Shoqata "Rruga Islame", nuk numëronte më shumë se dhjetë anëtarë. Ata kishin qendrën e tyre personale dhe aktivitetet e tyre nuk i kalonin kufijtë e qytezës.

Në vitin 1979-1980, kur shoqata "Kthimi i Islamit në Spanjë" kaloi në Sevilja, në të u bashkangjitën një numër spanjollësh, ndërsa kur u bë transferimi i shoqatës në Granadë, në vitin 1980, një numër i anëtarëve refuzoi të transferohej nga Sevilja, dhe hoxha Abdul Kadr Essufi i largoi nga shoqata. Me largimin e tyre nga shoqata, ata themeluan një shoqatë të posaçme, me datën 06.12.1981. Kjo ishte shoqata "Xhemati Islam i Seviljes". Komiteti i parë ekzekutiv i kësaj shoqate përbëhej prej Abdul-Hadi Sanz Kemino (kryetar), Abdul-Mugni Garsija Artaço (sekretar), Muhamed Ahmed Ali Sharki (arkëtar), i cili ishte nga Sebte, Othman Persapi Gonzales (anëtar), Umer Elapont Tormis (anëtar).

Shoqata, u regjistrua në mënyrë zyrtare, si shoqatë fetare në Ministrinë e Drejtësisë, me datë 13.05.1982. Anëtarët e saj, në atë kohë, numëronin përafërsisht 20 anëtarë.

Qendra (selia) e shoqatës, kur u themelua, ishte në një banesë, në rrugën Kondi Di Torihon, afër sheshit 'Evropa', në një lagje të varfër, prej lagjeve të Seviljes. Në fund të vitit 1982, shoqata u transferua në një seli më të mirë, në një lagje më të mirë, në rrugën Amor Di Dijos (që ka kuptimin: i dashur i Zotit). Kjo seli ishte thjesht, një shtëpi e vjetër me dy kate, në të cilën u caktua vendi për faltore (mesxhidi), shkollën dhe zyrat për shoqatën.

Pas shpërbërjeve, të cilat rezultuan me lindjen e shoqatës "Xhemati Islam në Andaluzi" (siç do t'a shohim në vazhdim), shoqata kaloi në një qendër më të vogël, në rrugën Mejson Del Moro (hoteli i muslimanëve) dhe aktiviteti i shoqatës "Xhemati Islam i Seviljes", vazhdoi të

mbetet shumë i kufizuar, brenda përbrenda qendrës së vet islame dhe numri i anëtarëve të saj, nuk u shtua aspak, që nga formimi i saj.

Në qytetin Arkesh, në regjionin Kadis, gjendet një rrugë mistikësh. Aty jetojnë spanjollë dhe anglezë, muslimanë dhe jomuslimanë. Ky grup mistik nuk konsiderohet musliman, me çdo kuptim të fjalës, dhe ata nuk bashkëpunuan me shoqatat dhe grupet e tjera islame.

Me datën 10.02.1982, Rozhe Garodi vizitoi Kordovën, para se t'a pranonte Islamin.

Vizitën e bëri në cilësinë e drejtorit të "Qendrës Ndërkombëtare për Dialog në Mes Civilizimeve". Atë e priti prefekti i Kordovës, Hulijo Engita.

Garodi foli për mundësitë, që Kordova të bëhej një qendër ndërkombëtare për dialog mes civilizimeve, dhe që të hapej një Universitet islam. Pastaj, Garodi i bëri apel "Xhematit Musliman në Andaluzi", që të mbajë "Samitin e Parë Islam për Muslimanët e Evropës", i cili u mbajt në Sevilja, nga data 19 deri 22.07.1985. Ai mori pjesë edhe vetë, dhe u zgjodh kryetar i Samitit ³⁹. Pas samitit, vazhdoi bisedimet me Asamblenë Komunale të Kordovës, për të marrë "Kështjellën e lirisë", që i ishte premtuar më parë "Shoqatës Islame të Kordovës". Asambleja Komunale dha pëlqimin që shoqata t'a përdorte si muzeum kulturor.

Në ndërtimin e muzeumit, ndihmoi Abdurrahman Medine Mulire, njëri nga liderët e "Xhematit Islam në Andaluzi", i cili më pas u bë drejtori i parë i asaj shoqate. Muzeumi u hap në fillim të marsit 1987, në prezencën e disa personaliteteve islame dhe joislame, nga lindja dhe perëndimi, pjesëmarrës të samitit për dialog në mes civilizimeve. Muzeu nuk ishte islam, edhe pse në të, ishin ekspozuar disa gjëra islame, siç ishin disa pjesë të shkëputura nga xhamia e Kordovës, nga Pallati i Kuq. Muzeun e punuan dy muslimanë andaluzianë, Jusuf Bagras Roldan dhe gruaja e tij, Merjem.

³⁹ "Roger Garaudy", El Pais (Madrid), 25.7.1985.

Projektin e investoi Mbretëria e Arabisë Saudite dhe disa investitorë të Gjirit Arab. Muzeumi, në të njëjtën kohë, nuk ishte qendër islame. Që nga fillimi i tij, në vitin 1988, u drejtua nga një drejtor i krishterë. Pra, drejtor nuk ishte mendimtari francez musliman Rozhe Garodi, i cili, gjithashtu, nuk kishte kurrëfarë aktiviteti në mesin e komunitetit musliman të Andaluzisë.

Në këtë kapitull, janë përmendur përafërsisht dhjetë shoqata islame, të cilat u themeluan në fillim të viteve të tetëdhjeta, prej personave të kthyer në fenë islame, nëpër vende të ndryshme të Andaluzisë... Të gjitha kanë anën negative dhe atë pozitive. - Ana negative është numri i madh i organizatave, që argumenton mosunitetin rreth një fjale, mos koordinimin e rradhëve, e ndoshta edhe përplasjet. Kjo nuk i përshtatet lëvizjes rilindase, dhe komentohet se kjo e pengon shumë shpresën e madhe të muslimanëve.

Mirëpo, prej këtij numri të madh ka edhe dobi. Kjo dobi erdhi nga ajo se, edhe pas dështimit të këtyre formave të përmendura më parë, u paraqitën ('Organizimi i emigrantëve muslimanë', 'Organizimi i hoxhës Abdul-Kadr Essufi' dhe 'Shoqata islame e Kordovës'), si polarizim (vendtubim), për të gjithë të kthyerit në Islam. Kështu u bë e mundur, që secili, i cili kishte mendime të reja t'i paraqesë mendimet e tij, dhe të organizojë grupe, që mbledhen rreth e qark tij, ashtu që me kalimin e kohës, të dalë në pah ç'ka është e suksesshme dhe ç'ka është e dështuar.

Vërtet, këto shoqata dhanë kontribut që vlen të falenderohet. Secila me metodën e vet, bënte thirrje për në Islam, në mesin e andaluzianëve dhe të tjerëve, që jetonin në Spanjë. Shumica e atyre që u konvertuan në Islam mbetën muslimanë, edhe përkundër përkatësisë, se cilës shoqatë i takonte dhe kalimit nga një shoqatë në shoqatën tjetër, apo ndryshimit të emrit të shoqatës, apo daljes së tërësishme nga shoqatat, dhe mbetjes i vetmuar. Nga fundi i viteve të tetëdhjeta, numri i besimtarëve

muslimanë në Andaluzi, që u kthyen në Islam, arriti përafërsisht në 4.000 (katër mijë), në vitin 1990.

Secilën shoqatë, prej shoqatave të përmendura, e ndoqi një fat i veçantë, i ndryshëm nga të tjerët. Kishte prej tyre, që lindën të vdekura, siç ishte 'Xhemati islam El-Murije', kishte të tilla që u bashkangjitën me të tjerët, siç është rasti me 'Shoqatën islame të Mallorkës', kishte të tilla, prej së cilave u shkëput një grup, e që më pas, u bë nga grupet (xhematet) më të mëdha në Andaluzi dhe shpresa e udhëheqjes së fatit islam. E tillë është shoqata "Xhemati islam i Seviljes", për të cilin do të shohim në vazhdim.

Përpjekjet organizative jashtë teritorrit të Andaluzisë

"Xhemati Islam në Spanjë", në rrugën Ohinjo Kaçesi në Madrid, konsiderohet si shoqata më e vjetër spanjolle jashtë Andaluzisë. Kjo shoqatë u regjistrua në Ministrinë e Drejtësisë, më datën 17.12.1979, nga ana e Alvaro Maçordom Kominez (sekretar i përgjithshëm), dhe Havijer Nikolas Kopijos Nijito e Tomas Parijo Gabrijel (kryetar), të gjithë qytetarë të Madridit.

Ahmed Abdullah Maçordom Kominez, sekretari i tij i përgjithshëm, konsiderohet themeluesi i kësaj shoqate. Ai është shkrimtar dhe gazetar, me origjinë nga Belnesije. Ka shkruar një sërë artikujsh, në gazetatat spanjolle, në mbrojtje të Islamit dhe çështjeve islame, si edhe shkruar një libër rreth historisë së zotëriut tonë, Muhammedit s.a.v.s. (*paqa e bekimi i Allahut qofshin mbi të*). Ka marrëdhënie të afërta në Ministrinë e Jashtme të Spanjës, si këshilltar për çështje islame, si edhe mban raporte të mira me ambasadat arabe, në Madrid.

Në programin organizativ të themelimit të kësaj shoqate, përcaktohen qëllimet e saj, të cilat janë: "Përhapja e fesë islame, ashtu siç na mëson Kur'ani dhe suneti, në mesin e të gjithë muslimanëve të Spanjës, të

njoftuarit e të gjithë personave, që shprehin dëshirë për të marrë njohuri për Islamin, formimi i degëve të "Xhematit Islam në Spanjë" në të gjithë territorin e atdheut, inkurajimin e mësimi të gjuhës arabe, sepse ajo është gjuha e Kur'anit dhe mundëson të mbahen lidhje me 21 shtete, me të cilat ekzistojnë marrëdhënie historike, të ngushta dhe miqësore, krijimin e marrëdhënieve vëllazërore, në të gjitha fushat, në mes popujve muslimanë dhe popullit spanjoll, interesimin që të gjithë muslimanët spanjollë të formojnë personalitetin e tyre të vërtetë islam, duke ndjekur dhe zbatuar me kujdes konditat e fesë islame, të lexojnë dhe të kuptojnë Kur'anin, të binden për mësimet e tij, etj, etj...".

Mes datave 26 - 28. 12. 1989, shoqata mbajti Samitin e Parë për muslimanët e Spanjës, në hotelin 'Praga', në Madrid. Qendra e shoqatës, në Madrid, përbëhej prej xhamisë dhe zyrave dhe ushtronte aktivitetet të kufizuar.

Në vitin 1980, shoqata arriti një marrëveshje me prefekturën e Kordovës, rreth xhamisë "El-Murbitu", të cilën e ndërtoi diktatori Franko, në sheshin 'Kopshti Mursid' në Kordovë, për ushtarët marokenë. Prefektura e dorëzoi këtë xhami për shoqatën, nën këto kushte:

- Përdorimi i godinës të bëhet vetëm për ritet dhe lutjet islame,

- Të gjitha punimet e rinovimit dhe meremetimit të bëhen nga ana e shoqatës, me pëlqimin paraprak të prefekturës,

- Afati i përdorimit të qendrës të vazhdohet për pesë vjetë,

- Shoqata duhet t'a mirëmbajë xhaminë në nivelin e duhur,

- Godina dhe të gjitha përmirësimit e bëra, i kthehen prefekturës, pas pesë viteve, pa kurrëfarë kompensimi.

Marrëveshja e tillë u arrit, dhe pas pesë viteve, prefektura e ktheu godinën në pronësinë e saj, e cila më

pas ia dorëzoi ambasadorit të Arabisë Saudite në Madrid⁴⁰, i cili ia dorëzoi shoqatës "Qendra Islame në Spanjë". Në këtë mënyrë, xhamia e vogël u bë filial e shoqatës në Kordovë.

Shoqata "Xhemati Islam në Spanjë", numëronte përafërsisht njëqind anëtarë, në të gjithë Spanjën. Përgjegjësit e saj, thonë se kanë pasues të tyre në Morie, në Belnisa dhe në Barcelonë. Shoqata kishte degën e saj në qytetin Sebte, të cilën e kryesonte Ahmed Zubejr, kryetari aktual i xhematit. Në përgjithësi, sot ndikimi i këtij grupi (xhemati), është i kufizuar vetëm në qendrën e vet në Madrid, ku bën aktivitete kryetari, dhe në qytetin Sebte, ku bën aktivitete sekretari i përgjithshëm. Që të dy, aktivitetet i kanë të orientuara në shkrime, botime dhe mbrojtje të Islamit, nëpërmjet gazetarisë dhe mediave të tjera. Ky grup ose xhemat, nuk kishte ndikim në regionin e Andaluzisë, e sidomos pas kthimit të "Al-Morabito", në qytetin e Kordovës.

Më datën 23.07.1983, u themelua shoqata "Xhemati Islam i Valencisë", nga Abdurrahman Ibad Abalos (kryetar), Fransisko Morin Rodriguez (sekretar i përgjithshëm) dhe Jusuf Ibad Abalos (arkëtar). Sistemi i shoqatës caktoi direktivat e vetë shoqatës për thirrje në Islam, sipas Kur'anit madhështor dhe Sunnetit të zotëriut tonë, Muhammedit s.a.v.s. Në muajin shkurt, të vitit 1984, shoqata hapi qendrën e saj në një apartament të madh, në rrugën San Martin, në Valencia⁴¹.

Abdurrahman Ibad Abalos, themeluesi i shoqatës, punonte si gazetar në Barcelonë, pastaj u vendos me banim në Mallorka, që ishte vendlindja e tij. Më parë, ai kishte punuar në ushtrinë spanjolle, në Tatvan, gjatë periudhës prej vitit 1953 deri 1954 dhe, për herë të parë, atje u njoftua me shoqërinë islame. Me t'u kthyer, filloi të

⁴⁰ "Trigo va a Ceder La Mezquita del Morabito a un Grupo Saudi", Diario-16, 20.02.1986.

⁴¹ "Musulmanes Valencianos Abren un Nuevo Centro Islamico", Levante, 04.05.1984

lexojë me pasion për Fenë Islame, dhe e përqafoi Islamin, fshehurazi, në vitin 1959, pasi ishte bindur plotësisht duke mos e shpallur haptazi, deri në vitin 1977. Pas tij, e gjithë familja e tij u bë muslimane. Në vitin 1978, vizitoi Kairon dhe u takua me një numër mendimtarësh muslimanë. Pas vizitës, u kthye në Mallorca dhe punoi si gazetar, në gazetën "Sur" (Jugu). Më pas, u bashkangjiti në shoqatën "Kthimi i Islamit në Spanjë", nga e cila, më vonë u shkëput dhe formoi shoqatën e sipërpërmendur.

Kjo shoqatë me aktivitet të kufizuar, vazhdoi të ballafaqohet me vështirësi ekonomike që prej fillimit të saj. Numri i anëtarëve, nuk u shtua më shumë se dhjetë. U vështirësua mjaft shumë edhe qëndrimi i imanit maroken, të cilin, shoqata e kishte sjellë për t'ua mësuar anëtarëve të vet, parimet islame. Nuk zgjati shumë dhe shoqata e ndërroi selinë e saj, në një vend tjetër, e që prej vitit 1989, shoqata ka mbetur pa selinë e saj.

Në Madrid, në vitin 1982, gjithashtu u themelua një shoqatë me titull "Instituti Perëndimor Islam për Kulturë", si një institucion kulturor i kryesuar nga doktori maroken Abdurrahman Xhahu Sheriif. Instituti rreth vetes kishte tubuar një numër të konsiderueshëm të mendimtarëve muslimanë spanjollë. Instituti, qendrën kulturore e kishte në rrugën 'Francisko Reti'. Instituti bëri përpjekje të madhe, që ia vlen të falenderohet, në njohjen e civilizimit islam, jashtë regjionit të Andaluzisë, në Spanjë. Nga aktivitetet më të fiksuara, ishin përgatitja e dy samiteve të rëndësishme kulturore. Njëri, u mbajt në vitin 1987, në Talitla (kryeqyteti i Kashtala Mansha-s), me titull "Andaluzia Islame, historia tetëshekullore", dhe Samiti i Dytë, mes datave 22-25. 09. 1988 në Tarvil, të Aragonit, me titull "Aragoni po e rikthen historinë e vet".

Konferenca e parë, u përqendrua rreth Islamit në Kashtala, e Samiti i Dytë, rreth studimeve të bëra për Aragonin. Instituti kishte për qëllim, që të studionte dhe gjurmonte rreth kulturës islame në Spanjë, fushat historike dhe artet islame, dhe lidhjen e tyre me

aktualitetin bashkëkohor spanjoll, e më pas botimin dhe publikimin e tyre.

Kryetari i institucionit, filozofinë e tij, e koncepton në mënyrën si vijon: "Marrëdhëniet, që ekzistojnë mes interesimit tonë kulturor dhe aktualitetit spanjoll, përcaktohen nëpërmjet vetëdijes për themelet e civilizimit islam në këtë vend, dhe publikimit të së vërtetës për Islamin në mjediset spanjolle, sepse kultura islame paraqet kulturën e popullit spanjoll, edhe përkundër asaj se rrethanat historike, nëpër të cilat ka kaluar, e bënë që t'a injorojë këtë kulturë"⁴².

Sa i përket shoqatës islame, që gjendet në Mursej, ajo i përket "Xhematit (grupit) Islam në Andaluzi". Mursej konsiderohet si zonë natyrore e Andaluzisë, edhe përkundër asaj se nuk përfshihet brenda territorit autonom të Andaluzisë. Ai duhet të jetë territor autonom i vetëngritur. Në vazhdim, në kapitullin e ardhshëm, do t'i studiojmë aktivitetet e këtij grupi, me "Xhematin (grupi) Islam në Andaluzi".

E tani, është më e qëlluar, nëse i japim një ndriçim të shkurtër, prezencës bashkëkohore (moderne) islame në Portugali, vend ky, i cili ka qenë pjesë prej vendeve të Andaluzisë islame. Ndikimin islam e gjejmë sidomos, edhe më tej të qartë, në zonat jugore të Lisbonës, në veçanti në regionin Shontmerije perëndimore (tani Faro), në Baxhe dhe Japora.

Në Portugali, gjenden përafërsisht njëzetmijë muslimanë (viti 1990), shumica e tyre janë muslimanë që emigruan nga kolonitë portugeze, në Portugali, të cilat e fituan pavarësinë në vitin 1974. Tani, shumica e këtyre muslimanëve, posedojnë nënshtetësi portugeze dhe i gëzojnë të gjitha të drejtat qytetare.

Muslimanët e Portugalisë, mund t'i ndajmë në pesë grupe:

⁴² "Spanja hallkë serike mes Perëndimit dhe botës Islame" Shark El-Ewsat, 08. 09. 1989.

1. Muslimanë afrikanë, me origjinë nga Mozambiku;
2. Muslimanë aziatikë, me origjinë nga gadishulli i Indisë, nga Gua, nga Makao dhe nga Timori;
3. Muslimanë afrikanë, me origjinë nga Guinea Bisao;
4. Muslimanë arabë, sidomos marokenë, algjerianë dhe egjiptianë; dhe
5. Muslimanë portugezë të sapokthyer në Islam.

Në vitin 1968, u formua "Grupi (xhemati) Islam i Lisbonës", si shoqatë e parë islame në Portugali, e cila u regjistrua zyrtarisht, më datën 28.03.1969. Shoqata u deklarua si shoqatë fetare-kulturore dhe jo politike. Kjo shoqatë, përcaktoi qëllimet ose direktivat e veta, për ngritjen e komunitetit të plotë islam në Portugali, themelimin e xhamisë së parë në vend, mbrojtjen e Islamit, publikimin e broshurave në gjuhën portugeze, mësimin e Islamit, përhapjen e mësimin të gjuhës arabe dhe parimeve islame në Portugali.

Themelues dhe kryetar i shoqatës, deri më sot, është Dr. Sulejman Veliji Muhamedij, me origjinë nga Mozambiku, i cili posedon aktivitet të madh, dhe gjithashtu është iniciator i formimit të shoqatës miqësore arabo-portugeze. Ndërsa, anëtarë të tjerë të drejtorisë, janë: Dr. Idris Muhamed Vekil (sekretar), Abdu Setar Davud Xhemal (arkëtar) dhe Faruk Ali Xhadet e Muhamed Husejn Musa.

Në korrik të vitit 1978, për herë të parë, shoqata botoi përkthimin me komentim të Kur'anit madhështor, në gjuhën portugeze, të përfshirë në dy volume. Botimi i dytë, doli nga shtypi në shtator të vitit 1979. Që nga viti 1980, filloi të botohej revista islame, në gjuhën portugeze, me titull "Islami".

Shoqata në fjalë, botoi edhe një seri librash islame në gjuhën portugeze, siç janë: "Për hir të kuptimit të Islamit", "Paqa nën ndriçim", "Kur'ani - mrekullia e fundit", të autorit Ahmed Didat, "Burimet e Ligjit Islam", "Muhammedi dhe Islami", "Islami dhe ligji", "Islami në

Portugalinë e sotme", "Palestina", "Mjerimi bashkëkohor", "Mendimi Islam", "Kur'ani dhe kultura portugeze", "Islami në botë", "Martesa në Islam", "Renesansa në botën islame", "Marrëdhëniet portugeze me botën arabe", etj, etj... Shumica e këtyre botimeve, janë të punuara nga Dr.Sulejman Veliji Muhamedij, kryetari i shoqatës.

Me datën 22.06.1979, qeveria portugeze i dha shoqatës një xhami të përkohshme, e cila ishte një pallat i vjetër, në qendër të Lisbonës. Shoqata, në bashkëpunim me ambasadat e vendeve islame, punoi në themelimin e Qendrës Islame, në afërsi të sheshit 'Spanja', me një vlerë katër milion dollarë amerikanë. U formua, gjithashtu, edhe Kuvendi i përbashkët i ambasadorëve të shteteve islame, që punonin në Lisbonë. Qendra, sot, ende nuk është ndërtuar⁴³.

Shoqata ka entin administrativ, asamblenë e përgjithshme, entin vëzhgues, sikurse që ka edhe komisionet e ndryshme për zgjidhjen e çështjeve të xhamisë së përkohëshme, për çështje shoqërore, sportive dhe për çështjen e varrezave të muslimanëve. Shoqata ka dy imamë, njëri është i dërguar nga kryesia e drejtorive për gjurmime shkencore, zgjidhje të çështjeve fetare (iftae), thirrje islame dhe udhëzim në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Ndërsa i dyti, është nga India. Shoqata punon për gjallërimin e riteve islame, si: pesë namazet në kohët e veta, namazin e xhumasë, dy bajramet dhe kremtimin e rasteve festive islame.

Me datën 27.01.1984, u formua shoqata "Grupi (xhemati) Islam i Taxhes Jugor", sikurse u formuan edhe shoqata të tjera islame, në periferi të Lisbonës si: në Ediblaç, në Balboa, Shant Andrian, Shant Antonio Doç Kapliroç, Kelina Do Sol, Botila Do Sekjim dhe Fort Di Kasa Aj Bijalonga dhe gjithashtu në jug, e sidomos në qytetin Japora. Xhamia e dytë e përkohshme gjendet në qytezën Almada, afër Lisbonës, në regjionin Langjiro, në

⁴³ Muhamed Kashtilju, "Ringjallja e Islamit në Portugali", Davatul-hak (Thirrja e vërtetë), (Marok), nëntor 1980.

afërsi të Tariro-s (krahina Stopal). Xhamia e tretë, gjendet në Kelina Do Sol, xhamia e katërt në Ediblaç, për të cilën dha kontribut një familje muslimane, e cila ia fali shoqatës godinën e xhamisë.

Në vitin 1988, në qytezën Lurish, në veri të Lisbonës, u themelua një shoqatë islame, së cilës komuna e Lurishit, i dha një vend për ndërtimin e xhamisë, që është në zonën e Shant Antonio Doç Kapliroç. Kjo shoqatë, nxjerr nga shtypi, revistën e pavarur me emrin "El-Furkan", të cilën e udhëheq Muhamed Jusuf Ademxhi. Anëtarët e kësaj shoqate, kryesisht janë muslimanë me origjinë aziatike, së bashku me disa muslimanë të rinj portugezë, në mesin e të cilëve Dr.Muhamed Luis Madurira, i cili me profesion është profesor i matematikës, dhe i cili u deklarua musliman, në vitin 1983.

Të gjitha shoqatat islame të Portugalisë, të cilat i përmendëm deri tani, i përkasin medhhebit synit, shumica e themeluesve (iniciatorëve) janë muslimanë, që shkuan në Portugali përkohësisht. Ekziston një grup i vogël, i cili, u përket shiitve ismailije, me origjinë nga India. Nga ana tjetër, u formua Qendra për Studime Arabe, në Universitetin Japora.

Si duket, organizimi islam në Portugali, edhe përkundër se filloi para Spanjës, prapë se prapë mbeti mbrapa, e sidomos kur shohim se edhe më tej shoqatat vazhdojnë të jenë në duart e emigrantëve, ndërsa muslimanët portugezë vazhdojnë të qëndrojnë anëtarë të thjeshtë të shoqatave. Puna ndryshon vetëm në jug, ku paraqitet vullneti, për themelimin e shoqatave islame, nga muslimanët e rinj portugezë, për të vepruar si ata në Andaluzi.

Sa i përket Xhebelu Tarik (Gjibraltarit), përafërsisht dhjetë përqind e banorëve, numri i të cilëve numërohet deri në tridhjetëmijë, janë muslimanë marokenë, të cilët nuk konsiderohen si qytetarë të Gjibraltarit, dhe nuk kanë të drejtat të plota në këtë koloni britaneze, më e rëndësishmja e të cilave është e drejta e qëndrimit.

Shumica e tyre, janë burra pa familjet e tyre, të cilët i shohim të sprovohen me sprovat më të vështira. Ata kishin xhaminë e tyre, në selinë e banimit të tyre, në një kazermë të vjetër ushtarake, në qendër të qytetit, që i ngjante një depoje të madhe, e adoptuar për xhami, që e mirëmbante grupi (xhemati) teblig.

Siç vërehet, prezenca e Islamit në Gjibraltar është e hershme (e vjetër). Mevlana El Xhed Sejidi Muhamed Ezemzemij El-Kitani, në kujtimet e tij për vizitën që ia kishte bërë Gjibraltarit, në vitin 1934, shkruan: "Sot, në këtë vend, ka një grup të vogël muslimanësh, në krye të tyre fisniku Mevlaja Ahmed dhe Mevlaja El-Hadij, bijtë e Ibni Axhibe, të cilët tregëtonin atje, prodhime marokene. Vërtet ne ishim në mikëpritje të tyre, pastaj aty ishte edhe fisniku Sejidi Abduselam bin Ulal El-Umrani, bashkë me ta ishin edhe afër njëzet të tjerë nga Tatvani, Tanxha dhe nga vendet e tjera, të cilët shitnin vezë dhe perime (zarzavate), dhe kishin dyqanin, në shtëpinë ku kishte qenë më parë konsullata marokene, që pretendohet të jetë xhami, e që ndryshe është një shtëpi e vogël, me një vend për abdes dhe një pus. Në këtë gjendje të zbrazët, ka mbetur që nga ditët kur ishte depo, kur ndodhi pavarësia e Marokut. Para kësaj shtëpie, ka një dhomë, në të cilën, një ditë, i biri i Umrani ka mësuar te dijetari, Kur'an".

Siç na paraqitet, muslimanët në Gjibraltar (Xhebelu Tarik), sapo janë organizuar, edhe përkundër asaj se faltorja islame kishte ekzistuar më parë, dhe se një numër i qytetarëve të Xhebelu Tarik (Gjibraltarit), ishin kthyer në Islam.

Ditët e para në Sevilje

Shoqata "Xhemati Islam në Andaluzi", u paraqit si rezultat i pastër i sprovës andaluziane, dhe u formua si rezultat i natyrshëm i lëvizjes kombëtare të Andaluzisë, që ka rrënjë islame. "Xhemati", vetë konsiderohet lëvizje islame andaluziane, që lidhet ngushtë me token e

Andaluzisë. Shohim se Palas Anfanti, themeluesi i parë dhe udhëheqësi shpirtëror i shoqatës "Xhemati", ka bindjen se nacionalistët modernë andaluzianë, që pretendojnë se janë ithtarë të Anfantit, nuk zbatojnë përveçse disa ide politike, dhe injorojnë idetë e tij rreth identitetit andaluzian, dhe domosdoshmërisë së njohjes së popullit të Andaluzisë, me historinë e tyre islame, me bindjen (besimin) islam, me mësimin e gjuhës arabe dhe hapjen e lëmive të kthimit në Islam, të atyre që e dëshirojnë një gjë të tillë.

Themeluesit ose iniciatorët e "Xhematit", kaluan nëpër tri etapa:

- Ata e filluan jetën e tyre publike në parti të majtiste,
- u integruan në parti të nacionaliste andaluziane,
- e prej aty, në Islam.

Shumica e tyre vijnë nga familje të kulturuara, që kishin aktivitet në lëvizjet majtiste, anarkiste dhe nacionaliste. Shumica e tyre, janë të lindur pas vitit 1950 ose 1960. Si shumë të rinj, një pjesë e tyre u bashkangjiti, në vitin 1965, në "Federatën e Rinisë Komuniste", ose në "Komitetin e Rinisë Internacionale", ose me "Partinë Komuniste të Spanjës". Në atë kohë, parti të majtiste, e në veçanti Partia Komuniste, mbledhte rreth vetes rininë andaluziane, të ndikuar nga trazirat e majit të vitit 1968, të Lëvizjes së Studentëve Francezë, e cila besonte në aftësinë e saj, që të ballafaqohet me pushtetin e diktatorit Franko.

Pasi skena politike spanjolle u pastrua (çlirua), pas vdekjes së diktatorit Franko, në vitin 1975, disa të rinj andaluzianë, që ishin të përkushtuar në Partinë Komuniste, i humbën shpresat tek ajo dhe vërejtën se, edhe ajo, është e njëjtë sikurse parti të tjera, në organizimin e saj piramidal dhe posedon një diktaturë të brendshme, sikurse zbuluan edhe faktin se, kjo parti, nuk

posedon ndonjë program të veçantë për Andaluzinë, e as që ka interesim për identitetin karakteristik andaluzian.

Disa nga këta të rinj, u bashkangjitën në partitë edhe më majtiste, si "Rinia e Gardës së Kuqe Spanjolle" dhe "Partia e Punës së Spanjës", ndërsa disa të tjerë, formuan lëvizjen kulturore për rikthimin e kulturës andaluziane.

Në vitin 1976, Lëvizja Kulturore u shndërrua në lëvizje politike, me emrin "Partia e Unionit Socialist të Andaluzisë". Edhe kjo parti, nuk zgjati shumë dhe u pezullua. Disa elemente të kësaj partie u bashkuan me elemente të "Partisë Andaloziane", në Mallagë, Granadë dhe Sevilje, dhe të gjithë së bashku, në të njëjtin vit, themeluan "Frontin për Çlirimin e Andaluzisë", si parti, që ka orientim të qartë nacionalist, që kërkon pavarësinë e Andaluzisë, dhe kthimin në origjinën e saj.

Në vitin 1977, ky grupim u zgjerua dhe organizoi një takim publik, ku u bashkangjitën grupe të shkëputura nga "Federata e Rinisë Komuniste të Andaluzisë", nga "Rinia e Gardës së Kuqe së Spanjës", nga "Partia e Punës për Unitet Marksist", dhe nga "Konfederata Kombëtare për Punë", që kishte orientim anarkist (mbretëror). Me hyrjen e të gjitha këtyre elementeve, në "Frontin për Çlirimin e Andaluzisë", ky front u shndërrua në "Frontin Andaluzian për Çlirim", me në krye Antonio Madine Melire, duke u bërë organizata më e rëndësishme rinore e Andaluzisë.

Ky front u persekutua jashtëzakonisht shumë nga qeveria e Suarezit. Pjesëtarët e frontit, e sidomos kryetari i tij, u ndoqën. Fronti u ballafaqua me vështirësi të mëdha materiale, gjë e cila ndikoi negativisht, dhe brenda një kohë të shkurtër, fronti u nda në tri fraksione:

1. Nacionalistët andaluzianë, të cilët kërkonin që Andaluzia të arabizohej për nga gjuha, dhe të kthehej identiteti andaluzian, i bazuar në bindjen e njësisë.

- 2- Ekologjistët, që kishin lidhje të ngushtë me lëvizjen e ekologjistëve evropianë (të gjelbërtit) dhe lëvizjet, të cilat quhen të reja.

3- Një grup i vogël, nga ithtarët e lëvizjes tradicionale të punëtorëve, të organizuar me programin e tyre dhe metodën e tyre, për rezistencë të vazhdueshme.

Në vitin 1978, kjo përçarje rezultoi me shpërbërjen e "Frontit Andaluzian për Çlirim", sikurse që u shpërbë edhe "Partia e Punës (komuniste) Spanjolle". Elementet e dy partive të shpërbëra, u bashkuan në një organizim të ri: "Partia e Çlirimit të Andaluzisë". Brenda partisë së re ishin dy orientime politike, njëri ishte nacional dhe tjetri komunist. Nacionalistët, filluan t'i përdorin simbolet islame brenda partisë, këto simbole i vizatuan edhe në murin e një kishe të Seviljes, gjë që e kundërshtuan komunistët brenda partisë.

Kjo çarje shkaktoi edhe shpërbërjen e kësaj partie, që u shpërbë në vitin 1980. Nacionalistët formuan "Grupin el-Az'har", me qëllim që të punojnë drejt ndërtimit të pavarësisë së Andaluzisë, nëpërmjet rrugës për gjetjen e identitetit të humbur, pa veprim politik, dhe përqendrim rreth studimit të shkrimeve të "Palas Anfanti-t" dhe "Agnasio Ilako-s", dhe të tjerëve.

Në muajin gusht 1981, Antonio Medina Molera, pranoi Islamit në qendrën "Xhemati Islam i Seviljes" dhe u bashkua me këtë grup, ndërkohë veten e quajti Abdurrahman. Kështu, pas një përpjekje të gjatë, Abdurrahman Medina Molera, arriti deri te Islami, me bindje të plotë dhe të paluhatshme ndaj parimeve të Islamit. Ky personalitet, lindi me 05.08.1952, në qytetin Gafik (regjioni i Kordovës), nga Rufail Medina Messe, i ati, njëri nga tregëtarët që jepte lehtësime të shumta dhe nga e ëma, Marije Molera Kaumos. Dy familjet, si ajo e të atit, po ashtu edhe së ëmës, mburreshin për origjinën e tyre El-Mursikije, që kishte aktivitet në lëvizjen anarkiste. Abdurrahmani u rrit në një atmosferë dijeje dhe studimi dhe diplomoi në njërin nga universitetet më të njohura në historinë e Andaluzisë, si dhe studioi komparacionin e feve.

Në vitin 1965, Abdurrahmani e filloi jetën e tij publike. Në atë kohë, nuk kishte më shumë se 13 vjet, si anëtar i "Komitetit të Rinisë Punëtore, anëtar në "Federatën e Rinisë Komuniste", dhe anëtar i "Partisë Komuniste". U burgos dhe u torturua në ditët e Frankos. Në vitin 1975, Medino ishte kryetar i grupit, i cili u largua nga "Partia Komuniste", dhe formoi "Partinë Andaloziane të Unitetit Socialist", më vonë "Frontin e Çlirimit të Andaluzisë", e më pastaj "Frontin Andaluzian për Çlirim".

Në vitin 1978, kryesoi "Partinë për Çlirimin e Andaluzisë". Pastaj, Medino u largua nga politika dhe e themeloi shoqërinë botuese, të cilën e quajti "Biblioteka e Botimeve Andaluziane", e cila botoi dy libra: "Historia e Përgjithshme e Andaluzisë", e përfshirë në gjashtë volume dhe librin tjetër me titull: "Leksikoni andaluzian". Pas një përpjekje të re për ringjalljen e "Frontit për Çlirimin e Andaluzisë", në vitin 1979, Medino arriti që të fitojë bindje të plotë për Islamin, si fe absolute e kompletuar, për t'a çliruar njeriun nga padrejtësia dhe armiqësia, dhe në gusht të vitit 1981, vendosi që t'a shpallë pranimin e Islamit nga ana e tij dhe të bashkangjitet me grupin "Xhemati Islam i Seviljes", duke zgjedhur emrin Abdurrahman, si shprehje të dëshirës dhe shpresës, që të jetë rob i singertë i Të Gjithëmëshirshmit.

Vendimi i Abdurrahman Medinës, për pranimin e Islamit, ishte vendim personal, dhe në fillim ai as që mendonte që t'iu bënte thirrje edhe shokëve të vet, për t'a pranuar Islamin. Pas disa muajve, shokët e tij në lëvizjen nacionaliste, filluan t'a pyesin se ç'ka e shtyri atë t'a ndrronte fenë. Më datën 17.01.1982, edhe dy shokë të tjerë të Abdurrahmanit, pranuan Islamin; ata ishin: Muhamed El-Muatemid Sançez Kastijanos (emri i tij i mëparshëm ishte Alfonso), dhe Ebu Jaser Rina Endradi (emri i tij i mëparshëm ishte Salbitor ose Salvator). Që të dy e pranuan Islamin, në qendrën e "Xhematit Islam të Seviljes", para Abdula Hak Aspinoza-s dhe Abdul-Hadi Sanz Kimeno-s.

Muhamed El-Muatemid, lindi më 10.05.1961, në Sevilja, babai i tij ishte inxhinjeri Francisko Sançez Delfijon Verozarijo Kestijanos Korkovijre. Në vitin 1975, filloi aktivitetin politik në "Rininë e Gardës së Kuqe për Spanjën", dhe në "Partinë e Punës së Spanjës". Në vitin 1972, u bashkangjit në "Partinë e Çlirimit të Andaluzisë". Në vitin 1980, ishte iniciator për themelimin e grupit "El-Az'har".

Ebu Jaser, lindi në Sevilja, më datën 112.04.1962, babai tij ishte Salbator Rina Kaldron, drejtor fabrike, me origjinë nga qyteza Moror, dhe e ëma, Rozarijo Endradi Ganolfo, me origjinë nga Renda. Ebu Jaser, jetën e tij publike, e filloi në vitin 1979, me bashkangjtitjen e tij në "Partinë Çlirimtare të Andaluzisë".

Më pas, gjejmë mjaft të rinj nacionalistë të Andaluzisë, t'a pranojnë Islamin, njëri pas tjetrit, siç janë: Fet'hije Pijadras Mareç, Umeje Lahos Barijas, motra e saj Merjem, Mensur El-Kordobi, etj...Hyrja në Islam e këtyre të rinjve dhe antarësimi i tyre në "Xhematin Islam të Seviljes", nxorri probleme të shumta: iniciatorët e themelimit të "Xhematit", shumica e të cilëve ishin nga shtresat me kulturë të kufizuar, nga jashtë Andaluzisë, nga Madridi, Oskado, Septe dhe vende të tjera, nuk e shihnin historinë e Andaluzisë si të dobishme për kthimin e Islamit në të, ata kishin bindjen se identiteti andaluzian është vetëm një ekstrem nacional dhe dëmtim i unitetit të muslimanëve të Spanjës, dhe se andaluzianët e hershëm e humbën Andaluzinë për shkak të dobësimit të Islamit të tyre.

"Xhemati", strukturën organizative e kishte të formës piramidale, ata zgjidhnin emirin (princin), i cili zgjidhte problemet e tyre. Ndërsa, në grupin e ri të andaluzianëve, shumica e tyre ishin personalitete universitare, që kishin historikun e tyre në lëvizjen nacionaliste andaluziane, edhe përkundër moshës së tyre të re. Organizimi i tyre ishte i formës konsultative, ata urrenin çdo gjë që kishte të bënte me monizmin ose centralizmin, në qeverisje ose udhëheqje.

Ata shihnin në Islam, forcën çliruese për personat dhe vendin e tyre, Andaluzinë... Ata, me besimin e tyre për globalizimin e Islamit, e shihnin se andaluzianët bashkëkohorë duhet të ishin popull musliman, i cili nga injoranca e imponuar dhe persekutimi shekullor, ishte detyruar t'a harrojë besimin dhe identitetin e vet. Prandaj është obligim i muslimanëve të Andaluzisë, që të futen brenda shoqërisë andaluziane dhe t'a ndihmojnë shoqërinë andaluziane që t'i njohë rrënjët e veta. Nga kjo bindje, u paraqit frika e parë, se Lëvizja Nacionaliste Andaluziane nuk gjeti zgjidhje për arritje deri te Islami, dhe se ata janë elita e shoqërisë andaluziane, të cilët duhet t'a pranojnë Islamin si forcë çlirimtare dhe pas injorancës dhe persekutimeve shekullore, duhen të ndihmohen patjetër qytetarët që të ndjekin të njëjtën rrugë.

Në janar të vitit 1982, këto kontradikta rezultuan në ndarjen e grupit në dy palë, andaluzianët pushuan së shkuari në qendrën e "Xhematit Islam të Seviljes". Më datën 22.06.1982, andaluzianët hapën një qendër të posaçme për ta, në shtëpinë nr. 3, rruga Berdi (E gjelbërt), në Sevilja. Numri i tyre, në atë kohë, nuk ishte më shumë se gjashtë, që i përmendem më lartë. Ata veten e tyre e quanin "Xhemati (grupi) Islam në Andaluzi" (përdornin shprehjen origjinale arabe "xhemati").

Numri i "Xhematit Islam në Andaluzi", filloi të shtohet me të madhe, pas transferimit në qendrën e saj të posaçme, ku iu bashkangjiten një numër i konsiderueshëm i të rinjve andaluzianë, ndërsa, në anën tjetër, anëtarët e "Xhematit Islam të Seviljes" nuk shtoheshin. Kjo e shtoi krizën në marrëdhëniet në mes dy grupeve. "Xhemati Islam në Andaluzi", punoi për mësimin e fesë Islame, me angazhimin e një studenti palestinez, i cili ishte anëtar në degën e Seviljes, së "Shoqatës Islame në Spanjë", me emrin Hilal Ebu Xhemel, i cili punoi si mësues, udhëzues dhe imam i grupit.

"Xhemati Islam në Andaluzi", filloi të paraqitet në opinion, nëpërmjet shkrimeve publicistike në gazetat ditore, nga Abdurrahman Medina. Dhe kjo, pas shkrimeve të një historiani ekstremist, me emrin Klaudio Sançez Albornoz, i cili në muajin prill 1982, shkroi një artikull në gazetën "Diario 16", rreth "Ripushtimit të Andaluzisë" (fjala ishte për muslimanët). Në atë artikull, në lidhje me historinë e Andaluzisë, ai shkruante: "Shoqëria islame në Spanjë ishte sterile, barbare, antivilizuese dhe antiliberale, shoqëri e degjeneruar. Është fati i madh që muslimanët u dëbuan!" Në vijim shkruan: "Ju, o miqtë e mi andaluzianë, harroni çastet e kaluara të zeza! Dhe ju, oj ti Lula dhe ti Karmin, oj ti Rozario dhe ti oj Ana, juve do t'ju këndojë Manolo Mashado, ju do t'a humbni Andaluzinë! A përsëri dëshironi që të bëheni vegël e kënaqësive, në mes grave? A dëshironi që përsëri të ktheheni në tregun e robërve?"

Albornoz vazhdoi me artikujt e tij serikë, në të cilët sulmonte barbarisht muslimanët e Andaluzisë dhe Fenë Islame. Atij i'u bashkangjitën edhe një grup nga llumi i tij, në fushatën kundër Islamit dhe shoqatave islame andaluziane. Në një artikull të gazetës "Diario 16", Albornoz në shkrimin e tij, me titull "Muslimanët e rinj andaluzianë"⁴⁴, i përgjigjet shkrimeve të muslimanëve, të cilat ishin përgjigje ndaj shkrimeve të tij krishtere të mëparëshme.

Shkrimin e tij e fillon me propagandën, se: Islami ka filluar të përhapet në Andaluzi, për shkak të "dollarëve të naftës" dhe vazhdon e pretendon se ai, vazhdimisht, ka qenë dhe është nga thirrësit për lirinë e besimit, duke përfshirë aty edhe besimin islam. Mirëpo, ai thotë se: "Është e drejta dhe obligimi im, që të qëndroj përballë vëllezërve bashkatdhetarë, të cilët po e shesin ndërgjegjen e tyre, dhe po konvertohen nga feja e tyre historike, e po i

⁴⁴ Claudio Sanchez Albornoz, "Los Nuevos Musulmanes Andaluces", Diario-16 (Madrid), 03.05.1982.

bashkangjitën një feje që nuk e njohin, dhe e gjithë kjo, po ndodh vetëm për një grusht dollarë!"

Ai shkoi deri në atë shtjellim të errët, sa që tha: "Çdo kush që e ka kaluar jetën e tij, duke studiuar shekujt e Mesjetës në Spanjë, i njeh fare mirë tre tradhëtitë, që sollën Islamin në Spanjë:

- tradhëtinë e bijve Pizita, të cilët i sollën muslimanët e perëndimit arab, që të tradhëtojnë fronin e babait të tyre,

- tradhëtinë e ithtarëve të tyre në betejën 'Lugina Let', të cilët kaluan në radhët e armikut, si dhe

- tradhëtinë e Tarik-ut, i cili shpalli në Talitla, se ai do dalë nga komanda dhe shërbimi i princit, i cili e solli për shërbim gjatë kalimit të ngushticës Xhebelu Tarik (Gjibraltari), dhe vendosja e tij në shërbim të kalifes, në Damask".

Pas sulmeve të tij, kundër muslimanëve të Andaluzisë, Alborno, në fund të artikullit, përfundon duke thënë: "Jo, për Islamin...muslimanët e Andaluzisë, nuk kanë të drejtë që të flasin për liri politike...sepse të gjitha grupet bashkëkohore islame, sot e injorojnë lirinë."

Më datën 18.05.1982, Alborno botoi një artikull tjetër, në të njëjtën gazetë, me titull "Në haremin e Kalifes"⁴⁵, si "vërejtje për andaluzianët bashkëkohës që mos t'a pranojnë fenë e kaluar islame (të dalë mode) dhe traditat e saj."

Alborno, në fillim të artikullit, shkruante se ai me vete kishte sjellë disa tregime nga libri "El-Muktebis", të Ibni Hajjan El-Kurtubiju-t (Kordovi), për t'ua paraqitur atë grave, të cilat po i tërheq feja Islame, e sidomos të njërës prej atyre, që është një farmacistë nga Kordova, e shtyrë në moshë, e cila erdhi me akuza për mashtrim nga Abdurrahman En-Nasir dhe sjelljet e tij me gratë e tij, e prej tyre një tregim të likuidimit të fqinjës së indinjuar nga ngacmimet dhe vardisja e tij ndaj saj, dhe përfundon

⁴⁵ Claudio Sanchez Alborno, "En el Haren del Califa", Diario-16, 18.05.19982.

shkrimin e tij, duke thënë: "Oj mikeshat e mia andaluziane, të dashuruara ndaj Spanjës islame, mund t'iu tregoj tregime rreth jetës së grave, jo më pak të tmerrshme, se sa nën sundimin e kalifëve dhe mbretërve muslimanë andaluzianë. Do t'a harroni simpatinë tuaj dhe do të falenderoni invazionin e krishterë, i cili ua ngriti nderin tuaj, ju çliroi juve nga persekutimi dhe padrejtësia, që jetonin gratë muslimane të Andaluzisë."

Në gusht të viti 1982, Zhoakin (Joaquin) Ibarz botoi një seri artikujsh, plot urrejtje e mëri, në gazetën "La Vanguardia", të Barcelonës⁴⁶, me titull "Kur'ani, perde për realizimin e qëllimeve jo të qarta". Vetë titujt argumentojnë për mërinë e tmerrshme ndaj Islamit dhe pjestarëve të tij, si: "Islamizimi i Andaluzisë, ëndërr imagjinuese", "Orientalistët kundër fushatës", "Islami tenton të kthehet në xhaminë e Kordovës", "Ahmedije - sekt i persekutuar", "Sektet mistike (sofiste)- sekte për pastrimin (shpëlarjen) e trurit" dhe "Pijazin, vendstrehim i Islamit të zi".

Shkrimtari në fjalë, nuk iu shmang as hyrjes në jetën private të disa muslimanëve e muslimaneve andaluzianë, si Ulja Suli nga familja "Tramp" në Katalonia, e cila jeton në Kordovë me burrin e saj, Ahmed El-Xhunejdi Herniro, pastaj Abdurrahman Rovano Hinokhoza, Mustafa Shika, Muhamed Del Boso dhe Fransine Bosh me bashkëshortin e saj Ankhil Fosmelijano, etj, etj...

Abdurrahman Medina Molera iu përgjigj Klaudio Sançez Albornoza-it, me një përgjigje bindëse, që kishte ndikim pozitiv, sikurse që iu përgjigjën edhe shumë muslimanë të tjerë andaluzianë. Më vonë, Medina botoi një seri artikujsh në gazetën spanjolle, në të cilat mbronte Islamin dhe personalitetin (identitetin) andaluzian, dhe bënte një ndërlidhje të ngushtë në mes tyre, siç është rasti me artikullin e shkruar rreth qëndrimit të qeverisë

⁴⁶ Joaquin Ibarz, "El Coran, Una Pantalla para Lograr Objetivos poco Claros", La Vanguardia (Barcelona), 11-12-13. 08. 1982.

spanjolle ndaj Andaluzisë, ku në hyrje ai shkruan⁴⁷: "Andaluzia ka qenë gjithnjë viktimë e formave të caktuara, të cilave u thuhet monopole udhëheqëse, kulturore dhe politike në Madrid. E sidomos, sa i përket burimit kulturor, që më së shumti ndriti, i njohur në Evropë: Kultura islame andaluziane". Artikulli i tij e përfundon me fjalët: "Ne andaluzianëve, nuk na shikon askush, si një grup njerëzor që kemi personalitet (identitet) të veçantë, por na shikojnë si një grup të bashkangjitur me një grup njerëzish të ngjashëm, që nuk kemi personalitet dhe kjo, që nga momenti kur pushoi fjala "Allahu Ekber" (Zoti është më i Madhi), të thirret nga muezinët andaluzianë, në lartësitë e minareve. Që nga ai moment, u zhduk vesa e mëngjezit mbi lulen e jaseminës, si loti që shterret nga thatësia."

Në janar të vitit 1983, numri i grupit "Xhemati Islam në Andaluzi" arriti në 60 anëtarë, prej tyre 15 ishin fëmijë. Qendra e "Xhematit" dukej e ngushtë, prandaj u detyruan që t'a ndërrojnë qendrën dhe kaluan në një më të madhe, në rrugën Lebis. Në anën tjetër, marrëdhëniet me "Xhematin islam të Seviljes" u keqësuan, por deshi Allahu dhe me datën 23.01.1983, u arrit një marrëveshje, si vijon: "Me emrin e Allahut, Mëshiruesit të Pashoq, Bamirësit të Pashembullt! Ne përfaqësuesit e dy shoqatave, betohemi para Allahut, se do t'i respektojmë parimet islame, të cilat kërkojnë nga ne bashkëpunim dhe vëllazërim midis nesh, unifikim të përpjekjeve tona për daret (thirrje) për në Kur'anin fisnik dhe sunnetin e shndritur, të punojmë për faljen e përbashkët të namazit të xhumasë. Lusim Allahun, që t'a ndritë çështjen tonë dhe të na bashkojë në një rrugë të vetme (të drejtë). Amin". Për "Xhematin Islam në Andaluzi", nënshkroi: Abdurrahman Medina, Jahja Rejs dhe Hilal Ebu Xhemel, për "Xhematin Islam të Seviljes" nënshkroi: Abdul-Hadi Sanez, Muhamed Ahmed

⁴⁷

Antonio Medina Molera, "Milenarismo y Misterio Andaluz", Diario-16, 10.12.1982.

dhe Othman Bersabi dhe dy dëshmitarë: Muhamed El-Hilw dhe Ali El-Kitani. Sevilje, më 23.01.1983"

Me këtë veprim, "Xhemati Islam në Andaluzi", filloi një nismë të re.

Nisma nga Sevilja

Pas kalimit në qendrën e saj të re, shoqata "Xhemati Islam në Andaluzi" filloi të hapë degët (filialet) e saj, nëpër qytete të ndryshme të Andaluzisë. Më datën 22.01.1983, përfaqësuesit e "Xhematit", me një numër muslimanësh, u mbledhën në Granadë. Në mesin e tyre ishin edhe Xhabir Bilarhil, drejtori i librarisë medicinale në Universitetin e Granadës, Harun Krakuil Romero, Muhamed Xhuma Bilajzi, e të tjerë... Në prezencë të autorit (të këtij libri), aty u vendos që të hapet dega e shoqatës në Granadë.

Me datën 01.03.1983, në një ceremoni zyrtare, u bë hapja e Qendrës Islame të Granadës, e cila u bë degë e xhematit. Qendra u hap në një banesë të madhe, në një ndërtesë banimi, në rrugën "Handaku", në pjesën e vjetër të qytetit të Granadës.

Më 01.05.1983, me "Xhematin" u bashkua zyrtarisht "Xhemati Andaluzian Islam", i kryesuar nga Umer Koka. Në këtë mënyrë, "Xhemati" u kompletua dhe u quajt "Xhemati i Andaluzisë Islame", në vend të emrit "Xhemati Islam në Andaluzi".

Në qershor të viti 1983, u formua "Xhemati Musliman i Sherishit" (regjioni i Kadis-ës). Në mesin e themeluesve të xhematit ishin: Abdul Aziz Garsia Fernandes dhe Abdul Kerim Hajlikero. Kjo është dega e tretë e xhematit, e cila e hapi qendrën, më datën 01.08.1983, në rrugën Pasorto nr. 9, në Sherish.

Në qershor të vitit 1983, u themelua gjithashtu edhe "Xhemati i Muslimanëve të Mallagës", mes të cilëve ishin: Esed Allah Del Milago Perez, Mulod Hamed Beshir, Ismail

Hurkiro Asoris dhe Sallahu Din Giardo Morino. Të gjithë këta, themeluan degën e katërt të xhematit, dhe më 01.09.1983, hapën Qendrën e tyre Islame, në banesën nr.26, në rrugën Marmoles.

Në tetor, të vitit 1983, një numër i muslimanëve të Kordovës, prej tyre Ahmed Sallahu Din, Abdullah El Fateh, Abdu Shekur dhe Abdul Melik, formuan, së bashku, degën e pestë të xhematit, dhe hapën Qendrën e tyre Islame, në rrugën 'Dy mbretërit katolikë', nr.12, në Kordovë.

Kështu, në fund të vitit 1983, "Xhemati Islam në Andaluzi " themeloi pesë degë, në qytetet si vijojnë: në Sevilje (qendra), në Granadë, në Sherish, në Mallagë dhe në Kordovë .

Në këtë mënyrë, 'Xhemati' u bë Shoqata e parë Islame Andaluziane, që i shtriu rrënjët jashtë qytetit të themelimit, në mbarë regjionet e Andaluzisë. Vlen të theksohet përfshirja e shoqatës, së themeluar nga Omer Koka në Granadë, në radhët e 'Xhematit'.

"Xhemati" u organizua mbi bazat e "Shura-së" (konsultës-debatit), jo në baza centraliste, d.m.th. që kishte kuvendin suprem, që përbëhej nga përfaqësuesit e degëve në qytete të ndryshme, që kryesohet nga presidenti i votuar. Xhabir Bilari nga Granada, ishte kryetari i parë i këtij kuvendi. Secila degë, kishte kuvendin lokal që përfaqësonte muslimanët e degës. Secili vendim merrej me konsultë.

Gjithashtu, në vitin 1983, "Xhemati" vendosi që ekzistenca e tij të njihet botërisht, prandaj për këtë, vendosi që të organizojë një ceremoni përkujtimore, me rastin e nëntëqind vjetorit të vdekjes së El Muatamid Bin Ibad Malik Ishbilie-s (Seviliani), dhe kjo të bëhej duke organizuar ceremoni kulturore islame andaluziane të nivelit të lartë.

"Xhemati" kërkoi nga komuna e Seviljes, që t'ia dorëzojë Pallatin e vjetër të Kalifëve, për t'a mbajtur ceremoninë, mirëpo komuna e Seviljes e refuzoi kërkesën.

"Xhemati", me të njëjtën kërkesë, iu drejtua për ndihmë komunës së Torjanës (simotra e Seviljes në Luginën e Madhe), përfaqësuesit e së cilës, me në krye Francisko Arkasi, iu përgjigjën pozitivisht dhe ia dorëzuan "Xhematit", pallatin "Hoteli Torjano", për të zhvilluar ceremoninë⁴⁸.

Në mes "Xhematit" dhe ministrit për kulturë, në qeverinë lokale andaluziane, ndodhi një debat i ashpër gazetaresk, ku ky i fundit pretendonte se mosdhënia e pallatit të Seviljes për "Xhematin", është bërë vetëm për shkaqe teknike, dhe se Torjano nuk ishte veçse një lagje prej lagjeve të Seviljes, dhe nuk mund t'ua dorëzonte pallatin, pa pëlqimin e komunës së Seviljes⁴⁹. Në mbrëmjen e ditës së xhuma, më 14.10.1983, filloi ceremonia në brigjet e luginës së madhe, në afërsi të Kullës së Floridit (e ndërtuar nga Muahidinët), në perëndim të diellit. Esedallah Del Milagro (nga Mallaga) thirri ezanin për namazin e akshamit, me zë shumë të bukur, që e ndoqi Alzurabi. Në namazin e akshamit, u bashkangjitën për afërsisht njëqind andaluzianë pas imamit Omer Koka, nën mbrojtjen e dhjetëra pjestarëve të policisë dhe nën shikimin dhe respektin e mijërave shikuesve, nga banorët e Seviljes. Në këtë ceremoni, u mblodhën shumica e anëtarëve të "Xhemati-t Islam në Andaluzi", të cilët erdhën nga qytete të ndryshme të Andaluzisë.

Pas namazit të akshamit dhe duasë, muslimanët andaluzianë lëshuan një kafaz me pëllumba të bardhë në Luginën e Madhe, si simbol për paqe, liri fetare dhe dashuri mes njerëzve, për të cilat apelon Islami.⁵⁰

⁴⁸ "El Ayuntamiento Sevillano Cederá un Local por el Homenaje a Al-Mu'tamid", Diario-16, 07.10.1983.

⁴⁹ "El Ayuntamiento Sevillano se Niega a Apoyar un Homenaje a Al-Mu'tamid", Diario-16, 06.10.1983.

⁵⁰ "Los Musulmanes Rezaron por Al-Mu'tamid en la Torre del Oro", Diario-16, 15.10.1983.

Pastaj, të gjithë kaluan nëpër Luginën e Madhe, drejt "Hotelit Torjano". Me këtë rast, banorët e Torjanës kishin zbukuruar shtëpitë e tyre dhe kishin nxjerrë çarçafët e tyre të bukur në ballkone, siç e kishin zakon në ditët e festave. "Hotel Torjano" ishte përplot pjesëmarrës, për afërsisht numëroheshin rreth pesë mijë vetë. Ceremonia filloi në një atmosferë festive dhe emocionuese. Filloi me emrin e Allahut, të Lartëmadhërishmit, të Gjithëfuqishmit dhe me salavate për të dërguarin e ndershëm. Fjalën e mori kryetari i atëhershëm i "Xhematit", Xhabir Bilari, i cili i bëri të qarta qëllimet e "Xhematit" dhe programin e xhemateve islame andaluziane, i cili bazohet në rrugën e besimtarëve të mëhershëm të singertë andaluzianë, në përpjekje për të kthyer identitetin fetar, kulturor e nacional për popullin e persekutuar dhe të përvuajtur andaluzian, që të bëhet trashëgimtari i vërtetë bashkëkohor, t'i japë fund rezistencës shekullore dhe të realizohet programi i Palas Infantit, për kthimin e identitetit personal andaluzian.⁵¹

Kur arriti koha e namazit të natës (jacisë), organizatorët ua bënë të qartë pjesëmarrësve, se çfarë kuptimi ka ezani. Disa prej tyre, me respekt të plotë, kërkuan që t'a dëgjojnë ezanin me endje. Aty u theksua se, ky ezan, dikur dëgjohej kudo në minaret e Andaluzisë, pesë herë në ditë dhe kjo, për shekuj të tërë. Pastaj, Esedullahu thirri ezanin.

Pjesëmarrësit ulën kokat e tyre nga rrënkethjet. Pas ezanit, pjesëmarrësit duartrokitën në mënyrë frenetike, si shprehje e kënaqësisë për atë që dëgjuan. Pastaj, Abdurrahman Medina foli për parimet e Islamit dhe për biografinë dhe veprimtarinë e El-Muatemid bin Aibad, duke thënë: "Do t'u lexojmë disa vargje poetike, në gjuhën tuaj arabe, që jeni detyruar me dhunë që t'a harroni, dhe do t'i përkthejmë në gjuhën kishtare, e cila iu është imponuar juve!" Muhamed Xhuma Pelajzi (nga Granada)

⁵¹ "Al-Mu'tamid, Ultimo Rey Arabe de Sevilla, Homenajeado al Pie de la Torre del Oro", ABC, 16.10.1983.

lexoi, në gjuhën arabe, disa vargje poetike të El-Muatemid-it, ndësa përkthimin në gjuhën spanjolle e lexoi kryetari i shoqatës Xhabir Bilari.

Pas kësaj, poeti andaluzian Hoze Luis Orteiz Novibo, lexoi poezitë e tij, në të cilat e shenjtëroi Andaluzinë dhe historinë e saj. Të gjithë qanë me lotë për identitetin e humbur dhe për dekadencën (harresën) e shkaktuar. Pastaj, artisti andalozian, Bibi Romero, interpretoi një pjesë muzikore në piano. Në ceremoni, morën pjesë edhe artistë të tjerë andaluzianë si: Hoze Mola Tomasa, Benito Morino, e të tjerë. "Xhemati Islam në Andaluzi", tregoi kujdes të madh që në këtë ceremoni, të mos mungojë pjesëmarrja e personaliteteve të njohura publike, ashtu që, kjo ceremoni, të mos mbetet vetëm ceremoni islame, por të jetë ceremoni dhe festë për të gjithë andaluzianët, dhe që ata të njihen me fenë dhe rrënjet e tyre të hershme.

Ceremonia pati sukses në realizimin e qëllimeve të "Xhematit", të cilat ishin:

1. Njohja me ekzistimin e "Xhematit" në Andaluzi;
2. Njohja me programin e shoqatës për popullin e Andaluzisë, si një grup musliman andaluzian;
3. Krijimi i lidhjes në mes "Xhematit" dhe faktorëve të fuqishëm dhe të rëndësishëm andaluzianë;
4. Forcimi i bindjes në vetvete tek anëtarët e "Xhematit", dhe aftësitë që kanë për organizimin e një pune të suksesshme.

Edhe përgjatë datave 28.11.1983 - 03.12.1983, "Xhemati Islam në Andaluzi", dëshmoi ekzistencën e vet para opinionit të Mallagës, me organizimin e "Javës kulturore andaluziane", në Universitetin e Mallagës, në bashkëpunim me Universitetin e Mallagës dhe Universitetin e Granadës⁵². Programi kulturor përfshinte një seri ligjërata (leksionesh): E hënë 28.11.1983, ligjërata "Shkencat natyrore në Andaluzinë Islame",

⁵² "Al-Mu'tamid, Ultimo Rey Arabe de Sevilla, Homenajeado al Pie de la Torre del Oro", ABC, 16.10.1983.

ligjërues Xhabir Bilar Khil; E martë 29.11.1983, ligjërata "Letërsia në Andaluzinë Islame", ligjërues Xh. M. Hakerti, profesor i Gjuhës Arabe në Fakultetin e Letërsisë, Universiteti i Granadës; E mërkurë, 30.11.1983, ligjërata "Metoda islame në shkrimin e historisë andaluziane", ligjërues Abdurrahman Medina Molira; E enjte, 01.12.1983, ligjërata "Vështrim i përgjithshëm historik rreth gjuhës andaluziane" të Fetiha Pijadras Mareç; E xhuma, 02.12.1983, namazi i xhumasë për muslimanët pjesëmarrës, në mbrëmje ligjërata me titull "Zhvillimi dhe ardhmëria ekonomike e Andaluzisë", ligjërues Aurora Komes, Manuel Delkado dhe Antonio Morias, të gjithë profesorë në Fakultetin Ekonomik, në Universitetin Mallaga; E shtunë, 03.12.1983, ligjërata "Pushtimi i Andalozisë Islame dhe rënia (shkatërrimi) i civilizimit" të prof. Antonio Zejdo Neranho, Drejtori i bibliotekës "Roli i publicistikës andaluziane", pastaj u ekspozua filmi me titull "Luani i shkretëtirës"; E dielë, 04.12.1983, akordohet me ditën e Andaluzisë tek nacionalistët andaluzianë; u mbajt nata letrare, me pjesëmarrjen e Trupës Tatvan El-Andalosi.

Në natën letrare ishte edhe "Universiteti", i cili është Grupi Andaluzian nga Mallaga, së bashku me të, ishte edhe poetja andaluziane Karmin Abnesa. Në këtë javë andaluziane, morën pjesë një numër i madh i shtresës së kulturuar intelektuale të Mallagës.

Abdurrahman Medina botoi një material në gazetë, ku shkruan se qëllimi i "Javës kulturore ishte njohja me spektret e ndryshme të kulturës andaluziane, me kulturën e popullit andaluzian, të cilën ne e trashëguam".

Dhe konfirmon: Sa na përket neve, vetë ekzistenca e popullit andaluzian është realitet, i gjalli duhet të qëndrojë mbi konkurrencat dhe rivalitetet politike, dhe koncepti i tij është se ekziston një popull që ka rrënjët dhe historinë e vet". Në këtë mënyrë "Xhemati Islam në Andaluzi", pati sukses me aktivitetin e dytë publik dhe fitoi simpati dhe respekt, tek shtresa intelektuale

andaluziane, gjë kjo, që i mundësoi që të krijojë raporte të mira me ta, dhe i tërhoqi me idetë e veta, dhe u hap mundësia që të bëjë thirrje islame deri në nivelet më të larta.

Në fillim të vitit 1984, "Xhemati" u orientua kah zgjerimi gjeografik dhe shtimin në numër. Formoi dy degë tjera, njërën në Vulbe (regjioni Vulbe) dhe tjetrën në Dhekwan (regjioni Mallaga), pastaj filloi të mendojë për hapjen e dy qendrave të saj të reja. Në shkurt të viti 1984, qendra islame e Seviljes që i përkiste (takonte) "Xhematit", kaloi dhe u transferua nga shtëpia me qira, në "rrugën Lebis", në një qendër shumë më të madhe, në rrugën 'Don Alonso Sabio', nr.4, në qendër të qytetit të vjetër, që deri më tani (1991) ishte selia kryesore.

Edhe qendra e "Xhematit", në Mallaga, u transferua nga rruga Marmoles, në një qendër më të madhe, në qendër të qytetit, në rrugën Salbeto.

Në përfundim të vitit 1984, "Xhemati" filloi të korrë suksese me programin për njohjen e masës (opinionit) andaluzian, me historinë e tyre dhe lidhjet që kanë me historinë e tyre. Mirëpo, që nga ditët e Frankos, shteti së bashku me kishën, kishin filluar që, në të gjitha qendrat kryesore të Andaluzisë, t'i festojnë përvjetorët e pushtimit të Andaluzisë, nga të krishterët kishtala.

Muslimanët e Andaluzisë, një ceremoni të tillë festive, e konsideronin nënçmim të historisë së tyre dhe poshtërim e sharje për ekzistencën aktuale të tyre, dhe konsideronin se ishte jo e logjikshme, që një gjë e tillë të ndodhë në Spanjën bashkëkohore, kur dihej se ishte pranuar ekzistenca e nacionalitetit andaluzian dhe e drejta e lirisë fetare.

Më datën 2 janar, është përkujtimi i rënies (pushtimit) së Granadës në duart e dy mbretërve katolikë, prej ku mori fund edhe asgjësimi i shtetit të fundit islam të Andaluzisë. "Xhemati Islam në Andaluzi", vendosi që të organizojë një manifestim të kundërt, me atë që bënte shteti dhe kisha, duke synuar që t'i jepej fund ceremonive

përkujtimore për rënien ose pushtimin e Granadës, apo edhe për t'ua bërë me dije qytetarëve, të vërtetën rreth identitetit të vërtetë të Granadës⁵³. Për këtë, "Xhemati", e quajti manifestimin e vet të kundërt: "Vajtimi për Granadën".

Antarët e "Xhematit" bënë shpërndarjen e flamurit të Andaluzisë, nga pjesa e sipërme e kullës Komarish, në Pallatin e Kuq, ndërsa, me makinat e tyre dhe buritë e tyre, marshonin nëpër qytet, duke ju thënë qytetarëve: "Kjo ditë është ditë pikëllimi, nuk është ditë gëzimi! Më datën 02.01.1492, Granada u pushtua dhe nuk u çlirua më kurrë!

Shteti dhe kisha le t'i respektojnë shpirtërat e stërgjyshërve tanë, që ranë dëshmorë ! Le t'i respektojnë ata, që u flijuan për mbrojtjen e tokës andaluziane. Humbja e Granadës, është humbja e sovranitetit të Andaluzisë ! "Xhemati" organizoi një ceremoni festive, në sheshin "Pasio Di Luis Tristes" (Korridori i të pikëlluarëve). Në të morën pjesë me mijëra qytetarë të Granadës, (më shumë, se sa morën pjesë në ceremoninë zyrtare të shtetit dhe kishës). Aty ishin pjesëmarrës edhe mendimtarë andaluzianë, si muslimanë, gjithashtu edhe jomuslimanë, të cilët mbajtën referate rreth madhështisë së Andaluzisë Islame. Në mesin e pjesëmarrësve, ishin edhe disa artistë dhe shkrimtarë andaluzianë, siç ishte rasti i trupës artistike "Kornikos Granadinos" e Karlos Kano. Poetët e Granadës, me në krye me Huan Di Loshe, lexuan poezitë e tyre, në të cilat shenjtëronin Andaluzinë, po ashtu për pjesëmarrësit këndoi këngëtari i njohur, Bibi el Di la Tomasa.

Kjo ceremoni ishte një opozitë e madhe dhe e mirë në Andaluzi⁵⁴ dhe Spanjë, pasi që për herë të parë,

⁵³ "Granada Conmemoro el 492 Aniversario de la Toma de la Ciudad por los Reyes Catolicos", Diario de Granada, 03.01.1984.

⁵⁴ "Granada Conmemoro el 492 Aniversario de la Toma de la Ciudad por los Reyes Catolicos", Diario de Granada, 03.01.1984.

muslimanët andaluzianë i paraqitën haptazi ndjenjat e tyre.

"Xhemati" arriti të argumentojë aftësitë e tij, në paraqitjen dhe arsyetimin e ndjenjave nacionale andaluziane. "Xhemati", nëpërmjet këtij manifestimi islam opozitar, arriti deri tek koordinimi me disa organizata andaluziane të Granadës, siç ishte rasti me shoqatën "Solidariteti Andaluzian", shoqata e "Renesancës Popullore", dhe me një numër të madh të antarëve të "Partisë Nacionale të Andaluzisë".

"Xhemati Islam", me punën që bëri gjatë këtij viti, arriti që të organizojë ceremoni islame, në opozitë të ceremonive përkujtimore, që i organizonte kisha dhe shteti, me rastin e përvjetorëve të pushtimit dhe rënies së qyteteve të Andaluzisë në duart e krishtereve, si në Granadë, në Volbë, Kordovë, Sevilje, Mallagë dhe qytete të tjera andaluziane.

Më datën 14.03.1984, "Xhemati" organizoi një ceremoni kulturore në Sherish, ku morën pjesë një numër i madh i të kulturuarve të qytetit dhe qytetarë të thjeshtë. Aty, mori pjesë edhe trupa artistike andaluziane "Vëllezërit Kalinti", gjithashtu u mbajtën edhe disa ligjërata, që bënë të mundur njohjen historisë së qytetërimit islam dhe inkurajimin e qytetarëve që t'a mësojnë gjuhën arabe, gjuhën e stërgjyshërve të tyre⁵⁵. Ky aktivitet kulturor u shndërrua në një aktivitet serik në disa qytete andaluziane.

U vendos që konferenca të mbahet me 20 deri 22.07.1984 (që përputhet me muajin Sheval 1404h.) në Kolegjin "Emilio Monius" në qytezën "Kugvijus Biga" në mallet e Granadës. Xhemati i kishte ftuar të gjithë anëtarët e vet, si dhe përfaqësuesit e grupeve islame të Spanjës. I kishte ftuar edhe disa personalitete marokiene si; Prof. Muhamed El-Hilvv, babain e tij Haxhi Idris El-Hilvv, Sejidi Muhamed Bin El-Mekij El Vezani, pastaj nga

⁵⁵ Francisco Vigueras "Reconstruir Al-Andalus" Diario de Granada, 3.1.1984

lindja arabe Hoxhën Fuad El-khatib, zv/sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Konferencës Islame për atë kohë dhe familja e tij, Dr.Muhamed Muhamed Umer Xhemxhum, prezentoj edhe shkrimtari i librit, sikur që e gjejmë të ftuar dhe që prezentoj babai i shkrimtarit Hoxha Sejidi Muhamed El-Muntesir El-Kitani. Nga andalozianët morrën pjesë për afërsisht 200 musliman, të cilët kishin ardhur nga të gjitha anët e Andalozisë⁵⁶

Qendrimi ishte në Kolegjin e marrë me qira përgjatë tërë kohës së Konferencës (Samitit). Aty ishte gjumi, ushqimi dhe falja e pesë kohëve të namazit. Konferenca u hap me leximin e Kur'anit, u pasua me hymnin kombëtar andalozian e pastaj të gjithë lexuan suren El-Fatiha për shpirtërat e dëshmorëve andalozian të cilët e humbën jetën e tyre përgjat shekujve duke mbrojtur Islamin në Andalози. Gjatë tri ditëve sa zgjati samiti u mbajtën një sërë ligjeratash. Ligjeruesit ishin mendimtar të ndryshëm nga Andalozia dhe jashtë saj.Ligjerata ishin të përqendruara rreth parimeve dhe mendimit islam, siç ishin temat: “Bindja Islame”, “Islami dhe çlirimi i popujve”, “Namazi: forma apo mënyra e tij dhe kuptimi”, “Cionizmi dhe Palestina”, “Rezistenca andaloziane”, dhe tema të tjera. Njëri nga organizatorët e konferencës i'u drejtua gazetarëve me këto fjalë :”Ne nuk jemi ishull fetarë në këtë tokë! Islami ynë është gjallë! Obligimi ynë është që të hyjmë në shoqërinë andaloziane dhe ta bindim masën. Islami merr frymë në këto troje dhe do të përhapet derisa të bëhet masiv sikur që ka qenë në të kaluarën.”⁵⁷

Samiti “Kugvijus Biga” ishte pikënisje e rëndësishme në historinë e “Xhematit islam në Andalози”. Pas këtij samiti “Xhemati”vendosi që të mbajë një takim të

⁵⁶ “Un Grupo Islamico:La Otra Cara de la Toma”El Defensor, 03.01.1984

⁵⁷ “Presentacion de la Comunidad Musulmana Al-Andalus” Diario de Cadiz, 15.05.1984

përgjithshëm për ta përcaktuar strategjinë e ardhmërisë së tij.

Ja kështu brenda dy viteve numri i anëtarëve të "Xhematit islam në Andalozi " arriti në afër pesë qind, që kanë filialat ose degët e tyre në shtatë qytete andaloziane; Sevilja, Granda, Sherish, Malaga, Kordova, Vulbe dhe Dhikvan. Muslimanët e Andalozisë në këtë mënyrë filluan ta shikojnë ardhmërinë dhe perspektivën e tyre me shumë optimizëm. Një gjë e till u paraqit në takimin e mbajtur me titull "Shoqatat Islame dhe perendimi" që u mbajtë në Sevilja gjatë kohës prej 10 deri 12 shtator 1984.

Rikthimi nga sëmundja e rëndë dhe nisma e re

Aktivitetet e "Xhematit Islam në Andaluzi", gjatë dy viteve 1983-1984, i mundësuan atij reputacion, brenda dhe jashtë Spanjës, gjë që shtoi xhelozitë të shumë nga shoqatat e vjetra islame, të cilat filluan t'a sulmojnë dhe të shkruajnë raporte negative nëpër ambasadat e shteteve islame. "Xhemati Islam i Seviljes", publikoi disa artikuj në gazetatat ditore, ku e sulmoi "Xhematin", e sidomos pas përkujtimit të El-Muatemid bin Ibad-it.

Ndikimi i disa qarqeve islame joandaluziane, bëri që të shkaktohen përçarje të mëdha brenda përbrenda "Xhematit". Ndërsa, përse i përket presionit të jashtëm, "Xhemati" vendosi që mos t'u përgjigjej sulmeve të shoqatave, për t'a ruajtur vëllazërinë islame, pa marrë parasysh qëndrimin e të tjerëve. Sa i përket përçarjes së brendshme, nuk u gjet zgjidhje.

Në fund të shtatorit të vitit 1984, "Xhemati" mbajti mbledhjen e përgjithshme, në selinë kryesore në Sevilje, për planifikimin e perspektivës, dhe forcimin e organizmit. Në mbledhje u paraqit një përçarje e rrezikshme rrënjësore, në mes dy palëve të "Xhematit".

Pala e parë, e kryesuar nga Xhabir Bilar Khil, kryetar i kuvendit të "Xhematit" në atë kohë, barte me vete idenë për organizimin piramidal, me deklaratën e tij se, organizimi i "Xhematit" i ngritur mbi bazat e "konsultës" "shura", nuk është organizim islam, por imitim i organizimit demokratik perëndimor. Xhabir propozoi që të bëhet "betimi", "besatimi për emirin" princin e Xhematit, me kërkesën që të konsultohet me të tjerët për zgjidhjen dhe udhëheqjen e çështjeve, dhe që të emërojnë për aktivitetet e ndryshme nga një "emir përgjegjës", sipas aftësive dhe devotshmërisë.

Ndërsa pala e dytë: e udhëhequr nga Abdurrahman Medina Molise, dëshiroi që t'a ruajë organizimin e vjetër të "Xhematit" dhe forcimin e lidhjeve me faktorët aktivë në shoqërinë andaluziane.

Secila palë, ishte këmbëngulese në mendimin e vet, dhe që të dyja këmbyen akuza ndaj njëra tjetrës, se ka dalë jashtë shpirtit islam.

Për të ruajtur unitetin e radhëve, u ra dakord që antarët e "Xhematit" të dalin në referendum. Kur u mbajt referendumi, i cili e mbështeti më shumë palën e dytë, pala e parë refuzoi që t'i pranojë votat e grave muslimane, gjë që shkaktoi përçarje të plotë: kjo përçarje ishte një kataklizmë (katastrofë) e vërtetë për "Xhematin". Ata, që u besatuan për Xhabir Bilar-in, si princ të tyre (emir), u ndanë dhe u organizuan me emrin "Xhemati i Andaluzisë Islame", ndërsa pjesa tjetër, u kthye në emrin e vjetër "Xhemati Islam në Andaluzi".

Këta të fundit u përqëndruan në organizimin horizontal, në krijimin e këshillave nëpër regjione, në krijimin e kuvendit ose këshillit të përgjithshëm të "Xhematit", zgjedhjen e kryetarit të këshillit ose kuvendit, i cili nuk do të kishte me shumë autoritet, se sa koordinimin e mbledhjeve dhe menaxhimin.

Përçarjen e ndoqi beteja për t'i nënshtuar qendrat e ndryshme, gjë kjo, që shkaktoi përçarje të jashtëzakonshme, në mesin e pjestarëve të "Xhematit".

Edhe pse numri i anëtarëve kishte arritur përafërsisht në pesëqind, xhematet e Dhekuanit, Vulbes dhe Kordovës, u përçanë dhe i mbyllën qendrat e tyre. Ndërsa, nga katër qendrat e tjera që mbetën, qendra e Granadës dhe Sherishit u bashkuan me Xhabirin, ndërsa ajo e Seviljes dhe e Mallagës u bashkuan me Abdurrahmanin.

Numri i pjestarëve të katër qëndrave, zbriti në gjysmën e numrit, që kishin para përçarjes. Kështu, viti 1984, përfundoi në mënyrë katastrofike, për sa i përket organizimit të muslimanëve andaluzianë. Sa i përket "Xhematit të Andaluzisë Islame", që i përkiste Xhabirit, ditë pas dite, numri i anëtarëve u pakësua aq shumë, sa që u detyruan t'a mbyllnin qendrën e tyre në Sherish. Ky grup, mbeti vetëm në Granadë, edhe përkundër asaj, se numri i anëtarëve kishte mbetur shumë i vogël. Por, nuk vonoi shumë dhe u mbyll edhe qendra e Granadës.

Kurse, sa i përket "Xhematit Islam në Andaluzi", ai filloi një nismë të re me një hov dhe organizim edhe më të mirë, politikë me të qartë, përvojë me të madhe, dëshirë të flaktë që t'a ruajë shtegun islam dhe andaluzian, përpjekje për pavarësim të plotë të "Xhematit" nga influencat e huaja. Pastaj, filloi të punojë rishtazi në ndërtimin e bazës së saj, duke i shtuar aktivitetet në fusha të ndryshme, për thirrje në Islam.

Mes datave 19-21 janar 1985, "Xhemati Islam në Andaluzi", vendosi që të organizojë "Samitin e Parë botëror për Muslimanët Evropianë", në Sevilje, me qëllim që të krijoheshin lidhje mes muslimanëve evropianë, për të studiuar rolin e fesë islame në ardhmërinë e Evropës, shndërrimin e Andaluzisë në qendër të rrezatimit islam për të gjithë kontinentin e Evropës dhe mbështetjen e renesancës islame në Evropë, nga vetë evropianët. "Xhemati" formoi komisionin organizativ të konferencës dhe dërgoi delegacione në anë të ndryshme të Evropës, për të kontaktuar me personalitete dhe shoqata islame lokale, që t'ua sqarojnë atyre synimet e konferencës dhe t'i ftojnë për pjesëmarrje në të.

Prej momentit, që u përhap lajmi për mbajtjen e Samitit, filloi organizimi i fushatës kundër "Xhematit" dhe disa personaliteteve të dalluara, nga disa qendra islame zyrtare, në Evropë dhe nga disa shoqata islame, në Spanjë.

Ata dërguan shkresa në të gjitha qendrat islame në Evropë, për t'a njollosur imazhin e "Xhematit" dhe synimet e tij. Fushatë kundër "Xhematit", bënë edhe armiqhtë e Islamit në Spanjë, me qëllim që të dështojë samiti dhe të shpërbëhet "Xhemati".

Fushata arriti kulmin, aq sa, disa nga gazetatat ditore antiislame të Spanjës botuan artikuj, në të cilët i frikësuan spanjollët prej muslimanëve të Andaluzisë dhe i akuzonin ata, se po përpiqen të "rikthejnë pushtetin" e Spanjës në emër të Islamit. Në mesin e këtyre artikujve, ishte edhe ai, që shkroi Huan Enriko Gomez, në revistën "Tiempo", me titull "Grupet islame spanjolle po përparojnë për sulme të reja"⁵⁸.

Artikulli fillon me këtë hyrje: "Në Spanjë veprojnë legalisht disa organizata islame, që pretendojnë, nëpërmjet synimeve të tyre, ripushtimin e Spanjës, dhe thirrjen e popullit spanjoll, që të jetojë nën simbolet islame".

Në të njëjtën kohë, opinionioni publik evropian i shqetësuar, po ballafaqohej me një valë të ashpër të operacioneve terroriste, për të cilat akuzoheshin grupe ekstreme islame. Artikulli përfshiu edhe deklaratën e Xhabir Bilarit, për daljen jashtë kornizës së tij, për argumentimin e ideve të veta. Megjithatë, "Xhemati", vendosi që të vazhdojë organizimin e Samitit dhe mos t'u përgjigjet sulmeve. Me datën 9 qershor 1985, gazeta "Diario-16", në faqet e para, me shkronja kapitale, paraqiti një artikull të rrejshëm, me titull: "Zbulimi i rrjetit të spiunazhit maroken në jug të Spanjës"⁵⁹. Gazeta

⁵⁸ Juan Enrique Gomez, "Los Grupos Islamicos Espanoles Preparan ya La Reconquista", Tiempo, 27.05.1985.

⁵⁹ Alvaro Vega, "Marruecos esta Estructurando una Red de Espionaje sobre el Sur de Espana", Diario-16, 19.06.1985.

pretendon, se gjoja shërbimi sekret spanjoll, ka zbuluar një rrjet, që kryesohet nga Abdurrahman Medina, i ndihmuar nga sekretari dhe miku i tij Muhamed El-hilw, e pastaj vazhdon me disa gënjeshtër. Gazeta vazhdoi fushatën e vet, në faqen e parë, për afërsisht një javë.⁶⁰

Kësaj fushate, iu bashkangjijt edhe "Xhemati Islam i Seviljes"⁶¹. Gazetat spanjolle i përsëritën akuzat e "Diario-16"⁶². Qëllimi ishte që kjo fushatë të rezultojë në disa aspekte.

1. Shpërthimi i përçarjes mes shoqatave islame në Spanjë

2. Frikësimi i donatorëve dhe përkrahësve të "Xhematit Islam në Andaluzi"

3. Shkatërrimi e imazhit të "Xhematit" në shoqërinë andaluziane dhe, së fundi, mbjellja e përçarjes midis pjestarëve të "Xhematit".

"Xhemati" iu përgjigj kësaj fushate me përgënjeshtër⁶³ dhe me kundërfushatë gazetareske. "Diario-16" u detyrua t'i publikojë përgjigjet e "Xhematit"⁶⁴, në të cilat përgjigjej Abdurrahman Medina. Ai shkruante: "Unë kam bindjen se egziston një fushatë antiislame nga qarqe cioniste, brenda partisë socialiste punëtore të Spanjës (në pushtet), dhe në ndjekjen e ligjit". Gjithashtu, shkrimtari i gazetës së përmendur, ishte i detyruar nëpërmjet avokatit në Sevilje, që t'i publikojë

⁶⁰ Alvaro Vega, "El Principal Responsable, el Abogado Lahlou Tiene Acceso Al Monarca, Hassan II", Diario-16, 10.06.1985.

⁶¹ Musulmanes Sevillanos Confirman que Hay una Red Andaluza de Espias Marroquies", Diario-16, 10.06.1985.

⁶² Ignacio Romero de Solis, "Ahora, una de Espias" ABC, 11.06.1985.

⁶³ "Antonio Medina Niega Cualquier Tipo de Relacion", Diario-16, 10.06.1985.

⁶⁴ Manuel Prados, "Abderrahman Medina Asegura que no Es un Espia de Marruecos", Diario de Granda, 11.06.1985. "Creo Que Hay una Ofensiva de Sectores Sionistas de PSOE Contra El-Islam", Diario-16, 17.06.1985.

gënjeshttrat dhe dezinformatat, të cilat janë publikuar⁶⁵. Edhe përkundër përfundimit të fushatës me dështim, disa shoqata islame, të humbura vazhduan fushatën e tyre kundër "Xhematit", në gazetatat spanjolle⁶⁶. Njëra nga këto shoqata, i dërgoi një letër ministrit të kulturës, në qeverinë lokale të Andaluzisë, në të cilën kërkoi që të mos t'i ofrojë ndihmë zyrtare 'Samitit Islam Evropian' - "i cili është organizuar në mënyrë kuturu, dhe i cili do të mbahet në emër të Islamit nga persona jomuslimanë, nga njerëz që nuk i njohim fare, dhe pa kurrfarë përpjekje ose këshillime me komunitetin e përqendruar në vendin tonë". "Xhemati" vendosi që edhe këtij provokimi mos t'i përgjigjet.

"Xhemati" refuzoi t'i përgjigjej cilësdo shoqatë islame, nga kujdesi që mos të binte në provokim të ndonjë plani të armikut të muslimanëve, të cilët tentojnë që të ndezin zjarrin e përcarjes, në mes muslimanëve. Edhe përkundër kësaj atmosfere të elektrizuar, "Xhemati" vazhdoi me organizimin e "Samitit të Parë Ndërkombëtar të Muslimanëve të Evropës".

Më datën 19.07.1985, Samiti filloi punimet në hotelin "Makarina", njëri ndër hotelet më të mëdhenj në Sevilja, nën kujdesin e policisë. Në Samit morën pjesë, për afërsisht njëqind personalitete islame, nga të gjitha anët e Andaluzisë dhe jashtë saj, nga anë të ndryshme të Evropës, si nga: Portugalia, Franca, Italia, Gjermania, Britania, Qiproja, etj. Kishte edhe nga shtetet joevropiane, nga shtetet arabe dhe Meksika. Nga vendet arabe ishte Dr. Abdullah Umer Nasif, hoxha Muhamed Awini, etj.

Në Samit morën pjesë edhe personalitete publike të Andaluzisë, deputetë të parlamentit andaluzian dhe të tjerë. Në mesin e tyre ishte Diego di Luis Santos, kryetar i Partisë Nacionale të Andalozisë, Luis Ornella, ish prefekti

⁶⁵ "Ali Kettani y Muhammad Lahhlou Rectifican", Diario-16, 31.07.1985.

⁶⁶ "Comunidad Islamica de Espana Advierte a la Junta sobre la Conducta de Medina", Diario-16, 13.07.1985.

i Seviljes, Muhamed Ilonanis, ministër i kulturës në qeverinë lokale të Andaluzisë. Kryesia e Samitit, pranoi edhe një numër telegramesh urimi dhe mbështetjeje për organizimin e këtij Samiti. Telegram urimi kishte dërguar Hulo Angita, prefekti i Kordovës, Pedro Rovez Perdizo, nënkryetar i "Fondit Pelas Anfant" dhe të tjerë. Samitin e pasqyruan edhe gazetatat spanjolle, televizioni dhe radiot.

Në Samit u ligjëruan këto tema: 'Studime rreth situatës aktuale të muslimanëve evropianë', 'Islami dhe Europa', 'Domosdoshmeria e formimit të një organizate botërore për muslimanët evropianë', 'Sheriati dhe normat edukative islame në shoqëritë industriale dhe teknologjike', 'Projektet për muslimanët evropianë', 'Panairi i vitit 1982 në Sevilje', 'Shkollat juridike islame dhe roli i tyre në arritjen e Islamit në Evropë', etj.

Samiti propozoi Rozhe Garodin për kryetar të tij, po ashtu u morën vendime të rëndësishme për përkrahjen e muslimanëve bullgarë. U pranua ftesa e Qipros (turke) që Samiti i Dytë të mbahej në Magusha, që të hapej qendra në Kordovë, që të koordinohet puna mes muslimanëve evropianë, që të formohet federata e tyre dhe të mbahen takime çdo tre vjet⁶⁷.

"Xhemati", pas suksesit që pati në organizimin e "Samitit të Parë Botëror Islam Evropian", vendosi që t'a rifillojë zgjerimin e vet, pasi nuk i kishin mbetur veçse dy qendra, ajo e Mallagës dhe e Seviljes.

Në muajin shtator 1985, u rihap qendra islame në Sherish (regjioni i Kadis-it), në ngushticën e Kampanjës, pastaj u punua për blerjen e një shtëpie në Kordovë dhe për kthimin e saj, në një qendër islame.

"Xhemati", më pas, vazhdoi të organizojë, për çdo vit, ceremoninë përkujtimore të "El-Muatemid bin Ibad "-it në Seviljë. Më datën 13.10.1985, "Xhemati" organizoi një piknik kulturor me anije, përgjatë bregdetit të madh të

⁶⁷ Manana , I kongreso Internacional de Musulmanes Europeos, "El Correro de Andalucia", 18.07.1985.

Seviljes, deri te Shiloka. Në këtë udhëtim, morën pjesë përafërsisht 200 persona, në mesin e të cilëve, përveç muslimanëve andaluzianë, ishin pjesëmarrës edhe gazetarë të njohur. Pikniku u mbyll me darkën, nikoqir i së cilës ishte Komuna e Shilokut.

Ditën e hënë, u organizua një ceremoni festive, në sheshin "Altevazino", në Toriano, me ndihmën e kuvendit komunal. Aty u lexuan poezi, nga shkrimtarët andaluzianë. Në ceremoninë festive morën pjesë, jo më pak se katër mijë persona⁶⁸, sa që gazetatat, për këtë shkak, e quajtën prefektin e Torianos 'Halifeja i Torianos'. Edhe kësaj radhe, armiqtë e muslimanëve nuk u ndalën nga sulmet kundër "Xhematit", duke akuzuar "Xhematin" se po e shfrytëzonte përvjetorin e "El Muatamid bin Ibad"-it, për thirrje islame⁶⁹.

Nga rezultatet e "Konferencës se Parë Botërore Islame Evropiane" dhe ngjarjeve të mëparëshme, "Xhemati Islam në Andaluzi", filloi të mendojë që të kalojë në aktivitete të larmishme, në fusha të ndryshme dhe të formojë aparate të posaçme, për secilën fushë ose lëmi. Si për shembull, për lëmin kulturor, "Xhemati" formoi "Wakfija Islame dhe Andaluzia", të cilën qeveria lokale e Andaluzisë e njohu zyrtarisht, si institucion, që punon për interesat e përgjithshme.

Nga rezultatet e tjera të "Samitit", gjithashtu ishte bindja e krijuar te "Xhemati", që patjetër duhej të punohej politikisht, që publiku andaluzian t'a njohë historinë e vetë islame, si diçka të veçantë, dhe që për këtë, të shfrytëzohen mundësitë politike⁷⁰.

Më datën, 29 nëntor 1985, pas kontakteve në tërë Andaluzinë dhe territoret e tjera spanjolle, u regjistrua

⁶⁸ Jose Maria Gomez, "El Califa de Triana", El Correo de Andalucia, 16.10.1985

⁶⁹ Fauto Botello, "Pobre Almotamid", El Correo de Andalucia, 17.10.1985.

⁷⁰ Guillermo Lopez-Vera, "La Comunidad Islamica Perpara un Partido Politico", El Diario de la Costa del Sol, 30.11.1985.

"Partia për Çlirimin e Andaluzisë", si organizatë politike, e cila shprehte mendimet e muslimanëve të Andaluzisë, dhe deklaronte se populli andaluzian është popull autonom, ka civilizimin e vet (islam), gjuhën e vetë të posaçme (arabe), dhe partia vendosi që në zgjedhjet lokale dhe evropaine, të dalë me kandidatët e vet⁷¹.

Viti 1985 përfundoi, e "Xhemati" e harroi sëmundjen shkatërruese të vitit 1984, dhe kështu filloi një nismë të re, në të gjitha fushat. Në vitin 1986, filloi përplasja e "Xhematit" me Rozhe Garodin.

Projekti i filozofit musliman francez ishte: Dialog në mes civilizimeve, e nuk i interesonte "Xhemati Islam në Andaluzi", dhe ky i fundit kishte bindjen se ai e kishte shfrytëzuar "Samitin e Parë Botëror për Muslimanët e Evropës", që të përqëndrohej vëmendja rreth prezencës së tij në Kordovë, prandaj edhe më pas ai kaloi dhe vizitoi shtetet arabe, për të grumbulluar të ardhura për "Universitetin Islam të Kordovës"⁷², me të cilat, në fund të udhëtimit, themeloi Muzeumin për dialog në mes civilizimeve, ndërsa, në anën tjetër, "Xhemati", kishte punuar që të themelonte Qendrën Islame, rreth së cilës, do t'i mbledhte muslimanët e përçarë të Kordovës, pastaj t'a shndërronte Kordovën, në një qendër të rëndësishme për rrezatimin e Islamit në Andaluzi dhe Evropë. Megjithatë, "Xhemati" vendosi që t'a ndihmojë Rozhe Garodin në projektin e tij, me dëshirën që të forcohej vëllazëria islame me të⁷³.

Në mars 1986, "Xhemati" bleu një shtëpi të vjetër në Kordovë, në rrugën Rio Hridja, afër Xhamisë Madhështore, e ndarë nga rruga 'Xhamia e Kadiut "Ebu Othman", dhe e shndërroi në Qendër Islame, pas

⁷¹ Alfredo Valenzuela, "Los Musulmanes Quieren Tener Representacion en el Parlamento Europeo", El Pais, 23.07.1985.

⁷² Merzuk Hilal, "Liga Islame në Kordovë, njëri nga vendet e kështjellave të Andaluzisë", Gazeta El-Akhbar, 31.02.1986.

⁷³ "Cordoba Sera Sede de la Futura Union Internacional de Musulmanes Europeos", Cordoba, 26.05.1986.

rinovimeve të domosdoshme. Pas rinovimit, kjo qendër insistoi në një program të posaçëm, për thirrje islame, në Kordovë.

Në korrik të vitit 1986, "Xhemati" hapi qendrën e gjashtë islame në Morsei.

Në fund të vitit, "Xhemati" arriti të ketë gjashtë qendra islame, në pesë regjione të ndryshme, Sevilja, Dos, Hormanas, Sherish, Mallaga, Kordovë dhe Morsei.

Ditën e dielë, më 22 qershor 1986, "Partia për Çlirimin e Andaluzisë", mori pjesë në zgjedhjet parlamentare të Andaluzisë, duke kërkuar çlirimin, pavarësimin e saj, njohjen e gjuhës arabe si gjuhë të saj, zbatimin e marrëveshjes kur u pushtua Granada, në vitin 1492, dokumenti i vetëm ligjor, i cili argumenton bashkangjitjen jologjore të Andaluzisë me Spanjën⁷⁴, dhe kthimin e emigrantëve andaluzianë⁷⁵.

"Partia" paraqiti njëqind kandidatë, në secilin regjion të Andaluzisë, ndër të cilët më të rëndësishmit ishin: Aishe Hormozin Zi Vrano në Almorie, Huan Pedro Rinkon Gujardo në Kadisë, Abdurrahman Medina Moler në Kordovë, Ismail Horkira Amoris në Granadë, Merjem Parias Lahoz në Vulbe, Almensur Perez Kalfanti në Gjion, Jaser Kaldrondias në Mallagë, Almuatamid Sançez Kastianoz në Sevilje.

Zgjedhjet parlamentare rezultuan me fitoren e 109 deputetëve, prej tyre: 60 Partia Socialiste Punëtore të Spanjës, 28 Aleanca Popullore (djathtiste), 2 Partia Nacionale e Andaluzisë, shtatë partitë e tjera nuk arritën të fitojnë asnjë vend në parlament.

"Partia për Çlirimin e Andaluzisë" fitoi 5.683 vota, ose 0.17% të votave.

⁷⁴ "Los Musulmanes Quieren que Se Cumplan Las Capitulaciones", El Dia de Granada, 05.06.1986.

⁷⁵ "Liberacion Andaluza Exige la vVuelta de Los Exiliados de Al-Andalus", El Correode Andalucia, 03.06.1986.

Partia më e afërt me idetë e "Xhematit Islam", ishte "Partia Nacionale e Andaluzisë", e cila nuk fitoi veçse dy ulëse, siç e theksuam më lart, për shkak të gabimit politik, që bëri (siç e kemi vërejtur) me rastin e themelimit të Krahinës Autonome të Andaluzisë. U paraqit dobësi e madhe, ishte mundur që të humbej rasti për formimin e Andaluzisë, në kohën kur Partia socialiste punëtore e Spanjës, e përkrahte parimin e autonomisë për Andaluzinë dhe përpiquej për hir të këtij parimi.

Partia Socialiste Punëtore e Spanjës, e ruajti pozicionin e vet, dhe në zgjedhjet e vitit 1990 arriti të fitojë 61 vende, Partia Popullore (djathtiste) 27 vende, Unioni Majtist (komunistët) 11 vende, ndërsa numri i vendeve për Partinë Nacionale të Andaluzisë, u rrit në 10 vende.

Kthimi në Kordovë

Kisha katolike vendosi që t'a caktojë vitin 1986, si vit të përkujtimit të 1.200 vjetorit, të themelimit të Xhamisë Madhështore të Kordovës. Për këtë, organizoi një ceremoni përkujtimore festive, në të cilën morën pjesë autoritete të ndryshme kulturore. "Xhemati", me këtë rast vendosi që të mbajë një Samit me titull "Islami - planprogrami i jetës", me qëllim që t'i njohë të tjerët, me Qendrën Islame të Kordovës dhe me qëllim që të merrej pjesë në përvjetorin përkujtimor të ndërtimit të Xhamisë së Madhe sipas modelit islam, duke e konsideruar si fillim të nismës së re islame, në kryeqytetin e halifatit islam të Andaluzisë.

Samiti u mbajt gjatë periudhës kohore prej 05-07 dhjetor 1986, në njërën nga sallat e pallatit të halifatit, që gjendet afër Xhamisë Madhështore, ndërsa të ushqyerit e pjesëmarrësve të Samitit, u bë vazhdimisht në Qendrën Islame.

Në Samit morën pjesë, përafërsisht 150 personalitete, nga Andaluzia dhe jashtë saj, prej tyre vetë autori (i

këtij libri), pastaj Prof. Muhamed El-Hilv nga Maroku, Dr. Muhamed Umer Xhemxhum nga Xhedja e Arabisë Saudite, Hoxha El-Habib bin El-Huxha, ish muftiu i Tunizisë, i cili u zgjodh kryetar i Samitit, Prof. Muhamed Alvizani nga Tatvani dhe të tjerë⁷⁶.

Samiti u hap me namazin e xhumasë (05.12) në Qendrën Islame, pasoi dreka e pastaj ligjërata rreth "Metodave të thirrjes Islame në Andaluzi" e shkrimtarit, pastaj ligjërata "Islami - planprogrami i jetës në Perëndim" e avokatit musliman andaluzian Ismail Horkira, pas kësaj ligjërate u formuan komisionet:

- Komisioni i Thirrjes Islame dhe
- Arsimit dhe Komisioni për Çështje Financiare dhe Metoda.

Dita e shtunë u rezervua, posaçërisht, për ligjërata, në të cilën ligjëruan ligjërues nga vendet arabe, siç ishin: Hoxha El-Habib bin El-Huxha nga Tunizia, Ibni Kuzman Albaluti nga Andaluzia, Aishe Moxhun nga Franca, dhe të tjerë. Samiti u mbyll ditën e dielë (07.12), me aprovimin e konkluzioneve dhe me mbledhjen e ngushtë të "Xhematit" në prezencë të mysafirëve joandaluzianë.

Samiti i Kordovës, pati sukses edhe përkundër sulmeve të zakonshme të gazetës "Diario-16"⁷⁷, dhe artikullit qëllimkeq, që publikoi revista "Kambio" nën titullin frikësues "Islami po na hyn brenda"⁷⁸. Nga vendimet më të rëndësishme të "Xhematit", pas Samitit ishte që t'a shpallte Kordovën kryeqendër për "Xhematin Islam në Andaluzi", në vend të Seviljes, kjo edhe përkundër asaj, se

⁷⁶ "Los Musulmanes Celebran en Cordoba el XII Centenario de la Mezquita", Cordoba, 06.12.1986.

⁷⁷ Sebastian Cuevas, "Servicios de Informacion han Vigilado el Congreso Islamico que Hoy Concluye", Diario-16, 07.12.1986.

⁷⁸ Sebastian Cuevas, "Servicios de Informacion han Vigilado el Congreso Islamico que Hoy Concluye", Diario-16, 07.12.1986.

Qendra Islame në Sevilje, mbeti qendra më e madhe islame e "Xhemat"-it dhe se kishte më shumë anëtarë dhe më shumë aktivitete.

Më datën 12 deri 15 shkurt 1987, Rozhe Garodi shpalli të hapur "Takimin botëror Ibrahimij", në muzeun të cilin e kishte ngritur në "Kështjellën e Lirisë (Liberta)", Kështjellën Islame në bregun e Luginës së Madhe në Kordovë, të cilën ia kishte ofruar komuna për këtë qëllim. Takimi, ose thënë Samiti, nuk i kishte ftuar fare anëtarët e "Xhematit", për të marrë pjesë, e as që ata kishin dhënë ndonjë kontribut për këtë projekt, e në mesin e tyre nuk e kishin ftuar as drejtorin Abdurrahman Medina Molire. "Xhemati" vendosi që t'a ndjekë me kujdes ndikimin e fshehtë të këtij projekti, i cili u formua me pasuritë e muslimanëve, ashtu që mos të humbin përfundimisht⁷⁹.

Pas takimit të Kordovës, "Xhemati" e korigjoi programin e vet arsimor. Gjatë së kaluarës, ata kishin qenë shumë të kujdesshëm, që të lehtësohej arsimimi islam i pjesëtarëve të vet, për këtë kishin ngritur shkolla islame në të gjitha qendrat islame, dhe kishin punësuar aty, profesorë nga Maroku.

Mirëpo, "Xhemati" nuk ishte i kënaqur me rezultatet e kësaj prove, sepse profesorët kishin shumë pak njohuri për thirrjen islame dhe, në të njëjtën kohë, nuk e njihnin gjuhën spanjolle aq sa duhet, prandaj vendosën që të dërgojnë delegacione nga të rinjtë e vet, në vendet islame, që të formohen kuadrot andaluziane. Për këtë, u arrit një marrëveshje, e cila u nënshkrua në mes "Xhematit" dhe Rrabitas (Ligës së Botës Islame), në Mekken e nderuar, për dërgimin e një grupi të rinjsh andaluzianë, në muajin e Ramazanit, të vitit 1404 Hënor (Hixhret), (që përputhet me muajin maj 1987), në vatrën e shenjtë, për të ndjekur një seminar intensiv trajnues në shkencat islame, për t'i kryer ritet e Umres dhe për të vizituar xhaminë e të Dërguarit (*paqa dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*).

⁷⁹ "Projekti Garodi në Kordova meriton përkrahje", El-Shark El-Ewsat, 07.03.1987.

Seminari do të organizohej nën patronazhin dhe shpenzimet e Ligës së Botës Islame. Për këtë u solidarizuan vullnetarë një numër i profesorëve të Universitetit "Al-Melik Abdul-Aziz", në Xhidde. U planifikuan mësimet, ligjëratat dhe vetë autori i këtij libri e kryesoi grupin e mësimdhënësve, si njëri nga vullnetarët⁸⁰.

Në këtë delegacion, ishin pjesëmarrës edhe pesë mësues të "Xhematit", prej tyre edhe Abdurrahman Habsawi, gruaja e tij Rrashide Kurum (e cila ishte gjithashtu mësuese), Abduselam Asrih, Muhamed El-Wezani, Ahmed Kamkum, ndërsa, nga të rinjtë andaluzianë, pjesëmarrës ishin: Ebu Jaser Rina Andaredi, Abdulaziz Garsia Fernandez, Mensur Perez Kalbinti, Jusuf Alhabib Figras Roldan, Arafat Baria Barira. Në fund të këtij seminari trajnues, secili u shpërblye me nga një diplomë.

Seminari ishte i suksesshëm, ndikimi i tij vazhdoi të qëndrojë me andaluzianët dhe të reflektohet në jetën e tyre islame, e sidomos atmosfera e muajit të madhërishëm të Ramazanit në vendet e shejta, la gjurmë të pashlyera: gjatë ditës pasonin mësimet, gjatë natës adhurimi, prandaj ndikimi tek ta ishte shumë i madh.

Më datën 10 maj 1987, "Partia Çlirimtare Andaluziane", mori pjesë në zgjedhjet lokale në Andaluzi⁸¹, ku fitoi tre vende në Asamblenë e qytetit 'Ishulli i Gjellbërt', nga 24 vende sa numëronte Asambleja, Partia Socialiste Punëtore e Spanjës i fitoi 13 vende, Aleanca Popullore 4 vende, Unioni Majtist (komunist) 2 vende, Partia e Mesme Socialdemokrate 2 vende.

Ishulli i Gjellbërt, është qyteti në ngushticën Xhebelu Tarik (Gjibraltar), regjioni Kades, numri i banorëve, të të cilit, arrin mbi njëqind mijë. Përfaqësuesit e "Partisë

⁸⁰ "Seminari trajnues intensiv në historinë dhe shkencat Islame", gazeta El-Medine e datës 27.06.1987.

⁸¹ "El Ex Alcalde Francisco Esteban Encabeza la Lista de Liberacion Andaluza'Candidatura por Algeciras", Diario Sur, 02.05.1987.

Çlirimtare Andaluziane", që fituan në zgjedhje ishin: Enver Istiban Baoca, prefekti i Ishullit të Gjellbërt, pastaj Alfonso Artega dhe Silvio Alonso. Në këtë mënyrë, "Partia Çlirimtare Andaluziane" argumentoi se ka aftësi, që kandidatët e vetë, të marrin vende në Asamblenë Komunale. Pas këtij suksesi, "Xhemati" vendosi që të hapë një Qendër Islame në Ishullin e Gjellbërt, pasi e kishte mbyllur qendrën e vet në Dos Hormonas, për shkak të distancës së afërt me Seviljen, dhe që të menaxhoheshin më mirë shpenzimet.

Edhe më tej, "Xhemati" vazhdoi t'i ketë gjashtë qendra, në qytetet si vijon: Sevilje, Kordovë, Sherish, Mallaga, Morsia dhe Ishulli i Gjellbërt.

Më pas, "Partia Çlirimtare e Andaluzisë", tentoi që të merrte pjesë në zgjedhjet regjionale të Ister Madora-s, në krahinën Batlios, duke kërkuar bashkangjitjen e regjionit të Morsei-t me regjionin e Andaluzisë⁸², por nuk u lejua që të marrë pjesë në zgjedhje, me argumentimin se kandidatët nuk janë banorë të krahinës⁸³. "Partia" paraqiti ankesën për Komisionin zgjedhor të krahinës së Batlios, në Gjykatën Legjislative, e cila e konfirmoi vendimin e Komisionit Zgjedhor⁸⁴.

Me datën 10 korrik 1987, "Partia" konkuroi në zgjedhjet parlamentare evropiane, duke deklaruar se "Europianizmi", si duket anon nga racizmi, dhe shkëputja e popujve evropianë nga popujt e tjerë fqinjë, sidomos nga shkëputja e popullit të Andaluzisë nga popujt fqinjë muslimanë⁸⁵.

⁸² "Liberacion Andaluza Quiere la Fusion de Badajoz y Murcia en Andalucia", Correo de Andalucia, 07.05.1987.

⁸³ "Rechazaba La Candidature de liberacion Andaluza en badajoz", Hoy de Badajoz, 12.05.1987.

⁸⁴ "Liberacion Andaluza Volvio a Recurrir", Diario de Extremadura, 19.05.1987.

⁸⁵ "Liberacion Andaluza Considera que el Europeismo es una concepcion Nefasta de la Vida", Diario, 28.05.1987.

Partia Çlirimtare e Andalozisë arriti t'i fitojë 9.881 vota, prej tyre 3.533 në Andaluzi, 2.081 në Katalonia, 1.232 në Belnesia, 2.935 në territoret e Spanjës.

Këto rezultate argumentuan qartë se, idetë islame janë të pranueshme në shoqërinë andaluziane dhe përkrahen prej saj. Edhe përkundër mundësive të kufizuara, "Xhemati" vazhdoi me aktivitete kulturore dhe publicistike. Që nga qershori 1987, u publikua pamfleti publicistik "Thirrja", në mesin e antarëve. Gjatë datës 28-29 qershor 1987, një delegacion i "Xhematit" organizoi "Qëndrim të qetë", një kohë të gjatë, para dyerve të Xhamisë së Madhe të Kordovës, për të përkujtuar rënien e Kordovës, më datën 29.06.1236 sipas erës së re.

Dhe kjo, sipas asaj që thotë Ibni Kuzman El-Buluti, njëri nga organizatorët e "Qëndrimit të qetë", sepse "pushtimi i Kordovës në kujtesën (memorien) andaluziane" është "shembull historik i dhunës mbi një popull me forcë, mohim e civilizimit islam për 751 vjet dhe zëvendësim e tij me kulturë krishtere kashtale", dhe se "Qëndrimi i qetë" është përqendrim i lartë, për 24 orë, për hir të paqes dhe dialogut mes popujve, dhe argumentim se mendimi andaluzian, vazhdimisht, është mendim për paqe dhe bashkëpunim.

Ne andaluzianët, jemi të gatshëm për t'ia zgjatur dorën kujtdo grupi, apo race, apo feje, apo kulture, ashtu siç kemi qenë në shekujt e kaluar⁸⁶. Muslimanët i falën pesë kohët e namazit në grup (xhemat), në mes të rrugës, që nga mbrëmja e ditës 29.06.1987.

Në muajin korrik 1987, shoqëria e ndërtimit shembi afro gjashtëdhjetë metra nga muri i pjesës së vjetër të qytetit, të cilin e kishin ndërtuar El-Muwahidun-ët në shekullin e dymbëdhjetë të erës së re. "Partia Çlirimtare e Andaluzisë" paraqiti një ankesë për vepër penale, kundër atyre që e shkatërruan murin dhe kërkoi dorëheqjen e përgjegjësve teknikë në Asamblenë Komunale, të cilët

⁸⁶ "LiberacionAndaluza Considera que el Europeismo es una concepcion Nefasta de la Vida", Diario, 28.05.1987.

dhanë leje për shembje. Partia kërkoi që të vendosen masa ndëshkuese, të bëhet kompensimi për të dëmtuarit, nga ana e qytetarëve të Kordovës, të cilëve iu dëmtuan pasuritë materiale dhe historike. "Xhemati" vendosi që të kundërshtojë kremtimin e përvjetorëve përkujtues të rënies (pushtimit) së qyteteve andaluziane, në duart e të krishterëve. Kjo ndodhi, edhe pas përvjetorit të rënies së Kordovës, me datën 19.08 1987.

"Xhemati" e kundërshtoi kremtimin e përvjetorit të rënies së qytetit të Mallagës në duart e krishterëve, dhe parashtroi pyetjen: Si ia lejon vetes prefekti i qytetit, Pedro Abrisio, që të ulet krenar në kremtimin e 500 vjetorit të masakrimit të njëzetmijë mallagasve, të cilët u masakruan nga ushtria krishtere e kashtalëve? "Xhemati Islam", në një pamflet që e shpërndau në opinion, bëri krahasimin e veprimit të prefektit në këtë mënyrë: ky veprim ishte njëlloj sikur populli i Pacifikut të detyrohej t'a kremtonte eksplodimin e bombës Gornika, ose populli i Katalanies t'a kremtojë ditën e 11 shtatorit, ditë kjo e kobshme, që i mundësoi dy mbretërve katolikë, që të hyjnë dhe t'a pushtojnë qytetin e Mallagës, pas një kohe të gjatë të shpartallimit ekonomik dhe kulturor". Në pamfletin i vet, "Xhemati" citon se "kremtimi i rënies së Mallagës, nuk mund të kuptohet ndryshe, përveçse si fyrrje (sharje) e rëndë për popullin e Mallagës dhe provokim për të⁸⁷".

Edhe "Partia e Unionit Majtist", e përkrahu qëndrimin islam, dhe shpalli se "ky kremtim është kremtim i masakrës" dhe e sabotoi kremtimin. Më datën 23 nëntor 1987, ishte përvjetori i rënies së Seviljes. Me këtë rast, "Xhemati" demonstroi me metodën e vetë, duke kënduar himnin kombëtar të Andaluzisë. Muslimanët u përkrahën nga Partia Nacionale e Andaluzisë, nga Unioni Majtist dhe nga Komitetet e punëtorëve⁸⁸. Muslimanët deklaruan se

⁸⁷ Francisco Acedo, "Malaga Afronte su Pasado desde la Feria", La Vanguardia, 30.08.1987

⁸⁸ Jose Bejarano, "Los Nacionalistas Interrumpen un Acto en la Catedral de Sevilla", La Vanguardia, 03.11.1987.

ishte turp i madh, që në këto kremtime të marrin pjesë personalitete andaluziane, të cilat ishin veprime ushtarake katolike që kremtohen për masakrën e bërë mbi popullin e Seviljes⁸⁹".

Më datën 04 dhjetor 1987, në ditën e përvjetorit të "Ditës së Andaluzisë", "Partia Çlirimtare e Andaluzisë" dhe "Xhemati Islam në Andaluzi" organizuan një protestë paqësore në Kordovë⁹⁰. Protestuesit u mbledhën në "Sheshin Koloni", në orën dymbëdhjetë të mesditës dhe duke bartur në duar flamuj andaluzianë morën drejtimin e Xhamisë së Madhe. Ata u përkrahën nga "Sindikatat Andaluziane të Punëtorëve" dhe organizata të tjera. Me këtë veprim, "Xhemati" arriti të bëhet udhëheqës (lider) i lëvizjes kombëtare të Andalozisë.

Pas kësaj proteste, ndodhi përplasja mes Rozhe Garodi-t dhe "Xhematit Islam në Andaluzi". Garodi i preferoi Abdurrahman Medina-s që, ose të mbetet në Xhemat, ose Drejtor i muzeut "Kështjella e Lirë". Garodi i shkruajti një letër Abdurrahmanit, nga i cili kërkoi dorëheqje, duke thënë: "Mua po më duket se është kontradiktore të jesh, në të njëjtën kohë, edhe krytar i partisë politike (që faktikisht nuk ishte), edhe kryetar i një Asosacioni (institucioni) fetar (që gjithashtu nuk ishte), si edhe kryetar i një Qendre Kombëtare. Të gjitha këto, bëjnë që parimet të shndërrohen botërisht në një mashtrim, pluhur syve. Për këtë arsye, kërkoj që të japësh dorëheqje, jo për shkaqe profesionale, por për shkakun e vetëm, se puna si kryesues i tre institucioneve, përplaset me qëllimet (synimet) e "Kështjellës së lirë".

Abdurrahman Medina refuzoi të largohej nga "Xhemati", dhe Garodi e shkarkoi nga posti i drejtorit të Muzeut, me datën 21.12.1987, dhe në vend të tij emëroi

⁸⁹ "El Aumentamiento Conmemoro Ayer la Conquista de la Ciudad", El Correo de la Andalucia, 24.11.1987.

⁹⁰ "Liberacion Andaluza Convoca en Cordoba una Manifestacion", Nuevo Diario, 05.12.1987.

një ish murg, i cili s'kishte kurrëfarë lidhje me Andaluzinë dhe historinë e saj.

Gazeta shkruante: Se ngjarjet filluan më datën 03.12.1987, në selinë komunale të Kordovës, kur përfaqësuesit e "Ligës nacionale" (Partia djathtiste) dhe të "Partisë Socialiste Punëtore unike" (në pushtet), u kërcënuan se do t'a anulojnë marrëveshjen, nga e cila Garodi fitoi të drejtën e shfytëzimit të "Kështjellës së Lirë", duke thënë se shkak ishte se ekzistonte mendimi i veçantë për historinë, në të cilën i jepej rëndësi e jashtëzakonshme Islamit, në llogari të krishterizmit dhe ebreizmit⁹¹.

Garodi e shpëtoi projektin, me rastin e shkarkimit të Abdurrahman Medina-s, i cili pas shkarkimit deklaroi: "Unë u shkarkova për shkak të refuzimit tim, dhe jo për shkaqe joprofesionale, u largova për shkak se jam anëtar në "Xhematin Islam", duke u kthyer kështu, në kohën e gjutisë së shtrigave dhe në ditët e gjykatave të bastisjes, dhe u desh që unë të jem dashi i kurbanit". Në muze paraqitën dorëheqjen e tyre punëtorët muslimanë⁹², ndërsa muslimanët e Kordovës dolën në protesta kundër Garodit⁹³, e akuzuan për tradhëtimin e muslimanëve andaluzianë⁹⁴, dhe e ndoqën nëpërmjet gjykatës⁹⁵.

Në gjygj kërkonin të drejtat e Abdurrahman Medina-s, por pas pak kohe, situata u qetësua, dhe secila palë ndoqi rrugën e vet. Mirëpo, në anën tjetër, kriza "e Xhematit" me Garodin, nuk i pengoi aktivitetet. Më datën 02 janar

⁹¹ Carmen Garijo, "Cesado Antonio Medina Como Conservador de la Torre de la Calahorra", Nuevo Diario, 22.12.1987.

⁹² Juan M.Niza, "Los Empleados de la Torre de la Calahorra Presentan su Dimision", Diario Cordoba, 24.12.1987.

⁹³ "El Colectivo Musulman Cordobes Tacha de Traidor a Garaudy", Nuevo Diario, 18.01.1988.

⁹⁴ Maria Olemo, "La Yamaa Islamica Acusa a Garaudy de Traicionar a Los Musulmanes Andaluces", Cordoba, 18.01.1988.

⁹⁵ C.Aumente, "Abderrahman Medina Reclama su Puesto de Trabajo Como tecnico en la Calahorre"

1988, muslimanët kundërshtuan kremtimin e përvjetorit të rënies së Granadës. Ata protestuan kundër kremtimit⁹⁶, për të cilin kisha dhe qeveria insistonin që t'a kremtonin edhe përkundër opozitës së "Xhematit".

Më 23 janar 1988, qeveria lokale e Andaluzisë, shpalli se "Institucioni Islam në Andaluzi", është institucion që mbron interesat e përgjithshme të shoqërisë.

Në shkurt të vitit 1988, "Xhemati" filloi të dërgojë studentë për të studiuar fenë Islame dhe gjuhën arabe në vendet islame. Grupi i parë, i përbërë prej pesë studentëve, u dërgua në Universitetin e Jordanisë, për dy vite e gjysmë, dy prej tyre ishin nga Kordova, një nga Morsei, një nga Sherishi dhe një nga Sevilja. Ky program u zgjerua, derisa numri i studentëve, të cilët u dërguan në disa vende islame arabe dhe jo arabe, arriti përafërsisht në katërdhjetë⁹⁷.

Në fillim të vitit 1988, përveç asaj që theksuam, "Xhemati" organizoi edhe disa protesta në qytetet e Andaluzisë, në përkrahje të 'Intifadës' (kryengritjes palestineze). Me datën 21.03.1988, u organizua një ceremoni festive "Në pallatin e rinisë", në qytetin Almuriye, ku morën pjesë me mijëra të rinj të këtij qyteti. U lexuan kumtesa dhe u mbajtën ligjërata e predikime⁹⁸.

Gjatë periudhës kohore, prej 15-22.04.1988, u organizuan protesta në qendrën kulturore "Huan 23" në Kordovë, gjatë një jave të plotë, ku morën pjesë mijëra persona⁹⁹. Ky aktivitet u pasua me hapjen e qendrës së re islame për xhematin, në Almuriye, që u radhit si qendra e shtatë me radhë.

⁹⁶ "Independentistas Andaluces Alteraron la Conmemoracion de la Toma de Granada", Ideal, 03.01.1988.

⁹⁷ Fejsal Shebul, "Populli u bën pritje studentëve nga Spanja. Në Universitetin e Jordanisë shpallin Islamin e tyre", gazeta jordaneze "Shaab", 13.02.1988

⁹⁸ "Hoy Acto Publico en Apoyo a la OLP", Ideal, 21.03.1988.

⁹⁹ "Manifestacion en Solidaridad con el Pueblo Palestion", Nuevo Diario, 16.04.1988.

Në prill të vitit 1988, "Xhemati" dhe "Partia Çlirimtare e Andaluzisë", morën pjesë në Kordovë, në protestat kundër varrimit të mbeturinave nukleare në zonën e "Alkebrilit", në krahinën e Kordovës¹⁰⁰.

Më datën 29.06.1988, që ishte përvjetori i rënies së Kordovës, "Xhemati" kërkoi prej Antonio Anfonso Florido, peshkopit të Kordovës, që të thirret ezani, të falet akshami dhe të mbahet ligjëratë predikuese, në Xhaminë e Madhe¹⁰¹. Peshkopi refuzoi¹⁰², me argumentimin se "nuk ka mundësi të lejojë që të bëhen lutje jokrishtere në Katedralen Katolike". Mirëpo "Xhemati" vërejti qartë se vendimi i peshkopit ishte marrë me forcë dhe provokim, dhe vendosi që t'a falë namazin, në rrugën përballë xhamisë¹⁰³, më të njëjtën datë që është shkruar më lartë.

Brenda një jave, nga 15 deri 22 qershor 1988, grupi i muslimanëve të Ishullit të Gjelbërt, ndërmorrën aktivitetin e tyre të parë në fushën e andaluzizmit, që ishte mbajtja e panairit "Me zë dhe shikim rreth qytetit Alzahar, historia dhe monumentet e tij"¹⁰⁴. Me këtë aktivitet, Qendra Islame në Ishullin e Gjelbërt, filloi serinë e aktiviteteve kulturore të rëndësishme.

Në këtë mënyrë, "Xhemati Islam në Andaluzi" u dha një larmishmëri të plotë aktiviteteve, duke i orientuar në fusha të ndryshme. Ai filloi të mendojë se si t'i forcojë marrëdhëniet jashtë dhe brenda Spanjës. Sa i përket marrëdhënieve të jashtme, të krijojë marrëdhënie vëllazërore me shoqatat islame në përgjithësi, ndërsa sa i përket brenda Andaluzisë, të krijojë bashkëpunimin e

¹⁰⁰ Sebastian Cuevas, "Quinientas Personas se Manifestaron Ayer Contra El Cementerio Nuclear de El Cabril", Diario-16, 10.04.1988.

¹⁰¹ Sebastian Cuan, "Musulmanes Piden la Mezquita para Conmemorar su Derrota", Diario-16, 18.06.1988.

¹⁰² "El Obispo no Accede a la Peticion de la Comunidad Islamica", Nuevo Diario, 28.06.1988.

¹⁰³ "Musulmanes Oran Frente la Mezquita", Nuevo Diario, 30.06.1988.

¹⁰⁴ "Clausurada Exposicion sobre Medina Azahara", Diario-16, 23.06.1988.

duhur me faktorët e rëndësishëm, në përgjithësi, dhe në veçanti, me shoqatat islame.

"Xhemati", po ashtu, filloi të mendojë rreth formimit të qendrave hulumtuese dhe botimit të revistave. Në të njëjtën kohë, i kushtoi kujdes forcimit të radhëve të veta, që mos t'i lejojë askujt, që t'a dëmtojë unitetin që mbretëronte në "Xhemat".

Marrëdhëniet me andaluzianët e shpërndarë

Nga gjysma e dytë e vitit 1988, "Xhemati Islam në Andaluzi", mori vendim, që të krijojë marrëdhënie të mira me andaluzianët e shpërndarë, e në veçanti me ata, që jetojnë në Afrikë dhe në Amerikën Latine. Më datën 14. 07. 1988, "Xhemati", ftoi Ismail bin Uthman bin Bereke, nga fisi 'El Anma', fis, i cili lidhet ngushtë me ushtrinë marokene në Andaluzi, me luftën e popullit Timbekto, nën komandën e andaluzianit Xhuder, në shekullin e shtatëmbëdhjetë të erës së re.

Zotëri Ismaili, u ftua që të mbajë disa ligjërata, në Qendrën Islame të Kordovës. Në ligjërata prezantoi një masë e madhe e qytetarëve të Kordovës. Ismail Uthman është një hulumtues i njohur në Qendrën 'Ahmed Baba', për studime Timbekto, në Mali. Në Andaluzi, kishte ardhur me ftesën e "Shoqatës për Studime Ndërkombëtare" dhe të "Shoqatës Kulturore 2020", të cilat ishin të kujdesshme që të përfitojnë nga njohuritë e tij, për të studiuar ndikimin andaluzian në botën arabe dhe afrikane¹⁰⁵. Zotëri Ismaili, së bashku me autorin (e këtij libri), morën pjesë në kremtimin e Kurban Bajramit, në Kordovë.

Në ceremoni, morën pjesë edhe një numër i madh muslimanësh të Kordovës, numri i të cilëve ishte mbi

¹⁰⁵ "El Primer Ejercito que Atravesco El Sahara era de Origen Andalusi", Nuevo Diario, 15. 07. 1988.

shtatëdhjetë¹⁰⁶. Pastaj zotëri Ismaili, si hulumtues, u bashkangjit në “Institutin Islam dhe Andaluzian”, që i përkiste “Xhematit Islam në Andaluzi”.

Më datën 03. 08. 1988, komuna Kastale (krahina Kadis), organizoi një ceremoni nderi, në nderim të prindit (babait) të autorit (të këtij libri), hoxhës Muhamed El-Muntasir El-Kittani, me emrin e të cilit, u emërua rruga kryesore e qendrës komunale, dhe rruga, tani, quhet “El-Muntasir El Kitani”. Ky nder iu bë për meritat, që hoxha kishte në shërbimin që i ka ofruar xhematit islam në Andaluzi, si dhe për ndihmën që ka dhënë, në tërësi për andaluzianët, për kthimin e personalitetit të tyre, identitetit dhe civilizimit andaluzian¹⁰⁷”.

Kuvendi komunal i dorëzoi autorit, në emër të babait të tij, si përfaqësues i babait, një letër zyrtare, në të cilën thuhej: “Kuvendi e ka marrë këtë vendim, si mirënjohje për dashurinë dhe ndihmën, që profesor Kittani ka treguar për Andaluzinë”. Autori (i librit) e zëvendësoi babain e tij edhe në Kastale, sepse babai i tij, nuk mundi të merrte pjesë, për shkaqe shëndetsore. Në pritje, mori pjesë edhe Kuvendi Komunal, i kryesuar nga Antonio Gonzales, kryetar i kuvendit dhe prefekti i Kastelës. Në pritje ishte edhe vëllai i prefektit, Muhamed Alzemzemi, dhe një numër i konsiderueshëm andaluzianësh.

Prefekti i qytetit organizoi një kremtë festive dhe shtroi drekë për mysafirët e nderuar, në njërin nga hotelet më të mirë të qytezës, duke e konsideruar këtë ditë, si ditë feste për qytezën e tyre. Në të vërtetë, ky nderim kaq i madh, ishte nderim për “Xhematin Islam në Andaluzi”, që tregoi kujdes të madh për t’a çmuar veprën e të atit të autorit të librit, i cili që në fillim kishte dhënë këshilla dhe e kishte inkurajuar “Xhematin”, qysh prej fillimit të aktiviteteve të tij.

¹⁰⁶ Sole Guinea, “En Cordoba ,tembien se Esta Celebrando la Fiesta Del Cordero”, Cordoba, 26. 07. 1988.

¹⁰⁷ “El Ayntamiento Aprueba Conceder el Nombre el Nombre de Muntaser Kettani a una Calle”, Diario de Cadis, 04. 08. 1988.

Gjatë periudhës kohore 16-21. 08 1988, Qendra Islame e Ishullit të Gjelbërt, që i përkiste "Xhematit", organizoi javën kulturore andaluziane, në qytetin fqinjë¹⁰⁸, ku morën pjesë grupe andaluzianësh nga Andaluzia dhe Maroku, dhe u ekspozuan edhe punime të arkitekturës dhe kuzhinës andaluziane. Në rastin e hapjes së këtij manifestimi, prezantoi edhe Antonio Rovez, prefekti i qytetit Tarifa, dhe së bashku me të, edhe prefekti i qytetit Sebte dhe i qyteteve të tjera, që kufizohen me komunën e Ishullit të Gjelbërt.

Me datën 23.11.1988, muslimanët e "Xhematit", dolën në protesta për të protestuar kundër krenimit të rënies së Seviljes në duart e të krishterëve, të komanduar nga Fernando i III-të, mbreti i Kashtalës në atë kohë. Protestuesit e shpallën këtë krenim si: "Vepër antimorale dhe fyerje për Seviljen dhe qytetarët e saj" dhe se "kisha dhe komuna me këtë krenim, po e fyejnë historinë tonë, të banorëve të Seviljes dhe të mbarë andaluzianëve, e sidomos kur dihej se me krenimin e këtij rasti, po nderohej një mbret kriminel, i cili e pushtoi Seviljen, me forcë dhe me dhunë, dhe që i detyroi shumë nga qytetarët e atëhershëm të Seviljes, që të emigrojnë, pasi i nxorri me dhunë nga shtëpitë dhe qyteti i tyre¹⁰⁹.

Në fillim të dhjetorit, nëpërmjet qendrës së vet islame në qytetin Morsei, "Xhemati", mori pjesë në tribunën e dialogut ndërfeetar mes besimeve spanjolle, tribunë, të cilën e organizoi gazeta "Abnijn" Almorsie.

Në tribunë morën pjesë përfaqësues nga "Xhemati Islam në Andaluzi", përfaqësues nga sekte të ndryshme krishtere, nga "Kisha Katolike", nga "Kisha Kristo", dhe nga "Kisha Angelika Almaamdanije¹¹⁰".

¹⁰⁸ Isidoro Jimenez, "Finaliza Hoy la Primera Semana Andalusi de Tarifa", El Pais, 21. 08. 1988.

¹⁰⁹ "El Ayuntamiento Conmemora Hoy la Conquista de Sevilla", Cordoba, 23. 11. 1988.

¹¹⁰ "Un Obispo, Tres Pastores y Un Musulman", La Opinion de Murcia, 03.12.1988.

Më datën 04.12.1988, muslimanët kremtuan “Ditën e Andaluzisë”, sipas metodës së tyre, duke protestuar të mbledhur në Sheshin Kolon, në Kordovë. Në një moment, turma e tyre buçiti dhe u nis në drejtim të Xhamisë së Madhe. Aty, u lexua deklarata me titull: “Për hir të lirisë sate Andaluzi!”. Në protestë morën pjesë me qindra muslimanë dhe përkrahës të tjerë jomuslimanë andaluzianë. Protestuesit kërkuan që të largohen patjetër, bazat ushtarake amerikane nga territori i Andaluzisë, në Morur dhe Rota, dhe kërkuan gjithashtu edhe çlirimin e Xhebelu Tarik-ut (Gjibraltarit)¹¹¹. Në fund të protesatve, protestuesit ngritën zërin e tyre edhe kundër prezencës së forcave spanjolle në Andaluzi dhe kërkuan largimin e tyre¹¹².

Në fund të dhjetorit, “Xhemati”, në kuadër të forcimit të marrëdhënieve me andaluzianët e shpërndarë, apo të shpërngulur nëpër vende të ndryshme të botës, ftoi për vizitë inxhinjerin e ri, me emrin Rridvan Bin Muhamed bin Mahmud Erreshiko, nga qyteza Sulejman në Tunizi, origjina e të cilit lidhej me Ebi Abdullah, mbreti i fundit musliman në Granadë¹¹³. Rridvani, qëndroi plot një muaj, në mikëpritjen e “Xhemati-it”. Gjatë kësaj kohe, ai vizitoi qendra të ndryshme islame dhe mbajti në to ligjërata, lidhur me emigrimin andaluzian në Tunizi.

Më datën 02. 01. 1989, “Xhemati” mori pjesë në kundërshtimin e kremtimit të rënies së Granadës dhe hyrjes në Pallatin ‘El-Hamra’. Ky kundërshtim u shpreh

¹¹¹ (Sqarim i përkthyesit lidhur me Gjibraltarin: Gjibraltari njihet si ngushtica dhe dalja perëndimore e Detit Mesdhe, me një sipërfaqe të ngushtë. Sot, Gjibraltari qëndron si koloni britaneze, në territorin e Spanjës. Përveç të tjerash, vlen të theksohet se emri i saktë, në gjuhën arabe, është “Xhebelu Tarik”, që do të thotë “Kodra e Tarikut”. Tariku është Tarik bin Zijad, çliruesi musliman i Andaluzisë)

¹¹² Maria Victoria Madrid, “Liberacion Andaluza Celebro el Dia de la Patria Andalusi”, Nuevo Diario, 05.12.1988.

¹¹³ Jesus Cabrea, “Un Descendiente de Boabdil Recorre Andalucía Buscando su Identidad”, Nuevo Diario, 20.12.1988.

me anë të protestës së organizuar, në të cilën u ngritën flamujtë e Andaluzisë. Në krye të protestuesve, ishte “Xhemati Andaluzian”. Kjo protestë, në të njëjtën kohë, paraqiste në mënyrë simbolike, kthimin e pallatit ‘El-Hamra’.

Që nga viti 1988, “Xhemati “ kishte filluar të mendonte rreth organizimit të një “Samiti Botëror Andaluzian Islam”, në të cilin do t’i mblidhte të gjithë andaluzianët e shpërndarë anekënd botës dhe, së bashku, me muslimanët e Andaluzisë, t’a mbante kuvendin në tokën e Andaluzisë, me qëllim që ky samit të ishte një rast i volitshëm, për të filluar bashkëpunimi mes atyre, që kishin mbetur në Andaluzi dhe ishin kthyer në Islam dhe atyre, rrënjët e të cilëve ishin shkukur nga vendi dhe ishin dëbuar e shpërndarë nëpër vende të ndryshme të botës, por që megjithatë, Andaluzia kishte mbetur e gjallë në personalitetin dhe zemrat e tyre. Më datën 25.01.1989, në faqet e gazetave spanjolle, u shpall zyrtarisht vendimi për mbajtjen e Samitit¹¹⁴.

Gjatë periudhës, prej 01 deri 03 shtator 1989, në qytezën Kastile (regjioni i Kadis-it), u formua komisioni për organizimin e Samitit¹¹⁵, nën udhëheqjen e Muhamed Ramirez Ferexh. Zotëri Muhamed Ramirez, mbajti një konferencë për shtyp, tek “Xhemati” i Ishullit të Gjelbërt (Islaverde), me datën 10.03.1989. Konferenca, u mbajt në njërin nga hotelet më të mëdha të Islaverde-s. Aty, ai ua bëri të qartë gazetarëve, qëllimet apo synimet e Samitit dhe rëndsinë e tij¹¹⁶, gjest, i cili pati një ndikim shumë pozitiv tek shtypi spanjoll. Reagimet pozitive të shtypit

¹¹⁴ Juan Enrique Gomez, “Ridwan Rachico, Descendiente de Boabdil, Tremolo la Bandera de Alo Andalus desde la Torre de la Alhambra” Ideal (Granda), 03.01.1989.

¹¹⁵ “Se Celebrara el I Congreso Mundial Andalusi que Tendra Como Sede Castellar”, ARES, 25.01.1989.

¹¹⁶ “Presentabo en Algeciras el I Congreso Mundial Andalusi”, Sur, 13.03.1989.

spanjoll, i përseriti edhe shtypi maroken në gjuhën franceze¹¹⁷.

Gjatë dy viteve, 1988-1989, Qeveria e Spanjës e angazhoi “Xhematin”, që të merrej me arsimimin e të papunëve dhe aftësimin e tyre. Në këtë mënyrë, “Xhemati” e organizoi vetveten dhe arriti që t’iu ofrojë arsimim adekuat, qindra personave, me investim nga shteti. Mësimet u organizuan nëpër qendrat e “Xhematit”, në Sevilje, Kordovë, Malagë, Mursie dhe Islaverde, në specialitete dhe sfera të ndryshme, midis të cilave edhe mësimi i gjuhës arabe, si një nga gjuhët kombëtare të Spanjës, e në veçanti, si gjuhë e vjetër e Andaluzisë.

Më datën 19.06.1989, “Partia Çlirimtare Andaluziane”, mori pjesë në zgjedhjet evropiane. Ajo fitoi vetëm 9.419 vota në të gjithë Spanjën, 462 vota më pak, se në zgjedhjet e vitit 1987. Prej numrit të përgjithshëm të votave, në Andaluzi u fituan 2216 vota, në Kasteloni 1999 vota dhe 5204 vota, në pjesët e ndryshme të Spanjës. Nga ky rezultat, dolën të pakënaqur edhe “Xhemati” edhe “Partia Çlirimtare Andaluziane”.

Kuvendi i “Xhematit”, pas kësaj pakënaqësie, u mbledh në Ishullin e Gjellbërt (Islaverde), ditën e shtunë, më datën 15.07.1989, dhe studioi dobhtë e aktivitetit politik në kohën aktuale, duke i bërë një analizë të thellë dhe duke i dhënë rastin secilit, që të shprehet në mënyrë të barabartë. Shumica, ishin të mendimit se, “Partia Çlirimtare Andaluziane” u formua me qëllim që, sa më shumë andaluzianë, të njihen me parimet islame dhe me identitetin andaluzian, gjë që, sipas vlerësimeve të zgjedhjeve të fundit, rezultoi se numri i simpatizantëve, që ishin bindur me këto ide, nuk ishte rritur aspak, e në anën tjetër, numri i armiqve të “Xhematit”, për shkak të aktivitetit politik, kishte shkuar në rritje.

Nga kjo, u vërejt qartë se “Partia”, për momentin ishte e dëmshme dhe patjetër duhej të merreshin masa.

¹¹⁷ “La Diaspora Andaluse S’Organise”, Le Matin du Sahara, 14.03.1989.

”Xhemati” vendosi që të kërkojë nga “Partia”, që t’a suprimojë vetveten dhe vërtet, ashtu ndodhi. Me shumicë votash, u aprovua vendimi për suprimimin e “Partisë Çlirimtare Andaluziane”¹¹⁸. ”Xhemati”, në të njëjtën kohë, vendosi që të bashkëpunojë me të gjitha partitë, që tregojnë simpati për popullin andaluzian, për idnetitetin andaluzian dhe për parimet islame.

Më datën 14.07.1989, “Komisioni Këshillues për Lirinë e Religjioneve”, e njohu zyrtarisht Fenë Islame si religjion, që ka rrënjë të thella dhe lidhje të ngushta me Spanjën, që do të thotë, se kjo njohje e Fesë Islame për herë të parë, që nga rënia e Granadës, para 497 viteve, dhe dëbimit të përgjithshëm të muslimanëve, para plotë 380 viteve¹¹⁹, iu mundësoi muslimanëve që të gëzojnë të njëjtat përkrahje, siç i gëzojnë edhe pjestarët e feve të tjera, si: katolikët, protestanët dhe ebrejtë, por me kusht, që të gjitha xhematet ose grupet muslimane të Spanjës, të bashkohen në një federatë të vetme, ashtu që qeveria, në relacion me muslimanët, t’i drejtohet një zëri të vetëm.

Në të njëjtin muaj, “Xhemati” formoi në Kordovë një qendër për studime andaluziane dhe nxori nga shtypi revistën “Lam Elif”, që ishte një revistë shkencore islame. Aty trajtoheshin tema të nivelit të lartë, paraqiteshin tema në gjuhën spanjolle lidhur me kërkime të ndryshme andaluziane-islame, tema me shumë interes për aktualitetin dhe historinë, tema që trajtonin patjetër, çështjen e identitetit andaluzian.

Kryeredaktor i revistës ishte Abdurrahman Medina Molire, drejtor për botime ishte Abdurrahman Muhamed Meanan Al-Habsavi. “Xhemati” nxori nga botimi, tre numra, deri në vitin 1990. Për secilin numër, nxori në treg një tirazh prej 5.000 kopjesh.

¹¹⁸ “El Partido Liberacion andaluza Anuncia su Disolucion por Problemas Economicos y de Falta de Apoyo”, Diario de Cadiz, 19.07.1989.

¹¹⁹ “La Comision de Libertal Religiosa Reconoce Oficialmente la Confesion musulmana”, El-Pais, 15.07.1989.

Në fillim të gushtit të vitit 1989, qendrën e “Xhematit”, në Ishullin e Gjellbërt (Islaverda), në Sherish (Jerez), në Sevilje, në Kordovë dhe në Malagë, e vizitoi një delegacion i përbërë nga: Prof. Kamil Selame Dekus, zëvendësi i sekretarit të përgjithshëm të Ligës (Rrabitas) së Botës Islame, Halil Muhamed Hamed, sekretari i përgjithshëm i Entit Humanitar Islam në Kuvajt, Prof. Muhamed Umer Xhemxhum, profesor në Universitetin ‘Mbreti Abdul Aziz’, në Xhidde, dhe Hamid Errifai, këshilltar në Ligën e Botës Islame¹²⁰.

Ditën e xhuma, në datën 01.09.1989, u hap “Samiti i Parë Andaluzian”, në selinë e Almeries, në qytezën Kastile (Krahina e Kadis-it). Samiti u hap me leximin e ajeteve fisnike, nga Kur’ani madhështor, e pastaj pasoi hymni kombëtar i Andaluzisë, në prezencën e Antonio Gonzales Espinoza, kryetar i Komunës së Kastiles, Antonio Roviz Haminis, kryetar i Komunës së Tarifit, Muhamed Ramirez Ferexh, kryetar i Komisionit Organizativ të Samitit, Abdurrahman Muhammed Meanan Al-Hibsavi, kryetar i Kuvendit të “Xhematit Islam në Andaluzi”.

Në Samit, morën pjesë edhe mbi 200 personalitete, nga komuniteti i shpërndarë andaluzian anekënd botës, prej të cilëve, vlen të dallohet Dr. Abdul Kerim Kerim, përfaqësues i shoqatës “Vargonjtë e Lirisë (triumfit)” dhe familja e tij, shkrimtari me familjen e tij, andaluzianë nga Tunizia, në krye të të cilëve qëndronte Rridvan Al-Rreshiko, pastaj edhe nga Algjeria, Meksika, Turqia dhe vende të tjera. Samitin e ndoqën, nga afër, mbi 30 gazetarë, nga shtete të ndryshme. Pjesëmarrësit e Samitit, gjatë tërë kohës, qëndruar në qendrën ‘Almerije’. Aty u falën pesë kohët e namazit me xhemat, në faltoren (xhaminë) që ishte punuar apostafat për raste të tilla.

Pas ceremonisë së hapjes, Abdurrahman Menana u shprehu mirëseardhje të pranishmive, e pastaj u prezentuan kryesuesit e delegacioneve, secili në emër të

¹²⁰ “Una Deleggacion de Arabia Saudi Visito el Castello de Guzman el Bueno”, Euro-a Sur, 02.08.1989.

shoqatës që përfaqësonte, duke filluar nga përfaqësuesi i Ligës së Botës Islame, me seli në Mekken e nderuar, pastaj "Vargonjtë e Çlirimit", me seli në Rribat të Marokut, Qendra e Studimeve Islame në Morbella, Fakulteti i Shkencave Islame në Stamboll, Xhamia e Parisit në Francë, Shoqata Kulturore Islame me seli në Tatvan, dhe shumë shoqata të tjera.

Në seancën e parë të Samitit, zotëri Abdurrahman Medina, paraqiti një temë shkencore, lidhur me rrënjët andaluziane dhe historinë e Andaluzisë. Pas tij, zotëri Francisko Sanço Rovano, paraqiti temën që kishte të bënte me andaluzianët në Ishullin Afriq.

I fundit, që paraqiti temën e tij në seancën e parë, ishte Haxhudin Sari El-Guthi (algjerian nga Franca), i cili paraqiti një temë lidhur me Misticizmin në Andaluzi. Pas seancës së parë, u fal namazi i xhumasë i udhëhequr nga imami Abdurrahman Meanan. Në seancën e dytë, autori (i këtij libri) mbajti një temë lidhur me rrënjët islame të nacionalitetit andaluzian bashkëkohor, gjithashtu profesor Muhamed bin Shakrun (nga Kazablanka), paraqiti punimin e tij rreth letërsisë andaluziane.

Pas këtyre temave u zhvillua një debat. Pas debatit, pjesëmarrësit e Samitit, udhëtuan për në qytezën Tarif. Atje falën namazin e akshamit, në një shesh publik të qytezës, pastaj u pritën nga kryetari i Komunës dhe Asambleja Komunale, të cilët u shprehën mirëseardhje mysafirëve. Mikpritje e ngrohtë, atyre iu bë edhe në "Shkollën e Evropës Jugore për Arte", shkollë në të cilën, drejtori i saj Harun Kumes Di Ablanida (anëtar i Xhematit), shtroi një darkë të mrekullueshme¹²¹.

Ditën e shtunë, u mbajt seanca e tretë dhe e katërt e Samitit, me ligjerimet e: Prof. Idris bin Muhamed bin Xheafer El-Kitani, lidhur me kulturën andaluziane, ligjërata e dytë u mbajt nga Karlos Buskamon, për monumentet arkeologjike andaluziane, ligjërata e tretë

¹²¹ Ana Rosa Jaragua, "Numeros Personalidades de la Cultura Islamica se Dieron Cita en la Jarandila", Europa Sur, 02.09.1989.

nga hoxha Ulal El-Beshir, rreth aktualitetit andaluzian. Ligjëratën e katërt me radhë, e mbajti Rridvan Al-Rreshiku, për emigrimin e andaluzianëve në Tunizi, ligjëratën e pestë Prof. El-Me'mun El-Fasi El-Heri, për historinë e familjes andaluziane në Marok, ligjërata e gjashtë u mbajt nga Prof. Xhabir Kabulara, e shtata nga Prof. Xheafer bin Muhamed Ezemzemi El-Kittani, rreth shpërndarjes andaluziane, e teta ishte ligjërata e Sherif Sejidi Alij Errisuni nga Shefshauni, e nënta me radhë ishte e Prof. Ali Ozak, nga Universiteti i Stambollit.

Programi i Samitit, mori fund të tretën ditë me radhë, me vizitën e Kashrshit (regjioni i Malagës), përndryshe vendlindja e Blas Infantit. Të gjithë qytetarët e kësaj qyteze, me në krye prefektin e tyre, organizuan një ceremoni festive për mysafirët e tyre, pjesëmarrës të Samitit¹²².

Samiti u mbyll të dielën (ditën e tretë), me formimin e Komitetit Suprem të Andaluzisë, i cili grumbulloi brenda vetes andaluzianët e emigruar dhe qytetarët e Andaluzisë. U zgjodhën dy kryetarë, Muhamed Remirez Ferexh dhe autori (i këtij libri). Këtij Komiteti, iu caktua si mision, forcimi i kulturës andaluziane në emigracion, ruajtja e lidhjeve të ngushta farefisnore andaluziane dhe krijimi i lidhjeve të ngushta me vëllezërit e tyre në Andaluzi.

Gjithashtu, u vendos që, Samiti i dytë të mbahet në Rrabort, i treti në Sevilje¹²³ dhe që të formohet Universiteti Islam në Kordovë, gjë për të cilën, u formua Komiteti organizativ. Më datën 18.11.1989, Komiteti mbajti mbledhjen e parë, në selinë e "Xhematit", në Islaverde.

Samiti u pasqyrua shumë mirë nga mjetet e informacionit spanjoll, si nga televizioni, ashtu edhe nga radioja dhe shtypi. Kjo pati ndikim pozitiv, sidomos në regjionin e Andaluzisë. Po ashtu, Samiti u mbulua mjaft

¹²² Ana Rosa Jaragua, "El Congreso Mundial Andalusi Rindio Homenaje a Blas Infante", Europa Sur, 3.9.1989.

¹²³ Ana Rosa Jaragua, "Musulmanes y Andalusies Podran Integrarse en Consejo Internacional", Europa Sur, 04.09.1989.

mirë edhe nga informacioni Maroken¹²⁴. “Xhemati Islam në Andaluzi” kishte bërë përpjekjet maksimale, saqë edhe financimin e kishte bërë nga buxheti i vet, pa ndihmën e ndokujt tjetër.

Gjatë periudhës 03-05.1990, “Xhemati” organizoi, në qendrën e vet të Kordovës, një Simpozium për dialog ndërfeetar mes disa feve të Spanjës. Aty morën pjesë një numër i madh qytetarësh të Kordovës dhe ishte një rast shumë i mirë, për t’ua paraqitur pjesëmarrësve Islamin¹²⁵. Në këtë Simpozium, morën pjesë përfaqësuesit e feve krishtere, ebreje, budiste, brahmaniste dhe ziradeshtije.

Në korrik të vitit 1990, “Xhemati”, hapi qendrën e vet, të tetën me radhë, në qytetin Kabre, në jug të regjionit të Kordovës. Me datën 10.09.1990, “Xhemati”, bleu në rrugën ‘Roji Lopez’, nr. 17, në qytetin Sherish, një shtëpi me vlerë prej 12 milionë pezeta, me një sipërfaqe 380 m², me të drejtën e rindërtimit të një Qendreje Islame, në një pozitë të jashtëzakonshme, mu në qendër të qytetit historik andaluzian.

“Xhemati” vazhdoi, gjithashtu, dialogun me grupet e tjera islame në Spanjë, që të formonte ‘Federatën e Plotë të Muslimanëve të Spanjës’, ashtu që të luante një rol efektiv, për banorët e Andaluzisë.¹²⁶ “Xhemati” arriti që të merrte shtëpinë e shoqatës “Xhemati Islam i Kordovës” dhe i përfshiu anëtarët e saj në mesin e vet, por asnjëherë, nuk kishte qenë ky qëllimi, për fillimin e aktiviteteve islame në Kordovë.

Të gjitha këto që lexuam, flasin për përpjekjet madhështore që ka bërë “Xhemati Islam në Andaluzi”, gjatë dhjetë viteve të një pune intensive dhe të mundimshme, derisa arriti të bëhet xhemati (grupi) më i

¹²⁴ Javier Martinez, “La Fundacion Islam y Andalus de Algeciras Quiere Crear una Universidad”, Sur, 18.11.1989.

¹²⁵ Azis Yacoubi, “Un Succes au dela des Previsions”, Le Matin du Sahara, 14.09.1989.

¹²⁶ C. Aumente, “Representantes de Diez Religiones ha blan de la mistica en Cordoba”, Cordeoba, 04.05.1990.

rëndësishëm, nga të gjitha grupet e organizuara islame në Spanjë.

Të gjithë këtë, “Xhemati” e bëri pa ndonjë ndihmë, që vlen të theksohet nga bota islame, por përkundrazi u ballafaqua me probleme dhe pengesa nga shoqatat e emigrantëve arabë e muslimanë. Për “Xhematin”, ekziston shpresë e madhe, që t’a vazhdojë rrugën e tij, derisa Islami të bëhet përsëri, faktor i rëndësishëm dhe udhëheqës i jetës, në tokën e përvuajtur të Andaluzisë, me ndihmën e Allahut xh.sh.

Përmbajtja:

1.	Parathënja	5
2.	Hyrje	36
3.	Ngritja dhe rënja e shtetit Islam në Andaluzi (711-1492)	40
4.	Tiranizimi dhe krishterizimi i dhunshëm (1492-1568)	54
5.	Kronologjia e diskriminimit	62
6.	Reprezaljet dhe apartejdi (1570-1608)	65
7.	Deportimi masiv i muslimanëve nga Spanja (1608-1614)	70
8.	Muslimanët e mbetur në Spanjë gjatë shekujve 17-të dhe 18-të	78
9.	Formimi i kombit andaluzian gjatë shekujve 19-të dhe 20-të	88
10	Shoqatat islame të emigrantëve	99
11	Drejtimi Durkavije në Granadë	109
12	Shoqata Islame e Kordovës	119
13	Përpyjekjet për organizime të tjera në Andaluzi	130
14	Përpyjekjet organizative jashtë teritorit të Andaluzisë	138
15	Ditët e para në Sevilje	147
16	Nisma nga Sevilja	157

17	Rikthimi nga sëmundja e rëndë dhe nisma e re	168
18	Kthimi në Kordovë	178
19	Marrëdhëniet me andaluzianët e shpërndarë	189
20	Përmbajtja	202

Sikur të kthehen sërish mësimet e Kur'anit, atje do të ishte dita më e mirë, nga të gjitha ato që kaluan. Të ndierit e barës së përgjegjësise, me rikthim të planifikuar dhe të drejtë, ashtu siç thotë i Lartësuari:

*“Para jush kanë kaluar (shumë popuj) ligje. Udhëtoni nëpër botë dhe shihni...”*¹²⁷

Ky ajet na obligon të studiojmë ligjet, ato që janë kontradiktore, sepse ato shkaktojnë lëvizjet e jetës dhe gjallërimit. Me këto qeveriset, dhe krijohen lëvizje në shoqëri, po ashtu këto edhe bëhen shkak i rënieve dhe ngritjeve të popujve. Shpalosja e këtyre ligjeve, nuk vjen si rezultat i studimit të tanishëm, por ato vijnë nga shikimi i thellësishëm i historisë dhe vetë jetës së historisë së bashku. Prandaj, domosdoshmërisht të udhëtohet nëpër tokë për ta tejkaluar kohën e tashme, për ditët e së ardhmes. Ato nuk duhen të zgjerohen deri në atë masë, sa që periudha e një jete njeriu, mos të jetë në gjendje t'i zbatojë ato ligje, se ato i kthehen bumerang shoqërisë. Nuk përfitojmë asgjë, vetëm nga mësimet e kohës së tashme, nga mosudhëtimet nëpër popuj tjerë, nga tentimi i avullimit të historisë, duke mos ju përmbajtur komentimeve dhe analizave të qëndrueshme. Studimi i

¹²⁷ Kur'an, 3-Ali Imran 137

përvojave dhe i rezultateve pozitive është domosdoshmëri, në të kundërtën, i Lartësuarit na mëson: “...*shihni si ka qenë fundi i atyre që i kanë përgënjeshtruar...*”